



E DREJTA E JETËS - E DREJTA PËR ARSIM - LIRIA E SHPREHJES - TË DREJTAT E PERSONAVE TË PRIVUAR NGA LIRIA - **RAPORTI** - NDIHMA JURIDIKE FALAS - RESPEKTIMI I TË DREJTAVE TË NJERIUT NGA ORGANET E ADMINISTRATËS SHTETËRORE - **VJETOR** - E DREJTA E PRONËS - RREGULLIMI I MARRËDHËNIEVE TË PUNËS - E DREJTA PËR NJË MJEDIS TË SHËNDETSHËM - MBROJTJA E KONSUMATORIT – **PËR** - RESPEKTIMI I TË DREJTAVE QË LIDHEN ME PUSHTETIN VENDOR - MBROJTJA DHE TË DREJTAT E FËMIJËS – **VEPRIMTARINË** - E DREJTA E FËMIJËS PËR MBROJTJE, MJEDIS FAMILJAR DHE PËRKUJDESJE ALTERNATIVE - TË DREJTAT **E** TË MITURVE NË KONFLIKT ME LIGJIN, VIKTIMA DHE/APO DËSHMITARË – **INSTITUCIONIT** - RESPEKTIMI I TË DREJTËS PËR KUJDES SHËNDETËSOR - RESPEKTIMI I TË DREJTËS PËR KUJDES SOCIAL - RESPEKTIMI I **TË** DREJTAVE TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR - BARAZIA GJINORE - TË DREJTAT E KOMUNITETIT LGBTIQ - TË DREJTAT E PERSONAVE TË MOSHUAR - **AVOKATIT** - E DREJTA E MINORITETEVE (PAKICAVE) KOMBËTARE - TË DREJTAT NË FUSHËN E SIGURIMEVE SHOQËRORE - MBROJTJA E GRAVE DHE VAJZAVE NGA DHUNA - E DREJTA PËR JETË FAMILJARE – **TË** - E DREJTA PËR NJË PROCËS TË RREGULLT LIGJOR – E DREJTA E INFORMIMIT – E DREJTA PËR PUNË - E DREJTA PËR TU MBROJTUR NGA DISKRIMINIMI - LIRIA E TUBIMEVE – **POPULLIT** - E DREJTA PËR TU MBROJTUR NGA USHTRIMI I TORTURËS - E DREJTA E DËMSHPËRBLIMIT PËR TË PËRNDJEKURIT - E DREJTA PËR TU ZGJEDHUR DHE PËR TË ZGJEDHUR – **VITI 2021**

PËRMBAJTJA

Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit	3
KREU I	6
Kudri ligjor dhe institucional	6
KREU II	9
Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2020 nga institucioni i Avokatit të Popullit	9
KREU III	19
Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike	19
3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2021	19
3.2 Të drejtat e personave të privuar nga liria.....	32
3.3 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit	38
3.4 Parandalimi i dhunës dhe torturës	47
3.5 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria	61
3.6 E drejta për një proces të rregullt ligjor	63
3.7 Ndihma juridike falas	68
3.8 Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist	70
3.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative.....	73
3.10 Respektimi i të drejtës së pronës.....	76
3.11 Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative.....	84
3.12 E drejta për një mjedis të shëndetshëm	86
3.13 Mbrojtja e konsumatorit.....	88
3.14 Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor	89
3.15 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës	93
3.16 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor	101
3.17 Respektimi i të drejtës për arsimim.....	106
3.18 Respektimi i të drejtës për kujdes social.....	109
3.19 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar.....	111
3.20 Barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGTBIQ	115
3.21 Respektimi i të drejtave të personave të moshuar	123
3.22 E drejta e minoriteteve (pakicave) kombëtare	125
3.23 Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore.....	129

3.24 Çështjet zgjedhore.....	131
KREU 4	138
Angazhime të tjera institucionale.....	138
4.1 Raport i Avokatit të Popullit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën Janar 2020-Shtator 2021”	138
4.2 Kërkesë e parashtruar nga Avokati i Popullit para Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e një dispozite ligjore, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.	145
4.3 Opinioni Amicus Curia, për padinë e paraqitur nga ana e paditëseve, A.A, E.M, H.M dhe A.M. në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	149
4.4 Kontributi i dhënë nga institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë procesit të Reformës në Drejtësi.....	157
4.5 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj si dhe operationet e.....	161
përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së.....	161
KREU 5	167
Bashkëpunimi	167
5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të	167
rekomandimeve të AP-së	167
5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar	172
5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve	174
5.4 Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij promovues	177
KREU 6	181
Shërbimet mbështetëse.....	181
6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative.....	181
6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet	185
KREU 7	192
Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre	192



Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit

Mbërrijmë në kohën e publikimit të këtij Raporti Vjetor të Avokatit të Popullit pas një tjetër viti të ashpër që vuri në sprovë shumëkënd. Pandemia globale e Covid-19 është pak të thuash se thjesht na e ka shndërruar mënyrën tonë të jetesës, të punës e të ndërveprimit.

Ndër shumë gjërave që pandemia u është imponuar në këto kohë të rënda, është edhe fokusi ynë. Kriza imediate e permanente duket se mëton ndër të tjera edhe t'i diktohet aftësisë sonë shoqërore për të evidentuar çështje të mëdha të së nesërme e midis emergjencës së aktualitetit, të arrijë të paralizojë veprimtarinë tonë planifikuese për të ardhmen.

Çështja ku do të doja të tërhiqja vëmendjen tuaj për këtë raport janë ndryshimet klimatike. Po. Është e vërtetë: jemi në një kohë luftërash, siç është ajo në Ukrainë, apo ajo me pandeminë globale që kërcënon jetën e

shumëkujt. Mirëpo këto nuk janë asgjë përpara rrezikut të mirëfilltë që vjen nga ndryshimet klimatike. Ato janë rrjedhojë e drejtpërdrejtë e pamundësisë sonë për të ndalur agresivitetin e industrializimit për hir të konsumizmit, shpyllëzimit masiv, ndotjes së pandalshme, shfrytëzimit barbar të rezervave ujore e tokësore, betonizimit të qyteteve e një mijë e një të zezave të tjera që ne njerëzit e botës së sotme po i bëjmë ekzaktësisht shtëpisë sonë të përbashkët, e të vetmes që kemi për sot e përgjithmonë: tokës.

Shumëkujt këtu në Shqipërinë e telasheve të mëdha e të përditshme, çështja mjedisore mund t'i tingëllojë në rastin më të mirë si një snobizëm e në më të keqin si një tallje.

Mirëpo Shqipëria nuk është një planet i veçuar nga Toka apo një satelit i saj. Ne nuk e kemi luksin të lemë asnjë çështje në hije pasi kemi nevojë për një ecje frontale përpara për të arritur objektivin e kthimit të Shqipërisë në një vend ku gjeneratat e ardhshme të shohin ambientin ku duan të jetojnë jo vetëm nga pikëpamja e lirive politike, shtetit të së drejtës, apo lirive ekonomike e sociale por edhe mjedisit.

Jo më kot, fëmijët dhe të drejtat e tyre, përfshi edhe ato për një të ardhme më të mirë, u bënë së fundi pjesë e Strategjisë së re 5-vjeçare të Këshillit të Europës për të Drejtat e Fëmijës.

Shqipëria ku do të lemë të jetojnë ata për të cilët pretendojmë se sakrifikojmë gjithçka, është një vend ku nuk do të donim të dënonim me internim as armikun më të egër. Nëse të gjithë në këtë moment nuk ndalim çfarë jemi duke bërë, për të nisur një ndryshim rrënjësor të mënyrë sonë të menduarit e të vepruarit me mjedisin në fokus, ajo që do të lemë pas është vetëm një shkretëtirë e pajetueshme.

Kriza globale e ndërlidhur me ndryshimin e klimës, degradimin e mjedisit, humbjen e biodiversitetit dhe ndotjen, çdo ditë shkelin të drejtat e panumërta të njerëzve dhe kërcënon gëzimin efektiv të të drejtave të njeriut për brezat e ardhshëm. Siç u pranua nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut në tetor të këtij viti, "çdokush, në çdo vend, ka të drejtën e tij për të jetuar në një mjedis të sigurt, të pastër, të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm".

Njohja e kësaj të drejte njerëzore është një progres historik dhe jep shpresë për të ardhmen e planetit. E drejta për një mjedis të shëndetshëm, duke përfshirë një klimë të sigurt dhe të qëndrueshme, në vetvete është një e drejtë e njeriut dhe bazë për një gamë të gjerë të të drejtave të tjera të njeriut, siç janë e drejta e jetës, e shëndetit, ushqimit, strehimit, ujit si dhe parimi i vetëvendosjes. Pa to, mbijetesa jonë është në rrezik.

Ne si institucione të të drejtave të njeriut duhet të luajmë rolin tonë në këtë luftë. Sigurisht, këndvështrimi ynë kryhet prej lentes së të drejtave të njeriut dhe krijimit të një sinergjie të nevojshme me organizatat e shoqërisë civile për të çuar përpara çështjet e të drejtave mjedisore. Ne duhet ta kuptojmë këtë rol. Të studiojmë çdo element të aksionit të përbashkët rigjallërues, të propozojmë ndryshimet e nevojshme kushtetuese apo ligjore, apo të interpretojmë kushtetutën tonë si një mekanizëm të gjallë i cili përmbledh esencën e kuptimit të dinjitetit njerëzor i cili s'mund kurrsesi të jetë një koncept i ngurtë e pa rrezatim.

PËRGJEGJËSIA PËR TË ARDHMEN është në fakt e para fjali deklarative që ne kemi në preambulën e kushtetutës sonë. Jetësimi i kësaj deklarate ka nevojë më shumë se kurrë sot për t'u bërë mënyrë të qeni e çdo politikëbërësi e opinion-bërësi!

Shqipëria, vendi ynë, ka pjesën e saj në këtë përpjekje globale. Çështjet mjedisore janë ende një periferi e vëmendjes sonë politike e asaj vendimmarrëse. Besoj se është rasti tani të themi se për vetë rëndësinë dhe emergjencën e gjendjes, është e papranueshme që problemet e mjedisit të konsiderohen thjesht si "punë e ministrisë së mjedisit", e që kjo punë të kufizohet në capak politika të zbehta që thuhet se s'japin asnjë ndikim real në mënyrën sesi zhvillohet ky vend, si rritet ekonomia, si formësohet arsimi, si performon industria apo shërbimet e çkamos tjetër.

Mjedisi i shëndetshëm dhe ekologjikisht i përshtatshëm për brezat e sotëm e të ardhshëm nuk mund të jetë më një objektiv social, por një e drejtë thellore e individit. Garantimi që ne si shoqëri me këtë nivel përparimi e koshience që kemi, nuk mund të mbetet në lidhje me mjedisin vetëm në kuadrin e një të drejte për informim më shumë. Neni 56 i kushtetutës së Republikës së Shqipërisë qartazi parashikon: kushdo ka të drejtë të informohet për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij.

Përgjatë këtyre pesë viteve pune intensive e rrethuar apo më saktë, e zhytur në çështje të të drejtave të njeriut në ndërgjegjien time gjithnjë e më shumë kristalizohej sidoqoftë ndjesia e pamjaftueshmërisë së të drejtave të parashikuara në kushtetutën tonë për t'iu përgjigjur nevojave dhe dukurive të reja që kristalizohej vijimësisht në këtë fushë.

Ne kemi nevojë të adresojmë të drejta të reja, e t'u japim fuqinë e vlerat që u takojnë, si të drejtave mjedisore, por edhe të drejtave të trashëgimisë kulturore apo edhe njohjen e detyrimit të çdo

administratë për të mirëadministruar vendin si një e drejtë e njeriut. Karta Europiane e të Drejtave të Njeriut përfaqëson një dokument me të drejta më të plota. Kjo është arsyeja pse Avokati i Popullit mendon se ka ardhur koha që kjo çështje të jetë pjesë e diskutimeve të shoqërisë civile e më tej, e ekspertëve kushtetues, në mënyrë që në të përgatisim hyrjen tonë në Europë duke treguar përkatësinë në standarde e vlera edhe për katalogun e të drejtave që u njohim e garantojmë qytetarëve tanë.

KREU 1

Kuadri ligjor dhe institucional

Institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut në Ballkanin Perëndimor, përfshirë dhe Shqipërinë, u krijuan në kontekstin e tranzicionit drejt demokracisë pluraliste. Të drejtat e njeriut ishin flamuri i tranzicionit drejt kësaj demokracie dhe kanë qenë në thelb të këtij procesi. Fillimi i këtyre proceseve përkoi me përpjekjet kryesore të komunitetit ndërkombëtar për të forcuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut në nivel global. Në fillim të viteve 1990, Kombet e Bashkuara filluan të promovojnë Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI), agjenci të pavarura kombëtare të krijuara posaçërisht për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut, në mënyrë që të *"kapërcejnë hendekun midis ligjit ndërkombëtar dhe praktikave të brendshme"*.

Përkufizimi i NHRI-së bazohet në standardet globale dhe është zhvilluar brenda sistemit të OKB-së, ku një NHRI përkufizohet si *"një organ i krijuar nga një qeveri sipas kushtetutës, ligjit apo dekretit, funksionet e të cilit janë përcaktuar në mënyrë specifike në drejtim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut"* apo si *"organe shtetërore me mandat kushtetues dhe/ose legjislativ për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut, që janë pjesë e aparatit shtetëror dhe financohen nga shteti"*. Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI) nuk janë as struktura gjyqësore dhe as ligjbërëse, kanë natyrë administrative jovendimmarrëse por opinionmarrëse.

Në ditët e sotme marrja në konsideratë e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut është e dukshme dhe e ndjeshme në çdo sferë të aktivitetit qeverisës dhe në shumë sfera të tjera të jetës publike dhe private. Termi *"Human Rights approach"* po kthehet në një filozofi aktuale qeverisjeje e sjelljeje. Numri dhe shkalla e përhapjes së institucioneve që kanë për objekt të punës së tyre të drejtat e njeriut reflekton këtë realitet. Megjithatë është e kuptueshme që, vetëm një institucion ligjërishit dhe efektivisht i pavarur, i shkëputur nga përgjegjësitë e qeverisjes ekzekutive dhe nga administrata gjyqësore, mund të luajë një rol unik dhe të mbajë një pozicionin udhëheqës në fushën e të drejtave të njeriut. Një institucion i tillë jep një kontribut të pazëvendësueshëm në përpjekjet e një vendi për të mbrojtur shtetasit e tij dhe për të zhvilluar një kulturë që respekton dhe zhvillon të drejtat e njeriut.

Përveç mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një nga synimet e institucioneve të tilla është të zhvillojë atë që quhet kultura e qeverisjes së mirë. Ky nocion ka disa karakteristika kryesore të cilat lidhen me pjesëmarrjen, orientimin drejt konsensusit, përgjegjshmërinë, transparencën, llogaridhënien, efektivitetin dhe efikasitetin, barazinë, gjithëpërfshirjen dhe ndjekjen e sundimit të ligjit. Ai siguron që korrupsioni të minimizohet, të merren parasysh pikëpamjet e pakicave dhe se zërat e grupeve më të cenueshme në shoqëri të dëgjohen në vendimmarrje. Ai gjithashtu i përgjigjet nevojave të tashme dhe të ardhme të shoqërisë.

Në këtë kuptim, edhe vetë Komisioni i Venecias, duke njohur dhe pranuar parimet themelore të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, të tilla si pavarësia, objektiviteti, transparenca,

drejtësia, paanshmëria, si dhe duke e konsideruar se këto institucione janë një element i rëndësishëm në një shtet të bazuar në demokraci, sundim të ligjit, respektim të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ka miratuar “*Parimet mbi mbrojtjen dhe promovimin e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut*”¹.

Gjithsesi, duke qenë se institucionet kombëtare të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut kanë në fokusin e tyre ndërtimin i një shoqërie ku institucionet shtetërore janë llogaridhënese ndaj qytetarëve dhe vepronë në mënyrë transparente, efektive dhe eficiente, është e domosdoshme mbështetja e vazhdueshme njerëzore dhe financiare për të garantuar që institucionet publike të vepronë në përputhje me standardet dhe aktet kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut.

Institucionit të Avokatit të Popullit, në përputhje me legjislacionin kombëtar por edhe atë ndërkombëtar (veçanërisht Parimet e Parisit² dhe të Komisionit të Venecias), i është përcaktuar një mandat i gjerë, i bazuar në standardet ndërkombëtare si institucioni më i lartë kombëtar për promovimin, parandalimin e shkeljeve dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Në përgjithësi, mandati i Avokatit të Popullit mbulon funksionet si: Ombudsman “klasik”; Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut (NHRI); Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, dhe Ombudsman për Fëmijët.

Ky mandat jetësohet në juridiksionin dhe kompetencat që këtij institucioni i parashikohen në Kushtetutë, ligjin “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe detyra të tjera të caktuara në ligje të veçanta. Me një përvojë tashmë mbi 20-vjeçare, institucioni i Avokatit të Popullit funksionon në Shqipëri krahas institucioneve të tjera të pavarura apo të barazisë, duke kontribuar në përmirësimin e praktikave të mirëqeverisjes dhe garantimit të të drejtave të qytetarëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit në Shqipëri është gjithashtu i certifikuar nga institucionet kompetente ndërkombëtare për standardet e larta që plotëson (është riakredituar në dhjetor 2020 me Statusin "A"). Këto standarde kanë të bëjnë me të drejtën për t'i paraqitur Qeverisë, Kuvendit dhe çdo organi tjetër kompetent me kërkesë të autoriteteve përkatëse ose *ex officio*, mendime, rekomandime, propozime për çdo çështje që ka të bëjë me promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Vendimi i riakreditimit është shoqëruar dhe me disa rekomandime të cilat do të jenë një nga sfidat më të rëndësishme të institucionit të Avokatit të Popullit në të ardhmen. Këto rekomandime kanë të bëjnë me nevojën e ndërmarrjes së iniciativave ligjore për të pasur një mandat më të gjerë që përfshin aftësinë për të adresuar të gjitha shkeljet e të drejtave të njeriut që rezultojnë nga veprimet dhe mosveprimet e subjekteve private; mundësinë që Avokati i Popullit të ketë një mandat të qartë për të inkurajuar ratifikimin ose aderimin në instrumentet rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut; nevojën për burime të mjaftueshme financiare për të ushtruar në mënyrë të plotë mandatin, duke përfshirë dhe sigurimin me kohë të plotë të punës të përfaqësuesve të zyrave rajonale të institucionit të Avokatit të Popullit.

¹ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL\(2011\)079-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL(2011)079-e)

² <https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/StatusOfNationalInstitutions.aspx>

Detyrat apo rekomandimet që parashtrohen pas përfundimit të këtij procesi akreditimi/riakreditimi drejtohen në radhë të parë për shtetet përkatëse dhe institucionet e tyre përfaqësuese (qeverinë, kuvendin) si dhe për institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut (Ombudsmanin). Kjo pasi statusi që i jepet një institucioni kombëtar reflekton dhe është treguesi më i qartë i rolit dhe rëndësisë që shteti përkatës i jep një institucioni të tillë.

Me një pozitë të tillë institucionale, pritshmëritë legjitime të publikut dhe të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tjerë të shoqërisë sonë të brishtë demokratike kanë qenë dhe janë ende të larta në krahasim me veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit. Në funksion të kapaciteteve dhe burimeve institucionale dhe duke marrë parasysh realitetet politike, ligjore, sociale, ekonomike, zhvillimore dhe kulturore të Shqipërisë, ambicia strategjike e Avokatit të Popullit është të bëhet aktori kryesor në funksionimin e sistemit kombëtar të të drejtave të njeriut në Shqipëri.

Me këtë qasje dhe ambicie strategjike, Avokati i Popullit synon të fokusohet në atë që konsiderohet e rëndësishme si për ngritjen e kapaciteteve të institucionit ashtu edhe për vendosjen e dialogut me aktorët përkatës. Avokati i Popullit është i vetëdijshëm se nuk mund ta fitoj i vetëm avancimin e axhendës së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ndonëse ai është i vendosur të ketë e ushtrojë një rol thelbësor në këtë drejtim, për të pasur rezultat të matshëm kërkohet angazhimi i të gjithë aktorëve të përkushtuar ndaj respektimit të të drejtave të njeriut.

KREU II

Zbatimi i rezolutës së Kuvendit të RSH-së për vitin 2020 nga institucioni i Avokatit të Popullit

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2020, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar, më datë 7.7.2020, rezolutën përkatëse ku, ndërmjet të tjerash, i ka rekomanduar institucionit të Avokatit të Popullit marrjen e një sërë masash që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore. Institucioni i Avokatit të Popullit si institucion i pavarur kushtetues i ka gjetur rekomandimet në përputhje me mandatin dhe vizionin e tij në zbatim të kësaj rezolute. Brenda kësaj periudhe 6-mujore, ka ndërmarrë veprimet e mëposhtme:

1. Marrja e masave proaktive nga ana e Avokatit të Popullit në lidhje me informimin e qytetarëve në forma më gjithëpërfshirëse apo të aksesueshme mbi njohuritë për të drejtat dhe liritë themelore të tyre dhe mekanizmat mbrojtës, duke u angazhuar konkretisht për realizimin e aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit 2018-2022, si krijimi i blogut për të drejtat e njeriut - Histori suksesi, në mbrojtje të të drejtave të njeriut brenda faqes zyrtare të AP-së.

Duke qenë se Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut konceptohen dhe veprojnë si institucione lider në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit, çështjet që lidhen me promovimin, informimin apo sensibilizimin lidhur me të drejtat e njeriut i ka pjesë të mandatit të tij.

Bazuar në Planin Strategjik të institucionit, i hartuar me qëllimin e krijimit dhe zhvillimit të një kulture të qeverisjes së mirë, u hartua dhe Plani i Veprimit (2019-2022), në të cilën janë parashikuar dhe një sërë aktiviteteve promovuese, për të arritur objektivin e përgjithshëm që qytetarët në Shqipëri të jenë gjithnjë e më shumë të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, si t'i kërkojnë ato dhe ku të drejtohen nëse të drejtat e tyre çënohen. Për arritjen e këtij objektiivi janë parashikuar një sërë veprimtarish që lidhen me: promovimin e të drejtave të fëmijëve, edukimin për të Drejtat e Njeriut, përfshirë integrimin e edukimit mbi të drejtat e njeriut në kurrikulën e sistemit arsimor në Shqipëri, si dhe forcimin e ndërveprimit midis të drejtave të njeriut dhe zhvillimit të qëndrueshëm, përfshirë rritjen e vetëdijes dhe respektin e bizneseve për parimet e të drejtave të njeriut.

Një nga aktivitetet e përfshira në këtë Plan Veprimi, tashmë i realizuar, është dhe blogu për të drejtat e njeriut - *Histori suksesi, në mbrojtje të të drejtave të njeriut*, brenda faqes zyrtare të AP-së. Në këtë blog janë përfshirë rastet e sukseshme të cilat, falë ndërhyrjes së institucionit të Avokatit të Popullit përmes rekomandimeve të tij kanë mundësuar adresimin (edhe sistematik) të problematikave në fusha të caktuara të së drejtës. Më shumë informacion mund të gjendet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/histori-suksesi-7/>

Gjithashtu, në kuadër të promovimit vlen të theksohet puna që është bërë gjatë kësaj periudhe në hartimin, publikimin dhe shpërndarjen e materialeve të ndryshme promovuese (në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, të burgosurve, etj), pjesëmarrjes në emisione të ndryshme televizive, etj, me qëllim rritjen e informimit dhe sensibilizimit mbi të drejtat e njeriut dhe rolin e Avokatit të Popullit si një Institucion Kombëtar për të Drejtat e Njeriut. Duhet të theksohet se ky aspekt është realizuar falë financimeve të donatorëve përsa buxheti i institucionit të Avokatit të Popullit në lidhje me promovimin nuk e mbulon një aspekt të tillë.

Avokati i Popullit ka vazhduar të mbajë një qasje proaktive ndaj mediave duke hapur kanale komunikimi të dyanshme, me aktivitetet e institucionit që ndiqen dhe prezantohen nga mediat dhe pyetjet dhe interesat mediatike që marrin përgjigje menjëherë nga institucioni. Gjithashtu reagimet zyrtare të Avokatit të Popullit për rastet e ndjeshme ndaj opinionit publik janë vazhdimisht të pranishme në media, pas publikimit të tyre nëpërmjet njoftimeve për shtyp dhe në faqen zyrtare të Institucionit apo në rrjetet sociale.

Faqja zyrtare: www.avokatipopullit.gov.al, përfshin tashmë më shumë hapësirë dhe më shumë interaktivitet për të 5 seksionet e institucionit tonë, si dhe një mbulim më të mirë të aktiviteteve, hapësirë për mediat dhe gazetarët, akses për qytetarët për të paraqitur ankesa online si dhe shembuj të rasteve të trajtuara. Në këtë faqe, gjithashtu, është e aksesueshme edhe një *vidio informuese per mandatin dhe rolin institucionit të Avokatit te Popullit, rastet dhe mënyrat ku qytetarët mund t'i drejtohen institucionit në rastet e shkeljeve të të drejtave të tyre nga organet e administratës publike etj.* Më shumë informacion për videon informuese gjendet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/multimedia/shpjegues-i-thjesht-far-sht-avokati-i-popullit-482/>

Siç është informuar edhe më parë, që nga viti 2018 ka nisur aplikacioni celular “Avokati i Popullit” që u jep mundësinë qytetarëve për t'u ankuar drejtpërdrejt nga celulari dhe të dërgojnë në kohë reale foto, video ose të dhëna audio në mbështetje të ankesave të tyre si dhe krijon një urë ndërvepruese midis përdoruesit dhe institucionit me njoftime në kohë reale që i dërgohen përdoruesit për ecurinë e ankesës gjatë trajtimit të saj nga stafi i institucionit të Avokatit të Popullit. Ai përfshin gjithashtu *informacione mbi mënyrën se si funksionon institucioni i Avokatit të Popullit, cilat janë të drejtat civile të mbrojtura* si dhe gjithashtu shembuj ku, bazuar në rekomandimet e Avokatit të Popullit, është arritur një ndryshim pozitiv. Në periudhën janardhjetor 2021, *9.6% të numrit të përgjithshëm* të ankesave të depozituara pranë institucionit të AP-së kanë ardhur nëpërmjet këtijë aplikacioni.

Ndërkohë që në rrjetet sociale (faqe në Facebook) “Avokati i Popullit” vazhdon të rritet me aktualisht më shumë se 8850 ndjekës të rregullt³, duke shënuar një rritje të qëndrueshme nga viti në vit.

Fushatat promovuese dhe puna në terren e përfaqësuesve rajonalë të Avokatit të Popullit ka qenë pjesë e rëndësishme e aktivitetit të përditshëm të punës së tyre, duke synuar në vazhdim rritjen dhe forcimin e besimit të qytetarëve tek Avokati i Popullit. Në këtë drejtim, duhet të përmendet edhe raporti i “*Barometrit të Ballkanit*” për vitin 2021, i cili mbështetet nga Këshilli Rajonal i

³ Në vitin 2020, ky numër ishte 8150 ndjekës.

Bashkëpunimit, një institucion i Bashkimit Evropian me fokus integrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, i cili në anketën e përceptimit të publikut e nxjerr Avokatin e Popullit në Shqipëri si një ndër institucionet të cilit publiku ka prirjen më të lartë për t'i besuar.⁴

2. Vijimin e organizimit të sesioneve informuese në shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve dhe stafit pedagogjik për të drejtat e tyre themelore dhe punën e AP-së në mbrojtjen e këtyre të drejtave

Zbatimi në praktikë i kësaj pike të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë, zbrërthyer në veprime dhe veprimtari konkrete nga Avokati i Popullit dhe Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, është si vijon:

Së pari, për marrjen e masave nga ana e Avokatit të Popullit në lidhje me **informimin e qytetarëve në forma më gjithëpërfshirëse apo të aksesueshme** mbi njohuritë për të drejtat dhe liritë themelore të tyre dhe mekanizmat mbrojtës, veprimtaria administrative e Avokatit të Popullit në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, u përqendrua në **botimin miqësor për fëmijët, për ndarjen e praktikave të mira të punës** së këtij institucioni me rastet e trajtuara e të zgjidhura pozitivisht, në interesin më të lartë të fëmijës. Risi në hartimin dhe lancimin e botimit miqësor “Fëmijët dhe të drejtat e tyre” përbën faza e konsultimit publik me pjesëmarrjen e gjerë të fëmijëve dhe adoleshentëve të rinj, institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës dhe shoqërisë civile. Botimi aksesohet lehtësisht edhe *online* në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.⁵ Gjithashtu, në kuadër të rritjes së promovimit dhe njohjes më të mire të institucionit të Avokatit të Popullit, u botua fletëpalosja “*SMPDF në institucionin e AP- Në shërbim të interesit më të lartë të fëmijëve, u shërbejmë interesave më të mira të të gjithë shoqërisë*”.

Së dyti, zbatimin e rekomandimit lidhur me vijimin e **sesioneve informuese në shkollat 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi**, me qëllim përmirësimin e njohurive të nxënësve dhe stafit pedagogjik për të drejtat e tyre themelore dhe punën e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e këtyre të drejtave. Gjatë vitit 2021 Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve ka realizuar **21 inspektime**, si dhe **37 ditë të hapura** dhe **veprimtari të karakterit promovues** në formatin hibrid për të drejtat e fëmijëve, kryesisht në institucionet e edukimit, shkolla 9-vjeçare dhe të mesme në rang vendi, si edhe në institucionet e privimit të lirisë, me qëllim përmirësimin e konsolidimin e njohurive të nxënësve dhe mësuesve për edukimin ligjor për/rreth të drejtave themelore të njeriut, veçanërisht të fëmijëve dhe punën e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Konkretisht, gjatë këtij viti janë realizuar në shkolla të ndryshme të vendit **19 veprimtari promovuese “Ditë të hapura” me pjesëmarrjen e nxënësve, mësuesve dhe prindërve** në rang vendi (me fokus edhe bashkitë e nivelit të dytë), në qytetet Prrenjas, Librazhd, Gramsh, Cërrik, Gjirokastrë, Përmet, Lezhë, Tiranë, Pogradec (Tushemisht dhe Verdovë), Lushnjë, Elbasan, Krujë, Rrogozhinë, Peqin, Kurbin, Pukë, Dropull, Korçë dhe Durrës.⁶

⁴https://www.rcc.int/docs_archive/Downloads/Balkan_Barometer_Public_opinion_2021v4_compressed.pdf.

⁵ <https://smpdf.avokatipopullit.weather.al/botime/>

⁶ Këto aktivitete janë realizuar falë mbështetjes financiare të ofruar nga UNICEF.

3. Përcjelljen në Kuvend të një raporti të detajuar për çështjet e dhunës në familje si dhe abuzimit seksual ndaj të miturve.

Në kuadër të zbatimit të kësaj pike të Rezolutës, Avokati i Popullit, nëpërmjet Seksionit të Përgjithshëm, ka përgatitur një raport të detajuar për **çështjet e dhunës në familje dhe ndaj grave** për periudhën Janar 2020-Shtator 2021, i cili i është dërguar Kuvendit të Shqipërisë.⁷

Raporti evidenton zhvillimet më të rëndësishme dhe në veçanti problematikat në lidhje me legjislacionin dhe masat e ndërmarra për luftën ndaj dhunës ndaj grave nga institucione të ndryshme, sipas përgjegjësisve ligjore dhe institucionale, si dhe paraqitjen e rekomandimeve konkrete. Një fokus të veçantë në raport ka edhe përgjigjja e institucioneve për adresimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje gjatë pandemisë së COVID-19, duke qenë se kjo situatë, ashtu si dhe në vende të tjera në mbarë botën, ka ndikuar në një rritje të ndjeshme të rasteve të dhunës.

Raporti adreson problematikat në lidhje me dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave kryesisht për periudhën 2020-2021. Si pikënisje (baseline) është marrë raporti i Avokatit të Popullit i përgatitur për Komitetin CEDAW, që shtrihet për periudhën 2016-2020.

Raporti fokusohet jo vetëm në dhunën fizike por edhe në format e tjera të dhunës ndaj grave, duke qenë se janë të ndërlydhura. Ai trajton kryesisht në çështjet e përmirësimit të legjislacionit, masat për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna, ofrimin e shërbimeve për të mbijetuarat dhe parandalimin. *Më shumë në lidhje me këtë raport gjendet në Kreun 4 “Angazhime të tjera institucionale”.*

Në lidhje me angazhimin për hartimin e një raporti të detajuar në lidhje me **abuzimin seksual ndaj të miturve**, Avokati i Popullit nëpërmjet Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve ka realizuar raportin “Për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi seksual, si një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve”.

Raporti është mbështetur në vlerësimin dhe analizimin e kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar që përfshijnë fenomenin e abuzimit seksual, si një ndër shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijës të kryer kundër kësaj kategorie të veçantë dhe të pambrojtur të shoqërisë tonë. Synimi i tij është pasqyrimi në mënyrë gjithëpërfshirëse të këtij fenomeni, pasojat e tij dhe masat e marra për ta parandaluar atë në nivel kombëtar në rendin juridik shqiptar.

Pjesa e parë e raportit pasqyron një analizë të thelluar të dispozitave ligjore dhe administrative të marra në nivel ndërkombëtar dhe shqiptar konkretisht, dokumentet ndërkombëtare ekzistuese, të cilat rregullojnë çështjen e abuzimit seksual të fëmijës, dhe një përmbledhje të kornizës ligjore dhe institucionale shqiptare.

Pjesa e dytë pasqyron reagimin institucional, koordinimin, bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës në nivel horizontal dhe vertikal institucional, si dhe kapacitetet për zbatimin e kuadrit ligjor nga burojnë funksionet kryesore të mbrojtjes së fëmijës së abuzuar apo shfrytëzuar seksualisht.

⁷ Dërguar me shkresën nr 15, datë 13.01.2022.

Në pjesën e tretë pasqyrohet situata e fenomenit të abuzimit seksual në vendin tonë. Pjesa e katërt është e fokusuar tek praktika administrative e institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë trajtimit të këtij fenomeni nga rastet e ndërmarra me iniciativë, të dhënat e mbledhura nga hetimet administrative të realizuara dhe pasojat e abuzimit seksual.

Ndërsa në pjesën e fundit pasqyrohen konkluzionet dhe rekomandimet e zhvilluara bazuar në analizën krahasuese të legjislacionit shqiptar me legjislacionin ndërkombëtar. Ky raport është dërguar tashmë pranë Kuvendit të Shqipërisë⁸, dhe është hartuar nga ekspertët e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

4. Zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit mes Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke marrë masa konkrete për të.

Siç e kemi theksuar edhe më parë, rekomandimet e ECRI-it (Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës) kërkojnë që organet e barazisë të koordinojnë dhe të bashkëpunojnë me njeri-tjetrin si dhe me institucionet e tjera të të drejtave të njeriut, përfshirë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (Ombudsmanin). Ky bashkëpunim është dhe mbetet i nevojshëm me synimin për të maksimizuar impaktin e tyre të përgjithshëm në lidhje me mandatin e barazisë. Koordinimi dhe bashkëpunimi përfshin dialogun në procesin e planifikimit të tyre, iniciativa të përbashkëta në punën e tyre si dhe një komunikim të vazhdueshëm e të qëndrueshëm.

Sa më sipër, bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me institucionin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka qënë i frytshëm dhe ka përfshirë të gjitha ato tema sensitive që dy institucionet mund të adresojnë në kuadër të respektimit të së drejtës për barazi para ligjit si dhe në luftën kundër diskriminimit të të gjitha formave.

Jo vetëm kaq por ky bashkëpunim ka qënë sinergjik në organizimin e punës së zyrave rajonale të ngritura nga ana e Avokatit të Popullit dhe e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në qytete të ndryshme të vendit. Për të pasur një qasje sa më reale dhe të koordinuar, nga ana e të dy institucioneve është rënë dakord që përfaqësuesit e tyre në zyrat rajonale, të marrin ankesa individuale dhe të adresojnë problematika që përfshihen në mandatin dhe fushën respektive të të dyja institucioneve.

Pikërisht për të qartësuar dhe konsoliduar këtë qasje institucionale, institucioni i Avokatit të Popullit dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi u dakortësuan për realizimin e disa trajnimeve gjatë vitit 2021, në fusha të ndryshme të së drejtës me qëllim rritjen e kapaciteteve të punonjësve të zyrave rajonale të Avokatit të Popullit dhe KMD-së, forcimin e bashkëpunimit midis tyre si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve që ofrohen ndaj qytetarit.

Deri më tani janë realizuar 3 (tre) trajnime të përbashkëta “online”, ku përveç përfaqësuesve të zyrave rajonale të dy institucioneve të sipërpërmendura kanë marrë pjesë edhe përfaqësues rajonale të Zyrës së Ndihmës Juridike Falas dhe konkretisht:

⁸ Dërguar me shkresën nr. 17, datë 14.01.2022.

Më datë 28 maj 2021, u zhvillua trajnimi i parë i fokusuar kryesisht në rolin, kompetencat dhe fushën e veprimtarisë të dy institucioneve (AP dhe KMD), plotësimin e formularëve të ankesave, mënyrën e përcjelljes së tyre, rastet e ndërmjetësimit dhe monitorimit të përbashkët, etj, duke ndarë dhe eksperiencat konkrete në këtë drejtim.

Më datë 21 shtator 2021, u organizua trajnimi i dytë që kishte të bënte me *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe rolin e pushtetit vendor në zbatimin e tyre*. Kjo pasi të gjitha OZHQ-të kanë objektiva të lidhura drejtpërdrejt me përgjegjësitë e qeverive lokale, veçanërisht me rolin e tyre në ofrimin e shërbimeve bazë. Kjo është arsyeja pse njësitë e qeverisjes vendore duhet të jenë në qendër të Axhendës 2030. Autoritetet lokale, si dhe shoqëria civile lokale, janë më afër qytetarëve dhe prandaj janë në gjendje të zhvillojnë modele të shërbimeve në përputhje me nevojat në zhvillim në komunitetet e tyre. Drejtuesit e zgjedhur në nivel lokal, në veçanti, kanë një mandat demokratik për të udhëhequr zhvillimin lokal dhe janë përgjegjës para qytetarëve të tyre nëse nuk arrijnë ta bëjnë këtë.

Me datë 3 dhjetor 2021, u zhvillua trajnimi i tretë online me përfaqësues të zyrave rajonale të dyinstitucioneve me fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Trajnimi u fokusua në kuadrin ligjor të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, konceptin e sistemit të integruar të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, parimet bazë të garantimit të të drejtave të fëmijës, veprimtarinë e institucionit kombëtar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, raportet e veçanta dhe rekomandimet, bashkëpunimi me shoqërinë civile, proaktiviteti, sfidat dhe bashkëpunimi institucional në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre.

Ky bashkëpunim do të vazhdojë edhe në të ardhmen ku është dakortësuar që të realizohet edhe një trajnim tjetër që do të fokusohet në *njohjen me veprimtarinë e organizatave ndërkombëtare* në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në bazë të marrëveshjes dhe trajnimeve të realizuara, për periudhën në fjalë nga zyrat rajonale të Avokatit të Popullit janë marrë 12 ankesa të referuara nga përfaqësuesit e zyrave rajonale të KMD.

Siç është informuar edhe më parë, të dy institucionet vazhdojnë të jenë pjesë aktive e Marrëveshjes së Bashkëpunimit për krijimin e *“Aleancës kundër urrejtjes”*, e cila si qëllim të saj ka angazhimin e aktorëve kryesorë të përfshirë në aspekte të ndryshme të parandalimit të gjuhës së urrejtjes, për të koordinuar dhe bashkuar përpjekjet, për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të advokuar si një front kundër këtij fenomeni.

Më datë 17 Maj 2021, në kuadër dhe të IDAHO 2021 (Dita Ndërkombëtare e LGBTIQ-së), u organizua një diskutim virtual ku morrën pjesë Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi z. Robert Gajda, Avokati i Popullit të Kosovës si dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile të Shqipërisë dhe Kosovës. Ky takim kishte si qëllim shkëmbimin e praktikave të pozitive si dhe dhënien e mesazheve sensibilizuese në lidhje me përfshirjen sociale të anëtarëve të komunitetit LGBTIQ në shoqëritë respektive.

Gjithashtu, përfaqësues nga të dy institucionet AP dhe KMD, morrën pjesë në trajnimin 3-ditor (16, 17, 20 Dhjetor 2021), të organizuar nga OSBE me temë: *“Monitoring Hate Speech and*

Gender-based Discrimination in Albania”. Gjatë këtij trajnimi pati dhe një diskutim të mënyrave të trajtimit të çështjeve /problematikave nga të dy institucionet respektive.

5. Marrjen e masave konkrete për zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara gjatë vitit 2020, si: "Memorandumi i Mirëkuptimit midis Avokatit të Popullit dhe Institutit të Statistikave "Për bashkëpunimin në fuqizimin e mbledhjes së të dhënave, përhapjen dhe analizën në dritën e të drejtave të njeriut dhe Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030" dhe marrëveshjes së nënshkruar me UNICEF-in "Marrëveshja e re e bashkëpunimit për periudhën 1 tetor 2020 – 30 shtator 2021", e cila i referohet planit të punës 2020-2021 mes UNICEF-it dhe qeverisë shqiptare.

Për funksionimin në praktikë të *Memorandumit të Mirëkuptimit* midis Avokatit të Popullit dhe Institutit të Statistikave “*Për bashkëpunimin në fuqizimin e mbledhjes së të dhënave, përhapjen dhe analizën në dritën e të drejtave të njeriut dhe Agjendës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030*”, fillimisht me Urdhër të Përbashkët të titullarëve të dy institucioneve, është ngritur grupi teknik i punës, me tre përfaqësues nga INSTAT dhe tre përfaqësues nga Avokati i Popullit.

Më pas brenda institucionit tonë, janë mbledhur dhe shqyrtuar nga çdo seksion çështjet konkrete, të cilat janë zberthyer në indikatore përkatës, me qëllim konstatimin e nivelit të respektimit të të Drejtave të Njeriut në vendin tonë. Këto të dhëna i janë përcjellë INSTAT-it, për të kuptuar metodologjinë e treguesve mbi ankesat e shqyrtuara nga institucioni ynë, si dhe janë zhvilluar disa takime ndërmjet palëve. Përveç grupit të punës të ngritur në kuadër të Memorandumit të Mirëkuptimit, është rënë dakord të ngrihen edhe nëngrupe pune teknike, që do të diskutojnë se si nevojat e Avokatit të Popullit do të përfshihen në statistikën që nxjerr INSTAT (kujojmë që INSTAT nxjerr të dhëna mbi bazën e formateve të miratuara nga Eurostat).

INSTAT-i në bashkëpunim me UNWOMEN ka organizuar një workshop me qëllim identifikimin dhe përpilimin e indikatorëve të mundshëm për plotësim nga Avokati i Popullit. Ky workshop shërbeu dhe si informacion për ekspertët e Avokatit të Popullit në kuptimin dhe përdorimin e duhur të statistikave zyrtare.

Në tagrin e tij ligjor si nxitës dhe promovues i standarteve më të larta të të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë rritjen e kapaciteteve të tij në drejtim të nxitjes të barazisë gjinore, mbrojtjes së të drejtave të grave dhe vajzave apo monitorimit të zbatimit të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, siç është informuar edhe më parë, institucioni i AP ka ndërmarrë sesione trajnimesh ku spikat trajnimi mbi “*Përdorimin e treguesve gjinorë për monitorimin e të drejtave të njeriut dhe SDG*”, i cili kishte si qëllim standardizimin e të dhënave gjinore të prodhuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, përdorimin e këtyre të dhënave të disagreguara për monitorimin e të drejtave të njeriut dhe Objektivave Globalë të Kombeve të Bashkuara, si dhe prezantimin e treguesve gjinorë në botimin vjetor të INSTAT për Burrat dhe Gratë.

Pikërisht, në zbatim edhe të marrëveshjes të nënshkruar me INSTAT, institucioni i Avokatit të Popullit ofroi kontributin e vet që u përfshi në publikimin “*Burrat dhe Gratë në Shqipëri 2021*”. Ky është një publikim me periodicitet vjetor, që paraqet të dhëna në fusha të ndryshme të jetës të ndara sipas gjinisë, me qëllim reflektimin e problematikave të shoqërisë në kuadër të arritjes së

barazisë gjinore, në të cilën është përfshirë dhe një kapitull me tregues mbi të drejtat e njeriut. Statistikat mbi të drejtat e njeriut pasqyrojnë të dhëna sipas gjinisë mbi ankesat për pretendime shkeljeje të të drejtave, të trajtuar nga Avokati i Popullit, sipas llojit të së drejtës.

Në datat 14-15 dhjetor 2021, u zhvillua trajnimi me temë: “Rritja e kapaciteteve të stafit të Avokatit të Popullit, INSTAT dhe Avokatit të Popullit Kosovë, në lidhje me Agjendën 2030 dhe të Drejtat e Njeriut”.⁹ Qëllimi i këtij trajnimi ishte rritja e rolit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të cilat përbëjnë edhe bazën e konceptimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, e që ka dhe duhet të luajë një rol specifik në procesin e zbatimit dhe monitorimit të Axhendës 2030.

Gjithashtu, për të mundësuar vënien në zbatim në mënyrë efektive të Memorandumit të Bashkëpunimit me Institutin e Statistikave, institucioni i Avokatit të Popullit, me asistencën e UN, është në proces të realizimit të mundësisë për një shërbim konsulence në këtë drejtim. Kjo konsulencë lidhet me identifikimin e statistikave aktuale të cilat prodhohen nga INSTAT, peridiocitetin e tyre dhe raportin specifik në të cilin publikohen, metodologjinë e përdorur. Konsulenca do të ketë për objekt identifikimin e burimeve nga të cilat INSTAT i mbledh këto të dhëna dhe cilat janë vështirësitë që has, organizimin e workshopeve, saktësimin e listës së indikatorëve që duhet të mblidhen dhe të publikohen si dhe përgatitjen e një plani veprimi që të përcaktojë, afatet, detyrat dhe burimet e financimit për publikimin e këtyre të dhënave.

Ndërkohë është rënë dakord me Zyrën e UN në Tiranë për realizimin e një projekti për krijimin e një sistemi të ri të menaxhimit të rasteve (case management system) çka do të mundësojë nga ana teknike mbledhjen e më shumë të dhënave dhe treguesve shtesë që lidhen me matjen e progresit dhe për të siguruar që asnjë mos të mbetet mbrapa në Axhendën për Zhvillim të Qëndrueshëm të 2030.¹⁰

Institucioni i Avokatit të Popullit ka nënshkruar me UNICEF *Marrëveshjen e Bashkëpunimit*¹¹ me qëllim mbështjetjen teknike, financiare dhe administrative të Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, për vitin 2020-2021.

Komponentët kryesorë të marrëveshjes ndërmjet Avokatit të Popullit dhe UNICEF-it konsistojnë në:

- ✓ promovimin dhe monitorimin e të drejtave të fëmijëve nga institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor;
- ✓ vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, pas monitorimit të kushteve dhe trajtimit të fëmijëve të privuar nga liria, duke marrë në konsideratë të veçantë masat për sigurimin dhe zbatimin e të drejtave të fëmijëve gjatë pandemisë Covid-19;
- ✓ advokimin dhe formëzimin në vijimësi të dialogut, me ekipe teknike multi-disiplinare, në nivel kombëtar dhe vendor, si dhe me mekanizmat shtetërorë përkatës që adresojnë mbrojtjen sociale të fëmijëve, duke marrë në konsideratë nevojat e veçanta gjatë pandemisë.

⁹ Ky trajnim u realizua falë mbështetjes së ofruar nga Zyra e UN në Tiranë.

¹⁰ Procesi i zbatimit po kryhet nga zyra e UN në Tiranë dhe aktualisht jemi në fazën e realizimit të procedurave të prokurimit për përzgjedhjen e kompanisë që do të zhvillojë sistemin e ri të menaxhimit të rasteve.

¹¹ Marrëveshja e Bashkëpunimit me nr.338 prot, datë 28.9.2020.

Në këtë kontekst, Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve për këtë periudhë kohore ka realizuar 4 inspektime në institucionet e privimit të lirisë (komisariatet e Përmetit, Elbasanit, Sarandës dhe në Institutin e të miturve Kavajë). Në përfundim të inspektimeve, Avokati i Popullit adresoi rekomandimet përkatëse në institucionet përgjegjëse.

Në vijim, realizoi veprimtarinë “*Tryezë pune, për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për garantimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktime dhe/ose dëshmitar gjatë periudhës së pandemisë*”. Në këtë tryezë pune morën pjesë përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, etj. Të gjithë pjesëmarrësit vlerësuan në këtë tryezë punën e kryer nga institucioni i Avokatit të Popullit për gjetjet dhe rekomandimet e prezantuara, masat që duhet të ndërmerren nga institucionet e tyre për të siguruar zbatimin e të drejtave të fëmijëve gjatë pandemisë Covid-19.

Në vazhdimësi të zbatimit të planit të punës së marrëveshjes ndërmjet UNICEF-it dhe Avokatit të Popullit janë organizuar 14 tryeza pune/veprimtari monitoruese me përfaqësues të autoriteteve publike në nivelin vendor (përfshirë dhe bashkitë e nivelit të dytë), përgjegjëse për mbrojtjen sociale të fëmijëve, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në bashkitë Dropull, Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Përrenjas, Cërrik, Gramsh, Pogradec, Shkodër, Lezhë, Durrës, Kavajë, Elbasan, Librazhd.

Në vijim të takimeve dhe monitorimeve të realizuara janë adresuar rekomandimet përkatëse për disa struktura të shërbimeve sociale në bashkitë e sipërcituara, bazuar në informacionin e mbledhur gjatë intervistave dhe përpunimit të pyetësorëve. Jemi në përfundim të rekomandimeve me problematikat dhe gjetjet kryesore për sfidat e ekipeve multi-disiplinore dhe institucioneve publike, që adresojnë çështjet e mbrojtjes sociale për fëmijët në nivelin vendor dhe, veçanërisht në zbatimin e masave të marra gjatë pandemisë Covid-19.

Gjetje dhe rekomandime përkatëse u prezantuan në veprimtarinë promovuese “*Tryezë pune për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor*”, e realizuar në 24 nëntor 2021 nga institucioni i Avokatit të Popullit. Tryeza e punës u zhvillua në formatin hibrit në të cilën morën pjesë përfaqësues nga 61 bashkitë e vendit, përfaqësues nga grupi i deputetëve Miqtë e Fëmijëve të KRSH-së, përfaqësues të ministrisë së linjës, Shërbimi Social Shtetëror, organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e fëmijëve.

Gjithashtu, pas një konsultimi të gjerë të botimit miqësor për fëmijët në lidhje me rastet e trajtuara nga Avokati i Popullit, në kuadër të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve me nxënësit e institucioneve të edukimit në datën 18 nëntor 2021 u lancua botimi miqësor “*Fëmijët dhe të drejtat e tyre*”, me pjesëmarrjen e gjerë të fëmijëve, të rinjve dhe institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës dhe shoqërisë civile. Ky botim miqësor “*Fëmijët dhe të drejtat e tyre*” përmbledh shkurtimisht përpjekjet e deritanishme të institucionit të Avokatit të Popullit me praktikën e mira të punës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës nga veprimet dhe mosveprimet e institucioneve të administratës publike dhe është publikuar në hardcopy dhe online¹² në faqen zyrtare të institucionit të Avokatit të Popullit.

¹² <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Botimi%20miqësor%20-%20SMPDF.pdf>

6. Monitorimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor në spitalet rajonale, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimit shëndetësor falas që u ofrohet qytarëve, si dhe adresimin e shkeljeve sistematike.

Në kuadër të këtij angazhimi, Avokati i Popullit paraqiti kërkesën në disa institucione për të mundësuar kontraktimin e burimeve njerëzore të nevojshme për të adresuar hartimin e këtij objekti në një kohë sa më të shpejtë e duke pasur parasysh edhe kapacitetet e kufizuara që kemi në këtë fushë. Pas miratimit të kërkesës, u kontraktuan dy ekspertë të jashtëm të cilët në bashkëpunim me ekspertët e institucionit të Avokatit të Popullit realizuan inspektime në 6 spitale rajonale të vendit, me qëllim intervistimin dhe verifikimin e ofrimit të shërbimit dinjitoz ndaj pacientëve. Ka përfunduar përgatitja e raportit të veçantë lidhur me monitorimin e ofrimit të shërbimit shëndetësor në 6 spitale rajonale të vendit i cili aktualisht është në proces konsultimi me OJF-të. Pas konsultimit ky raport do të dorëzohet në Kuvend.

Më shumë informacion rreth këtij raporti do të gjeni në Kreun III, pika 3.19 “Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor”.

KREU III

Vlerësim i situatës së respektimit të të drejtave të njeriut nga administrata publike

3.1 Përmbledhje e veprimtarisë të seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2021

➤ *Veprimtaria e Seksionit të Veçantë*

Në fokusin e veprimtarisë të Seksionit të Veçantë si pjesë e Institucionit të Avokatit të Popullit kanë vijuar të jenë disa çështje të trajtuara ndër vite që lidhen me garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve ligjzbatuese.

Gjatë vitit 2021 për rastet (ankesat dhe rastet me iniciativë) që kemi përfunduar hetimin administrativ dhe provuar se ankesat e shtetasve kanë qenë të bazuara, janë përgatitur 42 rekomandime, të cilat u janë drejtuar dhe ridrejtuar 128 organeve ligjzbatuese të administratës publike me një total prej 134 pikash nënrekomandime për t'u zbatuar nga ana e tyre.

Të drejtat të personave të burgosur, kanë qenë në vëmendjen e punës tonë pasi përveç veçimit të tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë, për shkak të gjendjes së pandemisë, ata edhe gjatë vitit 2021 kanë vijuar të përballen me disa kufizime të të drejtave të garantuara. Disa nga shqetësimet e adresuara prej tyre në Insitucionin e Avokatit të Popullit kanë të bëjnë me: respektimin e të drejtës ligjore të mbrojtjes, si dhe lejimin e avokatëve të takohen me këto subjekte në çdo kohë dhe sa herë kërkohen prej tyre; ankesa që kanë të bëjnë me trajtimin shëndetësor, të drejtën për t'u punësuar dhe shpërblyer për punën e kryer, të drejtën për t'u informuar etj.

Rëndësi u kemi kushtuar edhe ankesave të paraqitura nga *punonjës të policisë së burgjeve*, jo vetëm për faktin se edhe kjo kategori është subjekt i punës sonë për sa i përket të drejtave që gëzojnë, por edhe se mënyra e trajtimit të tyre pasqyrohet në marrëdhëniet me të burgosurit dhe ofrimin e shërbimeve ndaj tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar *rolin e strukturave të Policisë së Shtetit*, ka konstatuar në një mori rastesh se nuk janë respektuar të drejtat themelore të shtetasve, raste për të cilat janë dërguar rekomandimet përkatëse. Në objektin e ankesave apo rasteve me iniciativë të administruara ndaj këtyre strukturave, do të evidentonim rastet për shoqërimi të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për kushte të pa përshtatshme të ambienteve të shoqërimit; për cënimin e privatësisë nëpërmjet ushtrimit të kontrolleve të banesave dhe mjediseve të tjera në pronësi të shtetasve; për pengim të lëvizjes së lirë për të dalë lirisht jashtë shtetit, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në kuadër të respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut ka pasur një vëmendje të shtuar në verifikimin e problematikave të qytetarëve dhe shqetësimeve të tyre publike ndaj *strukturave të prokurorisë*, por edhe atyre të *drejtësisë* në përgjithësi. Ky fokus

lidhet kryesisht edhe me faktin e zbatimit prej disa vitesh tashmë të reformës në drejtësi dhe disa problematikave që ajo po sjell në hetimin e kallëzimeve dhe procedimeve penale, për shkak të vakancave të shkaktuara nga shkarkimet e një numri të konsiderueshëm të prokurorëve.

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, edhe *funksionimi i gjykatave* në të gjitha nivelet gjatë vitit 2021 është përballur me vështirësi. Procesi i vettingut ka rritur volumin e punës në sistem për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe moszëvendësimit të tyre me të rinj. Në disa raste të trajtuara nga ana jonë janë konstatuar zvarritje të proceseve gjyqësore, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, dorëzime me vonesë të vendimeve të arsyetuara, si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit.

Ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, ka sjellë ndryshimet strukturore dhe procedurale përkatëse në përfitimin e ndihmës juridike falas dhe parashikuar të gjithë garantitë ligjore nga institucionet përgjegjëse, me qëllim gëzimin nga ana e qytetarëve të të drejtave themelore në mënyrë të barabartë. Në këtë kuadër, kemi çmuar se jo vetëm miratimi i këtij ligji por bashkëpunimi i të gjithë aktorëve të përfshirë, duke zbatuar përgjegjësitë përkatëse, është i domosdoshëm për bërjen funksional dhe efektiv të tij.

Gjithashtu, Seksioni i Veçantë ka pasur në fokus çështjen e *pagesave të kësteve të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre*, që për hir të së vërtetës nuk ka përparuar me normat e dëshiruara apo të pritshme, për arsye që lidhen kryesisht me mungesën e fondeve të nevojshme. Për raste të veçanta të paraqitura përmes ankesave të shtetasve, kur janë konstatuar vonesa ose paqartësi në shpërndarjen e kësteve, janë hartuar dhe adresuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rekomandime individuale.





Paraqitja grafike e Seksionit të Veçantë në shifra për vitet 2020 dhe 2021

➤ *Veprimtaria e Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës (MKPT)*

Gjatë vitit 2021, Mekanizmit Kombëtar kundër Torturës ka kryer 68 vizita inspektuese, ndërkohë që 76 raporte inspektimi, shoqëruar me rekomandimet përkatëse u janë dërguar institucioneve publike, me qëllim përmirësimin e gjendjes të të drejtave të personave të privuar nga liria. Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë shumica të pranuar. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdimësi plotësimi i masave, si dhe marrja e përgjigjeve për ato rekomandime që janë ende pa përgjigje.

Mekanizmi Kombëtar ka kryer vizita inspektuese të paparalajmëruara në vendet e privimit të lirisë, përfshirë: 24 Institucione të Ekzekutimit të Vendimeve Penale; 32 Njësi Policore; 6 Qendra; 4 Spitale Psikiatrike dhe 3 Shtëpi të Moshuarish. MKPT për vitin 2021 ka trajtuar 38 ankesa dhe 9 raste me iniciativë.

Ankesa për burgjet kanë qenë 34 (pretendim ushtrim dhune, mungesë mjekimi dhe medikamentesh, kërkesa vaksinimi, shtimin e numrit për takime me familjarët etj), ndërsa ankesa për policinë kanë qenë 4 (pretendim ushtrim dhune, shoqërim i padrejtë).

MKPT në bashkëpunim me Departamentin e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX ka qenë pjesë e grupit të fluturimeve, për monitorimin e 26 operacioneve. Gjatë periudhës raportuese, MKPT ka publikuar 2 raporte të veçanta, dhe konkretisht raportet e veçanta mbi aktivitetin e MKPT-së për vitin 2018 dhe 2019.

Problematikat në I.E.V.P ashtu si dhe në vitet e mëparshme kanë konsistuar kryesisht në mungesën e nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”; në kushtet materiale tejet degraduese dhe pamundësinë e rikonstruktimit të mjediseve në regjimet e brendshme, ne disa nga I EVP-te; rritjes së mbipopullimit në disa nga I EVP-të si në I EVP 302, I EVP Berat, I EVP Durrës, I EVP Shën Koll Lezhë, I EVP Elbasan, I EVP Fushë Krujë; mungesën e mjekëve në sistemin penitenciar; nevojën e përmirësimit të ushqimit të të burgosurve si dhe rritjen e normës së kuotës ushqimore; mangësi të theksuara në ofrimin e mundësisë për arsim dhe aktivitete social-kulturore për të burgosurit, për shkak të kufizimeve si pasojë e pandemisë COVID-19; vonesa dhe mangësi në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e I EVP-ve; vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike; mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në *inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit*, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre, etj. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet, që u janë dërguar organeve eplore të Policisë së Shtetit.

Avokati i Popullit vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen për gjendjen në spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri. Për vitin 2021 nëpërmjet MKPT-së janë *inspektuar institucionet e shëndetit mendor* duke ju kërkuar organeve qendrore dhe spitalore zbatimin e akteve ndërkombëtare dhe kombëtare dhe konkretisht paketën e akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar.


Lidhur me niveli i respektimit të të drejtave të shtetasve të huaj, Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka ndërmarrë inspektime në qendrat e azilkërkuesve si *Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç, Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë, por dhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë* dhe në përfundim të këtyre inspektimeve, Avokati i Popullit ka adresuar dhe rekomandimet përkatëse për institucionet e administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor.

Edhe gjatë vitit 2021, ka vijuar të zbatohet Marrëveshja e Bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët “*Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Evropës Juglindore*”, për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve në Shqipëri, në zonën jugore të Shqipërisë (Gjirokastrë, Sarandë, Përmet) dhe në zonën juglindore (Korçë, Devoll Bilisht).

Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së gjatë takimeve dhe monitorimeve, me përfaqësues të FRONTX dhe të Departamentit të Kufirit dhe Migracionit kanë sugjeruar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore, duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të emigrantëve qoftë këta shqiptarë apo të huaj, si dhe respektimin rigoroz të standardeve të BE-së dhe të legjislacionit shqiptar.

Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka qënë pjesë e rëndësishme e projektit B-COMPETENT “*Përmirësimi i Kompetencave të Stafit Penitenciar në*

Evropë“. Projekti u përmyll me sukses në fundin e vitit 2021 duke sjellë risi lidhur me ndërtimin kapaciteteve në personelin civil dhe policor të burgjeve, për t'u marrë me korrektësi me të burgosurit e huaj dhe për të përmbushur nevojat dhe të drejtat e tyre të veçanta, në përputhje me legjislacionin dhe standardet ndërkombëtare.



Paraqitja grafike e seksionit të MKPT-së në shifra për vitet 2020 dhe 2021

➤ *Veprimtaria e Seksionit të Administratës*

Veprimtaria e Seksionit të Administratës, edhe për vitin 2021, është përqendruar në monitorimin e disa prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, të garantuara dhe parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut me Protokollet e saj Shtesë, si më poshtë vijon:

E drejta e pronës vijon të mbetet një prej të drejtave më të prekshme, të cënueshme dhe relevante në objektin e punës së Seksionit të Administratës. Nga gjithë kompleksiteti i realizimit të kësaj të drejte, çështje të tilla si ajo e regjistrimit të pronave, legalizimit të objekteve informale si dhe procedurat e shpronësimit të pronave pa një proces të rregullt ligjor mbeten nga çështjet më problematike e të mprehta. Në lidhje me të drejtën e pronës, Seksioni i Administratës ka ndjekur dhe vijon të ndjekë me kujdes të shtuar e me vëmendje të veçantë realizimin e këtyre të drejtave duke hartuar dhe dërguar një sërë rekomandimesh organeve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe lokal.

Strehimi dhe e drejta e banesës rezultojnë të jenë ndër çështjet më të mprehta sociale për vitin 2021. Problematikat kryesore të evidentuara lidhen me; mungesën e realizimit të procedurave transparente dhe konform proceseve të rregullta ligjore; mungesë transparence mbi aktet apo dokumentat që e hartuara për këtë qëllim dhe me pasoja për individët; zvarritje të procedurave të shqyrtimit të dosjeve përkatëse; mungesë transparence gjatë procedurave të përcaktimit të kriterëve për përzgjedhjen, si dhe mungesë transparence të vendimmarrjes, e cila kalon për miratim në organet kolegjiale të njësisë të qeverisjes vendore. Kjo e drejtë është trajtuar në kompleksitet nga ky seksion edhe në vijim të ankesave/rasteve me iniciativë që janë depozituar nga qytetarët për shkak të pasojave të tërmetit të nëntorit 2019, në harmoni me të drejtën e pronësisë lidhur procedurat e shpronësimit të banesave individuale për interes publik si dhe procedurave për strehimin social.

Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative, janë çështje që vazhdojnë të trajtohen nga Seksioni i Administratës, si një nga problematikat kryesore të shqyrtimit të ankesave/kërkesave për largimet, lirimet, transferimet, emërimet nga puna në administratën shtetërore të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil. Gjithashtu, janë adresuar dhe hartuar rekomandimet përkatëse për rastet që burojnë nga marrëdhënia e punës, si në nivel vendor ashtu dhe qendror.


Mbrojtja e konsumatorit është një tjetër fushë e së drejtës ku Seksioni i Administratës ka luajtur një rol proaktiv me Entin Rregullator të Energjisë (ERE), në takimet lidhur me ndryshimet në Rregulloren e tyre për afatin e trajtimit e përgjigjeve të ankesave, për rritjen e energjisë elektrike si dhe takimet zyrtare me drejtues të OSHEE e UKT për problematikat e paraqitura nga ankuesit. Janë analizuar me kujdes shpjegimet e dërguara nga institucionet si edhe të dokumentacionit të përcjellë dhe shpesh është vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës dhe mundësitë të rivënien në vend të të drejtave të shkelura.

Respektimi i lirisë së shprehjes është një tjetër fushë e rëndësishme e të drejtës që është pjesë e punës dhe veprimtarisë të Seksionit të Administratës. Në këtë aspekt janë monitoruar në vazhdimësi diskutimet e shumta në organet shtetërore shqiptare si edhe rekomandimet dhe

komentet e grupeve të interesit e partnerëve ndërkombëtarë sa i përket shërbimeve mediatike në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr. 91/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e shqipërisë", të ndryshuar datë 19.12.2019.

Në këtë drejtim, Seksioni i Administratës është treguar aktiv edhe gjatë vitit 2021 dhe nëpërmjet veprimtarisë tonë kemi synuar që të përmbushim detyrimin institucional përmes ndikimit dhe ndërgjegjësimit të strukturave shtetërore, për sjelljen në vëmendje të problematikave të shumta që paraqet ligji nr. 91/2019 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e shqipërisë", të ndryshuar, si dhe për të treguar gadishmërinë për të ofruar garancitë e standardeve ndërkombëtare për ushtrimin e rolit të medias dhe të gazetarëve në lidhje me çështje të caktuara.





Paraqitja grafike e Seksionit të Administratës në shifra për vitet 2020 dhe 2021

➤ *Veprimtaria e Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve*

Veprimtaria e Seksionit të Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve gjatë vitit 2021, është përqendruar në funksionet kryesore të mbrojtjes, promovimit dhe të garantimit të të drejtave të fëmijëve, të orientuara nga pikëpamjet dhe përvojat e fëmijëve, si dhe parimi i interesit më të lartë të fëmijës.


Në ndryshim nga viti 2020, për Avokatin e Popullit mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë vitit 2021, është parë në analizën e thelluar të ndikimit, që masat administrative të ndërmarra në kuadër të pandemisë covid-19, kanë pasur tek fëmijët. Kështu është analizuar nëse institucionet përgjegjëse shtetërore, në marrjen e këtyre vendimeve kanë pasur në fokus parimin e interesit më të lartë të fëmijës, në tre aspekte thelbësore:

- *mirëqenia fizike* në drejtim të sigurimit të shëndetit të mirë dhe zhvillimit të duhur të fëmijës;
- *mirëqenia mendore*, nëpërmjet ofrimit fëmijës, mundësinë për një zhvillim normal mendor;
- *mirëqenia sociale* në drejtim të sigurimit të mundësisë së fëmijës për një jetesë të shëndetshme shoqërisht dhe shpirtërisht.

Garantimi i mirëqenies së fëmijës në interesin më të lartë të tij, kërkon angazhimin e institucioneve përgjegjëse shtetërore në vijëmbësi, për konsolidimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës dhe rritjen e efektivitetit të tij. Një sistem i tillë efektiv, që përfshin ligjet, politikat, procedurat dhe praktikatat, parandalon dhe lufton problemet e ndryshme të keqtrajtimin, dhunës së çfarëdo lloj forme dhe diskriminimit, që mund të dëmtojnë mirëqenien e një fëmije, në aspektin e zhvillimit fizik,

mendor e social. Por jo vetëm, parësore për shoqërinë si e tërë, mbetet lufta kundër praktikave zakonore dhe mentaliteteve “*tabu*”, që çojnë dhe nxisin diskriminimin, keqtrajtimin dhe dhunën ndaj fëmijëve.

Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve, veprimtarinë e tij administrative në vitin 2021, në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, në zbatimin e interesit më të lartë të tyre, e ka përkthyer kështu:



Në krahasim me vitin 2020, gjatë vitit 2021, Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve në kuadër të identifikimit të shkeljes/shkeljeve të të drejtave të fëmijëve, ka trajtuar 227 ankesa/kërkesa/raste me iniciativë, nga të cilat 66 të tilla “*ex-officio*” dhe 102 ankesa drejtpërdrejt nga fëmijët. Gjithashtu, janë realizuar 21 inspektime, 37 ditë të hapura, veprimtari të karakterit promovues, si dhe 28 rekomandime (në total 124 rekomandime specifike), adresuar institucioneve përgjegjëse shtetërore.

Në ndryshim nga vitet 2018, 2019, 2020¹³, viti 2021 shenoi një rritje të trajtimit të numrit të ankesave/kërkesave drejtpërdrejt nga fëmijët, në 102 të tilla. Rritja e numrit të ankesave/kërkesave nga vetë fëmijët ka ardhur si rezultat i një pune 3 (tre) vjeçare të Institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet Komisionerit dhe Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, për të garantuar aksesin dhe lehtësinë e arritjes së AP-së nga ana e fëmijëve, duke i vendosur ata në qendër të veprimtarisë sonë ligjore dhe administrative. Po kështu, edhe bashkëveprimi me fëmijët dhe shoqërinë civile në veprimtaritë promovuese, kanë qenë një tregues i garantimit të lirisë së mendimit dhe shprehjes, pjesëmarrjes dhe dëgjimit të zërit të fëmijëve, duke prezantuar një qasje të re, efektive të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit, në drejtim të zbatimit të interesit më të lartë të fëmijës. Ky është rezultat edhe i zbatimit të Marrëveshjes me UNICEF që ka mundësuar një pjesë të kapaciteteve njerëzore dhe financiare.

¹³ Në vitin 2018, nga 1 ankesë/kërkesë e drejtpërdrejt, adresuar nga vetë fëmijët, në vitin 2019 u administruan 10 ankesa nga vetë fëmijët, në vitin 2020, 15 të tilla dhe në vitin 2021, 102 ankesa/kërkesa u administruan drejtpërdrejt nga fëmijët.

Në kuadër të përmbushjes së funksionit monitorues, në vitin 2021, Seksioni i Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve ka realizuar *21 inspektime/monitorime, prej të cilave 6 (gjashtë) inspektime/monitorime* në komisariatet/stacionet e Policisë së Shtetit në Elbasan, Durrës, Korçë, Sarandë, Përmet dhe Kamëz, si dhe *1 (një) inspektim* në IEVP (Institutin e të Miturve) në Kavajë, për monitorimin e mjedisit dhe kushteve të trajtimit të të miturve të privuar nga liria. Pas inspektimeve të kryera dhe evidentimit të problematikave, janë hartuar rekomandime konkrete, të cilat i janë adresuar strukturave përkatëse shtetërore.

Në funksion të garantimit të të drejtave të fëmijëve, si dhe të ushtrimit të ombudsnormës, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarrë një sërë veprimtarish, të cilat kanë konkluduar me hartimin dhe publikimin/lançimin e dokumenteve të rëndësishëm (qofshin këto të natyrës rekomanduese, sugjeruese, informuese apo edhe këshilluese), në dobi të fëmijëve, organeve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor, si dhe shoqërisë civile. Gjithashtu, institucioni i AP-së, nëpërmjet KMPDF është përfshirë në fazën e konsultimit të jashtëm dhe procesit legjislativ, për disa akte normative dhe nënligjore, si dhe dokumente strategjike të propozuara në fushën e mbrotjes së të drejtave të fëmijëve.

Si anëtar i rrjetit ENOC, për herë të parë, fëmijët, përfaqësues të vendit tonë në projektin ENYA, u përzgjedhën për të marrë pjesë në në Forumin e të Drejtave Themelore (FRA) për të mësuarit për të ardhmen: ndikimi i COVID-19 në të drejtat e fëmijëve.





Paraqitja grafike e Seksionit të Fëmijëve në shifra për vitet 2020 dhe 2021

➤ *Veprimtaria e Seksionit të Përgjithshëm*

Edhe gjatë vitit 2021, Seksioni i Përgjithshëm, si pjesë e Institucionit të Avokatit të Popullit, ka vazhduar ti kushtojë një vëmendje të posaçme grupeve, komuniteteve dhe individëve vulnerabël apo në risk, të cilët janë më të cënueshëm dhe të pambrojtur nga pjesa tjetër e popullsisë nga pasojat e situatës së jashtëzakonshme, të krijuar nga pandemia e Covid 19.

Në kuadër të kësaj veprimtarie theksojmë se, vazhdon të mbetet aktual në objektin e tij, rekomandimi i Avokatit të Popullit, për përmbylljen e procesit të nxjerrjes së akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim, të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.¹⁴ Sikurse kemi konstatuar në vazhdim, me miratimin dhe hyrjen në fuqi të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, deri në fund të vitit 2021, janë hartuar dhe miratuar 8 akte nënligjore. Ndërkohë, mbeten ende për t’u miratuar dhe hyrë në fuqi edhe 4 akte të tjera nënligjore. Me një fokus specifik ndaj të drejtave të minoriteteve kombëtare Rome dhe Egjiptiane, do të duhet që krahas luftës ndaj “antixhizmit”, të projektojmë politika konkrete integrimi dhe përfshirjeje reale të Romëve dhe Egjiptianëve, jo vetëm në nivelin e qeverisjes qendrore por specifikisht edhe në nivelin e vetëqeverisjes vendore, për ti bërë ata të ndihen pjesë e një shoqërie me diversitet, gjithëpranuese dhe demokratike.

¹⁴ Drejtuar me shkresën nr. K1/I10-2 datë 25.02.2020, Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Kryetarit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve.

Masa e *ndihmës ekonomike* vijoi të mbetet, në vlerësimin e ankuesve, shumë e ulët në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme për të mbijetuar. Lidhur me të drejtën për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore, konstatohet se problematikat vijnë të jenë të njëjta apo të ngjashme me ato të raportura në vitet pararendës, ku vend jo të vogël ka zënë trajtimi i ankesave lidhur me mosmarrjen e përgjigjes lidhur me kërkesën, për verifikimin e vjetërsisë së punës, si dhe për masën e ulët të përfitimit të pensionit të pleqërisë.

Raporti i veçantë “*Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri*”, i përgatitur dhe dërguar në Kuvendin e Shqipërisë gjatë vitit 2021, ka synuar kryerjen e një vlerësimi të situatës ekonomike, ligjore dhe sociale lidhur me vakumin normativ të mospërcaktimit të minimumit jetik, si përkufizim dhe si bazë, jo vetëm për Ndhmën Ekonomike, por edhe për politikat e tjera në mbështetje të individëve dhe familjeve të varfëra në Shqipëri. Ky raport përmban si rekomandim kryesor të tijin, hartimin dhe miratimin e metodologjisë për llogaritjen e minimumit jetik në Republikën e Shqipërisë, që do të shërbejë si udhërrëfyes dhe referencë zyrtare për llogaritjen periodike të Minimumit Jetik.

Sikurse kemi theksuar që në krye të herës, pandemia ka kompromentuar thellësisht nivelin aktual të *arsimimit*, duke e përkeqësuar atë. Qasja alternative, e adoptuar nga qeveria, për zhvillimin e mësimin dhe edukimit përmes platformave on-line të edukimit, është implementuar me jo pak sfida. Këto vështirësi lidhen edhe me mësuesit në mungesë të trajnimit për ofrimin dhe dhënien e mësimin on-line.

Në zbatim të rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë,¹⁵ Seksioni i Përgjithshëm në bashkëpunim me ekspertë të kujdesit shëndetësor përgatiti një raport për “*Monitorimin e ofrimit të shërbimeve me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara falas për qytetarët dhe adresimin e kundërvajtjeve sistematike*”. Nisur nga gjetjet e pasqyruara në këtë raport, janë dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

Vazhdimi i pandemisë së Covid-19, ka evidentuar në kuadër të respektimit të së drejtës për *përkujdesje shëndetësore* cilësore, faktin se individët e varfër dhe të cënueshëm financiarisht janë përballur me kosto të larta ekonomike shtesë sa i përket kujdesit shëndetësor. Ankesat dhe rastet me iniciativë të shqyrtuara nga ana e Avokatit të Popullit, evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: trajtimi mjekësor jo konform standardeve; burokracia lidhur me rradhët e pritjes në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT) dhe spitalet Covid; mungesa e protokolleve mjekësore të trajtimit të Covid-19; mungesa e mjeteve mbrojtëse për personelin mjekësor dhe mungesa e dezinfektantëve në spitale e poliklinika, apo edhe mungesa e personelit mjekësor dhe infermier në spitale rajonale dhe zona rurale.

Në zbatim të Rezolutës së sipërcituar është hartuar dhe dorëzuar në Kuvendin e Shqipërisë raporti “*Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën Janar 2020-Shtator 2021*”, i cili jep informacion jo vetëm mbi situatën e dhunës në marrëdhëniet familjare por trajton edhe çështje që kanë të bëjnë edhe me format e tjera të dhunës ndaj grave. Raporti synon të evidentojë në veçanti problematikat në lidhje me legjislacionin dhe masat e ndërmarra për luftën e dhunës

¹⁵ Miratuar në datë 07.07.2021.


ndaj grave nga institucione të ndryshme, sipas përgjegjësiave ligjore dhe institucionale, si dhe të paraqesë rekomandime konkrete.

Problematikat e konstatuara për *personat me aftësi të kufizuar* kanë qënë të shumta. Ato kanë konsistuar në, furnizimin me paketa ushqimore dhe të mbështetjes ekonomike të personave me aftësi të kufizuar, veçanërisht ata që banojnë në zonat e thella apo personave të pastrehë, të cilët janë me aftësi të kufizuar, etj. Sërish, mungesa e aksesit në mjediset publike dhe private, në marrjen e infomacionit, aksesit në drejtësi, vonesa në lëvrimin e fondeve për personat me aftësi të kufizuar, moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, moszbatimi i rimbursimit të biletës në transportin urban, i mjeteve didaktike të posaçme, mbeten problematika ende të pazgjidhura për këtë kategori individësh.

Grupimi i të moshuarve, si një ndër grupet më vulnerabël, ka qënë më i predispozuar ndaj problemeve shëndetësore, dhe më i godituri në rrezikshmërinë për humbje jete gjatë pandemisë. Institucioni i Avokatit të Popullit, ka bërë thirrje për solidaritet shoqëror, duke iu drejtuar autoriteteve shtetërore, me kërkesën specifike për zgjerimin e gamës së shërbimeve sociale të ofruara për këtë kategori, veçanërisht për të moshuarit me aftësi të kufizuar dhe ata që janë të vetmuar. Mbetet domosdoshmëri miratimi i ligjit “*Për statusin e moshës së tretë*”, për të mbështetur plotësisht dhe efektivisht pjesëmarrjen e të moshuarve në shoqëri, bazuar në nevojat dhe preferencat e tyre.

Komuniteti LGBTIQ vazhdoi të ballafaqohet me problematika të shtuara përgjatë vitit 2021, të tilla si: ekonomia e përkeqësuar, punësimi, strehimi dhe siguria, si dhe mundësinë e komunitetit LGBTIQ për të plotësuar nevojat e tij bazike. Papunësia e lartë mes anëtarëve të komunitetit LGBTIQ, ka të bëjë me faktin se ky komunitet vuan nga numri i lartë i papunësisë sistemike, për shkaqe të tilla si: diskriminimi, bullizmi dhe largimi i komunitetit LGBTIQ nga sistemi arsimor.





Paraqitja grafike e Seksionit të Përgjithshëm në shifra për vitet 2020 dhe 2021

3.2 Të drejtat e personave të privuar nga liria¹⁶

Edhe gjatë vitit 2021, pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19 ka diktuar në një farë mase punën tonë për të verifikuar ankesat e të burgosurve, gjithsesi kemi patur një rikthim të kujdesshëm në normalitet, duke kryer veprime hetimore në vend kur ka qenë e domosdoshme. Në fokusin e punës së Avokatit të Popullit kanë vijuar të jenë disa çështje të trajtuara ndër vite nga ana jonë.

Avokati i Popullit në përmbushje të misionit të tij kushtetues e ligjor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të shtetasve ka marrë në shqyrtim ankesën e bërë nga Dhoma Vendore e Avokatisë Shkodër që ka ngritur shqetësimin e ligjshëm lidhur me një shkresë e cila i është dërguar I EVP-ve në shkallë vendi nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, e cila nuk ka pasur elementët e nevojshëm të një akti administrativ por ka prodhuar pasoja juridike. Mbrojtësve ligjorë u është mohuar e drejta për të hyrë në I EVP-të dhe marrë takim me klientët e tyre të burgosur që kanë lëshuar akte përfaqësimi të firmosura nga ata vetë dhe të vërtetuara nga drejtuesit e këtyre institucioneve. Referuar kësaj shkrese të shpërndarë në të gjitha I EVP-të, aktet e përfaqësimit të të burgosurve duhen bërë para noterit publik edhe pse është i njohur botërisht fakti që asnjë noter në vendin tonë nuk e ushtron aktivitetin në ambientet e regjimit të brendshëm të ndonjë burgu.

Sqarojmë se pas administrimit të kësaj ankese nga institucioni ynë, në datën 04.12.2021 është bërë publik në media lajmi se me urdhër të Ministrit të Drejtësisë është shfuqizuar urdhri i datës

¹⁶ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në institucionin e Avokatit të Popullit.

17.11.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, në të cilin u kërkohet të burgosurve që për zgjedhjen e avokatit të firmosnin prokurën në prani të një noteri. Paraprakisht shprehim vlerësimin tonë lidhur me qëndrimin koherent dhe pozitiv të mbajtur nga Ministri i Drejtësisë për shfuqizimin e një akti të tillë që sjell pasoja lidhur me respektimin e të drejtës themelore të shtetasve për t'u mbrojtur me avokat, e konkretisht të shtetasve të burgosur në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale.

Pavarësisht se akti për të cilin na është drejtuar me ankesë Dhoma Vendore e Avokatisë Shkodër është shfuqizuar, nxitur nga ky rast por edhe faktit se problematika të tilla janë konstatuar edhe më parë nga strukturat e institucionit të Avokatit të Popullit gjatë inspektimeve të kryera në strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe në IEVP-të në shkallë vendi, vlerësuam të nevojshëm trajtimin e kësaj çështjeje. Herë pas here janë marrë ankesa nga disa të shoqëruar, të arrestuar/ndaluar dhe të dënuar me burgim të cilët kanë ngritur shqetësimin se nuk kanë marrë takim me avokatët mbrojtës në momentet e para të kryerjes së veprimeve procedurale nga punonjësit e Policisë së Shtetit, si dhe të administratës së IEVP-ve në rastin e të burgosurve. Sjellim në vëmendje se edhe më parë kemi shprehur qëndrimin institucional në lidhje me ushtrimin e të drejtës së mbrojtjes me avokat të shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar dhe dënuar penalisht me burgim gjatë kryerjes së procedurave administrative apo penale në organet e Policisë së Shtetit si dhe në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (IEVP) në shkallë vendi.

Në përfundim të analizës tonë iu drejtuam Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, 22 Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale dhe 12 Drejtorive Vendore të Policisë me rekomandime¹⁷ për: marrjen e masave të nevojshme nga strukturat e Policisë së Shtetit dhe të IEVP-ve për të respektuar të drejtën ligjore të mbrojtjes së personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar, paraburgosur e dënuar me burgim, si dhe lejimin e avokatëve të takohen me këto subjekte në çdo kohë dhe sa herë kërkohen prej tyre; marrjen e masave të nevojshme për trajnimin në vijimësi të punonjësve të Policisë së Shtetit dhe të IEVP-ve në shkallë vendi me qëllim njohjen dhe respektimin me rigorozitet të të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve; marrjen e masave organizative nga strukturat qëndrore të Ministrisë së Drejtësisë për ushtrimin e të drejtës së kontrollit të ligjshmërisë së akteve nënligjore të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me qëllim që shkelje të tilla të të drejtave ligjore të personave të burgosur të mos përsëriten në të ardhmen.

Avokati i Popullit gjatë veprimtarisë së tij dhe trajtimit të ankesave, gjithashtu ka konstatuar se, ndonëse ka kaluar afati ligjor i parashikuar në nenin 91 të ligjit të ri nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", ende nuk është miratuar Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve, e parashikuar në nenin 60/3 të këtij ligji dhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur (KDPM).

Referuar nenit 91 të ligjit nr. 81/2020, përgatitja dhe miratimi i Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve duhet të ishte bërë brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi i këtij ligji¹⁸.

¹⁷ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20lidhur%20me%20te%20drejten%20e%20mbrojtjes%20me%20avokat%20te%20personave%20te%20shoqeruar,%20arrestuar,%20ndaluar,%20denuar.pdf>

¹⁸ Sqarohet se ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 137, datë 23.07.2020 dhe ka hyrë në fuqi në datën 08.08.2020. Pra, afati 6 muaj është plotësuar në datën 08.02.2021.

Përveç sa më sipër, ne vlerësojmë se mos miratimi i Rregullores së re të Përgjithshme të Burgjeve krijon premisa për cënimin e të drejtave të të burgosurve nga administrata e IEVP-ve.

Në përfundim të analizës tonë iu drejtuam me rekomandim¹⁹ Ministrisë së Drejtësisë për: marrjen e masave të nevojshme dhe të menjëhershme nga strukturat e këtij institucioni për përgatitjen e Rregullores së re të Përgjithshme të Burgjeve në bazë e për zbatimin e ligjit nr. 81/2020 dhe të KDPM-së; dërgimin e Projekt Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve për marrje mendimi institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe të drejtave të fëmijëve; marrjen e masave të nevojshme për dërgimin për miratim të kësaj Rregulloreje në Këshillin e Ministrave.

Vlerësojmë qëndrimin koherent dhe pozitiv të mbajtur nga Ministria e Drejtësisë që në vijim na ka dërguar për mendim projektvendimin e Rregullores së re të Përgjithshme të Burgjeve dhe relacionin shoqëruar, duke bashkëpunuar dhe organizuar takime të përbashkëta në funksion të përmirësimit të draftit përkatës për të garantuar të drejtat e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve.

Në objektin e punës tonë ka qenë edhe çështja e miratimit të aktit nënligjor për punësimin e të burgosurve dhe shpërblimin e tyre, në proporcion me sasinë dhe cilësinë e punës së kryer.

Punësimi i të burgosurve është një kontribut i rëndësishëm në rehabilitimin dhe përgatitjen e tyre për t'u integruar në shoqëri. Legjislacioni i vendit tonë parashikon jo vetëm punësimin e të burgosurve, por edhe shpërblimin me para për punën e kryer. Punësimi i tyre ka si qëllim jo vetëm fitimin dhe zhvillimin e aftësive për punë dhe njohuri profesionale, por nga ana tjetër shpërblimi për punën e kryer është një mundësi që u jep të burgosurve një ndjenjë pavarësie, të cilën e kanë humbur gjatë vuajtjes së dënimit dhe njëkohësisht lehtëson barrën financiare të familjarëve pasi disa prej tyre mund t'i kenë familjet në kushte të vështira ekonomike dhe ngarkohen me kosto shtesë për takimet që kryejnë në burgje.

Në vitin 2013, i është dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projekt VKM-së për përcaktimin e kriterëve të shpërblimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Pavarësisht interesimit tonë të përvitshëm, ky akt është miratuar vetëm së fundi, në vitin 2021, me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimit të saj”*, ku ndër të tjera përcaktohet pagesa për punën e siguruar nga administrata e IEVP-së dhe nga subjekte private. Në vijim të punës sonë mbetet për t'u vlerësuar dhe monitoruar interesi i subjekteve private për të punësuar persona të burgosur dhe si do të zbatohet akti nënligjor në fjalë, për të garantuar të drejtën e tyre për të kryer një punë të denjë.

Sa i përket ankesave të të burgosurve që kanë të bëjnë me trajtimin shëndetësor, gjatë hetimit të tyre kemi vlerësuar se një nga veprimet e nevojshme hetimore është këqyrja e kartelës klinike. Në këtë mënyrë për të verifikuar pretendimet e ankuesve krijohet një tablo më e qartë mbi veprimet

¹⁹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimi%20per%20pergatitjen%20dhe%20dërgimin%20per%20miratim%20ne%20KM%20te%20Rregullores%20se%20Përgjithshme%20te%20Burgjeve.pdf>

apo mosveprimet e kryera nga stafi përkatës i administratës së I EVP-së. Evidentojmë faktin se, në pothuajse të gjitha rastet kemi hasur vështirësi për të kuptuar në mënyrë të qartë e të plotë të gjitha shënimet e lëna nga mjekët, duke përfshirë si stafin mjekësor (mjekët/infermierët) të I EVP-ve ashtu dhe mjekët specialistë të spitaleve ku të burgosurit janë dërguar për konsulta dhe ekzaminime specifike, kjo për shkak të shkrimit me dorë të pakuptueshëm. Pas këqyrjes ndër vite të dhjetëra kartelave klinike të të burgosurve, është ngritur shqetësimi lidhur me shënimet jo të qarta dhe të pakuptueshme të mjekëve. Shkrimi (kaligrafia) i pakuptueshëm mund të çojë në keqkuptime të stafit shëndetësor. Leximi, e më tej zbatimi i gabuar i shënimeve mund të sjellë si pasojë mjekimin e gabuar apo dhënien e dozës së gabuar duke rrezikuar në mënyrë të pajustificuar shëndetin dhe jetën e pacientit. Dokumentet e kartelës klinike të pacientit nuk janë eskuzivitet i mjekut që i përpilon ato. Shënimet duhet të jenë të lexueshme nga çdo mjek, staf shëndetësor, autoritet që ka kompetencë të njihet me të dhënat e pacientit, familjarë si dhe nga vetë pacienti. Nga ana jonë gjatë trajtimit të një rasti, u çmua me rëndësi përmirësimi i kësaj situatë duke i rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve marrjen e masave për plotësimin në mënyrë të qartë e të kuptueshme të dokumenteve mjekësore të lëshuara nga mjekët si dhe marrjen e masave për kalimin për aq sa është e mundur nga përshkrimi me shkrim dore i tyre, në formë elektronike.²⁰

Kujdesi shëndetësor ndaj të burgosurit sigurohet nga administrata e I EVP-ve në bashkëpunim me qendrën spitalore të burgjeve dhe me organet shtetërore përkatëse të shëndetësisë. Si shumë institucione publike, edhe I EVP-të u vendosën në kushte jo pak të vështira me shpalljen e pandemisë globale. Me qëllim parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19 në sistemin e burgjeve u morën disa masa kufizuese, ndër to edhe ndërprerja e konsultave dhe ekzaminimeve jashtë I EVP-së, përveç urgjencave mjekësore. Lehtësimi i masave kufizuese të diktuar nga situata e pandemisë dhe shifrat e raportuara nga institucionet përgjegjëse janë shoqëruar me marrjen e masave konkrete për të dërguar të burgosurit për vizitë mjekësore apo konsulta me mjekë të specializuar jashtë I EVP-së. I burgosuri S.G, i cili referonte të kishte probleme me zemrën, është dërguar nga I EVP Krujë dy herë në pavionin e Kardiologjisë në QSUT “Nënë Tereza” për të kryer provën ushtrimore, por kjo e fundit nuk është realizuar pasi ky departament ka qenë i mbyllur për arsye të pandemisë. Kjo ishte përgjigja verbale që kishte marrë stafi i I EVP Krujë në lidhje me rastin. Pas interesimit tonë në QSUT “Nënë Tereza”, na është kthyer përgjigje se pavioni i Kardiologjisë ka qenë i hapur dhe funksional edhe gjatë periudhës së pandemisë. Në këto rrethana, evidentuam se kishte një mungesë bashkërendimi të punës ndërmjet organeve përkatëse ndaj i rekomanduam I EVP Krujë përmirësimin e procedurës së komunikimit me institucionet spitalore publike jashtë I EVP-së. Nga ana jonë u çmua se komunikimi shkresor në vend të atij verbal do të ishte më i volitshëm në raste të tilla për të provuar të gjitha veprimet e kryera nga administrata e burgjeve në funksion të garantimit të trajtimit të shërbimit shëndetësor shtetasve të burgosur.

Në një rast tjetër që kemi marrë në shqyrtim, është hetuar mbi rezistencën pasive të një të burgosuri ndaj urdhrin për ndërrimin e dhomës, urdhër të cilin ai e konsideronte si të padrejtë. Përdorimi i forcës fizike dhe i mjeteve shtrënguese nga punonjësit e Policisë së Burgjeve në disa situata është

²⁰ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20plotesimin%20ne%20menyre%20e%20kuptueshme%20te%20dokumentave%20mjekesore.pdf>

i pashmangshëm gjatë detyrës së tyre, për të ruajtur rendin dhe sigurinë në IEVP. Disa të burgosur, për shkaqe dhe rrethana të ndryshme, nuk u binden urdhrave të stafit të IEVP-së. Në rastin konkret të trajtuar, punonjësit e Policisë së IEVP Korçë kanë lëvizur forcërisht të burgosurin nga një dhomë në një tjetër. Ky i burgosur ka paraqitur ankesë në institucionin tonë për ushtrim dhune fizike. Në përfundim të hetimit, nuk u provua pretendimi për tejkalim të forcës, por u konstatua se nga ana e stafit nuk është ushtruar kontrolli mjekësor i të burgosurit, detyrim që duhet të përmbushej në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe rekomandimeve të CPT-së, në rastet kur përdoret forcë për të kontrolluar veprimet e të burgosurit. Sipas këtyre parashikimeve, kontrolli mjekësor nuk lidhet vetëm me rastet kur ka patur ushtrim dhune fizike apo kur raportohen dëmtime trupore. Në çdo rast të përdorimit të forcës ndaj të burgosurit, mjeku i IEVP-së duhet të ekzaminojë të burgosurin, pasi mund të ketë tejkalim të forcës apo i burgosuri mund të pësojë dëmtime, qoftë edhe në kushtet e ligjshmërisë të kryerjes së veprimeve të punonjësve të policisë. Kjo vizitë duhet të pasqyrohet në kartelën klinike të të burgosurit, si çdo vizitë tjetër e mjekut të IEVP-së. Në përfundim nga ana jonë iu rekomandua²¹ Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Korçë marrja e masave për përmbushjen e këtij detyrimi ligjor.

Ankesa e një të burgosuri tjetër na ka vënë sërish në lëvizje për të verifikuar trajtimin e tyre gjatë shoqërimit me automjet nga një IEVP në një tjetër apo nga IEVP-ja për në gjykatë dhe anasjelltas. Më konkretisht, i burgosuri është ankuar se gjatë kohëzgjatjes së udhëtimit nga IEVP “Jordan Misja” për në IEVP Fier, ka patur disa ndalesa për të marrë dhe dorëzuar bashkëvuajtës të tjerë që udhëtonin në të njëjtin automjet. Ky udhëtim ka zgjatur disa orë, gjatë të cilit i burgosuri u ka kërkuar ujë për të pirë punonjësve të policisë të burgjeve që e shoqëronin, por i është dhënë për të konsumuar vetëm patatina të blera nga këta punonjës me shpenzimet e tyre. Në përfundim të hetimit të ankesës çmuam se, sigurimi i ushqimit për të burgosurit dhe stafin shoqërues në rastet e shoqërimit për arsye të pjesëmarrjes në proceset gjyqësore, vizita mjekësore dhe qëllime të tjera (nëse distanca është e largët dhe pritja është e gjatë), jo vetëm është detyrim që buron nga aktet nënligjore, por është edhe trajtim njerëzor i të burgosurve, të cilët qëndrojnë për një kohë të gjatë në kushtet e automjetit (veçanërisht kur kemi të bëjmë me të burgosur të mitur, femra dhe ata me probleme shëndetësore që kanë nevojë të veçanta), është trajtim në përshtatje me detyrën që po kryejnë punonjësit e burgjeve, të cilët gjithashtu kalojnë kohë të gjatë në automjet, në kushte dhe stres të shtuar. Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve iu rekomandua marrja e masave të nevojshme për sigurimin e një vakti ushqim dhe ujë të pijshëm për të burgosurit gjatë shoqërimit të tyre me automjet, nëse distanca është e largët dhe pritja është e gjatë si dhe për punonjësit (stafin) e shoqërimit.²²

Një rast i trajtuar nga ana jonë ka qenë edhe mbajtja e ndriçimit hapur në dhomat e fjetjes së të burgosurve gjatë orëve të natës. Kjo çështje është trajtuar edhe nga Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor ose Poshtëruës (CPT), në raportin e publikuar mbi vizitat që ka kryer në disa institucione të privimit të lirisë në Shqipëri, nga data 20

²¹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20lidhur%20me%20kontrollin%20mjekesor%20te%20te%20burgosurit%20kur%20perdoret%20force%20fizike%20E.%20M.pdf>

²² Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20trajtimin%20me%20ushqim%20tete%20burgosurve%20gjate%20shoqerimit%20i%20denuari%20O.pdf>

deri në datën 30 Nëntor 2018²³. Ky Komitet është shprehur se rregulli në fuqi lidhur me ndriçimin e qelive gjatë natës në burgje duhet të rishikohet dhe të bëhet e mundur, të paktën, për të zbehur ndriçimin artificial gjatë periudhave të gjumit. Ndriçimi gjatë natës në dhomat e fjetjes të të burgosurve është konsideruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i nevojshëm për vëzhgimin, mbikëqyrjen dhe ruajtjen e të burgosurve, parandalimin e tentativave për vetëdëmtimin, mbajtjen në parametra normal të elementëve të sigurisë si dhe parandalimin e tentativave të mundshme për arratisje. Nga ana jonë i është kërkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për të na informuar nëse ishin marrë masa për të gjetur një zgjidhje në lidhje me këtë ankesë. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na ka sqaruar se është e vështirë të gjendet zgjidhje për shkak edhe të infrastrukturës së IEVP-ve, të cilat nuk janë projektuar të kenë ndriçim reduktues. Aktualisht janë orientuar IEVP-të që të zëvendësojnë llampat e zakonshme me ato LED, me voltazh më të ulët. Kjo masë është menduar si një zgjidhje e pjesshme dhe e shpejtë e problemit. Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se nga viti 2019 e deri më tani duhet të ishte bërë një planifikim për adresimin e çështjes për të bërë të mundur që të gjendet një zgjidhje, e cila nuk do të cenonte elementët e sigurisë dhe njëkohësisht nuk do të përbënte shqetësim për të burgosurit.

Ndërsa i dënuari Sh.Sh. i është drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit me një ankesë, në të cilën pretendonte se nuk ishte informuar lidhur me përfundimin e procesit gjyqësor që kishte të bënte me kërkesën e tij për rishikimin e një vendimi të Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, me objekt bashkim dënimesh. Në përfundim të hetimit administrativ që ndërmorëm u konstatua se komunikimi i vendimit të gjykatës lidhur me kërkesën e këtij shtetasi për rishikimin e vendimit gjyqësor ishte bërë në adresën e tij të banimit në Tiranë dhe jo në IEVP Rrogzhinë (vendi ku ai vuante dënimin), ashtu sikurse përcaktohet në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale²⁴. Gjithashtu u konstatua se nuk është respektuar afati i përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale²⁵ lidhur me zbardhjen e vendimit nga ana e gjykatës dhe në dispozitivin e vendimit në fjalë nuk është shënuar afati për të ushtruar të drejtën e ankimit dhe gjykata ku mund të drejtohet ankuesi. Në vijim, i rekomanduam Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan marrjen e masave administrative duke garantuar zbatimin me korrektesë të dispozitave ligjore lidhur me njoftimin e vendimit të gjykatës të burgosurit në vendin e burgimit dhe shënimin në dispozitivin e vendimit penal të afatit të ankimit, gjykatës ku duhet të paraqitet ankimi dhe përlllogaritjen e afatit, për të garantuar të drejtën e ankimit të palëve në proces, në kuadër të procesit të rregullt ligjor.²⁶

Një rëndësi e veçantë nga institucioni i Avokatit të Popullit u është dhënë edhe ankesave të paraqitura nga punonjës të administratës së burgjeve, jo vetëm për faktin se edhe kjo kategori është subjekt i punës sonë për sa i përket të drejtave që gëzojnë, por edhe se mënyra e trajtimit të tyre pasqyrohet në marrëdhëniet me të burgosurit. Ankesat e paraqitura nga punonjësit e IEVP-ve kanë patur si objekt largimin e padrejtë nga detyra, mosdhënien e dietave, mosdhënien e kompensimit të koston të transportit nga vendbanimi në vendin e punës dhe mosderdhjen e kontributeve

²³ Raporti i Komitetit Europian për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin Çnjerëzor ose Poshtëruar (CPT) të Këshillit të Evropës, i bërë publik në datën 17.09.2019.

<https://www.coe.int/en/ëeb/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-3>

²⁴ Neni 139 i Kodit të Procedurës Penale.

²⁵ Neni 386 “Depozitimi i vendimit” i Kodit të Procedurës Penale.

²⁶ Për më shumë informacion, drejtohu në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Gjykatës%20Elbasan%20lidhur%20me%20njoftimin%20dhe%20permbajtjen%20e%20dispozitivit%20te%20vendimit%20penal.pdf>

suplementare. Hetimet administrative që ndërmorëm janë përqëndruar në dy raste: largimi nga detyra i një punonjësi të policisë së IEVP “Jordan Misja”, Tiranë dhe largimi nga detyra e drejtorit të IEVP Berat. Në gjetjet tona evidentuam se nuk është zbatuar procedura e parashikuar në ligj për zgjidhjen e marrëdhënies së punës. Në rastin e drejtorit të IEVP Berat u evidentua gjithashtu se në kontratën e punës së lidhur me drejtorët e IEVP-ve, nuk kishte të përcaktuar rregulla konkrete e të posaçme që kanë të bëjnë me procedurën e dhënies së një mase disiplinore. Ndërsa në çështjen e punonjësit të policisë së IEVP “Jordan Misja”, Tiranë u kërkua rishikimi i urdhrin për largimin e tij dhe rikthimi i tij në detyrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve si dhe plotësimin e të gjithë kërkesave që kanë të bëjnë me përmbajtjen e vendimit si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, kur ndaj punonjësit të Policisë së Burgjeve jepet masë disiplinore. Nga ana jonë çmohet se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe Ministria e Drejtësisë duhet të tregojnë një qasje tjetër kur marrin vendim për largimin nga detyra të një punonjësi të administratës së burgjeve, veçanërisht të atyre të nivelit komandues, jo vetëm se largohet nga radhët e administratës një punonjës me përvojë profesionale dhe eksperiencë të konsiderueshme pune, për të cilin është shpenzuar kohë dhe buxhet për t’u përgatitur, por nga ana tjetër ulet besimi tek punonjësit e tjerë të policisë së burgjeve për vlerësimin e meritave dhe profesionalizmit.

3.3 Respektimi i të drejtave të njeriut nga organet e Policisë së Shtetit²⁷

Gjatë vitit 2021, objekti i rasteve me iniciativë dhe ankesave të administruara²⁸ në institucionin e Avokatit të Popullit ndaj strukturave dhe punonjësve të Policisë së Shtetit ka qenë i larmishëm, ku do të evidentonim rastet për shoqërime të paligjshme apo mbajtje në gjendje shoqërimi tej afatit ligjor; për keqtrajtime fizike ose psikologjike në momentet e arrestimit, shoqërimit apo gjatë marrjes në pyetje të shtetasve në organet e policisë; për arrestime apo ndalime të paligjshme; për kushte të pa përshtatshme të ambienteve të shoqërimit; për mos marrje, mos administrim ose mos ndjekje të kallëzimeve apo ankesave të bëra prej tyre; për cënimin e privatësisë nëpërmjet ushtrimit të kontrolleve të banesave dhe mjediseve të tjera në pronësi të shtetasve; për pengim të lëvizjes së lirë për të dalë lirisht jashtë shtetit; për mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale lidhur me detyrimet financiare ndaj shtetasve; për refuzim të njoftimeve të OJF-ve apo të grupimeve të ndryshme të qytetarëve për të ushtruar të drejtën kushtetuese të tubimit gjatë pandemisë së shkaktuar nga COVID-19; për mos dhënie të informacionit dhe të dokumenteve të kërkuara nga shtetasit; për vendosje të masave administrative nga punonjësit e Policisë Rrugore; për mos mbajtje dhe mos dhënie të procesverbaleve për veprimet e kryera nga punonjësit e policisë; për refuzim të shtetasve për t’u pranuar në Akademinë e Sigurisë; për shkelje të të drejtave të shtetasve të huaj në Shqipëri dhe për refuzimin e pajisjes së tyre me leje qëndrimi; për cënim të të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit lidhur me mos ekzekutimin e vendimeve gjyqësore dhe me marrëdhëniet e punës, etj.

Në rastet kur nga ana jonë ka përfunduar hetimi dhe janë evidentuar shkelje të të drejtave kushtetuese dhe ligjore të shtetasve, janë bërë rekomandimet përkatëse që sipas tipologjisë dhe objektit të tyre, mund të përmenden si më poshtë vijon:

²⁷ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në Institutin e Avokatit të Popullit.

²⁸ Numri i rasteve me iniciativë dhe ankesave të administruara për vitin 2021 është 89.

➤ *Shoqërimi i shtetasve në organet e Policisë së Shtetit, respektimi i kriterëve ligjore dhe i të drejtave të tyre*

Shoqërimi i shtetasve në organet e policisë është një veprim administrativ rutinë në veprimtarinë e strukturave vendore të këtij organi. Por, për arsye se shoqërimi sjell si pasojë kufizimin e lirisë së tyre, ndonëse deri në dhjetë orë, kjo e drejtë e dhënë me ligj duhet të aplikohet në mënyrë korrekte e rigoroze konform kriterëve të përcaktuara qartësisht në nenet 6/25, 109 dhe 122/1 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe në Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Nga shqyrtimi i disa ankesave dhe nga inspektimet e bëra në organet e Policisë së Shtetit kemi konstatuar se numri i personave të shoqëruar ka qenë i lartë dhe veçanërisht në rastet e protestave/tubimeve të organizuara nga subjekte të ndryshme, organizata të shoqërisë civile dhe grupime qytetare.

Ndërkohë theksojmë se shoqërimi i shtetasve në organet e Policisë së Shtetit sjell edhe shqetësime të tjera për të shoqëruarit për shkak të mungesës së kushteve të ambienteve të shoqërimit, sikurse mund të përmendim mungesën e numrit të dhomave të shoqërimit, mungesën e orendive të nevojshme për të qëndruar ulur, mungesën e kushteve higjieno-sanitare, mungesën e dezinfektantëve anti COVID-19, etj.

Për rrjedhojë kjo gjendje faktike ka sjellë si pasojë edhe trajtimin jo në mënyrë humane të shtetasve të shoqëruar. Theksojmë se ky problem është evident edhe në Komisarariatet e Policisë Tiranë dhe respektivisht në Komisarariatet nr. 1, 2, 3, 4 e 5, nga 6 Komisariate që janë gjithsej në kryeqytet, ku banon gati gjysma e popullatës së vendit.

Problematika të tilla u konstatuan nga institucioni i Avokatit të Popullit në rastin e filluar me iniciativë pas zhvillimit të protestave në qytetin e Tiranës nga grupime qytetarësh, kryesisht të rinj, nga data 9 deri më 13 dhjetor 2020 për shkak të vrasjes së shtetasit K.R. nga një punonjës i Policisë së Shtetit. Kjo ngjarje e rëndë shkaktoi reagimin e qytetarëve në mbarë vendin, të cilët kërkuan zbardhjen sa më parë të saj dhe vendosjen para drejtësisë të personit përgjegjës. Në ditët në vijim u mbajtën disa protesta në qytete të ndryshme të vendit, ku pjesëmarrës ishin kryesisht të rinj, mes tyre edhe persona jo madhorë, nën moshën 18 vjeç. Në Tiranë, protestat ishin të shpërndara në disa zona të qytetit, në të cilat janë shënuar edhe raste ku disa pjesëmarrës kanë kryer veprime të dhunshme ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit, duke i goditur ata me sende të forta, duke dëmtuar disa godina të institucioneve shtetërore dhe objekte publike. Për këto akte institucioni i Avokatit të Popullit ka mbajtur qëndrim publik, si të papranueshme dhe të pajustificuara pavarësisht indinjatës së qytetarëve për shkak të ngjarjes së ndodhur. Në të gjitha rastet, Avokati i Popullit ka bërë thirrje për ushtrimin në mënyrë paqësore të së drejtës së protestës duke kërkuar vetëpërmbytje nga të gjitha palët.

Gjatë protestave apo fill pas tyre janë shoqëruar një numër jo i vogël protestuesish. Nga inspektimi i bërë nga grupet e ekspertëve në ambientet e Komisariateve dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë u konstatuan disa problematika që cenonin të drejtat ligjore të të shoqëruarve dhe arrestuarve, sikurse mund të theksojmë: numri i lartë i të shoqëruarve dhe arrestuarve ndër të cilët edhe të mitur; mungesa e dezinfektantëve dhe e maskave mbrojtëse nga Covid-19; shoqërimi i disa të miturve nën moshën 14 vjeç; mos plotësimi i Formularit të Raportit të Shoqërimit për të miturit

e shoqëruar; mos kryerja e kontrollit mjekësor të disa personave të arrestuar dhe mos plotësimi i kartelave shëndetësore; kushtet e papërshtatshme në ambientet e shoqërimit dhe sigurimit; mos informimi i familjarëve të disa të arrestuarve për vendndodhjen e tyre, në veçanti për ata të transferuar në komisariate jashtë qytetit të Tiranës për mungesë kapacitetesh; pyetja e të arrestuarve pa praninë e avokatit, etj.

Pas përfundimit të hetimit mbi bazën e gjetjeve tona i rekomanduam²⁹ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë: marrjen e masave të nevojshme për respektimin me rigorozitet të kriterëve ligjore gjatë shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit; marrjen e masave të nevojshme për zbatimin e detyrimeve ligjore për plotësimin e Formularit të Raportit të Shoqërimit në çdo rast shoqërimi të shtetasve sapo ata sillen në organin e Policisë, pavarësisht moshës së tyre; marrjen e masave të nevojshme për kryerjen sa më shpejtë të vizitave mjekësore shtetasve të arrestuar/ndaluar dhe plotësimin e kartelave mjekësore të tyre brenda afatit ligjor prej 12 orë nga arrestimi/ndalimi; marrjen e masave të nevojshme për pajisjen e shtetasve të shoqëruar, arrestuar/ndaluar me mjetet mbrojtëse anti Covid-19, si maska, dezinfektantë, detergjentë, etj, konform akteve normative në fuqi; marrjen e masave të nevojshme për trajnimin në vazhdimësi të punonjësve të Policisë për përdorimin e forcës dhe të mjeteve në dispozicion në përputhje me parimin e proporcionalitetit; marrjen e masave të nevojshme organizative për të reduktuar mbipopullimin e ambienteve të sigurisë sidomos në rastet e shoqërimeve dhe arrestimeve masive duke i transferuar ata në organet e tjera të Policisë së Shtetit; marrjen e masave të nevojshme për të respektuar të drejtat e personave të shoqëruar, arrestuar/ndaluar, si lejimin e avokatëve të takohen me këta subjekte në çdo kohë dhe sa herë kërkohen prej tyre, sigurimin e psikologëve dhe avokatëve që në momentet e para të shoqërimit të të miturve, si dhe njoftimin sa më shpejtë të familjarëve për vendndodhjen e tyre; analizimin e rasteve të shkeljeve ligjore, fillimin e ecurisë disiplinore dhe marrjen e masave përkatëse ndaj personave përgjegjës, si dhe përgjithësimin e tyre me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen.

Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

Me shumë shqetësim nga ana jonë janë ndjekur edhe rastet e shoqërimit të disa punonjësve të medias gjatë protestave që pasuan vrasjen tragjike të 25 vjeçarit K. R., të cilët kanë qenë në kryerje të detyrës duke raportuar në terren. Institucioni ynë pas përfundimit të hetimit administrativ ka rekomanduar³⁰ specifikisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë dhe Durrës marrjen e masave të nevojshme nga strukturat kompetente të Policisë së Shtetit për të analizuar rastet, objekt i këtij hetimi administrativ dhe nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse, në funksion të një sjellje korrekte të punonjësve të policisë në trajtimin e punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve; garantimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo

²⁹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%C3%AB%20nevojshme%20p%C3%ABr%20zbatimin%20me%20rigorozitet%20t%C3%AB.pdf>

³⁰ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20zbatimin%20me%20korrekt%C3%ABsi%20t%C3%AB%20rasteve%20dhe%20kriterëve%20ligjore%20t%C3%AB%20shoq%C3%ABrimit%20t%C3%AB%20shtetasve,%20n%C3%AB%20ambientet%20e%20organeve%20t%C3%AB%20Policis%C3%AB%20s%C3%AB%20Shtetit.pdf>

aktivitete të tjera të kësaj natyre; trajnimin në vazhdimësi të punonjësve të Policisë për përmirësimin e sjelljes së tyre në trajtimin e punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve; respektimin me rigorozitet të kriterëve ligjore gjatë shoqërimit të shtetasve në organet e Policisë së Shtetit; mos përsëritjen në të ardhmen të shkeljes së të drejtave të personave të shoqëruar në ambientet e policisë si dhe në trajtimin e punonjësve të medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre gjatë ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve.

Në vijim, jemi informuar nga strukturat e sipërpërmendura se rekomandimet tona janë mirëpritur dhe pranuar. Gjithsesi, pavarësisht këtij qëndrimi, vlerësojmë se nga ana e organeve të Policisë së Shtetit duhet të ndërmerren masa dhe veprime më konkrete dhe të efektshme në zbatim të rekomandimeve specifike të dërguara nga ana jonë. Kjo pasi, edhe pas këtyre ngjarjeve kemi evidentuar sërish problematika të përsëritura, ndaj e çmojmë të nevojshme trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë lidhur me rolin dhe misionin e mediave dhe punonjësve të tyre në transmetimin e ngjarjeve për publikun.

➤ *E drejta e shtetasve për të mos iu cënuar integriteti fizik dhe trajtuar me dinjitet*

Gjatë vitit 2021 janë administruar disa ankesa dhe raste të filluara me nismën e institucionit të Avokatit të Popullit pas bërjes publike në media të cilat kanë pasur si objekt ushtrim nga punonjësit e policisë të dhunës fizike e psikologjike dhe tejkalim të forcës në rastet e shoqërimit, pyetjes apo arrestimit/ndalimit të tyre si autorë të dyshuar të veprave penale, gjatë tubimeve të ndryshme të organizuara gjatë pandemisë nga grupime të ndryshme qytetarësh. Në rastet kur shkeljet e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve janë provuar, rekomandimet iu janë drejtuar strukturave të Policisë së Shtetit për fillimin e procedimeve disiplinore e dhënien e masave administrative si dhe marrjen e masave tekniko organizative për mos përsëritjen e tyre në të ardhmen.

Disa nga këto ankesa dhe raste kanë qenë si më poshtë vijon:

- Rasti i filluar me nismën e Avokatit të Popullit lidhur me ngjarjen e rëndë të ndodhur në qytetin e Tiranës në datën 8 dhjetor 2020 ku shtetasi K.R. u qëllua me armë zjarri nga një punonjës i Policisë së Shtetit dhe për pasojë humbi jetën. Punonjësi i policisë, i dyshuar si autor i veprës penale, është arrestuar nga organi i prokurorisë.

Policia e Shtetit ka ndërhyrë për të shpërndarë protestat duke përdorur forcën fizike, gaz lotsjellës dhe ujë me presion.

Përdorimi i forcës është i pashmangshëm në situata/kushte të caktuara gjatë kryerjes së veprimtarisë apo detyrave nga strukturat e Policisë së Shtetit. Punonjësi i policisë mund të ndodhet në rrethana të tilla që rrezikojnë jetën e tij apo të një personi tjetër si dhe mund të ndeshet me rezistencë të dhunshme ose pasive nga shtetas të ndryshëm. Në median vizive dhe atë elektronike u raportuan disa raste kur punonjës të Policisë së Shtetit kanë përdorur forcë të pajustificuar ndaj disa shtetasve. Nga ana jonë janë administruar pamjet filmike, të cilat janë këqyruar me vëmendje për t'u shprehur lidhur me rregullsinë e veprimeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, nëse ato ishin në përputhje me aktet normative që rregullojnë përdorimin e forcës.

Në përfundim të analizës sonë vlerësuam se të paktën në katër raste ka patur përdorim të paarsyeshëm të forcës nga ana e disa punonjësve të policisë. Raporti i hollësishëm ku përshkruhen rastet e marra në shqyrtim dhe referimi ligjor i është dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë. Këtyre institucioneve u kemi rekomanduar³¹ si vijon:

Marrjen e masave për analizimin e thellë e të gjithanshëm, me objektivitet dhe profesionalizëm të veprimeve të kryera nga disa punonjës të policisë ndaj disa shtetasve pjesëmarrës në protestat e dhjetorit 2020; fillimin e ecurisë disiplinore, identifikimin e punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore ndaj qytetarëve protestues, nxjerrjen e përgjegjësive konkrete dhe dhënien e masave disiplinore ndaj tyre; marrjen e masave nga Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat për kryerjen e veprimeve të nevojshme brënda afateve të arsyeshme për hetimin e shkeljeve ligjore të kryera nga disa punonjës të policisë ndaj disa shtetasve pjesëmarrës në protesta; marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve, për mënyrën dhe masën e përdorimit të forcës, si dhe për sjelljen me etikë dhe korrektesë me qytetarët si dhe përgjithësimin e këtij rasti në strukturat e Policisë së Shtetit. Vlen për t'u theksuar se këto hetime janë shumë të vështira për t'u hetuar dhe provuar. *Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua në pjesën më të madhe.*

- Ankesa e shtetasve L.K., M.K. dhe D.M. të cilat shprehnin shqetësimin lidhur me përdorimin e gazit lotsjellës gjatë protestës së datës 11 dhjetor 2020, të mbajtur në Tiranë, pas vrasjes së të riut K.R. nga një punonjës i Policisë së Shtetit. Sipas ankuesëve, përdorimi i gazit lotsjellës nga punonjësit e Policisë së Shtetit ishte bërë pa dallim ndërmjet protestuesve paqësorë, kalimtarëve të rastit apo shtetasve që kanë kryer veprime të dhunshme duke dëmtuar objekte të ndryshme. Gjithashtu, ato ngritën edhe shqetësimin se ndaj qytetarëve ishte hedhur gaz lotsjellës pa u njoftuar më parë me altoparlant që të shpërndahej turmase do të hidhej gazi.

Në përfundim të hetimit tonë administrativ gjatë të cilit u administruan edhe disa pamje filmike të protestave të bëra publike në rrjetet sociale si dhe të vëna në dispozicion nga ankuesit, konstatuam se protestuesit, në katër raste, nuk janë lajmëruar për përdorimin e gazit lotsjellës dhe ujit me presion, ka patur përdorim të paarsyeshëm të ujit me presion si dhe nuk është marrë parasysh rreziku i përdorimit të gazit lotsjellës në një zonë me dendësi të lartë banimi. Për shkeljet e konstatuara i rekomanduam³² Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit: marrjen e masave të nevojshme për analizimin me objektivitet dhe profesionalizëm të veprimeve të kryera nga disa punonjës të policisë për rastet në të cilat kanë hedhur pa paralajmërim dhe në mënyrë joproporcionale gaz lotsjellës dhe ujë me presion ndaj disa kalimtarëve dhe shtetasve pjesëmarrës në protestat e dhjetorit 2020; fillimin e ecurisë disiplinore, identifikimin e punonjësve të policisë që kanë kryer shkelje ligjore ndaj qytetarëve protestues dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete ndaj tyre; marrjen e masave të nevojshme për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të policisë për

³¹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20Zbatimin%20e%20parimit%20ligjor%20t%C3%AB%20proporcionalitetit%20kur%20p%C3%ABrdoret%20forc%C3%AB%20fizike%20p%C3%ABr%20t%C3%AB%20kontrolluar%20sjelljen%20e%20protestuesve.pdf>

³² Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20përdorimin%20e%20gazit%20lotsjellës%20dhe%20ujit%20me%20presion%20nga%20Policia%20e%20Shtetit.pdf>

t'iu përgjigjur në mënyrë efektive mbarëvajtjes së tubimeve si të njoftura më parë ashtu edhe atyre që organizohen në mënyrë spontane si dhe përgjithësimin e këtij rasti, me qëllim përdorimin në të ardhmen të gazit lotsjellës, ujit me presion dhe mjeteve të tjera në përputhje me të gjitha rregullat dhe procedurat e parashikuara që kanë të bëjnë me përdorimin e forcës. Rekomandimi u mirëprit dhe u pranua.

➤ *E drejta kushtetuese e privatësisë*

E drejta e privatësisë të çdo shtetasi është një nga të drejtat themelore kushtetuese e cila garantohet nga neni 37 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ. Sipas Kushtetutës, paprekshmëria e banesës është e garantuar. Kontrollat e banesës si dhe të mjediseve që njësohen me të, mund të bëhen vetëm në raste dhe mënyrat e parashikuara në ligj. Ndërkohë që si ligji i posaçëm i cili rregullon veprimtarinë e punonjësve të Policisë së Shtetit ashtu edhe dispozitat konkrete procedurale që normojnë rastet dhe kriteret që duhet të plotësohen për ushtrimin e kontrollit me iniciativë nga Policia Gjyqësore, nuk legjitimojnë ndërhyrjen e pa autorizuar në çdo rast. Në këto raste plotësimi dhe respektimi me rigorozitet i rregullave ligjore që legjitimojnë ushtrimin e kontrollit në ambiente private merr një rëndësi të posaçme nisur nga fakti se në këto situata cenohet një e drejtë kushtetuese. Në praktikë ndodhin raste që nga punonjësit e Policisë Gjyqësore të ushtrohen kontrole në banesat e shtetasve apo ambientet e tjera që njësohen me to, ndonëse nuk plotësohen kriteret ligjore, situata të cilat sjellin pasoja të pariparueshme ndaj qytetarëve dhe cenimin e imazhit të Policisë së Shtetit në publik.

Lidhur me cenimin e kësaj të drejte i referohemi rastit të ankesës së shtetasit H.I. i cili ngrinte shqetësimin se në datën 28.08.2020, gjatë orëve të natës punonjësit e Komisarariatit të Policisë Durrës kanë shkuar në banesën e dhëndrit të tij të quajtur G.K. me banim në fshatin Shënepremte të Bashkisë Divjakë dhe i kanë bërë kontroll banese. Ndonëse gjatë kontrollit të banesës nuk i gjetën asgjë të ndaluar nga ligji, ata e kanë shoqëruar atë në Komisarariatit të Policisë Durrës, me pretendimin se ishte autor i vjedhjes së disa bizhuterive në një banesë në qytetin e Durrësit ku është mbajtur 16 orë. Pas verifikimeve të bëra, ai është lënë i lirë sepse u provua që në orën në të cilën kishte ndodhur vjedhja, G.K. kishte qenë duke punuar në një banesë në qytetin e Lushnjës.

Nga shqyrtimi i kësaj ankese konstatoam se veprimi procedural i kontrollit të banesës së shtetasit G.K., nga OPGJ nuk ishte kryer në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, sepse nuk kishte arsye të bazuara për të kryer kontrollin e banesës së tij, si dhe nuk ka qenë një veprim i ngutshëm për të cilin nuk mund të pritej vendimi i organit procedues. Kontrolli është ushtruar në kohë të papërshtatshme nga ora 22:30 deri në orën 23:00 jashtë afatit ligjor të lejuar dhe pa patur urdhër me shkrim të organit procedues. Ndërkohë procesverbali i kontrollit të banesës nuk i është dërguar prokurorit për vleftësimin e tij brenda afatit ligjor, sikurse parashikohet në nenin 298/4 të Kodit të Procedurës Penale. Gjithashtu materialet hetimore lidhur me këtë ngjarje janë referuar në organin e prokurorisë tej afatit ligjor. Këto veprime vijnë në kundërshtim të plotë me detyrimet e përcaktuara në nenet 30, 206, 293, 294 e 298 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe me nenet 116, 117 e 118 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”.

Ndërkohë konstatoam se nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës nuk ishte marrë asnjë vendim për vleftësimin e kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit G.K. sikurse parashikohet në nenin 298/4 të Kodit të Procedurës Penale.

Përveç sa më sipër, gjatë shqyrtimit të kësaj ankese *konstatuam edhe një shqetësim serioz i cili lidhet me qëndrimin indiferent dhe pasiv të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës lidhur me shkeljet ligjore të kryera nga policia gjyqësore në këtë rast*. Ky institucion nuk është shprehur lidhur me vleftësimin e kontrollit të ushtruar nga oficeri i policisë gjyqësore në banesën e shtetasit G.K., por mjaftohet me konstatimin se nuk ka vendim për vleftësimin e tij. Po ashtu ky institucion nuk shprehet as lidhur me kohën e ushtrimit të këtij kontrolli, i cili është bërë tej afatit ligjor të lejuar dhe pa urdhër me shkrim të organit procedues. Ndonëse organi i prokurorisë ka konstatuar që materialet hetimore janë dërguar tej afatit ligjor nga policia gjyqësore e Komisarariatit të Policisë Durrës, nuk rezulton që të ketë ndërmarrë fillimin e procedimit disiplinor për analizimin e këtij rasti dhe ndëshkimin e personave përgjegjës në bazë të nenit 32 e vijues të ligjit nr. 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” me qëllim përmirësimin e punës në të ardhmen.

Për këtë rast i rekomanduar³³ Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë: marrjen e masave të nevojshme për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj oficerit të policisë gjyqësore dhe ndëshkimin e tij me masë disiplinore; marrjen e masave për trajnimin në vijimësi të oficerëve të policisë gjyqësore lidhur me kryerjen e veprimeve procedurale, për njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve gjatë kryerjes së misionit të tyre ligjor; përgjithësimin e këtij rasti në të gjitha strukturat vendore të Policisë së Shtetit, me qëllim mos përsëritjen e shkeljeve të tilla në të ardhmen nga punonjësit e policisë; analizimin e këtij rasti nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Prokurori i Përgjithshëm, nxjerrjen e përgjegjësive përkatëse dhe përgjithësimin e tij me qëllim mospërsëritjen e qëndrimeve të tilla në të ardhmen si nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore ashtu edhe nga prokurorët dhe drejtuesit e Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallëve të Para. *Rekomandimi u mirëprit dhe pranua nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Prokuroria e Përgjithshme, ndërsa KLP-ja nuk na ka kthyer përgjigje.*

➤ *E drejta kushtetuese e shtetasve për informim*

Sa i përket të drejtës së informimit, nga shqyrtimi i disa ankesave kemi konstatuar se ka raste që organet e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit nuk e respektojnë këtë të drejtë kushtetuese të shtetasve. Kjo situatë është rrjedhojë e mos njohjes së akteve normative që rregullojnë këtë të drejtë, por edhe e një mentaliteti të trashëguar nga e kaluara se këto organe janë disponuesit e dokumenteve të klasifikuara si “sekret shtetëror” dhe se kjo e drejtë është monopol i tyre.

Lidhur me këtë të drejtë po referojmë rastin e ankesës së shtetasit H.Sh. i cili ishte i punësuar në Gardën e Republikës. Ai i ishte drejtuar me kërkesë Sektorit të Burimeve Njerëzore për t’i dhënë një kopje të një dokumenti që ndodhej në dosjen e tij personale që sipas tij ishte bërë shkak për ecurinë e tij në karrierë. Nga ky sektor ankuesit i ishte kthyer përgjigje se dokumenti për të cilin ai pretendonte nuk ndodhej në dosjen e tij personale. Në vijim ky shtetas kishte kërkuar fotokopjen e dosjes personale, por sipas tij ajo nuk i jepej.

³³ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës. <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20dh%C3%ABnien%20e%20mas%C3%ABs%20disiplinore%20oficerit%20t%C3%AB%20policis%C3%AB%20gjyq%C3%ABsore%20Iir%20Bishtaja.pdf>

Nga përgjigjja e dërguar institucionit tonë nga Garda e Republikës u informuam se ankuesi nuk kishte kërkuar fotokopje të dosjes së tij personale, por një dokument që nuk ndodhej në këtë dosje. Referuar kësaj përgjigjeje dhe nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në përgjigjen e dërguar ankuesit ndërmjet të tjerave i sugjeruam që pas marrjes së përgjigjes tonë të paraqitej në Sektorin e Burimeve Njerëzore të Gardës së Republikës dhe të bënte kërkesë për njohjen me dosjen e tij personale dhe për të marrë një kopje të saj.

Ankuesi, në vijim, na u drejtua sërish me ankesë në të cilën shprehej se, ishte paraqitur pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore të Gardës së Republikës dhe kishte kërkuar të njihej me dosjen e tij. Ajo i është dhënë vetëm sa për ta parë, por nuk i ishte dhënë një kopje e saj.

Në përfundim të hetimit administrativ konstatoam se, pretendimet e ankuesit se atij nuk i është dhënë dokumenti i kërkuar (dosja personale), qëndronin. Nga përgjigjet e dërguara nuk rezultonte që të kishte ndonjë pengesë ligjore për dhënien e dosjes personale ankuesit.

Për sa më sipër i rekomanduam³⁴ Gardës së Republikës: marrjen e masave të menjëhershme nga Sektori i Burimeve Njerëzore të Gardës së Republikës për t’i dhënë kopje të dosjes personale shtetasit H.Sh.; analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive ligjore dhe marrjen e masave administrative ndaj personave përgjegjës që kanë cenuar të drejtën kushtetuese e ligjore për informim shtetasit H.Sh. si dhe përgjithësimin e këtij rasti me qëllim mos përsëritjen e tij në të ardhmen, si me punonjësit e Gardës së Republikës ashtu edhe me persona të tretë që mund t’i drejtohen këtij institucioni me kërkesë për informim lidhur me dokumente zyrtare. *Rekomandimi u mirëprit dhe pranua.*

➤ *Të drejtat ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit*

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave ligjore të punonjësve të Policisë së Shtetit edhe gjatë këtij viti ka qenë në vëmendjen e institucionit të Avokatit të Popullit. Të mbrosh të drejtat ligjore të punonjësve të administratës publike, pjesë e të cilës është edhe Policia e Shtetit, është jo vetëm një detyrim ligjor por në të njëjtën kohë edhe moral. Kjo buron nga fakti se punonjësit e policisë përballen me vështirësi të shumta dhe nga më të ndryshme, sikurse mund të përmendim: natyrën e profesionit që janë të detyruar të përplasen me elementin keqbërës që cenon rendin dhe sigurinë publike nëpërmjet kryerjes së aktivitetit kriminal, apo shkeljeve administrative; punën me turne; kohën reale të punës, tej orarit zyrtar, e cila nuk iu paguhet e plotë; punën edhe në ditët e festave dhe pushimit javor e larg familjeve; mos respektimin e disa të drejtave ekonomiko-financiare që ndonëse janë të parashikuara në ligjin organik, ende nuk i përfitojnë në masën e plotë, etj. Në vijimësi kemi vlerësuar se respektimi i të drejtave të punonjësve të Policisë së Shtetit është një kontribut i çmuar dhe një shtysë që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në motivimin dhe përkushtimin e tyre në kryerjen sa më mirë të misionit ligjor të Policisë së Shtetit dhe rritjen e performancës së këtij organi si dhe në rritjen e nivelit të respektimit prej tyre të të drejtave të shtetasve. Lidhur me këtë problematikë po referojmë rastin e mëposhtëm:

³⁴ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20per%20dhenien%20e%20dosjes%20personale%20H.%20Sh.pdf>

Shtetasi A.C., efektiv i Policisë së Shtetit, nëpërmjet ankesës ngrinte shqetësimin se gjatë kohës që ishte në marrëdhënie pune kishte lidhur një kontratë me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (DPPSH) për të ndjekur Ciklin e Parë të studimeve në Akademinë e Sigurisë për një periudhë 3 vjeçare. Në bazë të kësaj kontrate, për periudhën e studimeve ai duhet të trajtohej financiarisht sipas akteve normative në fuqi. Pavarësisht se në kontratë është përcaktuar që periudha e studimeve zgjat 3 vjet, në fakt çdo sezon shkollor ka zgjatur më pak se 6 muaj për çdo vit akademik dhe sipas VKM-së nr. 200, datë 15.03.2017, ai duhej të trajtohej me pagën bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të studimeve.

Ankuesi pretendonte se nga DPPSH është zbatuar në mënyrë jo të drejtë akti nënligjor, duke e konsideruar kohëzgjatjen e studimeve më shumë se 6 muaj dhe pas përfundimit të sezonit të parë të studimeve, për sezonin e dytë dhe të tretë, një periudhë kohe më pak se 12 muaj, e ka trajtuar atë me 40 % të pagës mujore.

Sipas tij, në këto rrethana janë gjendur edhe kolegët e tij studentë, disa prej të cilëve kishin ngritur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe kishin fituar të drejtën për të marrë diferencën e pagës që u është mbajtur padrejtësisht. Pavarësisht se ai nuk ka ndjekur rrugën gjyqësore, pas qëndrimit të mbajtur nga gjykata i është drejtuar me kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të përfituar në të njëjtën mënyrë si kolegët e tij, duke ia dhënë diferencën e pagës së mbajtur padrejtësisht pasi ndodhej në të njëjtat kushte me ta, por kërkesa e tij ishte refuzuar.

Nga shqyrtimi i ankesës si dhe analizimi i përgjigjeve të ardhura nga DPPSH, Akademia e Sigurisë dhe i vendimeve të formës së prerë të disa Gjykatave Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës Administrative të Apelit rezultoi se, nga DPPSH ishte zbatuar në mënyrë jo korrekte VKM-ja nr. 200/2017 duke e trajtuar ankuesin dhe kolegët e tij sipas pikës 12/b të kësaj VKM-je, duke përfituar 40% të pagës bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të shkollimit dhe jo sipas pikës 12/a të kësaj VKM-je, duke përfituar pagën bazë mujore për gradë që përfitonte përpara fillimit të kursit të shkollimit.

Një fakt pozitiv në trajtimin e kësaj çështjeje ishte se Këshilli i Ministrave kishte bërë ndryshimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së pikës 12 të VKM nr. 200/2017 duke i trajtuar studentët e Akademisë së Sigurisë me pagën e plotë gjatë periudhës së vazhdimit të studimeve.

Për të bërë të mundur rivendosjen në vend të të drejtës së shkelur ankuesit dhe punonjësve të tjerë të Policisë së Shtetit gjatë periudhës së studimeve në Ciklin e Parë në Akademinë e Sigurisë, i rekomanduar³⁵ Drejtorit të Përgjithshëm Policisë së Shtetit:

Marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur anulimin e akteve administrative të nxjerra ndaj ish-studentit/punonjësit të policisë A.C. dhe dhënien e diferencës së pagës të ndaluar në kundërshtim me pikën 12/a të VKM nr. 200/2017, për periudhën akademike 3-vjeçare 2017-2020

³⁵ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20dh%C3%ABnien%20e%20diferenc%C3%ABs%20s%C3%AB%20pag%C3%ABs%20t%C3%AB%20ndaluar%20n%C3%AB%20kund%C3%ABrshtim%20me%20pik%C3%ABn%2012-a%20t%C3%AB%20VKM%20nr.%20200-2017.%20punonj%C3%ABsit%20t%C3%AB%20policis%C3%AB%20A.pdf>

që ka ndjekur studimet në Ciklin e Parë në Akademinë e Sigurisë, respektivisht për vitin e dytë akademik 2018-2019 dhe për 6 mujorin e vitit të tretë akademik 2019-2020; marrjen e masave të nevojshme me cilësinë e organit epror për të bërë të mundur anulimin e akteve administrative të nxjerra nga strukturat vendore në qarqe dhe strukturave të tjera në vartësi ndaj ish-studentëve/punonjësve të policisë që kanë ndjekur studimet në Ciklin e Parë në Akademinë e Sigurisë gjatë periudhës akademike 3-vjeçare 2017-2020 dhe dhënien e diferencës së pagës të ndaluar në kundërshtim me pikën 12/a të VKM nr. 200/2017, pavarësisht faktit që nuk kanë ngritur padi lidhur me cenimin e kësaj të drejte ligjore; përgjithësimin e këtij rasti dhe tërheqjen e vëmendjes strukturave përkatëse me qëllim zbatimin korrekt të akteve normative në fuqi.

Meqënëse rekomandimi i cituar më sipër nuk u pranua, në vijim të ndjekjes së këtij rasti, muajt e fundit i bëmë rekomandim Ministrisë të Brendshme të cilit i kërkuam që me cilësinë e organit epror të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të ushtronte ndikimin e tij për të rivendosur në vend të drejtën financiare të ankuesit dhe punonjësve të tjerë ish studentë të Akademisë së Sigurisë. *Deri më tani nuk na është kthyer përgjigje ndonëse afati ligjor ka kaluar.*

3.4 Parandalimi i dhunës dhe torturës³⁶

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimin të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar, në vijim Mekanizmi Kombëtar³⁷ (MKPT) ka vijuar të përmbushë detyrat funksionale edhe gjatë vitit 2021. Më konkretisht, Mekanizmi Kombëtar ka kryer *68 inspektime periodike fizike* apo kontrole me tematikë të veçantë. Gjithashtu, në bashkëpunim me Frontex ka kryer rolin e monitoruesit në operacionet për rikthimin e detyruar të shtetasve shqiptarë që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në vendet e BE-së. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me *76 rekomandime* dhe me një korrespondencë zyrtare të dëndur për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve.

MKPT për vitin 2021, ka trajtuar *38 ankesa* dhe *9 raste me iniciativë*. Janë trajtuar *34 ankesa* për burgjet (pretendim për ushtrim dhune, mungesë mjekimi dhe medikamentesh, kërkesa vaksinimi, shtimin e numrit për takime me familjarët, etj.) si dhe *4 ankesa* për policinë e shtetit (pretendim për ushtrim dhune, shoqërim i padrejtë).

Qëllimi i këtyre vizitave dhe inspektimeve ishte vlerësimi i progresit të autoriteteve kompetente në zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si dhe respektimi i të drejtave të të burgosurve dhe personave që iu privohet liria, të drejta të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore të kësaj fushe, etj. Përveç kësaj, nga ana e MKPT-së është mbajtur në konsideratë edhe veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Administratën e Burgjeve dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

³⁶ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i MKPT-së në Institucionin e Avokatit të Popullit.

³⁷ Neni 81 i ligjit nr. 81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", si dhe neni 30 dhe 30/1 i ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar.

Gjetjet e konstatuara nga MKPT në inspektimet në institucionet penitenciare pasqyrohen si në vijim:

1. *Kushte materiale tërësisht të papërshtatshme në disa IEPV dhe pa mundësinë e rikonstruktimit të mjediseve në regjimet e brendshme, të cilat bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të burgosurve, si në I EVP Lezhë, I EVP Sarandë, I EVP Bënc, Tepelenë, I EVP 302 Tiranë, të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Këto gjetje vazhdojnë të konstatohen në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mungesës së investimeve dhe amortizimit.*
2. *Infrastruktura e ndërtimit të godinave të banimit dhe ambienteve të përbashkëta, paraqesin probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje të energjisë elektrike dhe ujit, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. Institucionet me problematika emergjente infrastrukturore paraqiten I EVP Durrës, I EVP Rrogzhinë, I EVP Tepelenë, I EVP Shënkoll, Lezhë. Përjashtim bënin I EVP-të e reja dhe ato të rikonstruara të cilat praktikisht kanë krijuar një situatë me dy standarde në sistemin penitenciar shqiptar.*
3. *Mbipopullimi ka pësuar një rritje përgjatë vitit 2021 në disa nga I EVP-të si në I EVP 302, I EVP 313, Jordan Misja, Tiranë, si dhe I EVP Durrës. Gjatë vizitave, grupet e inspektimit kanë gjetur 4 (katër) deri në 6 (gjashtë) persona që akomodohen në një qeli, duke mos respektuar standardin 4m² për çdo të burgosur. Bashkëlidhur në Aneksin 1, Tabela pasqyruese në lidhje me popullimin në IEPV-të.*
4. *Moszbatim i Marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Moszbatimi i ligjit nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, i ndryshuar, për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor me qëllim trajtimin e kësaj kategorie personash, ka sjellë problematikën e trajtimit të tyre në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat për më tepër gjenden në kushte mjaft të rënduara amortizimi e mbipopullimi. Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur u ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse mbylljen e I.E.V.P. Zahari, Krujë, ku ata trajtohen më së shumti dhe ka kërkuar në mënyrë të përsëritur me forcë për ngritjen e institucionit të veçantë të parashikuar me ligj. *Deri në ngritjen e këtij institucioni, Avokati i Popullit ka kërkuar përmbushjen e standardeve të kushteve materiale të këtyre mjediseve të lidhura drejtpërsëdrejti me investimet e pamjaftueshme, si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor, që mundësohet pikësepari me rritjen e numrit të punonjësve të stafëve mjekësore dhe atyre mbështetëse.**

5. Referuar rekomandimeve të CPT-së³⁸ dhe Avokatit të Popullit, nga ana Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në vitin 2018 u mor një vendim lidhur me zgjidhjen provizore të kësaj problematike. Fillimisht nisi me rikonstruktimi dhe përshtatja e dy godinave 4, 5 brenda I EVP-së Shën Koll³⁹, Lezhë, të cilat do të shërbejnë për akomodimin provizor të personave të trajtuar në I EVP Zahari, deri në ngritjen e institucionit të posaçëm të parashikuar me ligj. Në datat 27 dhe 28 nëntor 2021, u krye me sukses procesi i transferimit nga I EVP Krujë i 314 shtetasve me masë mjekësore⁴⁰ dhe akomodimi i tyre në dy godinat në I EVP Lezhë⁴¹. Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i gjithë stafi i I EVP Krujë, përfshirë psikiatër, infermierë, punonjës socialë, kujdestarë dhe sanitarë tashmë janë alokuar si kapacitete në dy godinat në I EVP Lezhë, dhe po ushtrojnë funksionin e tyre për trajtimin e specializuar të pacientëve me masë mjekësore. Numri i stafit që do të trajtojë këtë kategori personash në Lezhë është 35.⁴² Me transferimin e këtyre shtetasve në I EVP Lezhë, përveç përmirësimit të ndjeshëm të kushteve të banimit, është lehtësuar edhe aksesin e pacientëve në shërbime të specializuara shëndetësore, të cilat do të mundësohen nga shërbimet mjekësore të ambulancave/spitaleve shtetërore.
6. *Mungesa e mjekëve në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale* vijon të mbetet një problematikë shqetësuese e sistemit tonë penitenciar. Avokati i Popullit gjatë vitit 2021, në I EVP-të e inspektuara në rang vendi ka rekomanduar marrjen e masave për plotësimin e pozicionit të mjekut me kohë të plotë sipas parashikimeve në organikën e institucionit. Më problematike paraqitet situata në I EVP Kavajë, I EVP Tepelenë, I EVP Kukës, I EVP Korçë, I EVP Durrës, I EVP Fier, I EVP Peqin dhe I EVP Lezhë. *Bashkëlidhur në Aneksin 2, Tabela pasqyruese me të dhënat e stafit mjekësor në burgje për vitin 2021.*
7. *Cilësia dhe larmia e ushqimit*, mbetet problem shqetësues thujse në të gjitha I EVP-të.
8. *Mangësi të theksuara në ofrimin e mundësisë për arsim dhe aktivitete social-kulturore* për të burgosurit, për shkak të kufizimeve si pasojë e pandemisë COVID-19.
9. *Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet.*⁴³
10. Stafi i kujdesit shëndetësor në burgje, nevoja për krijimin e ambienteve të përshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore, pasi përgjithësisht janë të pa pajisura me mjetet e nevojshme dhe materiale ndihmëse.

³⁸ Në raportin më të fundit të publikuar nga CPT mbi vizitën e kryer në nëntor të vitit 2018 [https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-në-përmbledhjen-ekzekutive-CPT/inf-\(2019\)-28](https://www.coe.int/en/web/cpt/-/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-alban-në-përmbledhjen-ekzekutive-CPT/inf-(2019)-28) theksohet: “*Situata e pacientëve psikiatrikë në konflikt me ligjin ka qenë objekt i një dialogu të gjatë midis CPT-së dhe autoriteteve shqiptare, duke marrë parasysh që pacientët në fjalë janë mbajtur për shumë vite në kushte të papranueshme dhe me kujdes të pamjaftueshëm psikiatrik në Spitalin e Burgjeve në Tiranë dhe në Institutin e Veçantë të Zaharisë në Krujë...*”.

³⁹ CPT Report 2018, faqet 7,37,38, si dhe faqja 45 “*Administrimi i spitalit të ri në burgun e Lezhës nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të mundësojë shërbime të specializuara për këtë kategori, duke bërë të mundur aksesin e këtyre pacientëve në aktivitete kuptimplota jashtë qelive, përkujdesjen e nevojshme njerëzore dhe kontaktin me specialistë (psikiatër, psikologë, kujdestarë)*”.

⁴⁰ 217 shtetas me masë mjekësore “*shtrim i detyruar*” dhe 97 shtetas me masë mjekësore “*shtrim i përkohshëm*”.

⁴¹ I EVP Lezhë përmes urdhrin nr. 8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë është klasifikuar Burg i sigurisë së zakonshme, me një seksion të veçantë për trajtimin e shtetasve me masë mjekësore mjekim i detyruar.

⁴² Konkretisht, 2 mjekë psikiatër (me kohë të plotë), 1 mjek kardiolog, 1 mjek i përgjithshëm, 2 psikologë, 1 stomatolog, 1 kryeinfermier, 10 infermierë, 5 kujdestarë, 5 sanitarë, 6 punonjës socialë dhe 1 farmacist.

⁴³ Për më shumë, kjo problematikë është trajtuar në pikën 3.2 “*Të drejtat e personave të privuar nga liria*”.

11. *Vonesa dhe mangësi paraqiten në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore apo me të dhënat elektronike në sistemin e sigurimeve shëndetësore në shumicën e IEVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.*
12. *Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike vëreheshin ende në disa prej IEVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, si dhe rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.*
13. *Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në IEVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.*
14. *Sistemet qendrore të ngrohjes/ftohjes, pothuajse në të gjitha IEVP-të ku ishin të instaluar, nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit nuk i sigurohet ngrohja sipas parashikimeve ligjore.*
15. *Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e IEVP-ve.*
16. *Mungesa e dollapëve, raftë të rrobave. Rrobat mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve.*
17. *Çmimet e larta të produkteve të dyqaneve të IEVP-ve, problem i hasur në thuajse të gjitha institucionet e inspektuara.*

MKPT-ja u ka dërguar autoriteteve kompetente rekomandimet me problematikat e vërejtura të cilat nevojiten të adresohen me vendimmarrje nga organet e larta shtetërore, pasi në shumicën e rasteve ato janë rezultat i ashpërsimit të politikës penale, mungesës së fondeve, dhe mungesës së nxjerrjes së akteve nënligjore për të gjeneruar përmirësime të dukshme të sistemit, si në formë ashtu dhe në përmbajtje.

➤ *Mosnxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” brenda afateve të përcaktuara në ligj.*

Në raportet e monitorimit të Avokatit të Popullit si dhe të organizmave të tjera kombëtare dhe ndërkombëtare, një prej çështjeve kritike është niveli i zbatueshmërisë së ligjeve, ku nxjerrja e akteve nënligjore dhe zbatimi i tyre zë vend kryesor. Mungesa e nxjerrjes së akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të Paketës Penitenciare, të miratuara në korrik 2020⁴⁴, cenon zbatimin efektiv të ligjit në fjalë dhe e bën atë të pazbatueshëm. Për pasojë mungesa e akteve nënligjore apo vonesa në nxjerrjen e tyre cenon rëndë psrimin dhe funksionimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri si dhe sjell shqetësime në zbatimin integral të ligjit.

⁴⁴ Referuar nenit 91 të ligjit 81/2020

Konkretisht ende nuk janë nxjerrë:

- ✓ Vendimi i Këshillit të Ministrave për “Rregullat dhe kriteret e detajuara për kushtet teknike, të sigurisë, të përshtatshmërisë dhe të aksesueshmërisë nga personat me aftësi të kufizuara, që duhet të plotësojnë ndërtesat e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale”, detyrim i parashikuar në nenin 32 pika 2, duhet të ishte nxjerrë brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
- ✓ Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë “Norma ushqimore ditore”, detyrim i parashikuar në nenin 36 pika 8, duhet të ishte nxjerrë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
- ✓ Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë “Diagnostikimi dhe mjekimi pranë Qendrës Spitalore Universitare dhe institucioneve spitalore rajonale”, detyrimi i parashikuar në nenin 41 pika 13, duhet të ishte nxjerrë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
- ✓ Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për shëndetësinë “Rregullat e detajuara për mënyrën e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe funksionimin e skemës së sigurimeve shëndetësore për personat e burgosur”, detyrimi i parashikuar në nenin 41 pika 17, duhet të ishte nxjerrë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
- ✓ Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Drejtësisë dhe ministrit përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional “Rregullat më të detajuara për mënyrën e zhvillimit të arsimit dhe formimit profesional” detyrimi i parashikuar në nenin 45 pika 9, duhet të ishte nxjerrë brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Ndërsa Vendimi i Këshillit të Ministrave për “*Miratimin e Rregullores të Përgjithshme të Burgjeve*”⁴⁵, detyrim i parashikuar në nenin 25 të ligjit 81/2020, u miratuar shumë më vonë se përcaktimi ligjor. Ky akt nënligjor duhet të ishte nxjerrë brenda gjashtë muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

➤ ***Niveli i respektimit të të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë e policisë***

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambienteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre, etj. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve epnore të Policisë së Shtetit.

⁴⁵ Miratuar më datë 6 prill 2022

Inspektimet e kryera në njësitë policore gjatë vitit 2021 kishin si qëllim vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikën e ndjekura nga Policia e Shtetit në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, “Për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, “Për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit” si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimet e mëparshme.

Nga inspektimet e kryera në strukturat e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

1. Në disa raste ka patur mbipopullim të konsiderueshëm në DPV Tiranë si dhe në disa nga komisaritet në varësi të saj, ku ka ambiente sigurie. Në këto struktura punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbiipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal, por edhe për shkak se personat e dënuar me vendim të formës së prerë, në mungesë, vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

2. Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimin fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë. Pavarësisht se ka një qasje me korrekte dhe në respektim të të drejtave të njeriut nga punonjësit e Policisë së Shtetit, kemi patur disa ankesa. Ankesat e gjetura të bazuara janë ndjekur kryesisht nga grupe të përbashkëta me Seksionin e Veçantë, janë pasuar nga rekomandimet konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës. MKPT përgjatë vitit 2021 i ka dërguar rekomandim Komisaritetit nr.2 Tiranë në lidhje me “Rekomandim në lidhje me shoqërimit e shtetasve znj. L. H në Komisaritetin e Policisë nr.2 Tiranë”. Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës vlerëson të sjellë në vëmendje rëndësinë e veçantë që ka sjellja e organeve të shtetit kundrejt personave të shoqëruar, që në orët e para të shoqërimit. Një person i shoqëruar nga policia është në një situatë të cënueshmërisë së veçantë, pasi personi është plotësisht në duart e agjentëve të zbatimit të ligjit. Ky disekuilibër pushteti krijon një situatë rreziku ku mund të ndodhin abuzime dhe veprime arbitrare që cenojnë paprekshmërinë e personit.

Masat mbrojtëse, veçanërisht në fazat e hershme të shoqërimit, janë thelbësore për të parandaluar abuzimet. Këto masa përfshijnë:

- dhënien e informacionit personave të shoqëruar për të drejtat e tyre;*
- sigurimin e aksesit të një avokati;*
- njoftimin e anëtarëve të familjes dhe/ose një palë të tretë për personin;*
- dhënien e ekzaminimit nga një mjek për të konfirmuar ose përjashtuar pretendimet për keqtrajtim dhe për të ofruar ndihmë mjekësore nëse është e nevojshme.*

Përveç këtij rasti, nga monitorimi i shpeshtë i ambienteve të Komisariateve, MKPT ka konstatuar se personat e shoqëruar/ndaluar nga punonjësit e policisë nënshkruajnë deklaratën që vërteton se morën një kopje të fletës së fakteve me të drejtat e tyre vetëm në përfundim të procesit të marrjes në pyetje në komisariatit e policisë. CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse përgjatë vitit 2018- të se personat e shoqëruar /ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të lirisë, duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë. Sipas gjetjeve të MKPT, fleta shpjeguese me të drejtat e personave të ndaluar u jepet atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje. Ndërsa në rastin konkret ajo nuk i ishte dhënë ankueses deri në momentin në të cilin u zhvillua takimi me të prej përfaqësuesve të Avokatit të Popullit. Gjithashtu në një numër të konsiderueshëm komisaratesh, karta e të drejtave është e afishuar në pozicione që nuk mundësojnë vizualizimin nga ana e të shoqëruarve apo të ndaluarve.

Megjithëse Mekanizmi Kombëtar përgjatë inspektimit në Komisariatit nr.2, Tiranë, konstatoi se znj. L.H ka shënuar tek regjistri i shoqërimit se ka pretendimin se është dhunuar nga punonjësj e policisë së Komisariatit nr.2. Në përgjigjen e këtij Komisariatit drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit,⁴⁶ në asnjë rast nuk i referohen shënimit të personit të shoqëruar.

Gjithashtu, është vënë re se libri i ankesë/kërkesave shpesh herë është i pa plotësuar. Ligji nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, neni 115 përcakton se “*çdo person i shoqëruar, i ndaluar apo i arrestuar në ambientet e policisë si dhe çdo shtetas tjetër, ndaj të cilit punonjësit e policisë, kryejnë veprime sipas dispozitave të këtij ligji ose që cenohen gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, ka të drejtë t’u paraqesë kërkesë/ankesë me gojë ose me shkrim drejtuesve të policisë apo institucioneve të tjera shtetërore. 2. Personi, i cili shoqërohet nga policia sipas rasteve të parashikuara në këtë ligj, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës në çdo kohë. 3. Punonjësi i policisë, pasi e ka regjistruar kërkesën/ankesën, e dokumenton në regjistrin përkatës dhe është i detyruar ta dërgojë menjëherë atë në institucionin të cilit i adresohet ankesa. 4. Për kërkesat/ankesat që u drejtohen drejtuesve të policisë ku është i shoqëruari, i ndaluari apo i arrestuari, përgjigjja i jepet menjëherë, por jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e paraqitjes së tyre.”*

Po kështu, Rezoluta 31/31⁴⁷ e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, të vitit 2016, inkurajon shtetet të mbajnë të azhurnuar regjistrat zyrtarë të personave në mbikëqyrje policore që përmbajnë të paktën informacione për:

a. arsyet e arrestimit;

b. kohën e arrestimit dhe dërgimit të personit të arrestuar në një vend ndalimi, si dhe paraqitjen e parë para një organi gjyqësor ose autoriteti tjetër;

c. identitetin e zyrtarëve të zbatimit të ligjit në fjalë;

⁴⁶ Shkresa me nr. 375 prot. datë 20.01.2021

⁴⁷ https://ap.ohchr.org/documents/dpage_e.aspx?si=A/HRC/31/L.26/Rev.1

d. informacione të sakta në lidhje me vendin e ndalimit.

Këshilli për të Drejtat e Njeriut gjithashtu rekomandoi që Shtetet duhet t'i komunikojnë këto të dhëna personit të shoqëruar ose mbrojtësit të tij.

3. Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës duke ju referuar qëllimit të inspektimeve, verifikimit dhe respektimit të standardeve të përcaktuara në Ligjin nr.108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, në “Rregullat dhe Procedurat Standarde për Trajtimin dhe Sigurimin e Personave të Arrestuar dhe Ndaluar në Njësitë Policore”, miratuar me Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, dhe në Procedurën standarde të punës për “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 938 datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Programit të Punës të CPT nr. 5949, datë 09.07.2019 “Për përmbushjen e rekomandimeve të raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2019, rekomandimet e Avokatit të Popullit dhe Komitetit Evropian Kundër Torturës (CPT) për përmirësimin e trajtimit dhe respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria, në ambientet e Policisë së Shtetit”, ka detyrimin ligjor të ndërhyjë për zgjidhjen e problematikave të konstatuara. Avokati i Popullit lidhur me këto konstatime i rekomandoi komisariatit nr.2 Tiranë: Evidentimin e rastit dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete administrative për shkeljet e konstatuara nga ana e punonjësës të Komisarariatit nr.2 që lidhen konkretisht me:

- ✓ *mosvendosjen në dispozicion të kartës së të drejtave;*
- ✓ *mosrespektimin e procedurave standarde mbi raportimin e ankesave të personave të shoqëruar referuar regjistrave;*
- ✓ *marrjen e masave të nevojshme që personat e shoqëruar/ndaluar të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre nga fillimi i privimit të lirisë, duke u siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të lirisë, dhe vënia në dispozicion e kartës së të drejtave për njohjen me to;*
- ✓ *marrjen e masave për plotësimin dhe saktësimin në regjistër të kohës së privimit të lirisë nga punonjësi i policisë.*

4. *Mospërmbushjen e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (të paktën 3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultoni të pakta në numër dhe nuk krijonin ambiente të përshtatshme, dinjitoze, të pajisura me orënditë e nevojshme për qëndrim, të ndara më vete për femra, të rritur dhe të mitur.*

5. *Mospërmbushjen e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”. Përgjithësisht nën ambientet e sigurisë në DPV Tiranë, Gjirokastër, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisarariatet e varësisë të DPV Tiranë ku gjenden*

dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të këtyre standardeve. Në komisariatet e policisë nr.1, 2 dhe 3 në Tiranë, nga inspektimi rezultoi se disa dhoma sigurie janë mbyllur dhe janë nxjerrë jashtë funksionit me procesverbal.

6. *Problemet në ofrimin e një shërbimi shëndetësor nga disa DPV, sa i përket plotësimit korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e konsultave.* Në disa prej këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në procedurat standarde të Policisë së Shtetit, ndërkohë që në disa drejtori mjeku mungon.

7. *Problemet për instalimin e sistemit të monitorimit me kamera vëzhgimi në korridore, dhomat e shoqërimit dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve në disa komisariate.* Për sa më sipër vlen për t'u përmendur se sjellja e punonjësve të policisë së shtetit ndaj qytetarëve është përmirësuar ndjeshëm.

➤ ***Pasqyrimi në nivel kombëtar mbi dhomat e shoqërimit dhe intervistimin e të miturve, në strukturat vendore të policisë.***

Në bashkëpunim dhe me mbështetjen financiare të programit Suedez “*Forcimi i kapaciteteve të agjencive ligj-zbatuese shqiptare për të përmbushur standardet e të drejtave të njeriut në drejtësinë për të miturit – një qasje gjithëpërfshirëse e zinxhirit të drejtësisë*”, janë përshtatur dhe pajisur me mjete audiovizive ambiente miqësore për intervistimin e të miturve, në strukturat vendore të policisë e konkretisht:

- ✓ *Komisariatit e Policisë Nr.3, Tiranë*
- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Durrës*
- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Shkodër*
- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë*

Në bashkëpunim me UNICEF dhe me mbështetjen financiare të tyre janë përshtatur dhe pajisur me mjetet e duhura shtatë ambiente miqësore për intervistimin e të miturve në strukturat vendore të policisë e konkretisht:

- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Berat*
- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Gjirokastrë*
- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër*
- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Kukës*
- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Fier*
- ✓ *Komisariatit e Policisë Sarandë*
- ✓ *Komisariatit e Policisë Korçë*

Me mbështetjen financiare të organizatave “Word Vision” dhe “Nisma-Arsis” janë përshtatur dhe pajisur me mjetet e duhura shtatë ambiente miqësore për intervistimin e të miturve:

- ✓ *Drejtorinë Vendore të Policisë Lezhë*
- ✓ *Komisariatit e policisë nr.5 Tiranë*
- ✓ *Komisariatit e policisë nr.6 Tiranë*
- ✓ *Komisariatit e policisë Kurbin (por kjo njësi aktualisht nuk mund të përdoret për shkak të dëmtimeve që ka pësuar godina e komisaritit nga tërmeti, në nëntor 2019)*

➤ ***Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike***

Avokati i Popullit vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen për gjendjen në spitalet e kujdesit të shëndetit mendor në Shqipëri. Për vitin 2021, Mekanizmi Kombëtar ka inspektuar institucionet e shëndetit mendor si Spitali Psikiatrik Vlorë, Spitali Psikiatrik Shkodër, Spitali Psikiatrik Elbasan, IEVP Zahari, Instituti i Veçantë Shëndetësor i të Burgosurve (IVSHB) dhe Spitali Psikiatrik Tiranë “Xhavit Gjata”.

Problematikat e konstatuara në këto inspektime janë:

1. Moszbatimi i detyrimit ligjor për ngritjen e një institucioni të posaçëm mjekësor, të parashikuar në ligjin nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Avokati i Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar, ka tërhequr vëmendjen në mënyrë të përsëritur për kushtet e trajtimit në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale ku janë vendosur personat me çrregullime të shëndetit mendor që kanë kryer vepra penale ose persona me masë mjekësore mjekim i detyruar. Moszbatimi i ligjit nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, për ngritjen e një institucioni të posaçëm mjekësor me qëllim trajtimin e kësaj kategorie personash, ka sjellë problematikën e trajtimit të tyre në institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, të cilat për më tepër gjenden në kushte mjaft të rënduara amortizimi e mbipopullimi. Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të përsëritur u ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse mbylljen e I.E.V.P. Zahari, Krujë, ku ata trajtohen më së shumti dhe ka kërkuar në mënyrë të përsëritur me forcë për ngritjen e institucionit të veçantë të parashikuar me ligj. Deri në ngritjen e këtij institucioni, Avokatit të Popullit ka kërkuar përmbushjen e standardeve të kushteve materiale të këtyre mjediseve të lidhura drejtpërsëdrejti me investimet e pamjaftueshme, si dhe ofrimin e një shërbimi cilësor, që mundësohet pikësisht me rritjen e numrit të punonjësve të stafeve mjekësore dhe atyre mbështetëse. Referuar rekomandimeve të CPT-së dhe Avokatit të Popullit nga ana Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, në vitin 2018, u mor një vendim lidhur me zgjidhjen provizore të kësaj problematike, e cila nisi me rikonstruktimin dhe përshtatjen e dy godinave 4, 5 brenda IEVP-së Shën Koll , Lezhë, të cilat do të shërbejnë për akomodimin provizor të personave të trajtuar në IEVP Zahari, deri në ngritjen e institucionit të posaçëm të parashikuar me ligj. Në datat 27 dhe 28 nëntor 2021, u krye procesi i transferimit nga IEVP Krujë i 314 shtetasve me masë mjekësore dhe akomodimi i tyre në dy godinat në IEVP Lezhë . Sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i gjithë stafi i IEVP Krujë, përfshirë psikiatër, infermierë, punonjës socialë, kujdestarë dhe sanitarë

tashmë janë alokuar si kapacitete në dy godinat në I EVP Lezhë, dhe po ushtrojnë funksionin e tyre për trajtimin e specializuar të pacientëve me masë mjekësore. Numri i stafit që do të trajtojë këtë kategori personash në Lezhë është 35⁴⁸. Me transferimin e këtyre shtetasve në I EVP Lezhë, përveç përmirësimit të ndjeshëm të kushteve të banimit, është lehtësuar edhe aksesin e pacientëve në shërbime të specializuara shëndetësore, të cilat do të mundësohen nga shërbimet mjekësore të ambulancave/spitaleve shtetërore.

2. *Moszbatimi i nenit 28⁴⁹ të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” i ndryshuar, nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor, të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave për të cilët gjykata ka vendosur shkrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale, i ndryshuar. MKPT ka rekomanduar vazhdimisht gjetjen e një zgjidhjeje të shpejtë, efektive dhe të qëndrueshme, për shqyrtimin kryesisht brenda afateve ligjore nga gjykatat të të gjitha vendimeve të dhëna për “mjekim të detyruar në një institucion mjekësor”, si dhe për dërgimin e vendimeve në institucionet ku trajtohen personat përkatës.*

3. *Shtimi në organikat e spitaleve të mjekëve psikiatër, infermierëve “kujdestarë/task forcë”, stafit të sigurisë, sanitarëve dhe berberit, me qëllim ofrimin e një shërbimi të përshtatshëm për specifikat e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër. Avokati i Popullit vlerëson se është i nevojshëm: shtimi i menjëhershëm dhe në vitet në vijim i kuotave për specialistë në Psikiatri; riformulimi i kritereve të punësimit për funksionet klinike “kujdestar” dhe “task forcë”, me edukim infermieristik dhe njohuri të thelluara në rehabilitim psikiatrik spitalor, si dhe me aftësi moshore e fizike të përshtatshme për menaxhimin e axhitimit dhe riskut të lartë, si dhe trajnimi i punonjësve aktualë.*

4. *Vendosja e sistemit monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të spitaleve psikiatrike.*

5. *Krijimi/rikonstruksioni i plotë i dhomave të izolimit, duke i kompletuar ato në përputhje me pikën 4.6 “Infrastruktura e Izolimit”, të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Shëndetësisë, pjesë e paketës së akteve nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” i ndryshuar.*

⁴⁸ Konkretisht, 2 mjekë psikiatër (me kohë të plotë), 1 mjek kardiolog, 1 mjek i përgjithshëm, 2 psikologë, 1 stomatolog, 1 kryeinfermier, 10 infermierë, 5 kujdestarë, 5 sanitarë, 6 punonjës socialë dhe 1 farmacist.

⁴⁹ Ky nen parashikon se: 1. Institucionet mjekësore të posaçme janë institucione, që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shkrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale. 2. Trajtimi i personave në institucionet mjekësore të posaçme është i njëjtë me trajtimin e pacientëve të tjerë me çrregullime të shëndetit mendor. Institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

6. Pajisja e spitaleve me mjete të kufizimit mekanik, konform pikës 1.2 “Elementët e kufizimit”, germa b “Kufizimi Mekanik”, aktit nënligjor të cituar në pikën e mësipërme.

7. Mundësimi i riorganizimit të pavijoneve të pacienteve akutë më vete. *Nevojitet ndarja dhe riorganizimi i pavijoneve të veçanta të personave me aftësi të kufizuara, rezidentë, pacienteve akutë, sub-akutë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim më i plotë dhe sipas nevojave për secilën kategori, pasi vendosja e tyre në të njëjtin pavijon vështirëson trajtimin e tyre sipas standardeve të parashikuara në ligjin për shëndetin mendor dhe aktet nënligjore të tij.*

8. Përmirësimin e kushteve në pavijone, ngrohje, dushe dhe tualete në mënyrë që t’i ofrohet një shërbim sa më dinjitoz personave që trajtohen në spitalet psikiatrike, si dhe sigurimin e bazës së nevojshme materiale për stafet psiko-sociale.

9. Pajisja/vënia në funksion të plotë të laboratorëve klinike bio-kimike si dhe të aparateve të EKG-së.

10. Shërbimi mjekësor mbetet me mungesa dhe nevojë të përhershme për kushte më të mira materiale dhe mbështetje me staf sigurie. Për shkak të kushteve minimale të sigurisë, mjekët dhe stafi mbështetës janë gjithmonë të rrezikuar.

Për sa më sipër MKPT rekomandoi konkretisht për Spitalet Psikiatrike:

- ✓ Zbatimin e marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një institucioni të posaçëm mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”.
- ✓ Zbatimin e nenit 28 të ligjit nr. 44/2012 “Për Shëndetin Mendor” i ndryshuar, nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore dhe për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale.
- ✓ Shtimin në organikat e spitaleve të mjekëve psikiatër, infermierëve “kujdestarë/task forcë”, stafit të sigurisë, sanitarëve dhe berberit, me qëllim ofrimin e një shërbimi të përshtatshëm për specifikat e këtij shërbimi të shëndetit mendor me shtretër.
- ✓ Vendosjen e sistemit monitorues me kamera vëzhgimi në ambientet e përbashkëta të spitaleve psikiatrike.
- ✓ Krijimin/rikonstruksionin e plotë të dhomave të izolimit, duke i kompletuar ato në përputhje me pikën 4.6 “Infrastruktura e Izolimit”, të “Standardeve të Kufizimit Fizik në Shërbimet e Shëndetit Mendor të Specializuar me Shtretër.
- ✓ Pajisjen e spitaleve me mjete të kufizimit mekanik.
- ✓ Mundësimin e riorganizimit të pavijoneve të pacienteve akutë më vete.
- ✓ Përmirësimin e kushteve në pavijone, ngrohje, dushe dhe tualete në mënyrë që t’i ofrohet një shërbim sa më dinjitoz personave që trajtohen në spitalet psikiatrike.
- ✓ Pajisjen/vënien në funksion të plotë të laboratorëve klinike bio-kimike si dhe të aparateve të EKG-së.

- ✓ Përmirësimin e kushteve materiale dhe mbështetjen me staf sigurie për personelin mjekësor.
 - ✓ Ndarjen dhe riorganizimin në pavijoneve të veçanta të personave me aftësi të kufizuara intelektuale, rezidentë, pacienteve akutë, sub-akutë, në mënyrë që të ofrohet një shërbim më i plotë dhe sipas nevojave për secilën kategori.
- ***Niveli i respektimit të të drejtave në Qendrat e mbyllura për të Huajt, Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit si dhe në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut***

Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) për vitin 2021, në kuadër të monitorimit të respektimit të të drejtave në qendrat e pritjes të emigracionit, qendrën për mbrojtjen e viktimave nga trafikimi, etj, ka realizuar inspektimet përkatëse për të vlerësuar nivelin e respektimit të këtyre të drejtave.

- ***Qendra e Mbyllur për të Huajt, Karreç***

Mekanizmi Kombëtar zhvilloi një inspektim në Qendrën e Mbyllur për të Huajt në Karreç (QMHK).

Problematikat e konstatuara përgjatë inspektimit janë:

- ✓ Vazhdonte problematika e mungesa në staf si: mjeku, juristi, stomatologu, mungesa të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në respektimin e të drejtave të personave të huaj të parregullt në Republikën e Shqipërisë.
- ✓ Mungesa e aparatet kartofonike, të cilat janë të domosdoshme për personat e huaj, për të komunikuar me familjet. Grupi i inspektimit u informua nga stafi i institucionit se komunikimi i të akomoduarve me familjarët zgjidhej nëpërmjet qarkullimit të aparateve celular të personave që i dispononin, të cilët me orar të caktuar ua jepnin personave të tjerë për të komunikuar me familjarët apo përfaqësuesit ligjorë.
- ✓ Vijon mungesa në Qendër e përkthyesve, si një nevojë emergjente për komunikimet të cilët duhet të jenë për gjuhën angleze ose të gjuhës së huaj dominante të të huajve që ndodhen të akomoduar në këtë Qendër. Kjo mungesë sillte, në vazhdimësi, vështirësi në komunikimin dhe ndërveprimin e të akomoduarve me punonjësit e Qendrës.
- ✓ Mungesa e ambienteve rekreative dhe sportive. Mungonin aktivitetet kulturore, argëtuese e sportive dhe i vetmi aktivitet sportiv ishte ai i lojës me top, në një fushë të papërshtatshme për lojëra me këmbë.
- ✓ Mungesa në të gjitha ambientet e Qendrës e posterave me të drejtat ligjore të shtetasve të huaj të parregullt të ndaluar.
- ✓ Nuk ishte kryer lysterja periodike e dhomave të fjetjes së personave të huaj të akomoduar në Qendër, sidomos në korridorin e përbashkët të dhomave të banimit vërehej një ambient i papastër, mure të palyera dhe aromë e pakëndshme.

- ✓ Në Qendër nuk ofrohej shërbimi stomatologjik.
- ✓ Qendra kishte vetëm një infermier i cili u përgjigjej nevojave për shërbim mjekësor.
- ✓ Mungonin zilet e emergjencës në dhomat e fjetjes.
- ✓ Mirëmbajtja në sistemet hidrosanitare dhe elektrike në dhomat e izolimit janë bërë vetëm pjesërisht.

➤ *Qendra Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit Babrru, Tiranë*

Qendra Kombëtare Pritëse është e vetmja në territorin e Republikës së Shqipërisë ku akomodohen dhe trajtohen shtetas të huaj që kërkojnë mbrojtje në Shqipëri. Në këtë qendër strehohen azilkërkuesit pas paraqitjes së kërkesës për azil si dhe personat të cilëve iu është refuzuar aplikimi për azil, deri në përfundim të procedurave të ankimimit apo afateve për ushtrimin e tyre. QKPA-ja⁵⁰ ka buxhetin e vet, i cili është pjesë e buxhetit të Ministrisë së Brendshme, që mbulon çështjet e azilit dhe refugjatëve.

Problematikat e konstatuara përgjatë inspektimit janë:

- ✓ Qendra ka patur një fluks të madh azilkërkuesish dhe për këtë fakt shumë nga dyert, dritaret, mobilet, etj., kishin pësuar dëmtime të konsiderueshme.
- ✓ Nevoja emergjente në Qendër për mbështetje në staf dhe në mirëmbajtje, pasi burimet financiare dhe njerëzore i ka të kufizuara, çka e bëjnë të pamundur përballimin e situatave, kur ka mbipopullim që ndikon drejtpërdrejt në shkelje të të drejtave të azilkërkuesve të huaj.
- ✓ Mungesa e mjekut të përgjithshëm me kohë të plotë dhe një kujdestar nate në organikën e Qendrës. Mungesa e mjekut ka krijuar një situatë jo të favorshme në ofrimin e kujdesit shëndetësor ndaj personave të huaj të cilët paraqiten në institucion. Këta persona jo rrallë herë paraqiten me nevoja të theksuara për kujdes shëndetësor, pasi ata vijnë nga një rrugëtim i gjatë dhe i mundimshëm.
- ✓ Nevoja për rritjen e kuotës ditore të trajtimit me ushqim të azilkërkuesve, duke marrë parasysh rritjen e çmimeve të shportës së ushqimeve si dhe vlerësimin e tyre vit pas viti.
- ✓ Nevoja e domosdoshme për marrjen e masave për rikonstruksionin e godinës 4 (katër) katëshe dhe godinave 1 (një) katëshe nr. 3 dhe nr. 4, për të bërë të mundur krijimin e kushteve normale për jetesën e këtyre personave, pasi rritja e fluksit nuk është shoqëruar me rritjen e kapaciteteve të stafit mbështetës. Për shkak të situatës së krijuar nga fluksi i vitit të kaluar ambientet e banimit si dhe struktura e godinave kanë pësuar dëme të konsiderueshme materiale duke i nxjerrë jashtë funksionit të tyre, kjo dhe për shkak se ndërmjet azilkërkuesve kishte konflikte të mbartura prej nga vinin dhe sistemimi i tyre në ambientet e akomodimit i vinte në vështirësi.

⁵⁰ Në zbatim të nenin 44, të ligjit nr.10/2021 "Për Azilin në Republikën e Shqipërisë", si dhe në zbatim të vendimit nr. 322, datë 4.5.2016 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e qendrës kombëtare pritëse për azilkërkuesit".

➤ *Qendra Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, Linzë*

Mekanizmi Kombëtar kreu një inspektim në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, në vijim (QKPVT) Linzë.

Kjo Qendër ka si mision përmirësimin e statusit social të viktimave të mundshme të trafikimit, ndërgjegjësimin dhe aftësimin e tyre për jetesë të pavarur në komunitet, nëpërmjet zhvillimit të vazhdueshëm të procesit të vetëvlerësimit, të luftës së stigmës ndaj kësaj kategorie dhe diskriminimit që kanë efekt të drejtpërdrejtë në riintegrimin e plotë. Qëllimi i kësaj Qendre është rehabilitimi i grave e vajzave të trafikuar ose të identifikuar si potencial trafikimi. QKPVT u ofron përfituesve një vendqëndrim të përkohshëm të sigurt, jashtë rrezikut, duke ofruar në të njëjtën kohë, ndihmë të specializuar për riaftësimin dhe rikthimin në jetën normale.

Problematikat e konstatuara përgjatë inspektimit janë:

- ✓ Nevoja për rikonstrukcionin e pjesshëm të godinës dy katëshe, pasi ambientet e saj kanë pësuar dëme të konsiderueshme dhe janë të pasigurta ambientet e banimit në të.
- ✓ Nevoja për përfundimin sa më shpejt të rikonstrukcionit të godinës tre katëshe brenda Qendrës.
- ✓ Është e domosdoshme pajisja e menjëhershme e institucionit me një automjet për garantimin e ofrimit të shërbimeve për përfitueset jashtë Qendrës.

3.5 Respektimi i të drejtave të njeriut nga Prokuroria⁵¹

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar dhe trajtuar 35 çështje në të cilat janë ngritur dhe parashtruar pretendime dhe shqetësime ndaj veprimtarisë së organit të Prokurorisë. Njëkohësisht, nga ana jonë ka vijuar edhe trajtimi i 54 çështjeve dhe ankesave të mbartura nga viti 2020, për shkak të regjistrimit në javët e fundit të vitit, apo edhe të vonesave të konstatuara në kthimin e përgjigjeve nga strukturat e prokurorive, të cilave u jemi drejtuar për të marrë informacionet dhe shpjegimet e nevojshme lidhur me pretendimet dhe shqetësimet e parashtruara nga ankuesit.

Nga këto raste të regjistruara në vitin 2021, rezulton se 5 çështje janë trajtuar dhe shqyrtuar me iniciativë nga institucioni i Avokatit të Popullit, duke dëshmuar qartë vëmendjen e shtuar që i kushtohet në vijimësi nga ana jonë problematikave të qytetarëve dhe shqetësimeve të tyre publike ndaj strukturave të prokurorisë në të gjitha nivelet në veçanti, por edhe atyre të drejtësisë në përgjithësi. Ky fokus dhe vëmendje e veçantë lidhet kryesisht edhe me faktin e zbatimit prej disa vitesh tashmë të Reformës në Drejtësi dhe disa problematikave që ajo po sjell në hetimin e kallëzimeve dhe procedimeve penale, për shkak të vakancave të shkaktuara nga shkarkimet e një numri të konsiderueshëm të prokurorëve në të gjitha prokuroritë.

Në mënyrë të grupuar dhe sipas rëndësisë së cënimit të të drejtave në procesin penal, ankesat e qytetarëve paraqiten si më poshtë:

⁵¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Së pari: Për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale.

Ankesat e qytetarëve ndaj prokurorisë për zvarritje në hetimin e procedimeve penale zënë pjesën e konsiderueshme të numrit të përgjithshëm të çështjeve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit. Duke u bazuar në përgjigjet dhe qëndrimet zyrtare të mbajtura nga Prokuroritë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë, arsyet e zvarritjes në hetimin e procedimeve penale lidhen kryesisht me numrin e reduktuar të prokurorëve në strukturat e hetimit dhe procedimit penal, për shkaqet e zbatimit rigoroz të reformës në drejtësi dhe shkarkimit të një numri të konsiderueshëm të prokurorëve; numri i lartë të çështjeve për një prokuror; kompleksiteti i çështjeve, sidomos ato që kanë të bëjnë me dhunën në familje, marrëdhënie seksuale me të mitur, apo vepra të tjera të rënda penale; probleme dhe zvarritje të kthimit të përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet e drejtësisë të shteteve të huaja si dhe komandimet e prokurorëve të çështjeve në prokurori të tjera për të mbuluar vakancat e krijuara.

Së dyti: problematika në zbatimin e dispozitave procedurale që parashikojnë dhe rregullojnë të drejtat e palëve në procesin penal, e më konkretisht mosnjohja me aktet dhe provat mbi bazën e të cilave ngrihen akuzat penale; munges ose vonesat në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë, kryesisht kallëzuesit të veprës penale, sidomos në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal.

Vonesa për njoftimet e palëve në procesin penal kanë ndodhur dhe për rastet kur organi i Prokurorisë ka marrë vendim për pushimin e çështjes. Gjithashtu, konstatohet edhe fakti se në rastet e pezullimit të hetimit, në disa raste organi i Prokurorisë nuk njofton/informon apo nuk iu dërgon palëve vendimin përkatës.

Avokati i Popullit ndër vite ka insistuar në respektimin e të drejtës së qytetarit për t'u informuar me vendimet përfundimtare të Prokurorisë, duke synuar garantimin e të drejtës së ankimit që duhet t'u njihet individëve ndaj vendimeve respektive në çdo fazë të hetimit.

Nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit administrohen në vijimësi ankesa dhe kërkesa të shtetasve për ndihmë juridike me objekt të veçantë verifikimin e kryerjes apo moskryerjes së veprimeve nga ana e organit të prokurorisë për regjistrimin e kallëzimeve penale, kryerjen e veprimeve hetimore dhe më pas marrjen e një vendimi respektiv brenda afateve proceduralë. Kjo situatë po reflektohet tashmë, siç e theksuam edhe më lart, për shkak të reduktimit maksimal të numrit të prokurorëve në të gjitha nivelet, duke shkaktuar edhe një cenim të standardit të një procesi të rregullt ligjor, në të gjitha dimensionet e tij.

Realiteti është në kufijtë e një situatë jo normale të ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave ligjore nga ana e organit të Prokurorisë në mbrojtjen e marrëdhënieve juridike dhe garantimin e të drejtave të individëve që cënohen nga vepra të ndryshme penale dhe që kërkojnë ndihmën dhe mbrojtjen e strukturave të shtetit, detyrë e cila në rastin konkret duhet të ushtrohet nga Prokuroria brenda një afati sa më të arsyeshëm. Aktualisht, konstatojmë një mungesë efektiviteti në hetimin e veprave të ndryshme penale, për shkak të numrit të reduktuar të prokurorëve, zgjerimit të gamës

së veprave penale, rritjes së ndërgjegjësimit të individëve për kallëzimin dhe referimin e veprave të ndryshme penale, të cilat më parë ishin jo të zakonshme për realitetin dhe shoqërinë shqiptare si dhuna në familje dhe marrëdhëniet seksuale me të mitur apo familjarë.

Avokati i Popullit kërkon dhe synon ndërgjegjësimin maksimal të të gjitha strukturave të angazhuara për mbarëvajtjen dhe funksionimin e sistemit të Prokurorisë, me qëllim që të merren masa efektive, të përshtatshme, të shpejta dhe konkrete për vendosjen në normalitet dhe garantimin e ushtrimit të ndjekjes penale nga Prokuroria brenda hapësirave dhe parashikimeve të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale.

3.6 E drejta për një proces të rregullt ligjor⁵²

Në vlerësimin e Avokatit të Popullit, funksionimi i sistemit të drejtësisë edhe gjatë këtij viti është përballur me vështirësi. Vijimi i reformës në drejtësi ka rritur volumin e punës në sistem për shkak të mungesave dhe largimeve të një numri të konsiderueshëm gjyqtarësh dhe moszëvendësimit të tyre me të rinj.

Krahas sa më sipër, kanë vijuar edhe vështirësitë e shkaktuara nga pandemia globale COVID-19. Kështu, gjatë vitit 2021 janë konstatuar zvarritje të proceseve gjyqësore, shtyrje të gjykimit të çështjeve të reja, dorëzime me vonesë të vendimeve të arsyetuara si dhe problematika në respektimin e plotë të të drejtave procedurale gjatë gjykimit.

Ringritja e pushtetit të tretë në vend po kryhet me ritme të ngadalta, plotësimi i Gjykatës Kushtetuese, pas një periudhe të gjatë mungese, ende nuk ka përfunduar. Po e njëjta situatë është në Gjykatën e Lartë.

Kryetari i Gjykatës së Lartë është shprehur se mbi 35 mijë çështje presin të gjykohen në Gjykatën e Lartë prej vitesh,⁵³ e cila duhet të funksionojë me një numër prej 19 gjyqtarësh, por deri tani vijon të jetë ende e paplotësuar, duke funksionuar vetëm me 10 gjyqtarë⁵⁴. Ka pasur përmirësim në gjykimin e çështjeve krahasuar me vitin 2020, pasi gjatë vitit 2021 janë dhënë rreth 3609 vendime.

Situata e krijuar në Gjykatën Administrative të Apelit e cila është një e vetme në vend, paraqet problematika në gjykimin e çështjeve.⁵⁵ Në nenin 48, pika 2 të ligjit nr.49/2012 “Për organizimin

⁵² Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

⁵³ Konferencë me Median e Zv. Kryetarit të Gjykatës së Lartë, datë 30.12.2021: “Ulja e çështjeve të prapambetura, sfida! 500 dosje në vit për një gjyqtar”.

<https://www.google.com/url?sa=i&url=https%3A%2F%2Ftop-channel.tv%2F2021%2F12%2F30%2Fzv-kryetari-i-gjykatës-se-lartë-ulja-e-çështjeve-te-prapambetura-sfide-500-dosje-ne-vit-per-nje-gjyqtar55%2F&psig=AOvVaw1v1sMyT4->

⁵⁴ E dhëna, si më lart, lidhet me vitin 2021. Ndërsa jatë muajve të pare të vitit 2022 u emëruan edhe dy anëtarë të tjerë duke çuar numrin në 12 gjyqtarë.

⁵⁵ Më datë 19.10.2021, Komisioni Evropian miratoi dhe publikoi Raportin e Progresit për Shqipërinë për vitin 2021. Sipas këtij raporti, një ndër gjykatat me nivelin më të lartë të çështjeve të prapambetura është Gjykata Administrative e Apelit. *Kjo e fundit ka 15 178 çështje nga të cilat 7 463 janë më të vjetra se dy vite. Ndërsa norma e evadimit është 37%.*

Për më tepër, shih linkun:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

dhe funksionimin e gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, parashikohet se “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.” Gjithashtu, në ligjin nr.49/2012, konkretisht në nenin 3 të tij, renditet si një ndër parimet themelore të gjykimit administrativ edhe sigurimi i një procesi të rregullt gjyqësor brenda afateve të shpejta dhe të arsyeshme, kjo me synimin për të garantuar një mbrojtje efektive të të drejtave subjektive dhe interesave të ligjshme të personave.

Nga ana tjetër, vetë Kodi i Procedurës Civile, i cili përcakton rregulla të detyrueshme, të njëjta dhe të barabarta për gjykimin e mosmarrëveshjeve civile e të mosmarrëveshjeve të tjera, me ndryshimet e vitit 2017, i ka kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së respektimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit, duke e trajtuar këtë institut në një kre të veçantë. Në dispozitën e nenit 399/2, pika 1 e këtij ligji përcaktohet afati maksimal se:

“1. Afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, për qëllimet e përcaktuara në nenin 399/1, do të konsiderohen:

a) në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë;

Dispozitat e lartpërmendura të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr.49/2012, kanë si qëllim vendosjen për herë të parë të standardeve, si dhe një kufi në raport me termat kohorë lidhur me gjykimin brenda afatit të arsyeshëm. Kështu, në çdo rast, sipas dispozitës së nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi administrativ në shkallën e parë dhe në apel nuk mund të zgjasë më tepër se një vit nga fillimi i tij në secilën shkallë.

Fakti i ngarkesës së lartë sasiore të gjyqtarëve⁵⁶, në mënyrë të veçantë në Gjykatën e Apelit Tiranë ose Gjykatën Administrative të Apelit është një tjetër faktor që ndikon në vonesat për shqyrtimin e çështjeve gjyqësore. Nisur dhe nga ankesat që janë paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit, vlerësojmë se çështja kërkon ndërhyrje, pasi vonesat po dëmtojnë qytetarët.

Theksojmë se Gjykata Administrative e Apelit aktualisht punon me vetëm 5 gjyqtarë nga 13 që janë në organikë. Në kushte të ngjashme, në vend gjatë kësaj kohe, kanë funksionuar edhe gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

Vonesa e konsolidimit të institucioneve funksionale të drejtësisë, është e dëmshme dhe cenon besimin e publikut në sistemin gjyqësor. Përshpejtimi dhe finalizimi i reformës në drejtësi janë të domosdoshëm.

⁵⁶Sipas Raport Progresit për Shqipërinë për vitin 2021, në vitin 2020, Shqipëria ka pasur 307 gjyqtarë me kohë të plotë (10.8 për 100,000 banorë) dhe 300 prokurorë me kohë të plotë (10.5 për 100,000 banorë). Sipas Komisionit Europian për Efiçencën në Drejtësi (CEPEJ), mesataret evropiane janë 21 gjyqtarë/12 prokurorë për 100,000 banorë.

Për më tepër, shih linkun:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

Plotësimi progresiv i vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese, Gjykatën e Lartë, gjykatat e apelit dhe ato të rretheve gjyqësore, me qëllim rritjen e cilësisë së dhënies së drejtësisë dhe ofrimin e shërbimeve gjyqësore, brenda afateve të arsyeshme kohore, si dhe rritja e kapaciteteve si në numrin e gjyqtarëve, duke plotësuar vakancat e krijuara, por njëkohësisht rritja e kapaciteteve të tyre trajnuese, profesionale dhe mbështetëse, do të ndikonin pozitivisht.

Kryerja e riorganizimit gjyqësor në konsultim me të gjithë aktorët e përfshirë në proces, si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, institucione të pavarura, përfaqësues të shoqërisë civile, qytetarë, etj, optimizimi i burimeve njerëzore në drejtësi si dhe rritja e cilësisë së shërbimit pa dëmtuar aksesin në drejtësi të shtetasve janë procese që duhet të kryhen.

Kryesisht, ankesat e përcjella nga shtetasit pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë përqendruar në:

- ✓ zvarritje të proceseve gjyqësore dhe në veçanti afate të tejzgjatura për marrjen në shqyrtim të çështjeve nga Gjykatat e Apelit, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë;
- ✓ dorëzimin me vonesë të vendimit të arsyetuar/mosnjoftimin e palëve nga gjykata brenda afateve të përcaktuara në Kodet e Procedurës;
- ✓ mosmarrjen në shqyrtim të çështjeve të reja nga gjykatat e shkallës së parë për një afat disa mujor;
- ✓ kërkesa të shumta për përsheptim të gjykimit nga gjykatat e apelit, për shkaqe të justifikuara si sëmundje dhe vështirësi ekonomike;
- ✓ kërkesa për përfitim të ndihmës juridike detyësore nga gjykatat, etj.

Këto çështje të adresuara nga qytetarët, Avokati i Popullit i ka bërë prezente pranë organeve gjyqësore përkatëse, duke theksuar se kanë të bëjnë me thelbin e procesit të rregullt ligjor. Pavarësisht nga mirëkuptimi i situatës së krijuar, vlerësojmë se nuk mund të neglizhohet për asnjë moment e drejta e qytetarëve për një proces të rregullt ligjor sipas garancive të parashikuara në nenin 6 të KEDNJ-së.

Po ashtu, janë adresuar disa rekomandime drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë dhe gjykatave⁵⁷.

Një vend të rëndësishëm ka zënë trajtimi i problematikave të konstatuara gjatë protestave të organizuara në dhjetor 2020 për shkak të vrasjes së shtetasit K.R. nga një punonjës i Policisë së

⁵⁷ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimet përkatëse.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20garancive%20t%C3%AB%20procesit%20t%C3%AB%20rregullt%20ligjor.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandohet%20marrja%20e%20masave%20p%C3%ABr%20respektimin%20e%20afateve%20procedurale%20p%C3%ABr%20arsyetimin%20dhe%20dor%C3%ABzimin%20e%20ven dimeve%20gjyq%C3%ABsore.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20t%C3%AB%20nevojshme%20p%C3%ABr%20zbatimin%20e%20akteve%20normative%20dhe%20atyre%20individuale%20p%C3%ABr%20kufizimin%20e%20p%C3%ABrhapjes%20s%C3%AB%20virusit%20COVID.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20drejtuar%20Gjykates%20Administrative%20Ote%20Apelit.pdf>

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20Gjykates%20se%20Apelit%20Shkoder%20akronime.pdf>

Shtetit, në hetimin dhe gjykimin e veprave penale përkatëse nga organet e prokurorisë dhe gjykatat, duke i kushtuar fokus të veçantë, shoqërimeve, ndalimeve, arrestimeve dhe trajtimit të shtetasve të mitur.

Në analizë të akteve ndërkombëtare dhe legjisllacionit vendas, Avokati i Popullit ka arsyetuar se standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut kërkojnë që çdo kufizim i lirisë duhet të jetë përjashtim, objektivist i justifikuar dhe për një kohëzgjatje jo më shumë se sa është absolutisht i domosdoshëm. Standardet ndërkombëtare inkurajojnë shprehimisht mospërdorimin e masave shtrënguese të kufizimit të lirisë gjatë hetimit dhe gjykimin, deri në dhënien e vendimit.

Në vlerësimin tonë, spektri i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të parashikuara në Kushtetutë plotësohet nga deklarimi konstitucional që askush nuk duhet t'i nënshtrohet arbitrarisht arrestimit ose ndalimit dhe që gjithkush gëzon njëllë të drejtën për një proces të rregullt ligjor, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale kundër tij.

Është detyrë e gjykatës që të vlerësojë kërkesat e organit të prokurorisë për caktimin e masave të sigurimit personal, duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat, në favor ose kundër interesit publik, që përlligj një përjashtim nga parimi i respektimit të lirive të individit, duke pasur parasysh prezumimin e pafajësisë dhe paraqitjen e tij në argumentimin e vendimit të dhënë⁵⁸.

Gjykata duhet të analizojë me kujdes nëse nga provat e paraqitura në gjykim rezulton e provuar se ekziston rreziku i largimit të të dyshuarit, shmangies së tij ndaj hetimeve, rreziku i marrjes së provave apo rreziku që ky person të kryejë një vepër tjetër të rëndë apo më të rëndë. *Numri i të paraburgosurve në Shqipëri zë 50 për qind të të gjithë të burgosurve, ndërkohë që mesatarja e të paraburgosurve në vendet evropiane është 20 për qind.*⁵⁹

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve parashikon parimin e interesit më të lartë të fëmijës. Ky parim, po ashtu përshkon edhe ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”. Interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë synimi kryesor në çdo vendim që merret mbi jetën e fëmijës si nga institucionet shtetërore apo ato private. Interesi më i lartë i fëmijës gjen zbatim në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren nga autoritetet publike dhe jopublike, si dhe nga gjykatat në lidhje me fëmijët.

Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur sipas nenit 14 të tij përcakton se në procedurën e të drejtës penale për të mitur përparësi u jepet masave alternative të shmangies nga procedimi penal. Këto masa që synojnë shmangien e të miturit nga procedimi penal ose zbatimi i masave të drejtësisë restauruese vlerësohen si mundësia e parë.

⁵⁸ Tomasi kundër Francës, datë. 27.08.1993.

⁵⁹ Këshilli i Evropës, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit çnjerëzor dhe poshtëruës (KPT), Pjesë nga raporti i 26-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2017.

² Statistikat Vjetore Penale të Këshillit të Evropës, SPACE I – Popullsia në burgje, Anketë 2015, PC-CP (2016) 6, 15 dhjetor 2016, tabelat 4 dhe 5.1. Sipas kësaj ankete, mesatarisht, rreth 25% e të gjithë të burgosurve në zonën e Këshillit të Evropës kanë qenë në paraburgim.

Në nenin 15 të Kodit, arrestimi, ndalimi ose burgimi i të miturit parashikohet si masë e fundit, për një kohë sa më të shkurtër, si dhe këto masa janë objekt i rishikimit të rregullt periodik nga gjykata. Gjithashtu, duke qenë se personave në hetim, pjesëmarrës në protesta u është atribuar, ndër të tjera, vepra penale e “*Organizimit dhe pjesëmarrja në grumbullime e manifestime të paligjshme*”, dëshirojmë të evidentojmë vendimin nr.24 datë 04.05.2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë⁶⁰.

Në këtë çështje me kërkesë të Gjykatës së Apelit Shkodër u mor në shqyrtim papajtueshmëria me Kushtetutën e togfjalëshit “*pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta*”, në paragrafin e parë të nenit 262 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë. Avokati i Popullit, i thirrur në këtë proces si subjekt i interesuar, ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur si vijon:

- ✓ Legjislacioni që mbulon lirinë e tubimit paqësor duhet të jetë i qartë dhe i hartuar në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Sipas këtyre të fundit, nuk është e nevojshme që legjislacioni i brendshëm të kërkojë njoftimin paraprak të një tubimi, por njoftimi u mundëson autoriteteve shtetërore të lehtësojnë mbledhjen e protestuesve si dhe të sigurojnë rendin publik dhe të mbrojnë të drejtat e të tjerëve.
- ✓ Liria e tubimit nuk i nënshtrohet asnjë formaliteti miratimi nga organet e policisë, por për ushtrimin e kësaj të drejte, sipas ligjit nr. 8773/2001, kërkohet vetëm bërja e njoftimit në organet e policisë në një kohë të përcaktuar. Fakti që në ligjin nr. 8773/2001 përdoret termi “*njoftim*” dhe jo “*kërkesë*”, drejtuar organeve të policisë për zhvillimin e tubimit është me rëndësi, pasi garanton ushtrimin e së drejtës së tubimit nga ana e shtetasve. Pra, vendimin për ushtrimin e së drejtës së tubimit e merr vetë subjekti njoftues dhe nuk kërkohet miratimi/leja e organit të policisë.
- ✓ Togfjalëshi që përmban neni 262, paragrafi i parë, i Kodit Penal, objekt kërkesë, është i papajtueshëm me nenin 47 të Kushtetutës, si dhe me nenet 11 dhe 18 të KEDNJ-së, pasi kufizon ushtrimin e së drejtës së tubimit me marrjen e lejes, ndërkohë që leja nuk parashikohet as në Kushtetutë, as në ligjin nr. 8773/2001 për tubimet. Ky togfjalësh jo vetëm është i tejkaluar në kohë, pasi i përket periudhës përpara miratimit të Kushtetutës së vitit 1998, por nuk është përshtatur as me ligjin nr. 8773/2001 për tubimet.
- ✓ Parashikimi në dispozitën ligjore, objekt shqyrtimi, për dënimin e organizatorëve dhe/ose pjesëmarrësve në një tubim paqësor me gjobë ose burgim gjer në një vit është joproporcional, në kundërshtim me nenin 17, pika 1, të Kushtetutës dhe ligjin nr. 8773/2001. Edhe pse në rastin e parashikimit të nenit 262, paragrafi i parë, nuk ndodhemi përpara ndonjë interesi publik të cenuar, masa e dënimit që parashikohet në të është më e rëndë sesa masat e dënimit të parashikuara nga ligji nr. 8773/2001.

Në përfundim, Gjykata Kushtetuese vendosi pranimin e kërkesës: Shfuqizimin e shprehjes “*pa marrë më parë lejen nga organi kompetent sipas dispozitave të veçanta*” në paragrafin e parë të nenit 262 të Kodit Penal; dhe detyrimin e Kuvendit të plotësojë normën ligjore nga data e shpalljes

⁶⁰ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24 datë 04.05.2021. Për më tepër, shih:

https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=3251&nr_vendim=1, botuar në Fletoren Zyrtare me nr.87, datë 7.6.2021.

së vendimit të Gjykatës Kushtetuese deri në hyrjen në fuqi të tij, 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare. *Deri në datën e përgatitjes së këtij raporti dispozita nuk është plotësuar.*

3.7 Ndhimja juridike falas⁶¹

Në vëmendjen e Avokatit të Popullit ka qenë vënia në zbatim e ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, nxjerrja e akteve nënligjore, ngritja e strukturave të parashikuara nga ligji dhe efektiviteti i tij, në kuadër të kërkesave dhe nevojave të qytetarëve që shteti t’ua garantojë këtë shërbim.

Nisur nga ankesat individuale⁶², gjatë vitit 2021, kemi trajtuar problematikën e shtetasve që kanë përfituar me vendim gjyqësor ndihmë juridike falas dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore, por këto vendime në disa raste kanë mbetur në letër, të pazbatuara nga dhomat vendore të avokatisë, duke mos përmbushur detyrimin ligjor për të caktuar avokatin përkatës.

Lidhur me këtë çështje, kemi adresuar rekomandim në Ministrinë e Drejtësisë dhe për dijeni Dhomës Kombëtare të Avokatisë⁶³. Caktimi i avokatëve që ofrojnë ndihmën juridike dytësore, sipas parashikimeve ligjore dhe nënligjore në fuqi është në kompetencën e Dhomës Vendore të Avokatisë.

Konkretisht, në nenin 24 të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, “Dhënia e ndihmës juridike dytësore nga avokatët”, si dhe Udhëzimit të Përbashkët nr.18, datë 05.08.2020 “Për rregullat e zbatimit të parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që do të ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore në proceset civile dhe administrative”, parashikohet se:

“Në rast të pranimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore veprohet sipas rregullave të mëposhtme:

- a. dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas parimit të rotacionit;*
- b. dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike dytësore”.*

Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas na ka informuar se në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional, pas komunikimit të vendimeve të gjykatave i është drejtuar dhomave vendore të avokatisë ku ka kërkuar zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe vijimin e procedurës për caktimin e avokatit që do të ofrojë ndihmën juridike dytësore, por në raste të përsëritura nuk ka marrë përgjigje.

⁶¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

⁶² Për vitin 2021, janë 4188 raste të cilat janë trajtuar si këshillime dhe orientime mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin subjektet ankues/kërkues për trajtimin e rasteve.

⁶³Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim-F.pdf>

Institucioni i Avokatit të Popullit u është drejtuar dhomave vendore të avokatisë dhe Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë, duke theksuar detyrimin për zbatimin e vendimeve gjyqësore, si dhe kemi kërkuar bashkëpunim për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Evidentojmë se, **nuk** ka pasur reagim dhe **nuk** na është kthyer asnjë përgjigje si nga dhomat vendore, ashtu edhe nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë.

Çmujmë se, pavarësisht faktit që dhomat e avokatisë nuk janë institucione të administratës publike, në rastin konkret ato ushtrojnë një funksion të institucionit përgjegjës bashkarisht me institucionet e tjera shtetërore për ofrimin e një shërbimi, sikurse është ndihma juridike falas. Në këtë kontekst, mungesa e bashkëpunimit me institucionin e Avokatit të Popullit për zbatimin e vendimeve gjyqësore dhe për t'i garantuar shtetasve ndihmë juridike falas në kuadër të procesit të rregullt ligjor, tregon neglizhencë të theksuar.

Në nenin 6 të ligjit nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, përcaktohen shprehimisht institucionet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike, të cilat janë:

- ✓ Ministri i Drejtësisë
- ✓ Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas
- ✓ Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë
- ✓ Gjykatat kompetente

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas luan rol thelbësor për shërbimet e ndihmës juridike dytësore. Konkretisht publikon listën e avokatëve të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, publikon kontratën tip me avokatët dhe kryen pagesat e tyre. Gjithashtu kjo strukturë, miraton me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë një projektudhëzim për kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore si dhe duhet të lidhë, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga Dhoma e Avokatisë e Shqipërisë për ofrimin e ndihmës juridike dytësore.

Ndërsa, detyrat e Dhomës Kombëtare të Avokatisë janë të përcaktuara në nenin 9 të ligjit nr.111/2017.⁶⁴ Në zbatim të ligjit, Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas ka nënshkruar kontratën për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore falas, për dhomat vendore të avokatisë, për vitin 2021.

⁶⁴ Në nenin 9 të ligjit nr.111/2017, parashikohet se ky institucion përgjegjës:

a. miraton me udhëzim të përbashkët me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;

b. miraton, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sipas parashikimeve të nenit 24, të këtij ligji, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga dhomat vendore të avokatisë;

c. brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, Dhoma Kombëtare e Avokatisë miraton listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe ia përcjell këtë listë Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas dhe dhomave vendore të avokatisë. Në hartimin e kësaj liste, Dhoma Kombëtare e Avokatisë mban parasysh, për aq sa është e mundur, përfshirjen e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore;

d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me Drejtorinë e Ndihmës Juridike Falas;

dh. kryen detyra të tjera që i caktohen nga ligji.”

Ndërkohë, në rastin e trajtuar nga institucioni ynë, gjykata ka nxjerrë një vendim ku ka vendosur ofrimin e ndihmës juridike falas dhe përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore për shtetasin i cili plotëson kriteret ligjore, detyrim i cili ngarkon në mënyrë të drejtpërdrejtë dhomën vendore të avokatisë për zbatim.

Në nenin 24 të ligjit nr.111/2017 përcaktohet:

“a) dhoma vendore e avokatisë cakton një avokat nga lista e avokatëve që japin shërbimet e ndihmës juridike detyësore, sipas parimit të rotacionit; b) dhoma vendore e avokatisë përcjell vendimin e gjykatës kompetente, së bashku me vendimin e saj mbi caktimin e avokatit, këtij të fundit dhe personit të cilit i është pranuar kërkesa për ndihmën juridike detyësore.”

Nga dhoma të ndryshme në shkallë vendi (Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan, Fier, Shkodër) nuk ka pasur reagim për zbatimin e vendimeve gjyqësore, gjë që bie në kundërshtim me dispozitat ligjore të parashikuara në ligjin nr.55/2018 *“Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”*, si dhe ligjin nr.111/2017, duke iu mohuar kërkuarve të drejtën themelore të parashikuar nga Kushtetuta, të drejtën për akses të barabartë në sistemin e drejtësisë.

Vlerësojmë se jo vetëm miratimi i ligjit nr.111/2017 *“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”*, por edhe bashkëpunimi i të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë ligj, duke zbatuar përgjegjësitë përkatëse, janë të domosdoshëm për bërjen funksional dhe efektiv të tij.

Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në rast se mohohet kjo e drejtë procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesin në gjykatë është, para së gjithash, një kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t’iu drejtuar gjykatës.⁶⁵

Po ashtu në aktet e Këshillit të Evropës është vendosur standardi se ndihma juridike duhet të mundësohet për të gjithë qytetarët që nuk kanë mundësi ekonomike, jo vetëm për mbrojtjen ligjore në proceset gjyqësore, por edhe në rastet e nevojës për këshillim ligjor.⁶⁶

3.8 Të drejtat e ish të dënuarve dhe përndjekurve politikë nga sistemi komunist⁶⁷

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka pasur në fokus çështjen e pagesave të kësteve të dëmshpërblimit të ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre, në zbatim të ligjit

⁶⁵ Vendimi nr.52, 14.11.2014 i Gjykatës Kushtetuese.

Vendimet nr.17, datë 18.07.2008; nr.5, datë 06.03.2009; nr. 48, datë 24.09.2014 të Gjykatës Kushtetuese.

⁶⁶ Rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës R(81)7 dhe R(93)1 synonin në thelb të tyre zgjerimin e ndihmës juridike falas në të gjitha fazat e proceseve civile, administrative, penale, përfshirjen e organizatave joqeveritare në ofrimin e këshillimit dhe ndihmës juridike, marrjen e masave për reduktimin e tarifave gjyqësore etj.

Shih Rekomandimin R (81)7: <https://rm.coe.int/168050e7e4>.

Shih Rekomandimin R (93)1: https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016804df0ee

⁶⁷ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Veçantë në Institutin e Avokatit të Popullit.

nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëshmipërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, të ndryshuar.⁶⁸

Po ashtu, për raste të veçanta të paraqitura përmes ankesave të shtetasve, kur janë konstatuar vonesa ose paqartësi në shpërndarjen e kësteve, janë hartuar dhe adresuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë rekomandime individuale⁶⁹. Ndërkohë nga ana jonë, për shkak të ndjeshmërisë publike të kësaj çështjeje, është parë me interes dhe e arsyeshme regjistrimi dhe ndjekja me iniciativë e monitorimit në përgjithësi të procesit të dëshmipërblimit të shtresës së të përndjekurve politikë.⁷⁰

Kështu, është konstatuar në media, konkretisht në gazetën “Panorama” të datës 17 shkurt 2021 se është publikuar një listë e dytë, ku përfshihen trashëgimtarët e të dënuarve politikë që marrin këstin e tretë të dëshmipërblimit. Ndërkohë, në një artikull të kësaj gazete, Presidenti i Unionit Mbarëkombëtar i të Burgosurve dhe të Përndjekurve Politikë të Shqipërisë, është shprehur se ritmet e dhënies së kësteve janë tepër të vonuara në kohë dhe do të bëjnë që të zhduket edhe brezi i tretë i trashëgimtarëve. Një shqetësim i tillë është ngritur edhe nga Kryetari i Shoqatës së Ish të Përndjekurve politikë dega Shkodër, lidhur me shtyrjen e dhënies së këstit të tretë të dëshmipërblimit për ish të përndjekurit politikë.

Në kuadër të hetimit administrativ të nisur nga ana jonë është kërkuar informacion pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, mbi fondin e vënë në dispozicion për dëshmipërblimin e ish të dënuarve politikë për vitet 2020 dhe 2021, numrin e dosjeve që janë procesuar për dhënien e këstit të tretë, personat përfitues gjatë vitit 2020 dhe sa dosje parashikohet të procesohen gjatë vitit 2021.

Në kthimin e përgjigjes, ndër të tjera, Ministria e Financave dhe Ekonomisë evidenton se: “*Fondi i miratuar për kategorinë e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist për vitin 2021 është 1 miliard lekë. Numri i dosjeve të parashikuara për t’u procesuar me fondin aktual të vitit 2021 në dispozicion është 1827 dosje e përkthyer kjo në 10218 subjekte përfituese (individë) në total.*”

Në përmbushje të mandatit të tij kushtetues, Avokati i Popullit ka qenë dhe mbetet i angazhuar në misionin e tij të mbrojtjes, garantimit dhe promovimit të të drejtave të njeriut, ku përfshihen edhe të drejtat e ish të dënuarve politikë apo të të afërmve të tyre që vijnë pasojat e rënda të ish-regjimit diktatorial. Në këtë kuadër, një rëndësi të veçantë merr edhe “*Drejtësia Tranzicionale*”, si një proces shumëdimensional, në të cilin duhet të ecet paralelisht në të gjitha drejtimet.

⁶⁸ Gjatë vitit 2021 janë ndjekur 14 raste që kanë pasur në fokus çështjen e pagesave të kësteve të dëshmipërblimit të ish të dënuarve politikë dhe trashëgimtarëve të tyre

⁶⁹ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimet përkatëse.
[https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20p%C3%ABr%20dh%C3%ABnien%20e%20k%C3%ABstit%20t%C3%AB%20tret%C3%AB%20t%C3%AB%20d%C3%ABmshp%C3%ABrblimit%20trash%C3%ABgimtar%C3%ABve%20t%C3%AB%20z.%20S.pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20p%C3%ABr%20marrjen%20e%20masave%20p%C3%ABr%20rishikimin%20e%20dosjes%20s%C3%AB%20d%C3%ABmshp%C3%ABrblimit%20t%C3%AB%20ish%20t%C3%AB%20d%C3%ABnuarit%20politik%20H.K.%20duke%20rivler%C3%ABsuar%20trash%C3%ABgimtar%C3%ABt%20dhe%20m%C3%ABnyr%C3%ABn%20e.pdf)

⁷⁰ Për më shumë informacion, drejtohuni në faqen zyrtare të institucionit ku do të gjeni rekomandimin përkatës.
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandim%20-%20drejtuar%20Ministrise%20se%20Financave%20dhe%20Ekonomise%20-%20Dhjetor%202021.pdf>

Drejtesia Tranzicionale, sipas Buckley-Zistel, i referohet *“instrumenteve dhe përpjekjeve për t’u përballur me të kaluarën pas një konflikti apo regjimi të dhunshëm dhe që bëjnë të mundur tranzicionin drejt një shoqërie të qëndrueshme në paqe dhe më demokratike”*.

Pavarësisht parashikimeve të ligjit nr.7514, datë 30.09.1991, i ndryshuar, *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*, rehabilitimi i ish të përndjekurve politikë duhet të kishte përfunduar tashmë, por për fat të keq, kjo shtresë vijon të mbetet e marginalizuar dhe problem thelbësor i shoqërisë shqiptare.

Në ligjin nr.7748, datë 29.07.1993 *“Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”*, ekziston detyrimi ligjor dhe moral i shtetit për zbatimin e ligjit e të drejtën për kompensim dhe fillimisht ligji parashikonte se procesi i kompensimit do të plotësohej në fund të vitit 1994. Po ashtu, ligji garantonte lehtësitë dhe përparësitë për kërkesat individuale dhe kolektive në fushat ekonomike, financiare dhe veprimtaritë sociale.

Pavarësisht se trajtimi i dëmshpërblimit dhe kompensimit pasuror të ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga regjimi komunist, fillimisht buron nga ligji nr.7514, datë. 30.09.1991 *“Për pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”*, i ndryshuar, saktësohet dhe rregullohet në mënyrë më të plotë në ligjin *“Për Statusin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”*, ku përcaktohet kuptimi i kompensimit pasuror të këtyre personave si një shpërblim i menjëhershëm me të holla, pensioni jetësor, kompensim rroge, tokë, lokal dhe forma të tjera përfitimi material, të cilat do t’i jepen personit të përndjekur ose familjes së tij kur ai ka vdekur, pa kthim, në kompensim të jetës, humbjes së lirisë, punës së papaguar dhe vuajtjeve, duke pasur si qëllim kryesor krijimin e kushteve dhe të mundësive për një integrim sa më të shpejtë të tij dhe të familjes së tij në jetën normale ekonomiko-shoqërore të vendit tonë.

Duke krahasuar dhe analizuar realizimin e masave të përcaktuara në kuadrin ligjor, shpesh nga neglizhenca në hartimin dhe mosnxjerrja në kohë e akteve nënligjore nga organet shtetërore, për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në ligjet e mësipërme, ish të dënuarit dhe të përndjekurit politikë, nuk kanë përfituar plotësisht dhe në kohë nga zbatueshmëria e plotë e kuadrin ligjor dhe për rrjedhojë janë krijuar pasoja serioze në rehabilitimin e tyre. Nga institucionet shtetërore përgjegjëse, jo vetëm që nuk janë realizuar detyrimet ligjore ndaj shtresës së ish-të dënuarve, por nuk ka as një afat apo datë të saktë se kur do të mbarojë procesi i plotë i dëmshpërblimit, duke shtyrë kështu për një periudhë të pacaktuar e të tejzgatur rehabilitimin e kësaj shtrese të shoqërisë.

Në vitin 2007, u miratua ligji nr.9831, datë 12.11.2007 *“Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”*, në zbatim të të cilit janë nxjerrë edhe aktet nënligjore, me qëllim miratimin e skemës së shpërndarjes për kompensimin e ish të dënuarve politikë të komunizmit. Përqindja e planifikuar çdo vit në buxhetin vjetor për dëmshpërblimin e ish të përndjekurve politikë rezulton në nivel të pamjaftueshëm për përfundimin e këtij procesi brenda një kohe optimale, por do të vijojë të zvarritet në vite, duke mos u realizuar brenda *afateve të arsyeshme*.

Iniciativat e ndërmarra disa herë nga ekzekutivi me qëllim ndryshimin e procedurave, e kanë ndërlikuar shpeshherë procesin dhe përsëri akoma nuk ka një afat përfundimtar të plotësimin të

detyrimin të shoqërisë shqiptare për finalizimin e dëmshpërblimit për ish të dënuarit e të përndjekurit dhe trashëgimtarët e tyre. Gjendja sociale në të cilën gjendet aktualisht kjo kategori, nuk është një gjendje për t'u marrë si model, por një gjendje varfërie.

Duhet bërë i mundur përsheptimi i dhënies së përfitimeve/dëmshpërblimeve për shtresën e ish të përndjekurve politikë, duke vënë në vend të drejtat e shkelura dhe përmirësimin e cilësisë së jetesës së kësaj kategorie. Ky proces tashmë 30 vjeçar po e bën të paarrtshme këtë të drejtë, përse një pjesë e mirë e personave që kanë vuajtur në atë regjim po moshohen e rrjedha e ciklit të jetës është e paevitueshme.

Katër vitet e fundit, fondi i parashikuar për këtë kategori ka ardhur duke u ulur, gati është përgjysmuar. Në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2019, KLSH ritheksonte:⁷¹ *“Konstatohet se vlera e detyrimit të njohur nga shteti shqiptar dhe i papaguar për ish të përndjekurit politikë deri në fund të vitit 2019 është 33,182 milionë lekë. Nëse buxheti i këtij fondi do të vazhdojë me këtë ritëm, ky detyrim do të mund të shlyhet pas rreth 32 vitesh.”* Këto vite i shtohen 30 viteve që tashmë kanë kaluar nga shembja e rregjimit komunist e rezultojnë më të gjata se vetë kohëzgjatja e rregjimit.

Avokati i Popullit vlerëson përpjekjet e bëra, por shpreh shqetësimin për rritjen dhe përmirësimin e tij në të ardhmen, në kuadër edhe të zbatimit të rekomandimeve të adresuara Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Rekomandohet marrja e masave të nevojshme nga pushteti ekzekutiv dhe në mënyrë të veçantë Ministria e Financave dhe Ekonomisë për realizimin efektiv, brenda afateve të arsyeshme, të së drejtës për marrjen e kësteve të dëmshpërblimit për shtresën e ish të dënuarve/përndjekurve politikë.

Në fillim të vitit 2022, Ministria e Financave dhe Ekonomisë na ka informuar se vlerëson dhe merr në konsideratë çdo rekomandim të dërguar nga institucioni i Avokatit të Popullit, por realizon lëvrimin e kësteve në varësi të fondit që miratohet për secilin vit buxhetor. Fondi i miratuar për kategorinë e ish të dënuarve politikë të rregjimit komunist, për vitin buxhetor 2022 është vetëm 1 miliard lekë. Mbetet domosdoshmëri rishikimi i këtij fondi për vitet buxhetore në vijim.

Ndërkohë, nuk është pranuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë rekomandimi i Avokatit të Popullit për marrjen e masave organizative për nxjerrjen e Vendimit të Këshillit të Ministrave për miratimin e skemës së pensionit të veçantë për të internuarit dhe dëbuarit gjatë rregjimit totalitar.

3.9 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative⁷²

Procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile dhe administrative, titujve ekzekutivë të ngarkuar Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor për ekzekutim, si pjesë përbërëse e procesit të gjyqimit, ka mbartur dhe mbart pothuaj të njëjtat problematika sikurse pasqyruar në raportet e viteve të kaluara të Avokatit të Popullit, për shkak se, autoritetet e ngarkuara me ligj për

⁷¹Po ashtu kjo theksohet edhe në Raportin e Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2020 linku si vijon: <https://panel-klsh.almotech.co/storage/phpbuokI4.pdf>

⁷² Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në Institucionin e Avokatit të Popullit.

ekzekutimin e tyre nuk kanë kryer apo nuk kryejnë në afatin e përcaktuar apo të arsyeshëm, veprimet e parashikuara në ligj për ekzekutimin e tyre.

Gjatë vitit 2021, pranë institucionit të Avokatit të Popullit, *janë administruar 15 ankesa* në të cilat prezantohet situata e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutiv. Krahasuar me numrin e ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2020 (gjithsej 29), rezulton numër më i vogël ankesash, por problematikat e konstatuara janë të njëjta apo të ngjashme me ato të viteve të kaluara. Në procesin e shqyrtimit të *15 ankesave të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, 9⁷³ raste janë mbyllur pasi ankesat nuk kanë qenë të bazuara.*

Vlen të përmendet se fryma e zbatimit të ligjit në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titujve ekzekutivë ndaj subjektit privat është më “agresive” dhe efiçente krahasuar me atë shtetëror.

Çështja e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të dhëna prej gjykatave në Republikën e Shqipërisë apo Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në një afat të arsyeshëm, mbetet një çështje me rëndësi thelbësore për shtetin, pasi lidhet me krijimin, forcimin dhe zhvillimin e një sistemi gjyqësor të respektueshëm për të gjithë. Tejzgjatja e ekzekutimit, “*vënia në diskutim*” e drejtësisë së dhënë nga gjykata, sjell rritjen e numrit të çështjeve të paekzekutuara si dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të tyre. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm nga ana e organeve të Administratës Publike, në cilësinë e debitorit, mbetet një çështje e cila nuk vjen në përputhje me nenin 142/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 451/a të Kodit të Procedurës Civile, si dhe me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e organeve të administratës publike.

Mungesa e burimeve financiare për përmbushjen e detyrimeve në të holla prej organeve debitore të administratës publike nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqësore. Kjo është e mirëpërcaktuar si në vendimet e dhëna prej Gjykatës Kushtetuese ashtu dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut⁷⁴.

Çështja e ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ-së gjithashtu mbart probleme lidhur me afatin e dorëzimit/përmbushjes së detyrimit të vendosur. Edhe pse subjektet janë përballur me një kohëzgjatje të konsiderueshme në zgjidhjen e së drejtës deri në GJEDNJ, përsëri materializimi i së drejtës të fituar nuk është respektuar rast pas rasti prej Shtetit Shqiptar në afatin 90 ditor të përcaktuar për ekzekutimin e tyre⁷⁵. Çështja e ekzekutimit të vendimeve të dhëna prej GJEDNJ-së kundër Shtetit Shqiptar do të jetë objekt prezantimi prej institucionit të Avokatit të Popullit me rastin e përgatitjes së një raporti të veçantë.

Institucioni i Avokatit të Popullit tërheq vëmendjen se ekzekutimi i vendimeve të GJEDNJ-së nuk nënkupton vetëm shlyerjen e detyrimit ndaj individëve por edhe ndryshimin e qëndrimit apo praktikës administrative që shkelja të mos ndodhë më në të ardhmen.

⁷³ Në përgjigjet e dhëna për këto raste është dhënë përgjigje shteruese subjektit ankues duke orjentuar zgjidhjen e çështjes pranë organit kompetent apo informimin e ankuesit se shkelja e së drejtës nuk ka ndodhur.

⁷⁴ Shih vendimin nr.16, datë 04.05.2011 të Gjykatës Kushtetuese, Vendimin datë 18.11.2004, të GJEDNJ-së “*Qufaj kundër Shqipërisë*”.

⁷⁵ Çështja *Sharxi dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 10613/16; Çështja *Beshiri kundër Shqipërisë*, nr.29026/06; Çështja *Veveçka kundër Shqipërisë* nr.40554/04; Çështja *Kasmi kundër Shqipërisë* nr.1175/06”; Çështja *Tërshana kundër Shqipërisë* nr.48756/14; Çështja *Budo kundër Shqipërisë* nr.75763/17; Çështja *Xhoxhaj kundër Shqipërisë* nr.15227/19.

Qëllimi kryesor i vendimeve të Gjykatës është *eliminimi i praktikave në shkelje të të drejtave dhe detyrimeve të Konventës ndërsa dëmshpërblimi është tërësisht dytësor në realizimin e qëllimit që ka ky Mekanizëm i zbatimit të Konventës*. Në vendin tonë vërejmë me keqardhje se në lëmin e të drejtës së pronës ky aspekt nuk trajtohet në mënyrën e duhur dhe vendimet shihen veç si shuma detyrimi por jo si udhëzim apo interpretim përfundimtar për të konstatuar praktikatat e paligjshme dhe cenuese për të drejtat e njeriut, sipas parashikimeve të Konventës. Në këtë drejtim mendojmë se Kuvendi, së pari, si edhe më pas administrata shtetërore në përgjithësi por edhe Avokati i Shtetit në veçanti, duhet të kenë fokusin e duhur në vlerësimin, shmangien dhe eliminimin e praktikave që kanë çuar në cënimin e të drejtave të qytetarit në përgjithësi por edhe të së drejtës së pronësisë në veçanti, duke qenë se aplikimet më të shumta në GJEDNJ kanë qenë në lidhje me këtë çështje.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të administruara gjatë vitit 2021, me objekt mosekzekutimin e titujve ekzekutiv, Avokati i Popullit, gjykon se, shkak i cili ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor është edhe problematika që mbart Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*. Për përmirësimin e kësaj situatë, Avokati i Popullit, rast pas rasti ka ndërhyrë dhe do të vijojë ndërhyrjen pranë organeve përkatëse për rregullimin e saj. Edhe pse objektivi i Qeverisë ka qenë dhe është, moslejimi i borxheve të reja, i shprehur ky në VKM nr.50, datë 05.02.2014, *“Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”*, rezulton se ky objektivi nuk është arritur.

Organet apo institucionet debitoare, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është vendosur nga gjykata, nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr.2, datë 06.02.2012, të Ministrit të Financave, *“Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”*, (neni 62), apo në Udhëzimin nr.1, datë 13.06.1997, të Ministrit të Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7, sipas të cilit, përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryej auditimin e gjithë procesit, i cili ka sjellë dëmin ekonomik, si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile kundër personave që kanë shkaktuar dëmin. Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura ka sjellë dhe do të sjellë cenim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë.

Cenimi i parimit për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, në vlerësimin e institucionit të Avokatit të Popullit, vjen edhe nga një sërë shkaqesh të tilla si:

- ✓ mungesa e vullnetit prej autoritetit të administratës publike për përmbushjen e detyrimit të vendosur në dispozitivin e vendimit gjyqësor apo në ligj⁷⁶;
- ✓ mungesa e nivelit profesional të përmburësve gjyqësorë, i cili shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë si dhe nxjerrjes së akteve jo në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- ✓ mosnjohja e legjislacionit civil dhe atij procedural nga ana e përmburësve gjyqësorë;

⁷⁶ Rasti i mosrespektimit të detyrimit prej Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve e Ndriçimit Publik pranë Bashkisë Tiranë, sikurse vendosur me vendimin nr.3014, datë 18.11.2020, prej Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë. Pa shkak, kjo Drejtori nuk ka përmbushur dhe nuk përmbush detyrimin e vendosur edhe pse ka kaluar afro 1 vit e gjysëm nga data e lindjes së detyrimit.

- ✓ kryerja e veprimeve përmbarimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keqinterpretimi i dispozitivit të vendimit gjyqësor;
- ✓ mungesa e një kontrolli efektiv ndaj zbatimit të VKM-së nr. 50, datë 05.02.2014 “Për Miratimin e Strategjisë për Parandalimin dhe Shlyerjen e Detyrimeve të Prapambetura e të Planit të Veprimit”;
- ✓ mungesa e vullnetit prej përmbaruesve gjyqësorë për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që është vendosur me vendim të gjykatës.

Problematikë e trashëguar është procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt detyrimin e subjektit debitor privat të paguajë shuma të caktuara në të holla. Në rastin e kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të tij mbi të ardhurat mujore të debitorit, krijohen situata në cenim të interesave jetike të tij. Fakti që deri më sot nuk është mundësuar caktimi i minimumit jetik, ka bërë që parashikimi i vendosur në nenin 533 të Kodit të Procedurës Civile të jetë i pazbatueshëm prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, vendosja e masës së sekuestros mbi pagën e debitorit kryhet pa cenuar minimumin jetik, i cili deri më sot është i papërcaktuar. Në procesin e shqyrtimit të ankesave, institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se Shërbimi i Përmbarimit Gjyqësor ka kryer veprime për vjeljen e detyrueshme të detyrimit në të holla nga të ardhurat mujore të debitorit (paga), në kushtet e mospërcaktimit me ligj të minimumit jetik.

3.10 Respektimi i të drejtës së pronës⁷⁷

E drejta e pronës është një e drejtë themelore shumë e rëndësishme në një shtet demokratik. Mosrespektimi i së drejtës së pronësisë si një ndër të drejtat më themelore të njeriut vazhdon ende të përbëjë një fenomen shqetësues për realitetin shqiptar. Respektimi dhe mbrojtja e së drejtës së pronës ka qenë në fokus të një numri të konsiderueshëm ankesash, *gjithsej 133, të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Krahasuar me numrin prej 59 ankesash të regjistruara në vitin 2020, konstatohet rritje e ndjeshme numerike e çështjeve të pranuar për shqyrtim gjatë vitit 2021.*

Në ushtrim të kompetencave dhe detyrave të tij funksionale, institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë mjaft aktiv dhe i fokusuar në trajtimin dhe shqyrtimin në themel të disa prej problematikave kyçe, të ndjeshme dhe delikate për komunitete të gjera individësh, siç janë komunitetet e banorëve që po preken në vijimësi në zonat e reja për zhvillim, njësitë administrative nr. 4, 6 dhe 8, Bashkia Tiranë.

⁷⁷ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

Objekti i ankesave të administruara në institucionin e Avokatit të Popullit ka qenë i orientuar kryesisht ndaj strukturave të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, drejtorive vendore të saj, bashkive, IMT-ve pranë tyre, Agjencisë së Trajtimit të Pronave si dhe organeve të cilat janë ngarkuar me çështjen e rindërtimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti i nëntorit 2019.

Ankesat kanë patur për objekt kundërshtimin e veprimeve apo mosveprimeve të institucioneve të sipërpërmendura lidhur me:

- ✓ mosregjistrimin e titujve të pronësisë, kryesisht AMTP-ve për tokat bujqësore të dhëna në pronësi apo përdorim;
- ✓ mosrespektim të afateve ligjore në trajtimin e kërkesave/aplikimeve të individëve;
- ✓ mospërfundimin e procedurave nga organet e njësisive të qeverisjes vendore për formalizimin dhe finalizimin e akteve mbi trojet e dhëna për qëllime ndërtimi;
- ✓ mosnxjerrjen e akteve të pronësisë për pasuritë që nuk zotërojnë një titull pronësie, apo “oborret në përdorim”;
- ✓ mospërfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të bëra në vitet 2005, 2006 dhe 2014, prej subjekteve posedues të ndërtimeve informale;
- ✓ mosushtrimin e detyrimit për saktësimin/korrigjimin e të dhënave kadastrale lidhur me sipërfaqen e pasurisë, kufijtë dhe pozicionin e saj në terren;
- ✓ shkeljen e së drejtës së pronësisë në kushtet e mosrespektimit të procedurave për kufizimin e kësaj të drejte;
- ✓ qasjen me dy standarde në regjistrimin e pasurive të paluajtshme (shtet/privat);
- ✓ detyrimin e individit për marrjen e shërbimit pranë drejtorive vendore të ASHK-së vetëm nëpërmjet portalit e-Albania;
- ✓ mosrespektimin e të drejtës së pronës si dhe parimin për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor gjatë shpronësimit dhe prishjes së ndërtimeve në zonat e reja për zhvillim;
- ✓ mungesën e hartimit të akteve nënligjore për mënyrën e krijimit, grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave dixhitale, si një element që do të garantonte ruajtjen dhe sigurinë e informacionit kadastral;
- ✓ mosbërjen publike pa kërkesë të informacionit bazik mbi hartën kadastrale, adresën e pronës, emrin e pronarit, vendimmarrjet e Këshillit të Ministrave, gjykatave ose të dhënave mbi funksionimin e tregut të pasurive.

Theksojmë se shkelja e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve të kryera nëpërmjet veprimeve ose mosveprimeve të punonjësve apo strukturave të caktuara të drejtorive vendore të ASHK-së kanë ardhur edhe si rezultat i mosnjohjes së ligjit dhe keqpërdorimit të tij në zgjidhjen e çështjeve objekt shqyrtimi. *Në lidhje me çka është paraqitur në raportin përfundimtar të institucionit të Avokatit të Popullit në Kuvend për vitin 2020 në pikëpamje të mbrojtjes të së drejtës së pronësisë vërehet se situata është përmirësuar.*

Avokati i Popullit thekson se e drejta e pronës duhet të gëzojë mbrojtje jo vetëm në tekstet e ligjeve dhe akteve nënligjore por duhet të jetë në themel të punës së çdo institucioni të administratës shtetërore për të garantuar zbatimin efektiv të kësaj të drejte.

Çështja e respektimit të pronës apo parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor ka qenë dhe është objekt shqyrtimit prej institucionit të Avokatit të Popullit në rastin e kryerjes së veprimtarisë administrative prej organeve publike në zbatim të projektit: *“Për shpalljen e zonës së re për zhvillim, njësia administrative nr.4, 6 dhe 8 zona Kombinat, dhe “5 Maj”, Bashkia Tiranë, dhe caktimin e Bashkisë Tiranë, si njësi zbatuese”*.

Pranimi për shqyrtim i çështjeve është kryer mbi bazë të ankesave të individëve të ndryshëm apo iniciuar kryesisht prej institucionit tonë. Për njohjen e situatës në të cilën ndodhet respektimi i së drejtës të pretenduar të shkelur, prej ankuesve, është kërkuar organeve publike të informojnë rreth veprimtarisë administrative të zhvilluar si dhe të japin shpjegime bazuar në pretendimet e individëve ankues.

Informacioni dhe shpjegimet e dhëna prej organeve publike, si Bashkia Tiranë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nuk kanë qenë të sakta dhe të plota referuar kërkimeve të institucionit tonë. Edhe pse i jemi ridrejtuar Bashkisë Tiranë në mënyrë të ripërsëritur, informacioni dhe shpjegimet sikurse kërkuar nuk janë përmbushur. Ky qëndrim ka penguar dhe pengon institucionin e Avokatit të Popullit në nxjerrjen e konkluzioneve rreth situatës në të cilën ndodhet respektimi i së drejtës të pronësisë apo parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor për çështjet që shqetësojnë individët ankues si dhe përfundimin e procedurës administrative në një afat të arsyeshëm.

Në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimeve të kryera që në vitet 2005, 2006 apo 2014, prej subjekteve poseduese të ndërtimeve informale, konstatohet se, nga ana e ish-ALUIZNI-t apo Agjencisë Shtetërore të Kadastrës është cënuar dhe vijon të cënohet parimi për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor si rrjedhojë e mospërfundimit të procedurës administrative në shqyrtimin e vetëdeklarimeve. Ky qëndrim i organeve publike ka sjellë dhe do të sjellë pasoja negative për individë posedues të ndërtimeve informale. Nëse shqyrtimi i vetëdeklarimeve do të kryhej në afatin ligjor të përcaktuar, çdo njeri subjekt posedues i ndërtimit informal për zonat e përmendura, do të ndodhej në kushtet e disponimit të lejes së legalizimit për ndërtimin informal, e për rrjedhojë, të përfitimit të të drejtës që vjen nga shpronësimi i objektit në zbatim të projektit publik.

Çështja e regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës të 26 mijë vendimeve të dhëna në vite prej Agjencisë së Trajtimit të Pronës të njohjes së pronës me të drejtë kompesimi mbetet edhe sot e pazgjidhur. Ky detyrim i parashikuar në nenin 193/h, 196 të Kodit Civil, si dhe nenin 24 të ligjit nr.111/2018 *“Për Kadastrën”*, rezulton ende i papërbushur.

Mospërfundimi i procesit të kompesimit të pronave të njohura subjekteve me të drejtë kompesimi me një nga format e parashikuara në ligjin nr.133/2015 *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, mbetet çështje mjaft e mprehtë, referuar kohëzgjatjes të mosekzekutimit të tyre. Po kështu, kjo çështje mbetet problematike edhe për faktin se subjektet që e kanë përfituar në pronësi, kryesisht sipas ligjit 7501/1991 *“Për tokën”*, i ndryshuar, dhe ligje të tjera të veçanta, kanë disponuar dhe disponojnë mbi pronat e ish pronarëve në kushtet kur procesi i kompesimit ende ndodhte larg përfundimit. Alternativa e kompesimit fizik të pronave të njohura në pronësi me të drejtë kompesimi mund dhe duhet të jetë forma kryesore e kompesimit pasi fondet

e tokës kanë ekzistuar dhe ekzistojnë. Kjo formë kompesimi është zgjidhje me kosto shumë më të ulët se sa ajo financiare që duhet të përballojnë taksapaguesit shqiptarë.

Zbatimi i saktë dhe i plotë i kërkesave dhe dispozitave të ligjit nuk është parë si funksioni më i rëndësishëm prej saj. Mospërbushja dhe mosushtrimi i detyrave ligjore në mënyrë efikase dhe të përshtatshme si dhe sa më shpejtë të jetë e mundur janë situata të konstatuara në veprimtarinë administrative të drejtorive vendore të ASHK-së. Konstatimi i situatave të tilla tregon se realizimi efektiv i funksioneve publike administrative nuk ka ndodhur. Krijimi i një institucioni të vetëm, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, me qëllimin e centralizimit të të gjithë veprimtarisë së institucioneve si ish-ZVRPP, ish-ALUIZNI dhe ish-Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, nuk ka dhënë efektivitetin e pritur në zgjidhjen e çështjeve të regjistrimit të pronave.

Ndër çështjet e mbartura në vite është se hartat ekzistuese kadastrale kanë një tendencë të lartë të mos jenë në përputhje me situatën në terren. Problematika që haset më shpesh është se njësitë e pasurive të paluajtshme (parcelat dhe ndërtesat) në shumë raste janë të pozicionuara gabimisht. Me kalimin e kohës për shkak të ndryshimeve në specifikime dhe referencë, problematika është rritur. Në shumë raste, kur ka kopje të ndryshme fletë harte, vihet në diskutim se cila hartë është aktuale apo e sakta.

Në zyrat e ASHK-së të dhënat mbi parcelat nuk mungojnë, por nuk dihet me saktësi statusi i pronës. Kjo situatë është përgjithësisht më e komplikuar në zonat urbane, sidomos në Tiranë dhe rreth saj, si dhe në zonat bregdetare më të mëdha, ku ka shumë ndërtime informale. Gabimet më së shumti janë akumuluar për shkak të mospërputhjeve që vijnë edhe nga mungesa e dokumentacionit. Gabimet në regjistrimet e pronave përgjithësisht reflektohen në kufijë të gabuar, madhësinë e parcelës dhe dokumentacionin e pronësisë. Gabimet zakonisht zbulohen në kohën kur bëhet një transaksion në njësinë përkatëse të pasurive të paluajtshme pasi pronari i pronës apo pronarët kufitarë nuk kanë dijeni për gabimet në të dhënat kadastrale mbi pasuritë.

Përveç konstatimeve dhe gjetjeve të lartpërmendura, institucioni i Avokatit të Popullit në procesin e shqyrtimit të rasteve të prezantuara nga individë të ndryshëm ka konstatuar se:

Organet e administratës publike në nivel lokal kanë nivel shumë të ulët bashkëpunimi apo ndërveprimi dhe nuk përmbushin detyrimin ligjor për dhënie shpjegimesh dhe informacioni tek Avokati i Popullit në afatin ligjor të caktuar, situatë kjo e konstatuar vit pas viti. Po ashtu, këto organe në nivel lokal, nuk përmbushin detyrimin ligjor për qëndrimin në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të adresuara nga Avokati Popullit.

Tjetër çështje që haset në veprimtarinë e drejtorive vendore të ASHK-së është se gabimet që kanë ardhur nga veprimtaria e ish zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, sot drejtoritë vendore të ASHK-së, nuk korrigjohen edhe pse korrigjimi i gabimit të konstatuar, sipas ligjit nr.111/2018, “Për Kadastrën”, është i detyrueshëm për t’u kryer me iniciativën e vetë organit.

Gjithashtu, duhet theksuar se drejtoritë vendore të ASHK-së nuk kanë nisur apo përfunduar regjistrimin fillestar të pronave në 359 zona kadastrale⁷⁸. Mungesa e regjistrimit fillestar të pasurive në këto zona kadastrale ka sjellë pasiguri të individëve në dokumentet e pronësisë që zotërojnë. Pasuria mund të zotërohet me dokumente nga më shumë se një individ. Pasiguria ligjore e dokumentave të pronësisë që zotërojnë mbajtësit e titullit në këto zona reflektohet së pari në konfliktet e mundshme me persona/individë/subjekte që zotërojnë edhe ata dokumente pronësie për të njëjtën pronë, pasojë e të cilave, përveç cënimit të të drejtës së pronësisë mbi qarkullimin civil të sendit, gjeneron edhe në konflikte.

Edhe në ato zona kadastrale ku ka përfunduar regjistrimi fillestar i pasurisë në përputhje me ligjin 111/2018 “Për Kadastrën” ka problematika të shumta në drejtim të pajisjes së individëve apo subjekteve me aktet kadastrale, si certifikata, kartela, etj., pasi ende këto zyra kërkojnë nga individët dokumentacion plotësues edhe pse ky është një detyrim i vetë drejtorive vendore të ASHK-së për t’u përmbushur.

Theksojmë se regjistrimi i titujve të pronësisë është një shërbim që garantohet nga shteti. Kjo veprimtari ka në themel respektimin dhe garantimin e së drejtës së pronësisë. E drejta e pronës nuk mund të vihet në diskutim apo cenohet nga dështimi i sistemeve të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Legjislacioni në fuqi garanton se procesi i krijimit të titullit të pronësisë si dhe regjistrimit të tij kryhet në çdo rast prej organit publik/shtetëror, për rrjedhojë, çdo gabim në të dhënat kadastrale, cenim të së drejtës së pronësisë, bëjnë përgjegjës organin publik/shtetëror për zgjidhjen e tij si dhe pagimin e dëmshpërblimit. Përkundër situatës ligjore të krijimit dhe regjistrimit të titujve të pronësisë, në veprimtarinë e drejtorive vendore të ASHK-së konstatohet “delegimi” për zgjidhje të çështjeve të ndryshme jo pranë organit kompetent të administratës publike por pranë individit pronar të sendit.

Një çështje aktuale në marrëdhënien midis subjekteve të interesuar dhe ASHK-së është përcaktimi në pikën 6, të VKM-së. 389, datë 13.5.2020, “Për miratimin e listës dhe të tarifave të shërbimeve kadastrale”, ku përcaktohet se: “Të gjitha subjektet e interesuara, duke përfshirë edhe institucionet publike, e paraqesin kërkesën për shërbime kadastrale në rrugë digjitale online, nëpërmjet platformës e-Albania. Tarifa e shërbimit paguhet në momentin e paraqitjes së kërkesës për shërbim nga subjekti i interesuar ose në momentin e dhënies së pëlqimit për përfitimin e shërbimit nëpërmjet noterit”. Nisur nga përcaktimi i sipërcituar, ASHK-ja nuk pranon kërkesa/aplikime të subjekteve të interesuar për marrje shërbimi veçse në rrugë dixhitale nëpërmjet platformës e-Albania. Kuptimi dhe zbatimi i pikës 6 të VKM-së nr.389/2020, interpretohet dhe zbatohet në mënyrë të gabuar prej ASHK-së kur kushtëzon dhënien e shërbimit vetëm në rrugë elektronike. Ky kuptim dhe zbatim i pikës 6 të aktit nënligjor në fjalë, vjen ndesh me përcaktimin e nenit 10/2 të Kodit të Procedurës Administrative, në të cilin parashikohet, se: “Organi publik promovon mundësinë e palës për të aksesuar autoritetin publik në mënyrë elektronike. Kjo mundësi nuk është e lidhur me ndonjë detyrim të palës për të përdorur mjete të komunikimit elektronik”.

⁷⁸Raporti per planin e veprimit per 5 prioritetet e KE-së, <https://www.drejtesia.gov.al/raportim-per-planin-e-veprimit-per-5-prioritetet-e-komisionit-evropian/>

Në kushtet e mosrespektimit të detyrimit ligjor si më sipër cituar, veprimtaria e ASHK-së nuk vjen në përputhje me parimin e ligjshmërisë, dhënies së ndihmës aktive, si dhe detyrimin ligjor të parashikuar në pikat 1 dhe 3 të nenit 10 të K.Pr.A., se:

- ✓ *Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjore në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre.*
- ✓ *Organi publik, që zhvillon procedurën administrative, siguron që padia e palës të mos përkeqësojë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave që pala gëzon sipas ligjit.*

Tjetër çështje e lindur nga kuptimi dhe zbatimi i gabuar i pikës 6 të VKM-së nr.389/2020, datë 13.05.2020, është kërkitimi i pagimit të tarifës prej institucionit të Avokatit të Popullit me rastin e kërkitimit të informacioneve dhe shpjegimeve për çështjet në proces shqyrtimi. Për këto probleme të krijuara prej ASHK-së, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar zgjidhjen e tyre nëpërmjet rekomandimit⁷⁹ i cili u është dërguar Këshillit të Ministrave dhe ASHK-së⁸⁰. Theksojmë se kjo VKM nuk është konsultuar paraprakisht me institucionin tonë dhe se zbatimi i saj ka çënuar veprimtarinë e Avokatit të Popullit.

Për sa i takon trajtimin e ankesave për Agjencinë e Trajtimit të Pronave në përputhje me ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, konstatohet se numri më i madh i ankesave është në drejtim të zvarritjes së procesit të kompensimit financiar, proces i cili nuk është realizuar në të tërë elementët e tij dhe për më tepër subjektet e kompesuara ende nuk kanë marrë kompensimin financiar. Për këtë problematikë nga institucionet përkatëse nuk ka përgjigje shteruese duke rënduar më tej gjendjen problemit të përfitimit financiar të ish pronarëve.

Lidhur me të drejtën e kompensimit bazuar në VKM-në nr.699, datë 30.10.2019, “Për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi parcelat e objekteve të legalizuara dhe kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken prej tyre”, në bazë të cilit është bërë Njoftimi Publik mbi fillimin e procesit të pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimet informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve janë sipas VKM Nr.699, datë 30.10.2019, ende pronarët e pasurive të cilët preken nga ndërtimet informale nuk kanë përfituar sipas këtij akti nënligjor kompensimin financiar. Kjo situatë është konstatuar nga çështjet objekt shqyrtimi prej institucionit tonë.

Tjetër problematikë e konstatuar gjatë veprimtarisë së Avokatit të Popullit në vite, por që vazhdon edhe për vitin 2021, është shpronësimi për interes publik i pronës private nga shteti. Shpronësimi për interes publik i pronës private në RSH, përveç garancive kushtetuese dhe parashikimit nga

⁷⁹ Ky rekomandim gjendet në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/P%C3%ABr%20zgjidhjen%20e%20disa%20problemeve%20t%C3%AB%20evidentuara%20n%C3%AB%20komunikimin%20me%20disa%20Z.%20Sh.pdf>

⁸⁰ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rekomandimet-4/?page=2>

KEDNJ⁸¹, rregullohet edhe nga përcaktimet e ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik” (ndryshuar me ligjin nr. 20/2016, datë 10.3.2016 dhe ligjin nr. 11/2020) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Pothuaj në të gjitha rastet, konstatohet se organet e administratës shtetërore sillen “në mënyrë arbitare” me titullarët e së drejtës së pronës/pronarët por edhe poseduesit, duke qenë se i zhveshin këta të fundit nga e drejta e pronësisë dhe nuk i dëmshperblejnë/kompensojnë paraprakisht, kundrejt një shpërblimi të drejtë dhe brenda afateve ligjore.

Qytetarët ndihen të pafuqishëm nga forca shtrënguese e shtetit i cili në këtë rast e përdor “forcën” jo në mbrojtje të tyre por ndaj tyre. Shteti, nëpërmjet organeve të administratës publike, duhet të kujdeset për interesat pronësore të qytetarëve, në rast shpronësimi, duke pasur në konsideratë procesin e rregullt ligjor dhe nevojat social-ekonomike të tyre. Vërtet kushtetuta, KEDNJ⁸² si dhe ligjet, parashikojnë kufizime të së drejtës së pronësisë, por këto kufizime duhet të jenë të ligjshme, të bëhen vetëm në rast të një interesi publik, kundrejt shpërblimit të drejtë, si dhe të kenë në themel parimin e proporcionalitetit. Koncepti i shpronësimit dhe shpërblimit të pronës nuk përfshihet vetëm për pasuritë e regjistruara por edhe për ato që i janë nënshtruar një procesi të ligjshëm, sikurse pasuritë në proces legalizimi.

Në lidhje me këtë problematikë, pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka administruar një numër ankesash në të cilat individët ankohen ndaj institucioneve përgjegjëse për shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe raste të iniciuara kryesisht për shqyrtim nga institucioni ynë. Nga ankesat e depozituara pranë institucionit tonë, për të cilat kemi adresuar edhe rekomandime tek institucionet përgjegjëse, konstatohet se shpërblimi njihet vetëm kundrejt atyre individëve të cilët e kanë regjistruar pasurinë. Një problematikë e bërë prezente në ankesat pranë institucionit të Avokatit të Popullit, është fakti që edhe pse individëve u janë marrë pasuritë për interes publik, konstatohet zvarritje e procedurave administrative nga ana e institucioneve që kanë për detyrim plotësimin e dokumentacionit për marrjen e shpërblimit.

Si përfundim theksojmë se shpronësimi për interes publik i pronës private përbën një kufizim sensitiv/delikat në të drejtën kushtetuese që duhet të trajtohet me kujdesin e duhur dhe të jetë në vëmendjen e institucioneve shtetërore, në mënyrë që të mos jetë apo perceptohet arbitrar nga individët.

Gjykata e Strasburgut në vendimmarrjet e saj me fokus shqyrtimin e çështjeve që lidhen me problematikën e procesit të kompesimit⁸³, ka bërë të qartë se, e drejta për strehim përfshin edhe

⁸¹ Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, nënshkruar më 4 nëntor 1950 dhe hyrë në fuqi më datë 3 shtator 1953, prej qeverive, anëtar të Këshillit të Evropës, ka mbajtur parasysh Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, të shpallur nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara më datë 10 dhjetor 1948. Qëllimi i Deklaratës është sigurimi i njohjes dhe zbatimit universal dhe efektiv të të drejtave të shpallura në të. Vendet anëtare të Këshillit të Evropës me qëllim realizimin e një bashkimi më të ngusht midis tyre si dhe mbrojtjen e zhvillimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore kryen nënshkrimin e Konventës duke ripohuar përkushtimin e tyre të thellë ndaj lirive themelore që përbëjnë vetë themelin e drejtësisë dhe të paqes në botë, ruajtja e të cilave mbështetet kryesisht në një regjim politik me të vërtetë demokratik, nga njera anë dhe, nga ana tjetër, në një koncept dhe një respekt të përbashkët për të drejtat e njeriut që ato kanë marrë përsipër të mbrojnë.

⁸² Nisur nga qëllimi i nënshkrimit të Konventës prej vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, Shqipëria ka aderuar në të gjitha protokollat e KEDNJ-së, përveç protokollit 9, 103 dhe 14 bis, duke ratifikuar me ligjin nr.8137, datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, botuar në Fletoren Zyrtare nr.28/2008 (12 vjet pas ratifikimit të saj).

⁸³Affaire Bagdonavicius dhe të tjerë kundër Ruisë, (Kërkesa nr.19841/06), Strasburg 11 tetor 2016.

rastin e godinave të ndërtuara në mënyrë të paligjshme ose që iu mungon dokumenti i pronësisë. Thelbi i konstatimit të gjykatës ishte që autoritetet shtetërore nuk shqyrtuan faktin nëse prishja e shtëpive të ankuesve ishte në përputhje me parimin e proporcionalitetit, para se të vijonin me prishjen e objekteve. Institucionet shtetërore gjatë veprimtarisë së tyre administrative duhet të kenë parasysh dhe t'i referohen këtyre vendimeve të cilat ndër vite kanë rënduar buxhetin e shtetit dhe për pasojë atë të shtetasve shqiptarë. Organet e administratës shtetërore duhet të jenë shembull i zbatimit të parimit të ligjshmërisë, ku me ligjshmëri kuptohet kërkesa për respektimin e përpiktë dhe pa kushte të kushtetutës, ligjeve dhe akteve nënligjore nga të gjithë organet e administratës shtetërore, personave zyrtarë, organizatave shoqërore dhe shtetasve në Republikën e Shqipërisë. Ndër të tjera, ligjshmëria nënkupton garantimin e të drejtave të njeriut, gjë që nuk rezulton të jetë garantuar nga institucionet shtetërore si bashkitë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, IMT-të pranë Bashkive, ministria përgjegjëse për shpronësimet, etj.

Tjetër çështje në marrëdhënie me drejtoritë vendore të ASHK-së që vijon të jetë problematike është pamundësia e komunikimit përmes linjës telefonike, edhe pse linjat janë disponibël, që do të thotë se kjo mënyrë aksesit për qytetarët është jo funksionale.

Veprimtaria IKMT dhe IMT

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT) dhe Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit (IMT), në bashki janë strukturat kryesore që kanë si detyrë funksionale respektimin e normave, standardeve, kushteve zhvillimore të territorit, si dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme. Juridiksioni dhe kompetencat e tyre janë të përcaktuara në Ligjin nr.9780 datë 16.07.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, i ndryshuar. Të dy këto organe shfaqen me kompetenca vendimmarrëse/ekzekutive, që nga vendosja e gjobave, pezullimi i punimeve të ndërtimit e deri tek prishja e ndërtimeve të kundërligjshme.

Gjatë vitit 2021 Avokati i Popullit ka administruar një numër të konsiderueshëm ankesash që lidhen me veprimtarinë dhe detyrat e IKMT-së në nivel kombëtar dhe IMT-ve në nivel lokal, pasi funksionojnë pranë bashkive. Nga ky numër total i ankesave, vetëm disa prej tyre lidhen me veprimtarinë e IKMT-së dhe numri më i lartë, në fakt, lidhet me veprimtarinë e IMT-ve, në bashki.

Objekti i këtyre ankesave ka të bëjë kryesisht me shkeljen e procedurave ligjore gjatë procesit të prishjes së ndërtimeve nga ana e IMT-së, të cilat kanë ndërhyrë në lirin shesheve në zbatim të projekteve të mëdha publike. Në rastin e prishjeve të ndërtimeve në njësitë administrative nr.4, 6 dhe 8, objekti i ankesave të paraqitura lidhet me mosnjohimin e vendimmarrjes për prishje objekti, mosdhënie afati të arsyeshëm banorëve për të liruar shtëpitë nga sendet dhe orenditë.

Veprimtaria e IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, për prishjen e ndërtimeve në njësitë administrative të lartpërmendura justifikohet me marrjen dijeni të vendimeve të Këshillit të Ministrave për shpronësimin për interes publik, dhe se, mbi bazë të tyre, është kryer prishja e ndërtimeve. Kjo veprimtari nuk mund të konsiderohet e rregullt dhe e mbështetur në ligj, për shkak se, leja për prishjen e ndërtimeve lëshohet/nxirret prej Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe se ajo është pjesë

përbërëse e lejes së ndërtimit sipas përcaktimit në Kreun IV, pika 1 dhe 6 të VKM-së nr.887, datë 24.12.2019, i ndryshuar. Në kushtet e mungesës së lejes për ndërtim edhe leja për prishjen e ndërtimeve nuk është nxjerrë, për rrjedhojë veprimtaria e IMT-së në prishjen e ndërtimeve konsiderohet e kundërligjshme në kuptim dhe zbatim të parashikimeve të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjatë procesit të shqyrtimit nga ana jonë të këtyre çështjeve, janë konstatuar disa problematika në veprimtarinë e IMT-së, pranë Bashkisë Tiranë, si:

- ✓ Vendosja e afateve të shkurtra në njoftim për prishje të ndërtimit si dhe njoftimit publik të subjekteve në mënyrë të papërligjur. Mënyra e njoftimit publik të zhvilluar prej IMT-së pranë Bashkisë Tiranë, për prishjen e ndërtimeve në njësitë administrative nr.4, 6 dhe 8, është e pa përligjur për shkak se subjektet posedues të ndërtimeve janë të njohura, vendi i njoftimit është i njohur, njoftimi në adresën e tyre është i mundur.
- ✓ Mungesë transparence në veprimtarinë e këtyre organeve gjatë procedimeve të iniciuara në ngarkim të shtetasve, pa u vënë në dijeni dhe pa patur paraprakisht një njoftim zyrtar, mbi vendimmarrjen për ndërhyrjen që do të kryhej. Kjo gjë ka cenuar të drejtën e ankuesve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.
- ✓ Vonesa dhe mungesë informacioni në vartësinë vertikale të detyrimit ligjor të raportimit të IMT-ve tek IKMT.
- ✓ Mungesë reagimi konkret të IKMT-së si një filtër i ligjshmërisë së vendimmarrjeve të organeve të tjera, në kuadër të zbatimit të parimit ligjshmërisë në fushën e inspektimit të ndërtimit. Procedurat konkrete administrative, që duhet të zhvillohen rast pas rasti nga IKMT-ja, duhet të kenë si një element të domosdoshëm hetimin aktiv nga ana e vet këtij organi, të fakteve, provave dhe procedurave të ndjekura paraprakisht, me qëllim që të parandalohen shkelje të ligjit.
- ✓ Dëmi financiar i shkaktuar nga ana e IKMT-së, apo të IMT-ve në bashki, gjatë prishjes së objekteve të ndërtuara me leje që, paraprakisht janë përfshirë në procesin e shpronësimit për interes publik, por që ende nuk kanë marrë vleftën e dëmshpërblimit që i takon, përbën kosto shtesë dhe e vendos veprimtarinë e këtyre organeve në kushtet e parashikuara nga ligji nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës publike”, i ndryshuar.
- ✓ Mungesë bashkëpunimi gjatë procedurave të ndërmarra nga ana jonë për trajtimin dhe hetimin e shqetësimeve të parashtruara nga individë të ndryshëm, duke shkaktuar edhe zvarritje dhe vonesa të trajtimit dhe shqyrtimit administrative të problematikave të shumta që parashtron ushtrimi i veprimtarisë nga këto struktura të rëndësishme në mbrojtjen e ligjshmërisë mbi territor.

3.11 Rregullimi i marrëdhënieve të punës dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative⁸⁴

Institucioni i Avokatit të Popullit, vazhdon të trajtojë marrëdhëniet e punës si një nga problematikat kryesore dhe të rëndësishme të shqyrtimit të ankesave për largimet nga

⁸⁴ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në institucionin e Avokatit të Popullit.

puna në administratën shtetërore të depozituara nga persona që gëzojnë ose jo statusin e nëpunësit civil si dhe hartimin e rekomandimeve, për garantimin e stabilitetit dhe mbrojtjes së të drejtave që burojnë nga marrëdhënia e punës, në nivel vendor dhe qendror. Menaxhimi i marrëdhënieve të punës në administratën publike dhe respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurat administrative, kanë qenë ndër fushat për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të investohet nëpërmjet kryerjes së hetimeve të thelluara administrative dhe adresimit të rekomandimeve, për shkak të ankesave të depozituara nga vetë punonjësit të cilët janë liruar, transferuar, pezulluar apo kanë marrë masë disiplinore.

Gjatë vitit 2021, janë trajtuar gjithsej 47 raste/ankesa të regjistruara pranë institucionit të Avokatit të Popullit që lidhen me marrëdhëniet e punës, prej të cilave 20 raste të zgjidhura në favor të punonjësve dhe pjesa më e madhe është në proces ose në përfundim të hetimit administrativ.

Në parim vlerësohet se çështja e rregullimit dhe menaxhimit të duhur të marrëdhënieve të punës në administratën publike, si për punonjësit, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas dispozitave të Kodit të Punës, ashtu dhe për nëpunësit, marrëdhënia e punës së të cilëve rregullohet sipas legjislacionit në fushën e shërbimit civil, është tepër e rëndësishme për të garantuar ndërtimin, funksionimin dhe qëndrueshmërinë e një administrate publike të bazuar në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike⁸⁵.

Duhet thënë se në disa raste nga organet e administratës publike ka kuptueshmëri dhe zbatueshmëri të pamjaftueshme lidhur me parimet dhe procedurat e duhura që duhet të ndiqen për të garantuar respektimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procedurën administrative, jo vetëm lidhur me marrëdhënien e punës, por edhe në përgjithësi⁸⁶. Në disa raste, kemi vlerësuar se procedurat administrative kanë qenë të paqarta dhe të paplota, duke mos krijuar garanci për respektimin e parimit të qartësisë dhe sigurisë juridike, i cili është një nga parimet më të rëndësishme në procedurat administrative, aq më tepër në rastet kur procedura administrative cenon drejtpërdrejt një interes dhe të drejtë të ligjshme të palës, siç është e drejta për punësim, e rrjedhimisht, për mirëqenie shoqërore dhe ekonomike⁸⁷.

⁸⁵ Procesi i rregullt ligjor, i garantuar si e drejtë themelore e njeriut zbatohet edhe në procedurat administrative, ndonëse ai nuk është i parashikuar shprehimisht në ligjin horizontal për procedurat administrative (Kodi i Procedurave Administrative).

⁸⁶ Në rastet kur, pas analizimit me kujdes të shpjegimeve të dërguara nga institucionet, si edhe të dokumentacionit të përcjellë, institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës administrative, ai ka adresuar edhe rekomandimet përkatëse. Në këtë kuadër, për shembull, në marrëdhënien e punës por edhe në marrëdhënien juridike në përgjithësi, Avokati i Popullit ka rekomanduar disa herë që institucionet të kryejnë një analizë të rasteve konkrete (të rrethanave të faktit) dhe të hartojnë relacionet të plota e të detajuara të masës së përgjegjësisë në nivel hierarkik ndërmjet strëurave të institucionit lidhur me emërimet dhe lirimet/largimet e ankuesve në kundërshtim me ligjin. Kjo, për të konkluduar qartësisht të paktën lidhur me masën e përgjegjësisë në nivel hierarkik të institucionit, duke adresuar drejt përgjegjësinë tek personat përkatës. Shih rekomandimet konkrete lidhur me të drejtën e punës në faqen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit në <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications>.

⁸⁷ Kjo e drejtë gjendet e pasqyruar dhe mishëruar plotësisht përmes elementëve thelbësorë të këtij parimi, të cilat janë ligjshmëria, transparenca, informimi, proporcionaliteti, drejtësia dhe paanësia, objektiviteti, përdorimi i gjuhës të njohur nga subjekti, e drejta e aksesit dhe përfaqësimi, e drejta e informimit, e drejta për t'u dëgjuar, kontradiktoriteti, koha e arsyeshme, arsytimi i vendimmarjes, e drejta e ankimit administrativ dhe gjyqësor, etj. E drejta për një proces të rregullt në procedurat administrative, e sanksionuar nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 6), Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 42), është një parim themelor kushtetues i konfirmuar tashmë nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese të

Ka munguar edhe në këtë rast bashkëpunimi efektiv me Avokatin e Popullit për të mundësuar hetime të plota dhe të shpejta. Institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës administrative, dhe ka adresuar edhe rekomandimet përkatëse⁸⁸.

Në këtë kuadër, për shembull, në marrëdhënien e punës por edhe në marrëdhënien juridike në përgjithësi, Avokati i Popullit ka rekomanduar disa herë që institucionet të kryejnë një analizë të rasteve konkrete (të rrethanave të faktit) dhe të hartojnë relacione të plota e të detajuara të masës së përgjegjësisë në nivel hierarkik ndërmjet strukturave të institucionit lidhur me emëri met dhe lirimet/largimet e ankuesve në kundërshtim me ligjin. Kjo, për të konkluduar qartësisht të paktën lidhur me masën e përgjegjësisë në nivel hierarkik të institucionit, duke adresuar drejt përgjegjësinë tek personat përkatës⁸⁹.

Ndër problematikat kryesore të evidentuara nga ankesat e depozituara apo nga rastet e ndjekura me iniciativë nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me marrëdhënien e punës në administratën publike, nënvizojmë:

- ✓ *ankesa/raste lidhur me lirim/largim të padrejtë nga detyra;*
- ✓ *ankesa/raste lidhur me procedurat e emërimit në administratën publike;*
- ✓ *ankesa/raste për transferim të padrejtë në një tjetër pozicion;*
- ✓ *ankesa/raste lidhur me zbatimin e institutit të pezullimit të marrëdhënies në shërbimin civil;*
- ✓ *ankesa/raste lidhur me procedurat e ristrukturimit të institucioneve të administratës publike*
- ✓ *kërkesë/ankesa për zbatimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për rikthimin e nëpunësve civilë në detyrë.*

Veçanërisht, çështja e largimeve nga puna do të vijojë të mbetet një nga pikat kyçe për punën e Avokatit të Popullit, me qëllim dhënien e kontributeve në përmirësimin e punës dhe krijimin e një administrate publike funksionale në përputhje me standartet evropiane.

3.12 E drejta për një mjedis të shëndetshëm⁹⁰

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të ketë prioritet të punës së tij monitorimin e situatës mjedisore në Republikën e Shqipërisë, si edhe zbatimin e legjislacionit respektiv në këtë fushë nga institucionet qendrore dhe organet e qeverisjes vendore, me qëllim ndikimin në përmirësimin e

Shqipërisë, që shërben si garanci për subjektet e së drejtës nga veprime apo mosveprime të organeve të pushtetit shtetëror, e reflektuar gjerësisht në Kodin e Procedurave Administrative, i cili është ligji horizontal që rregullon organizimin dhe funksionimin e veprimtarisë administrative dhe të administratës publike në tërësi.

⁸⁸ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rekomandimet-4/>

⁸⁹ Shtysa për të ndërhyrë në zgjidhjen e këtyre problematikave nëpërmjet rekomandimeve ka ardhur, ndër të tjera, edhe për shkak të faktit se, në mjaft raste, në dokumentacionin e vënë në dispozicion pranë institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me ankesat, përgjithësisht nuk është përcjellë akti administrativ i duhur ose nuk është paraqitur fare. Kjo do të shërbente për të vërtetuar metodologjinë e ndjekur nga institucioni për realizimin e vendimarrjes, ose veprimet që janë kryer për identifikimin e përgjegjësisë në të gjithë nivelet e hierarkisë që kanë shkaktuar shkeljen e të drejtave të qytetarëve. Shpesh moskryerja e analizave të argumentuara, ka penguar marrjen e një vendimi të drejtë për punonjësin.

⁹⁰ Kjo fushë e së drejtës është mbuluar nga Seksioni i Administratës deri më datë 18.10.2021. Me miratimin e urdhërit të Avokatit të Popullit, nr.154, datë 18.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe të drejtave specifike që do të mbulohej nga ndihmëskomisionerët e seksioneve në institucionin e Avokatit të Popullit”, kjo fushë e së drejtës tashmë mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

gjendjes së mjedisit në Shqipëri, si edhe garantimin e standardeve të një mjedisi sa më të shëndetshëm.

Gjithnjë e më shumë pranohet se kriza klimatike është ndër sfidat më të mëdha të të drejtave të njeriut të kohës sonë, duke përkeqësuar pabarazitë, thelluar pasigurinë dhe kërcënuar kështu jetën, shëndetin dhe mënyrën e jetesës. Organizmat e të drejtave të njeriut në nivel rajonal dhe ndërkombëtar trajtojnë gjithnjë e më shumë ndryshimet klimatike si çështje thelbësore. Në nivel ndërkombëtar vlen të përmendim rezolutën 46/7 e Këshillit të OKB-së për të Drejtat e Njeriut, e miratuar në mars 2021, në të cilën ajo njeherë edhe një herë ndikimet negative në të drejtat e njeriut të ndryshimeve klimatike, duke theksuar se dëmi mjedisor mund të ketë implikime negative, direkte dhe indirekte, për realizimin efektiv të të gjitha të drejtave të njeriut⁹¹.

Për rrjedhojë, Avokati i Popullit në suazën edhe të zhvillimeve globale, të nevojës që përgjegjësia mbi çështjet e mjedisit të aktualizohet edhe në vendin tonë si dhe si shprehje e mandatit promovues që ka si institucion kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në dhjetor të vitit 2021, me mbështetjen e Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, zhvilloi Konferencën e tij Vjetore me temë: *“Të Drejtat e Brezave të Ardhshëm dhe Ndryshimet Klimatike”*⁹².

Pjesëmarrës në Konferencë ishin aktorë të rëndësishëm shtetërorë, si Kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë e po ashtu edhe përfaqësues të institucioneve e organizatave kryesore ndërkombëtare, të tilla si Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri, Kreu i Delegacionit të BE-së në Shqipëri, etj.

Pjesëmarrësit në Konferencë shprehën pikëpamjen se të drejtat e miliona njerëzve në mbarë botën janë prekur tashmë nga kriza klimatike. Shqipëria nuk bën përjashtim. Kjo ngre pyetje mbi drejtësinë, paqen, sigurinë, barazinë në dhe midis kombeve e brezave. Veprimet klimatike duhet të ndërmerren në të gjitha nivelet dhe nga të gjithë aktorët. Shumë individë dhe grupe si fëmijët, të rinjtë dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut për mjedisin, kanë marrë përsipër iniciativa të guximshme për të qenë në vijën e parë të luftës, për të ndërtuar drejtësinë klimatike.

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar gjithsej 41 ankesa ndaj organeve të administratës publike të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit, duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm të çështjeve të filluar me iniciativë nga vetë institucioni. Në këtë kuadër, mund të theksojmë çështjen e ndotjes dhe djegies së plehrave në Elbasan, Fier, Lushnjë, Durrës, Vlorë, etj, të cilat kanë shkaktuar tym toksik dhe erë të rëndë në këto qytete.

Nga ana jonë në vazhdimësi është konstatuar se shkak i burimit ndotës është pikërisht mosveprimi i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj ndaj subjekteve të ndryshme që shkaktojnë ndotjen mjedisore. Në lidhje me këto problematika është evidentuar se kjo situatë ka ardhur si pasojë e depozitimit të mbetjeve urbane në këto vende dhe se për zgjidhjen e kësaj situatë janë marrë masa për evadimin e këtyre mbetjeve në Landfillin e Sharrës, Tiranë si dhe në atë të Fierit, me qëllim kthimin e situatës në normalitet.

⁹¹ UN Human Rights Council, Resolution on the Environment and Human Rights, UN Doc. A/HRC/46/L.6/Rev.1, 17 March 2021.

⁹² <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/home/news/this-article-is-available-only-in-albanian-739/>

Objekt i ankesave të paraqitura dhe të marra në shqyrtim ka qenë edhe ai lidhur me ndotjen akustike, e cila në tërësinë e saj dëmton cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve. Lidhur me trajtimin e problematikave të ngritura për ndotjen akustike dhe të ajrit institucioni i Avokatit të Popullit ka dalë edhe me rekomandime përkatëse⁹³.

Avokati i Popullit konfirmon rëndësinë që duhet t'i kushtohet gjendjes së mjedisit dhe mbrojtjes së ambientit në Shqipëri. Këto fusha kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe bashkëpunim të të gjithë faktorëve, me qëllim që të garantohet kujdesi për shëndetin dhe të rritet cilësia e jetës për brezat e sotëm dhe ata të ardhshëm.

3.13 Mbrojtja e konsumatorit⁹⁴

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të trajtojë, analizojë me prioritet ankesat e regjistruara në fushën e mbrojtjes së konsumatorit. Ai ka luajtur një rol proaktiv edhe me Entin Rregullator të Energjisë (ERE) sidomos në takimet on line lidhur me ndryshimet në Rregulloren e tyre për afatin e trajtimit e përgjigjeve të ankesave si dhe komunikimet e herë pas hershme për problematikat për rritjen e energjisë elektrike.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka analizuar me kujdes shpjegimet e dërguara nga institucionet përgjegjëse si edhe dokumentacionin e përcjellë duke vlerësuar se ka vend për përmirësim të procedurës dhe mundësi të rivënies në vend të të drejtave të shkelura. Këto parregullsi apo përmirësime të tyre, janë adresuar edhe në takimet e herë pas hershme të zhvilluar me drejtues të Furnizuesit të Shërbimit Universal të cilët kanë krijuar një urë komunikimi lidhur me trajtimin e rasteve të paraqitura pranë institucionit tonë por nuk gjendet e reflektuar shkresërisht në mënyrë që bashkëpunimi të jetë konstruktiv.

Institucioni i Avokati i Popullit, gjatë vitit 2021, është angazhuar maksimalisht për të dhënë kontributin institucional për çdo iniciativë dhe ankesë/kërkesë në mënyrë që të garantojë hapësirën e individëve për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore.

Siç e theksuam edhe më sipër, është konstatuar disa herë mungesa e bashkëpunimit nga Ujësjiellës Kanalizime, çka ka sjellë pengesë të punës duke shkaktuar vështirësi për shqyrtimin brenda një afati sa më të shpejtë të rasteve/problematikave të regjistruara. Një nga problematikat është edhe ajo e vendosjes së tarifave dhe taksave, marrja dhe mbledhja e tyre nga UKT.

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit vazhdojnë të adresohen ankesa të cilat lidhen kryesisht me pretendime për mbi faturime të energjisë dhe ujit, ndërprerje të energjisë/ujë, faturime

⁹³ Rekomandimi për: *Marrjen e masave të menjëhershme për ushtrimin e autoritetit administrativ në cilësinë e organeve eprorë të institucioneve që kanë kompetencën për të realizuar matjen e ndotjes akustike dhe ndotjes së ajrit me qëllim analizën e situatës dhe zgjidhjen e problematikës së ankuesit; Marrjen e masave administrative për identifikimin e funksionareve të administratës publike të cilët janë përgjegjës për mospërmubushjen e detyrimit për ushtrimin e detyrave funksionale me qëllim orientimin e ankuesit, analizën e situatës dhe zgjidhjen e problematikës; Marrjen e masave për hartimin e një kuadri të posaçëm rregullator të përbashkët ndërinstitutional ku të adresohen qartësisht orientimet për qytetarët, për trajtimin e ankesave të lidhura me këto problematika. Për më shumë lidhur me këto çështje gjendet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rekomandimet-4/>*

⁹⁴ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në Institucionin e Avokatit të Popullit.

aforfe, mosveprime të operatorëve kundrejt ankesave të qytetarëve, mungesë e sahatëve, pa mundësi ekonomike për të paguar shërbimin, cilësinë e shërbimeve që ofrohen prej tyre.

E drejta për të pasur disa shërbime elementare si shërbimi i furnizimit me ujë të pijshëm dhe me energji elektrike është një nevojë thelbësore njerëzore, një e drejtë themelore, mungesa e së cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut. Rritja e investimeve në këtë fushë si dhe zhvillimi i modeleve të shërbimeve të ofruara në përputhje me nevojat në zhvillim të komunitetit do të mundësojnë arritjen e qëllimeve të zhvillimit të qëndrueshëm.

Në veçanti duhet të sigurohen masa për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, duke përfshirë masat për të ndihmuar dhe për të shmangur ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike dhe ujë. Në disa ankesa operatorët e furnizimit me energji dhe ujë e orientojnë qytetarin për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura duke zbatuar një aktmarrëveshje si të vetmen mundësi lehtësuese për të shlyer detyrimet e akumuluar, por pa i analizuar dhe zgjidhur problematikat në thelb.

3.14 Respektimi i të drejtave që lidhen me pushtetin vendor⁹⁵

Roli i qeverisjes lokale për të parandaluar pabarazitë dhe për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut tani po bëhet më kritik me zhvillimet e fundit në Shqipëri. Veprimet e tyre janë apo duhet të jenë thelbësore për të ruajtur hapësirën qytetare dhe lirinë e shprehjes, për të siguruar qasjen në shërbimet themelore dhe për të përmirësuar planifikimin urban dhe synuar në arritjen e objektivave sociale të shtetit. Ky rol i qeverisjes vendore është tashmë i njohur dhe konfirmuar në shumë akte të organizmave ndërkombëtare, përfshirë dhe rezolutat e miratuara nga Këshilli i të Drejtave të Njeriut të OKB.

- *E drejta për strehim*

Një prej të drejtave më të rëndësishme, objekt i trajtimit nga pushteti lokal, është e drejta për strehim. Kjo e fundit është një prej të drejtave themelore më të rëndësishme të njeriut, që lidhet drejtpërdrejt me të drejtën për jetën dhe shëndetin. Shteti duhet të garantojë mbrojtje ligjore për strehim dhe të ofrojë një bazë për realizimin progresiv të të gjitha aspekteve të së drejtës për strehim të përshtatshëm.

Ajo që duhet evidentuar është roli proaktiv i Avokatit të Popullit në mbrojtjen e kësaj të drejte, ku evidentohet se pjesa më e madhe e rasteve që i përkasin të drejtës për strehim, të trajtuara për vitin 2021, është iniciuar nga vetë institucioni. Këto raste i përkasin problematikave të ndyshme, ku peshën më të madhe e zënë problematikat e ardhura si pasojë e tërmetit të nëntorit 2019.

Në total të të gjitha rasteve të trajtuara, të cilat janë rreth 60 raste, rezulton se 83% të rasteve rrjedhin si pasojë e problematikave të shkaktuara nga tërmeti (madje vërehet një tendencë në rritje

⁹⁵ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Administratës në Institucionin e Avokatit të Popullit.

për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, ku kjo problematikë zinte një peshë prej 67% të rasteve), nga totali i rasteve që trajtonin të drejtën për strehim, ndërsa pjesa tjetër i përket problematikave që kanë të bëjnë me banesat sociale, kredi të buta dhe bonus qiraje, problematikave lidhur me përmirësimin e kushteve të jetesës, me vendstrehimet, etj. Ndërmjet rasteve që kanë të bëjnë me të drejtën për strehim përfshihen edhe ato që i përkasin komunitetit Rom dhe atij Egjiptian.

Gjatë hetimit administrativ të procesit të rindërtimit në tërësinë e tij por edhe të rasteve konkrete, kemi hasur në pengesa nga vetë organet shtetërore përgjegjëse për trajtimin e kësaj problematike. Evidentojmë me shqetësim të vazhdueshëm faktin se organet kompetente (si bashkitë apo MSHR) nuk janë bashkëpunuese, duke mos na kthyer përgjigje apo edhe kur kemi përgjigje këto nuk janë ezauruese në të gjitha kërkimet tona.

Duhet theksuar se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të drejtë të veprimtarisë administrative nga ana e tyre, lidhur me të drejtat dhe interesat e ligjshme të individëve.

Përsa i përket shqyrtimit administrativ, deri në këtë fazë të procesit, rezulton se shqetësimet kryesore të ankuesve kanë të bëjnë me bonusin e qirasë, strehimin e tyre, procesin e rindërtimit, transparencën e organeve shtetërore në vlerësimin e objekteve dhe hartimin e dokumentacionit përkatës, zvarritjen e procesit të rindërtimit, etj.

Gjatë hetimit administrativ janë konstatuar problematika lidhur me mungesën e trajtimit të të gjithë banorëve të prekur me bonus qiraje. Në mjaft raste qytetarët nuk kanë mundur të aplikojnë apo janë paraqitur pengesa të tjera të cilat kanë të bëjnë edhe me faktin se një pjesë e shtetasve kanë një qasje më të ulët në mjetet e komunikimit elektronik. Kjo ka pamundësuar përfshirjen e tyre në listat e përfituesve.

Banorët shprehen se janë të paqartë dhe nuk kanë informacion mbi kohëzgjatjen e procesit të rindërtimit të pallateve dhe zona ku do të rindërtohen pasi mungon transparenca e institucioneve lidhur me këtë fakt. Edhe në kërkesat tona kemi kërkuar vazhdimisht informacion lidhur me kohëzgjatjen e procesit, transparencën e këtij procesi në tërësinë e tij dhe në raste të caktuara e konkrete, fazën në të cilën gjendet, aktet administrative të nxjerra për këtë qëllim, por nuk kemi marrë përgjigje të sakta dhe që shprehin qëndrim transparent nga institucionet përgjegjëse.

Konstatohet se organet përgjegjëse nuk kanë treguar kujdes të shtuar ndaj grupeve në nevojë, lidhur me familjet që jetojnë në çadra apo mjedise të tjera të përshtatura për strehim, veçanërisht në rastet kur kanë pjesëtarë të sëmurë, invalidë të grupeve të ndryshme, fëmijë, gra shtatzëna apo të divorcuara me fëmijë, të moshuar, etj. Jetesa në këto vendstrehime cenon rëndë normimet ligjore e nënligjore dhe parimet e së drejtës. Ligji “Për strehimin” në dispozitat e tij sanksionon parimin e strehimit të përshtatshëm duke parashikuar edhe kushtet që duhet të plotësohen për t’u konsideruar një strehim i përshtatshëm.

Për më tepër, vijimi i pandemisë së shkaktuar nga COVID-19 e ka përkeqësuar edhe më tej situatën e këtyre familjeve. Jetesa në çadra apo vendstrehime të barazvlefshme nuk ju mundëson këtyre individëve kushtet për të marrë masat ndaj virusit. Mungesa e ujit, dritave apo hapësirat e kufizuara për ruajtjen e distancimit social, por edhe problematika të tjera kanë vështirësuar në ekstrem jetesën e tyre. Institucionet përgjegjëse duhet të kishin marrë masa dhe të trajtohej me prioritet situata e kësaj kategorie, e këtyre individëve apo familjeve që jetojnë në kushte varfërie dhe në vendstrehime që përbëjnë rrezik për jetën dhe shëndetin e tyre në këtë situatë të pazakontë pandemie.

Një pjesë e banorëve ankohen për mungesën e një akt ekspertimi të thelluar për banesat e tyre pasi vlerësimi është bërë vetëm mbi një akt-konstatimi. Për vlerësim të saktë e të drejtë shihet e domosdoshme një vlerësim i thelluar i objekteve të dëmtuara i cili shërben për të saktësuar shkallën e dëmtimit të pësuar dhe nevojën për ndërhyrje. Në vlerësimin e dëmeve, është evidentuar paqartësi në veprime dhe mungesë transparence me qytetarët. Në mes të banorëve, ka shumë prej tyre që pasi kanë insistuar për vlerësim nga ekspertët pretendojnë se u ka ndryshuar niveli i dëmit, duke u rritur, çka dëshmon se kishte një nevojë të madhe për vlerësime të thelluara, që duhet t'i paraprijnë riparimeve, në mënyrë që të mund të trajtojnë dëmet reale të banesave.

Gjithashtu pretendohet se akordimi i fondeve të unifikuara sipas nivelit të dëmit, nuk përmbush nevojën për të siguruar riparimin e dëmeve në ndërtesat ku mund të bëhen riparime dhe rforcime dhe secila prej tyre paraqet specifikën e saj. Brenda banesave kolektive, dëmi i apartamenteve nuk është i njëjtë nga kati në kat dhe mungesa e vlerësimit të thelluar individual, bën që shpërndarja e barabartë e vlerës monetare të rindërtimit të mos shkojë në përpjestim të drejtë me nevojën. Për shumë familje, sidomos ato me të ardhura minimale kjo sjell përkeqësim të gjendjes ekonomike të tyre në kushtet kur shihet domosdoshmëria e sigurimit të të ardhurave shtesë për të mundësuar një banesë të sigurt dhe me një standard normal për jetesë.

Kjo situatë është reflektuar ndjeshëm edhe tek banorët e zonave rurale të cilët vazhdojnë të jetojnë në kushte të vështira jetese për shkak të pamundësisë së largimit nga zonat e banimit, në kushtet e emergjencës, pasi duhet të kujdesen për ekonominë bujqësore dhe gjënë e gjallë, si të vetmet mjete jetese. Në disa raste banorët janë shprehur se jetojnë në çadra që nuk plotësojnë as kushtet minimale të jetesës apo edhe në kasollet e bagëtive apo vendstrehime të tjera të sajura për banim. Nuk duket se janë marrë masat maksimale për këtë kategori, në kushtet kur kanë kaluar dy vite nga tërmeti dhe ende jetojnë në vendstrehime të tilla të papërshtatshme.

Ndërkohë një problematikë tjetër evidentohet, sipas pretendimeve të banorëve të prekur, pasi me nënshkrimin e kontratave të përfitimit të ndihmës për rindërtim, nuk janë dhënë kopje të nënshkruara banorëve, për t'iu referuar afateve kohore për rindërtimin dhe formën e inspektimeve. Mospajisja me kontrata palëve nënshkruese paraqet cenim të së drejtës së tyre për transparencë dhe vendos në kushte pabarazie palët kontraktuese. Organet shtetërore janë njësoj përgjegjëse ndaj të drejtave të qytetarëve si në rastet e gjendjeve të zakonshme dhe të atyre të jashtëzakonshme dhe kjo e fundit nuk mund të sjellë abuzime në emër të saj.

Duke iu rikthyer trajtimit të rasteve konkrete, vërehet se ajo që paraqitet më evidente dhe përbën shqetësimin më të madh të banorëve të këtyre zonave ka të bëjë me mungesën e transparencës së

organeve shtetërore lidhur me procedurat e rindërtimit. Këta banorë ankohen pasi nuk kanë informacion lidhur objektet/banesat që do të përfitojnë nga ky proces, ku do të jenë ato, cili do të jetë afati kohor kur këto do t'iu vihen në dispozicion e të tjera problematika. Lidhur me këtë shqetësim, Avokati i Popullit konstaton mungesën e transparencës pasi në të gjitha kërkesat e drejtuara organeve kompetente e veçanërisht Ministrin të Shtetit për Rindërtim, nuk ka një përgjigje definitive dhe sqaruese lidhur me këtë fakt për rastet konkrete të kërkuara por edhe për procesin në tërësinë e tij. Duket se mungesa e transparencës ka shoqëruar këtë proces, lidhur me vlerësimin e dëmeve të objekteve ashtu edhe me transparencën e fondeve të përdorura për këtë qëllim.

Një nga parimet e procesit të rindërtimit është parimi i kontrollit dhe përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve si dhe parimi i informimit dhe transparencës. Këto parime rregullohen drejtpërdrejt në kushtetutë, në ligje të veçanta dhe sanksionohen edhe në aktin normativ Nr. 9, datë 16.12.2019, *“Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”*, ku është specifikuar roli i qeverisë nëpërmjet organeve përfaqësuese të saj si edhe roli i donatorëve në funksion të procesit të rindërtimit. Transparenca nënkupton që hartimi i programit kombëtar të rindërtimit, specifikat e tij dhe vendimet e nxjerra në funksion të programit kombëtar të rindërtimit duhet të jenë të aksesueshme publikisht, nga kushdo dhe në kushtet e njohurive minimale teknologjike. Kriteret për përcaktimin e përfituesve, mënyrës së kompensimit e të fondeve përkatëse, duhet të jenë të qarta dhe të jenë objekt i mekanizmave të pavarur verifikimi. Të gjithë indikatorët e progresit, ecurisë së rindërtimit, koha e nevojshme për përfundimin e tij dhe fondet e përdorura për çdo rast, duhet të jenë transparente dhe të publikohen në faqet përkatëse në funksion të transparencës.

Të dhënat e publikuara duket se janë minimale, nuk shprehin parimin e transparencës reale dhe në disa raste është e vështirë për t'u aksesuar nga të gjithë personat dhe me njohuri jo të thella në mjetet e komunikimit elektronik. Qeveria, organet kompetente kanë detyrimin të raportojnë në mënyrë të vazhdueshme për përdorimin e fondeve. Gjithashtu, duhet të ketë një strategji të qartë komunikimi dhe një mekanizëm për shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe trajtimit të tyre me shpejtësi dhe korrektesë ligjore. Programi për rindërtimin e banesave duhet të ketë në qendër përfituesit e tij, pronarët e banesave apo objekteve të tjera të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, duke siguruar pjesëmarrjen efektive të tyre përmes mekanizmave konsultues.

Sa më sipër, në një situatë të tillë të vlerësohet nga çdo bashki, njësi e qeverisjes vendore apo institucionet e tjera kompetente, situata social-ekonomike e të gjitha familjeve që jetojnë në çadra apo vendstrehime të tjera alternative dhe të krijohet mundësia e strehimit të përshtatshëm në përputhje me normat ligjore.

Duhet të merren masat e duhura për rimëkëmbjen e ekonomisë në këto zona të prekura si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, veçanërisht për subjektet e veçanta dhe në nevojë për shkak të mundësive të pakta buxhetore, ku duket se tërmeti ka dëmtuar ndjeshëm jetesën e tyre. Gjithashtu duhet një kujdes i shtuar ndaj banorëve të zonave rurale të cilët janë të predispozuar për t'u varfëruar akoma më shumë, pasi në pjesën më të madhe të rasteve të ardhurat e tyre janë prej gjëse së gjallë. Avokati i Popullit ka marrë në shqyrtim dhe po vijon hetimin administrativ për një numër çështjesh, për të cilat do të shprehim qëndrimin tonë në përfundim të hetimit administrativ.

- *E drejta për ofrimin e shërbimeve publike*

Në kuadër të shkeljes të të drejtave të njeriut në ofrimin e shërbimeve publike, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme nga organet e qeverisjes vendore respektim të këtyre të drejtave. Në këtë aspekt për t'u përmendur kanë qenë ankesat drejtuar institucionit tonë lidhur me problematikën që haset më së shumti në fushën e infrastrukturës dhe kryesisht në atë të pasjes së rrugeve sipas standarteve të përcaktuara, mirëmbajtjes së tyre, ambienteve të përbashkëta sipas të gjitha normave mbi të drejtën në komunitet e më gjerë.

Gjatë vitit 2021, Avokati i Popullit ka administruar disa ankesa që lidhen me këtë çështje, dhe konkretisht *19 raste*.

Institucioni i Avokatit të Popullit risjell në vëmendje rëndësinë kyçe të jetesës në ambiente normale dhe të përshtatshme si një mënyrë shprehjeje e një prej parakushteve për përmbushjen e detyrimit që shteti ka për ofrimin dhe garantimin e shërbimeve publike. Për këtë, nëpërmjet rekomandimeve iu është kërkuar institucioneve që të veprojnë pozitivisht në ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për garantimin dhe sigurimin e ofrimit të shërbimeve të cilat kanë ndikim në sigurinë dhe mbrojtjen e jetës.

3.15 Mbrojtja dhe të drejtat e fëmijës⁹⁶

Burim parësor për trajtimin e rasteve që cenojnë të drejtat e fëmijës për vitin 2021, kanë shërbyer ankesat e bëra drejtëpërdrejt nga vetë fëmijët. Në praktikën tonë administrative, gjatë trajtimit të këtyre ankesave, kemi synuar jo vetëm zgjidhjen e problematikave të hasura e të identifikuara, por edhe promovimin dhe nxitjen e një kulture të re, sa i takon zberthimit korrekt në praktikë të parimit të interesit më të lartë të fëmijëve dhe, në cilësinë e organit monitorues, të respektimit të detyrimeve ligjore që burojnë në kuptim të ligjit nr.18/2017, nga i gjithë mekanizmi i sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës.

Problematikat e evidentuara gjatë vitit 2021, në ndryshim nga viti 2020, janë kryesisht të lidhura me ndikimin, që kanë patur në të drejtat e fëmijëve, masat administrative të çfarëdo lloji natyre, të ndërmarrura nga qeveria dhe institucionet shtetërore, për parandalimin e përhapjes së covid-19. Barrierat sistematike dhe strukturore në këto raste lidhen kryesisht me aksesin në të drejta nga ana e fëmijëve, veçanërisht e dukshme kjo për fëmijët në nevojë dhe sfida për institucionet përgjegjëse shtetërore vijon të mbetet vlerësimi më i mirë i interesit më të lartë të fëmijës.

Kështu, për monitorimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës në nivel qendror dhe vendor, nisur nga shqyrtimi dhe trajtimi i rasteve me iniciativë, monitorimet dhe inspektimet e kryera në terren, kemi konstatuar shkeljen e të drejtave të fëmijëve lidhur me:

- *të drejtën e fëmijës për arsim;*
- *të drejtën e fëmijës për mbrojtje, mjedis familjar dhe përkujdesje alternative;*
- *të drejtën e fëmijës për pjesëmarrje;*
- *të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë.*

⁹⁶ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Mbrojtjes së Fëmijëve në Institucionin e Avokatit të Popullit.

➤ *E drejta për arsim*

Vendi ynë ka ndërmarrë reforma të rëndësishme në arsim, të cilat kanë përmirësuar aksesin në edukim dhe rritjen e rezultateve të të nxënësve, duke përfshirë decentralizimin e qeverisjes së institucioneve të edukimit dhe prezantimin e kurrikulës, bazuar në kompetenca. Një ndër masat e marra nga qeveria për vitin 2021, në kuadër të reformës në arsimin parauniversitar, është zgjerimi i skemës së librave falas në arsimin 9-vjeçar, e cila passolli rritjen e aksesit të fëmijëve në arsimin e detyruar.

Pavarësisht arritjeve pozitive të reformës, kryesisht problematikat e konstatuara në këtë fushë lidhen me:

- *pabarazi në mundësitë e rezultateve arsimore*⁹⁷;
- *mjediset dhe infrastrukturën e institucioneve të edukimit*⁹⁸;
- *paqartësi në role, kompetenca dhe përgjegjësi, ndërmjet autoriteteve në nivel qendror dhe vendor*⁹⁹;
- *mungesën e planifikimit të buxheteve për arsimin parauniversitar*¹⁰⁰.

Për këtë qëllim, institucioni i AP-së, ka adresuar rekomandimet për mekanizmat shtetërorë përgjegjës, që edukimin dhe arsimin e kanë pjesë të fushës së tyre të veprimtarisë shtetërore, në nivel qendror dhe vendor. Më konkretisht, ndër rekomandimet më të qenësishme përmendim:

Në aspektin e realizimit të së drejtës së fëmijës për arsim cilësor e gjithëpërfshirës, *Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe organeve të vetqeverisjes vendore*:

- ✓ *menaxhimin efektiv dhe eficient të sistemit arsimor në të gjitha nivelet, bazuar në mekanizmat funksionale për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies;*
- ✓ *planifikimin e buxheteve shtesë vit pas viti, për arsimin parauniversitar;*
- ✓ *hartimin dhe miratimin e planeve konkrete për menaxhimin e situatave të emergjencës në sistemin parauniversitar;*
- ✓ *krijimin e mjediseve të përshtatshme për nxënës efektivë, nëpërmjet përmirësimit dhe zgjerimit të infrastrukturës shkollore;*

⁹⁷ Mundësitë jo të barabarta në arsim për shkak të gjinisë, etnisë, përkatësisë sociale dhe vendndodhjes gjeografike, kanë nxjerrë në pah rënien e numrit të nxënësve nga viti në vit në disa bashki të vendit, e dukshme kjo sidomos në bashkitë e vogla (Rrogzhihë, Peqin, Gramsh, Prrenjas etj.), si pasojë e migracionit. Ndërkohë, në disa bashki të tjera vërehet një numër më i lartë nxënësish (Tiranë, Durrës, Elbasan). Sikundër, edhe infrastruktura e dobët në zonat rurale dhe mungesa e transportit sjellin kufizime të tjera në aksesin e nxënësve në shkolla.

⁹⁸ Nga vizitat në terren, vërehet, se institucionet e edukimit nuk plotësojnë standardet e përshtatshme, sidomos në zonat rurale, ku hasen vështirësi në plotësimin e nevojave bazë infrastrukturore dhe operacionale, duke përfshirë laboratorët e shkencave natyrore, etj., së bashku me pajisjet dhe mjetet didaktike e të nevojshme, për t'i bërë ato funksionale.

⁹⁹ Psh., vendimi për mbylljen e institucioneve të edukimit për shkak të ftohtit në mbarë vendin, u mor nga organet qendrore (MAS), ndërkohë që autoritetet vendore në cilësinë e autoritetit përgjegjës për sigurimin e ngrohjes në institucionet arsimore, u vendosën në pabarazi sa u takon mbështetjes financiare nga buxheti i shtetit. Kjo, si rrjedhojë e mungesës së ekzistencës së një procesi të qartë për përcaktimin e fondeve, ndërmjet institucioneve të edukimit dhe nxënësve, ku shkollat nuk kanë autonominë e duhur që ju nevojitet për të shpenzuar fondet në përputhje me nevojat.

¹⁰⁰ Kuadri i buxhetimit afatmesëm, për periudhën 2021-2023, nuk parashikon rritje të ndjeshme të buxhetimit për arsimin parauniversitar. Tek masat plotësuese për rishikimin e buxhetit gjatë pandemisë për arsimin nuk është vërejtur asnjë shtesë buxheti apo detajim zërash buxhetorë, që synojnë fëmijët, realizimin e të drejtave dhe mbrojtjen e tyre. Vetëm nga ana e njësisë të vetëqeverisjes vendore u dyfishua fondi i emergjencës që u përdor për grupet në nevojë, përfshirë fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe familjet e tyre. Sidoqoftë, burimet financiare ishin të pamjaftueshme.

- ✓ *trajnimin e stafëve pedagogjike të institucioneve të edukimit, me qëllim mbështetjen për identifikimin/njohjen e gjendjes emocionale, ndjenjës së ankthit dhe të frikës të nxënësit, në rastet e situatave të emergjencës.*

Si një nevojë për pasqyrimin e problematikave dhe parashtrimin e rekomandimeve, për rritjen e mëtejshme të efektivitetit në zbatimin dhe respektimin e të drejtës së fëmijës për t'u arsimuar në këtë situatë pandemie, por jo vetëm, institucionit i Avokatit të Popullit (SMPDF) hartoi dhe një Raport sintezë për problematikën e evidentuarë në ushtrimin e të drejtës për arsim të fëmijës gjatë pandemisë dhe në vijim.

➤ *E drejta e fëmijës për mbrojtje, mjedis familjar dhe përkujdesje alternative*

Ritja e mirëqenies në vendin tonë udhëhiqet nga programe të ndryshme të planifikimit, menaxhimit dhe zhvillimit, duke mos patur një qasje gjithëpërfshirëse me/në qendër fëmijën. Pavarësisht kuadrin ligjor të mbrojtjes së fëmijës dhe ngritjes së strukturave përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor, sistemet sektoriale në nivel vendor nuk përfitojnë financimet e duhura në burime financiare dhe njerëzore. Kjo pasjell mospërbushjen e nevojave të fëmijëve në interesin më të lartë të tyre. Në vlerësim të angazhimeve të institucioneve shtetërore ndaj mbrojtjes së fëmijëve, mbetet ende punë për t'u bërë, parë në kontekstin e shkeljeve të evidentuara, si vijon:

- ✓ *ndërprerjen e shërbimeve të mbrojtjes gjatë dhe pas periudhës së pandemisë covid-19¹⁰¹;*
- ✓ *mosfunksionimi i Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror¹⁰²;*
- ✓ *mungesa e fondeve shtesë apo rregullimeve specifike¹⁰³;*
- ✓ *funksionimi i Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës vetëm me një punonjës (PMF)¹⁰⁴;*
- ✓ *mungesa e fondeve për administrimin e rasteve të mbrojtjes së fëmijëve¹⁰⁵;*
- ✓ *probleme në funksionimin e grupit teknik ndërsektorial (GNT-ve), për trajtimin e rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje¹⁰⁶.*

Për këtë qëllim, në aspektin e garantimit të të drejtave të fëmijëve për mbrojtje sociale, mjedis familjar dhe përkujdesje alternative, *Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe*

¹⁰¹ Institucionet përgjegjëse shtetërore nuk morën masat e duhura në kohë, për t'u përgjigjur nevojave të fëmijëve që jetojnë në varfëri, fëmijëve pa kujdes prindëror, me probleme të shëndetit mendor, veçanërisht fëmijëve me aftësi ndryshe.

¹⁰² Në zbatim të legjislacionit të shërbimeve shoqërore, vendimit nr.136, datë 7.3.2018, të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin dhe administrimin e Regjistrin Elektronik Kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror", Shërbimi Social Shtetëror është struktura përgjegjëse për përditësimin dhe mirëmbajtjen e tij. Regjistri është baza elektronike e të dhënave të përfituesve, subjekteve ofruese, institucioneve përgjegjëse, llojit dhe kohëzgjatjes së shërbimeve të kujdesit shoqëror.

¹⁰³ Masat kundër përhapjes së pandemisë covid-19 ishin të natyrës organizative dhe synonin mbrojtjen e shëndetit të popullatës, por ato nuk adresonin qartë nevojat e fëmijëve si individë dhe mënyrën sesi duheshin zbatuar në përputhje me parimin e interesit më të lartë të fëmijës.

¹⁰⁴ Pavarësisht detyrimit ligjor për krijimin e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijës, si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe, që ka për detyrë parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje, në pjesën më të madhe të bashkive nuk respektohet detyrimi ligjor, ku parashikohet si standard minimal: (1) një punonjës i dedikuar për 3000 fëmijë në çdo njësi administrative duke penalizuar punën e PMF në përbushjen e detyrave funksionale ligjore për shkak të ngarkesës së punës.

¹⁰⁵ Pothuajse në shumë prej bashkive të vendit fëmijët kanë nevojë për shërbime specifike të përkujdesit social, shërbime të cilat janë ende të pangritura dhe mungojnë.

¹⁰⁶ Pavarësisht se bashkitë kanë përbushur detyrimin ligjor për ngritjen e grupit teknik ndërsektorial, konstatohen sfida dhe problematika, për sa i përket zbatimit në praktikë të detyrave dhe funksionimit të Grupit Teknik Ndërsektorial, si një nga mekanizmat kryesorë vendorë, thelbësor në mirëfunksionimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve

organeve të vetqeverisjes vendore u kemi adresuar rekomandimet përkatëse, ndër të cilat si më të genësishëme, përmendim:

- ✓ hartimin e një plani veprimi të detajuar për menaxhimin e situatave të emergjencës dhe buxhetimin e tij, me qëllim garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës;
- ✓ forcimin e bashkëpunimit ndërinstytucional dhe koordinimin e punës, ndërmjet institucioneve përgjegjëse, pjesë e grupit teknik ndërsektorial;
- ✓ integrimin e regjistrit elektronik kombëtar për rastet e fëmijëve në nevojë për mbrojtje në Regjistrin Elektronik Kombëtar të Shërbimeve të Kujdesit Shoqëror dhe bërjen funksionale të këtij të fundit;
- ✓ rritjen e numrit të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve në strukturën e shërbimeve shoqërore pranë bashkisë dhe njësisë administrative dhe buxhetimin e njësisë së mbrojtjes së fëmijës;
- ✓ zbatimin e sanksioneve në rastet e kundërvajtjeve administrative nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës në përputhje me legjisllacionin në fuqi;
- ✓ bashkëpunimin me INSTAT, për gjenerimin dhe prodhimin e të dhënave sasiore, për numrin e fëmijëve nga 0 - 18 vjeç për çdo bashki, nëpërmjet CENSUS-it që pritet të realizohet së shpejti, ku të përfshihet edhe prodhimi i kësaj të dhëne, që zgjidh njëherë e mirë problematikat që lidhen me numrin e punonjësve të mbrojtjes së fëmijës për çdo bashki¹⁰⁷.

➤ *Të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin, viktimat dhe/apo dëshmitarë*

Është fakt sot se kriminaliteti tek të miturit dhe sjelljet devijante të tyre përbëjnë një nga dukuritë shqetësuese të shoqërive në mbarë botën, që prek jo vetëm viktimën e krimit, por edhe familjen e delikuentëve të mitur, të ardhmen e tyre dhe shoqërinë në përgjithësi.

Në shoqërinë në të cilën jetojmë sot, drejtësia për të miturit është një shqetësim i gjerë për zbatimin e ligjit. Avokati i Popullit, si institucion kombëtar i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në vijimësi ka përgatitur raporte sintezë për gjetjet dhe problematikat e konstatuara në drejtësinë për të miturit në vendin tonë, sikundër ka adresuar rekomandimet për autoritetet shtetërore përgjegjëse.

Avokati i Popullit gjithnjë ka vënë theksin në detyrimin, që kanë aktorët kyç të administrimit të drejtësisë penale për të mitur karshi të drejtave të fëmijëve dhe adoleshentëve të rinj, të akuzuar për shkelje të ligjit penal. Dhe, për këtë, Avokati i Popullit qartëson, se një sistem i drejtësisë për të mitur duhet të sigurojë, që fëmijët dhe adoleshentët të gëzojnë të gjitha të drejtat njësoj si qeniet e tjera njerëzore. Por, gjithashtu, ky sistem duhet t'u sigurojë atyre mbrojtje të veçantë, që i nevojitet moshës dhe fazës së tyre të zhvillimit, në përputhje me parimet kryesore të sistemit të drejtësisë për të mitur, përkatësisht, rehabilitimin e fëmijëve dhe adoleshentëve, zhvillimin e tyre gjithëpërfshirës dhe ri-integrimin e tyre në shoqëri, për të bërë kështu të mundur që ata të luajnë një rol konstruktiv brenda këtij sistemi.

Sistemi i drejtësisë për të mitur duhet të respektojë parimet e sanksionuara në KDPM¹⁰⁸, që zbatohen posaçërisht për të miturit dhe, në mënyrë të veçantë, duhet të vlerësojë dhe respektojë

¹⁰⁷ Institucioni i AP-së, për t'i ardhur në ndihmë bashkive, në plotësimin e standardit ligjor të parashikuar në ligjin nr.18/2017, në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit me INSTAT, do të monitorojë në vijimësi zbatimin e këtij rekomandimi.

¹⁰⁸ Ligji nr.37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur"

rregullat, nëpërmjet të cilave sigurohet zbatimi i parimeve të përgjithshme të Kodit, për personat që nuk kanë arritur ende moshën e përgjegjëse penale, por edhe atë të pjekurisë. Ndaj, problematikat që vërehen në lidhje me administrimin e drejtësisë penale për të mitur janë si vijon:

- ✓ *mungesa e zbatimit të masave alternative të shmangies nga dënimi*¹⁰⁹;
- ✓ *ekzistenca e një hendeku të konsiderueshëm, ndërmjet asaj që parashikohet e sanksionohet në legjislacion dhe përvojave të të miturve në konflikt me ligjin dhe adoleshentëve të rinj, të akuzuar për shkelje të ligjeve penale*¹¹⁰;
- ✓ *trajtimi jo në mënyrën e duhur të të miturit në konflikt me ligjin, viktimë dhe/apo dëshmitar dhe adoleshentët e rinj, nga Policia e Shtetit, e cila arreston, ndalon apo shoqëron kryesisht, ata që vijnë nga familje me një strukturë socio-ekonomike më të varfër*¹¹¹;
- ✓ *mosrespektimi i të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin dhe adoleshentëve të rinj, kur ata janë të privuar nga liria*¹¹².

Për këtë qëllim, në aspektin e garantimit të një drejtësie miqësore për të miturit në konflikt me ligjin, viktima dhe/apo dëshmitarë, institucioni i Avokatit të Popullit u ka adresuar rekomandimet përkatëse Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndër të cilat si më të qenësishme, përmendim:

- ✓ *aksesin e të miturve në konflikt me ligjin, viktima dhe/apo dëshmitarë*¹¹³ ;
- ✓ *përmirësimin e cilësisë së shërbimit nga profesionistët e institucioneve të administrimit të drejtësisë penale për të mitur;*
- ✓ *mbështetjen e strukturave të specializuara në institucionet e drejtësisë penale, për t'i pajisur me kapacitetet, infrastrukturën, burimet e nevojshme financiare dhe njerëzore;*
- ✓ *forcimin e bashkëpunimit institucional brenda sistemit të drejtësisë penale për të miturit;*
- ✓ *aplikimin e programeve rehabilituese dhe/ose të ndërmjetësimit për dënimet alternative ose aplikimin e dënimeve alternative të parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur;*
- ✓ *aplikimin e masave të shmangies alternative nga dënimi për të miturit në konflikt me ligjin.*

¹⁰⁹ Dënimi me burg në rastin e personave nën moshën 18 vjeç, duhet të përdoret si mjete i fundit. Kësisoj, Avokati i Popullit nxit organet kompetente të lëvizin në drejtim të eliminimit të formave të ndëshkimit me burgim në rastin e fëmijëve dhe adoleshentëve të rinj.

¹¹⁰ Në këtë mënyrë, Avokati i Popullit vëren, sesi, me përjashtim të disa shembujve e të praktikave më të mira, sistemi i drejtësisë penale për të miturit në vendin tonë karakterizohet nga disa shfaqje të diskriminimit, formave të dhunës, mungesës së profesionistëve të specializuar në çështjet e drejtësisë për të mitur dhe një mungesë, për sa i përket aplikimit të masave të shmangies nga dënimi apo në rastin më të keq, një abuzim me masat e përdorura për të privuar të miturit nga liria e tyre.

¹¹¹ Kontakti i parë i fëmijëve dhe adoleshentëve me sistemin e drejtësisë për të mitur është përmes policisë dhe, për ta, kjo është një përvojë jo fort e mirë. Avokati i Popullit ka konstatuar në hetimet administrative të kryera, për praktikën policore, në të cilat fëmijët dhe adoleshentët mbahen në mënyrë rutinore, pikërisht bazuar në perceptimin rreth sjelljes së tyre, ose thjesht sepse supozohet se janë “në rrezik”, ose të braktisur, pasi ata jetojnë në rrugë ose enden përreth ata që u përkasin pakicave, ose ata që identifikohen se i përkasin komuniteteve të caktuara, atij Rom dhe Egjiptian. Ndodh shpesh, që fëmijëve dhe adoleshentëve, që kryejnë ose akuzohen për kryerjen e veprave penale, t’u shkëputen çdo kontakt me familjen dhe komunitetin - kontakte të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave dhe zhvillimin e tyre.

¹¹² Avokati i Popullit shpesh herë ka konstatuar, se kushtet në mjediset, në të cilat fëmijët dhe adoleshentët privohen nga liria, në përgjithësi, janë joadekuate dhe shpesh krijojnë dhunë psikologjike tek fëmijët ose adoleshentët, ose edhe pengesë në zhvillimin e tyre harmonik, fizik e social. Për më tepër, kushtet e paraburgimit jo gjithmonë garantojnë siç duhet të drejtat e tjera të fëmijëve dhe adoleshentëve, të drejta që nuk duhet të kufizohen kurrë kur ata janë në paraburgim, të tilla si: e drejta për jetën, integritetin fizik, shëndetin, ushqimin dhe arsimin dhe veprimtaritë e karakterit argëtues e kulturor.

¹¹³ Kjo nënkupton zbatimin korrekt të rregullave të përgjithshme procedurale të drejtësisë penale për të miturit në mënyrë integrale nga organet përgjegjëse të shërbimeve sociale, arsimore, policia e shtetit, ndihma ligjore falas, etj.

Për të parandaluar sadopak shndërrimin e të miturve dhe adoleshentëve të rinj në delikuentë në shoqëri, aktorët kyç të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, profesionistët, organizatat dhe *oif* vendase apo të huaja, komuniteti, duhet të përfshihen në mënyrë aktive në sigurimin e shërbimeve thelbësore për mirëqenien e fëmijëve në interesin më të lartë të tyre.

➤ *E drejta e fëmijës për pjesëmarrje*

Çdo fëmijë gëzon të drejtat në përputhje me standardet e Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës në interesin më të lartë të tyre. Një ndër të drejtat e fëmijës, është edhe e drejta për pjesëmarrje në çdo vendimarrje, që lidhet dhe i afekton fëmijët drejtëpërdrejt. Garantimi i kësaj të drejte duhet të fokusohet në prezencën e proceseve efektive, ku zëri i fëmijës dëgjohet, vlerësohet dhe respektohet në vendimarrje që lidhen me të drejtat e tyre. Legjislacioni ynë në mënyrë eksplicite¹¹⁴ parashikon pjesëmarrjen e fëmijës dhe, në këtë drejtim, ka filluar një punë e mirë nga legjislativi dhe ekzekutivi, në përfshirjen e tyre, si një ndër palët kryesore, gjatë hartimit dhe konsultimit të akteve ligjore dhe nënligjore. Vlen të përmendim këtu grupin e deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë “*Miqtë e fëmijëve*”, Këshillin Kombëtar të të Drejtave të Fëmijëve, etj. Fëmijët prezantojnë një këndvështrim, ekspertizë dhe mençuri, që duhet të merret në konsideratë dhe vlerësohet gjatë çdo procesi vendimarrjeje. Pavarësisht kësaj, pjesëmarrja e fëmijëve dhe dëgjimi i zërit të tyre në proceset vendimarrëse në nivel qendror dhe vendor është ende një koncept i ri dhe akoma nuk kemi të konsoliduar një proces të strukturuar të përfshirjes së tyre. Konkretisht, problematikat e konstatuara janë:

- ✓ qeveritë e nxënësve nëpër shkolla janë *struktura të dobëta*, që nuk përfaqësojnë zërin e fëmijëve;
- ✓ *mospërfshirja e fëmijëve në vendimarrjet që lidhen me ta*, e konstatuar në vendimarrjet e qeverisjes vendore;
- ✓ *mungesa e mbështetjes* nga ana e institucioneve shtetërore për fuqizimin dhe zgjerimin e rolit të fëmijëve.

Për këtë qëllim, në aspektin e garantimit të pjesëmarrjes dhe dëgjimit të zërit të fëmijëve, institucioni i Avokatit të Popullit u ka adresuar rekomandimet përkatëse institucioneve përgjegjëse shtetërore në nivel qendror dhe vendor, ndër të cilat si më të qenësishme, përmendim:


- ✓ *fuqizimin e rolit të qeverisjes së nxënësve* nga MAS;
- ✓ *bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës* nga strukturat e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, për të fuqizuar dhe mbështetur qeverisjen e nxënësve;
- ✓ *investimin dhe mbështetjen* nga të gjitha ministrinë e linjës me burime dhe energji, për t’u dhënë fëmijëve hapësirë veprimi dhe mendimi.
- ✓

Besojmë se ky lloj investimi tek fëmijët është fillimi i një praktike të mirë pune, që ata të gëzojnë të drejtat, për të vendosur statusin në shoqëri në një shkallë, që të mund të mbrojnë interesin e tyre në hapa të njëjtë me të rriturit.

¹¹⁴ Neni 35 i ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, neni 36 i ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH-së”, të ndryshuar.

Të drejtat e fëmijës në kuadër të promovimit dhe garantimit të të drejtave

Në funksion të zhvillimit të veprimtarive promovuese, institucioni i Avokatit të Popullit është fokusuar në drejtim të:



Për këtë qëllim, institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet Komisionerit dhe Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, ka realizuar veprimtari të ndryshme promovuese, duke luajtur rol proaktiv në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e institucioneve të administratës shtetërore në nivel qendror dhe vendor, në ushtrimin e detyrave të tyre funksionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Veprimtaritë e zhvilluara me karakter informues dhe ndërgjegjësues, janë pasqyruar edhe në faqen zyrtare të rrjetit social *facebook* të institucionit të Avokatit të Popullit /seksioni i fëmijëve, nëpërmjet të cilave bëhet thirrje për ndërgjegjësimin e cilitdo institucioni të administratës shtetërore, për respektimin e dinjitetit, integritetit dhe realizimit të të drejtave të fëmijëve¹¹⁵.

Gjithashtu, në partneritet me organizatat ndërkombëtare janë realizuar publikime për të sjellë në vëmendje të organeve shtetërore, respektimin e të drejtave të fëmijëve. Më konkretisht, përmendim

¹¹⁵ Si psh: publikime për Ditën Kombëtare të Jetimëve, për 1 qershorin, për personat me aftësi të kufizuara/fëmijët me aftësi ndryshe, për ditën e parë të shkollës për nxënësit e arsimit parauniversitar, me qëllim ndërgjegjësimi të institucioneve përgjegjëse; reagim institucional për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës, neglizhencës dhe abuzimit seksual, pasi forcimi i shëndetit fizik e emocional i fëmijëve nuk është vetëm një komponent kyç i promovimit të të drejtave të tyre, duke përfshirë interesin e tyre më të lartë, por ka edhe përparësi të jashtëzakonshme.

rekomandimet e ENOC¹¹⁶ drejtuar Këshillit të Evropës për të siguruar që të drejtat e fëmijës të garantohen në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara të të Drejtave të Fëmijës dhe Komentet e Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës, si dhe përvoja e fituar gjatë menaxhimit të situatës së pandemisë COVID-19, të shërbejë si mësim për menaxhimin e çdo situatë emergjence dhe krize në të ardhmen. Këto rekomandime të ENOC, do të bëjnë të mundur hartimin dhe nxjerrjen e udhëzimeve të Këshillit të Evropës, të cilat do të pasqyrojnë një qasje gjithëpërfshirëse strategjike për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave të fëmijës në situata krizash dhe emergjence.

Sikundër, Komisioneri për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve ka marrë pjesë aktive në shumë veprimtari, në të cilat ka prezantuar qasjen institucionale të Avokatit të Popullit, orientuar drejt dy komponentëve kryesore:

së pari, ndarjen e përvojës dhe praktikave të mira të punës;

së dyti, parashtrimin e problemeve dhe shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimeve/monitorimeve dhe sesioneve informuese në terren.

Në lidhje me ndarjen e përvojës dhe praktikave të mira të punës, ndër veprimtaritë kryesore të organizuara përmendim tryezë për lancimin e botimit miqësor “*Fëmijët dhe të drejtat e tyre*”, me rastet pozitive të trajtuara nga Avokati i Popullit¹¹⁷ dhe 19 veprimtari promovuese “*Ditë të hapura*” me pjesëmarrjen e nxënësve, mësuesve dhe prindërve në rang vendi¹¹⁸.

Në lidhje me parashtrimin e problemeve dhe shkeljeve të konstatuara gjatë inspektimeve/monitorimeve dhe sesioneve informuese në terren, ndër veprimtaritë kryesore, të organizuara, përmendim: tryezë pune, për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për garantimin e të drejtave të të miturve në konflikt me ligjin, viktimat dhe/ose dëshmitar gjatë periudhës së pandemisë¹¹⁹; tryezë pune për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve për mbrojtjen e fëmijës në nivel vendor¹²⁰; pjesëmarrja në takimet *online* në zbatim të projektit ENYA¹²¹, pjesëmarrja e Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve dhe e të riut L.B., përfaqësues i vendit tonë në ENYA 2021, në Forumin e të Drejtave Themelore (FRA) për të mësuarit për të ardhmen; ndikimi i COVID-19 në të drejtat e fëmijëve, etj. Përmes zhvillimit

¹¹⁶ Rekomandimet e konferencës vjetore të Rrjetit ENOC, në datë 27.9.2021, me temë: “*Covid-19 dhe të drejtat e fëmijëve: Të mësuarit për të ardhmen*”. Kjo konferencë kishte qëllim/fokus kryesor të drejtat e fëmijëve në situatën e pandemisë Covid-19: si dhe sa ka ndikuar Covid-19 në ushtrimin e të drejtave.

¹¹⁷ Në datën 18 nëntor 2021 u realizua lancimi i botimit, me pjesëmarrjen e gjerë të fëmijëve dhe të rinjve, institucioneve të administratës shtetërore, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare.

¹¹⁸ Këto veprimtari kanë synuar informimin e nxënësve mbi rolin e Avokatit të Popullit dhe nxitjen e bashkëpunimit me këtë institucion, informimin e nxënësve, prindërve dhe mësuesve për/rreth të drejtave të fëmijëve dhe mënyrën si ushtrohen ato, administrimit të ankesave/kërkesave drejtpërdrejt nga fëmijët, prindërit dhe mësuesit, si dhe dëgjimin e zërit të fëmijëve për çështje dhe problematika të ndryshme.

¹¹⁹ Në zbatim të planit të punës së marrëveshjes, ndërmjet Avokatit të Popullit dhe UNICEF-it janë organizuar 6 inspektime në komisarate/stacionet e Policisë së Shtetit dhe institucionin e privimit të lirisë, ku gjetjet dhe rekomandimet janë prezantuar në datën 28.7.2021, në këtë tryezë.

¹²⁰ Kjo tryezë u realizua në 24 nëntor 2021, në formatin hibrid dhe në të morën pjesë përfaqësues nga 61 bashkitë e vendit, përfaqësues nga grupi i deputetëve të KRSH-së, “*Miqte e Fëmijëve*”, përfaqësues nga ministrinë e linjës, Shërbimi Social Shtetëror, organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e fëmijëve.

¹²¹ The European Network of Young Advisors 2021: “Let’s Talk Young, Let’s Talk About the impact of Covid -19 on children's rights”. Institucioni i Avokatit të Popullit është përzgjedhur për herë të dytë në këtë projekt të rëndësishëm të ENOC, ku pjesëmarrës në mes të fëmijëve nga vende të ndryshme të botës, ishin dhe dy fëmijë si përfaqësues të vendit tonë.

të veprimtarive me karakter informues dhe ndërgjegjësues kemi synuar që të drejtat e fëmijëve të respektohen dhe të trajtohen me të gjithë kujdesin e duhur dhe të nevojshëm për moshën e tyre, në interesin më të lartë për ta.

Në kuadër të ndërgjegjësimit dhe advokimit për rolin që Avokati i Popullit luan në drejtim të promovimit të të drejtave të fëmijëve janë organizuar një sër aktivitetesh promovuese dhe paraqitje studimesh që lidhen me fushën..

Në cilësinë e përfaqësuesit të institucionit të Avokatit të Popullit, për promovimin e të drejtave të fëmijëve, SMPDF ka marrë pjesë në mënyrë aktive në konferencën vjetore *online* të Rrjetit ENOC, me temë diskutimi “*Covid dhe të drejtat e fëmijëve: të mësuarit për të ardhmen*”.

Edhe gjatë vitit 2021, Avokati i Popullit nëpërmjet Komisionerit ka luajtur një rol proaktiv me pjesëmarrjen në mediat vizive dhe të shkruara, për ndërgjegjësimin, edukimin dhe informimin e publikut me problematikat e identifikuar, adresimin e zgjidhjeve të këtyre problematikave nga organet përgjegjëse të administratës shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe detyrimin kushtetues dhe ligjor, që organet shtetërore të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, kanë për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit ¹²².

3.16 Respektimi i të drejtës për kujdes shëndetësor¹²³

E drejta e shëndetit përmban të drejta në të cilat përfshihet (i) e drejta për një sistem të kujdesit shëndetësor që krijon mundësi të barabarta për secilin për të patur nivelin më të lartë të mundshëm të shëndetit, (ii) e drejta e parandalimit, trajtimit dhe kontrollit të sëmundjeve, (iii) e drejta e aksesit në mjekësinë bazë, (vi) kujdesi për nënën, fëmijën dhe shëndetin riprodhues, (v) e drejta e aksesit të njëjtë dhe në kohë në shërbimet shëndetësore bazë, (vi) e drejta e informimit dhe edukimit shëndetësor, (vii) e drejta e pjesëmarrjes së popullsisë në vendimmarrjen lidhur me shëndetin në nivel kombëtar dhe komunitar, (viii) e drejta e mosdiskriminimit që përbën parimin kyç në të drejtat e njeriut dhe është parimi kryesor në gëzimin e të drejtës në standardin më të lartë të mundshëm në shëndetësi.

Qëllimi kryesor i aksesit të barabartë në kujdesin shëndetësor të të gjitha grupeve shoqërore, është reduktimi, ose minimalisht mos thellimi më tej i pabarazisë shëndetësore ekzistuese. Të dhënat tregojnë se individët, pjesëtarë të grupeve më vulnerabël të popullsisë, kanë më shumë nevojë për kujdesin shëndetësor. Rezulton se pjesëtarët e grupeve më vulnerabël të popullsisë kanë përqindje të larta të sëmundshmërisë dhe shëndet të keq, dhe është pikërisht kjo kategori që nuk marrin gjithmonë kujdesin shëndetësor për të cilin kanë specifikisht nevojë. Pabarazia është e pranishme pothuajse kudo dhe mund të shpjegohet me një sërë pengesash gjeografike, financiare dhe social-

¹²² Pjesëmarrja në emisionin “*Historia ime*” në televizionin kombëtar Klan, për të diskutuar rreth abuzimit seksual të të miturve dhe mbrojtjen e tyre; pjesëmarrja në emisionin “*Për të fol*” Scan TV, me temë kriminalitetin te të miturit, një dukuri shqetësuese vitet e fundit në vendin tonë dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në monitorimin e zbatimit në praktikë të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur; pjesëmarrja në televizionin A2CNN, për të diskutuar rreth dukurisë negative të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve dhe trafikimit të tyre për qëllime përfitimi; pjesëmarrja në televizionin A2CNN dhe në televizionin Euronews Albania, për situatën në rritje të rasteve të abuzimit seksual te fëmijët; intervistë për UNICEF Shqipëri, me temë “*Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të fëmijëve - në zemër të Avokatit të Popullit*”.

¹²³ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

kulturore. Barra e pagesës për kujdesin shëndetësor, është një shqetësim në rritje për grupet vulnerabël.

Me një qasje e cila ka në fokus të saj respektimin e të drejtave të njeriut dhe pacientit, përfshirë pacientët pjesëtarë të grupeve vulnerabël, të sanksionuara shprehimisht në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe në përmbushje të tagrit të tij ligjor, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2021 e në vijim problematikat e bëra prezente, qoftë nëpërmjet ankesave të ndryshme të depozituara pranë institucionit, por edhe ato të evidentuara në rastet e bëra publike në median e shkruar dhe online dhe ka adresuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale disa problematika të qënësishme të bëra publike në media nga profesionistë të sistemit shëndetësor, intelektualë e akademikë, me qëllim mundësimin e ushtrimit efektiv të së drejtës së qytetarëve për kujdes shëndetësor dhe akses të barabartë në këto shërbime.

Referuar ankesave të regjistruara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2021, rezulton të jenë *regjistruar 70 ankesa*, nga të cilat *40 rezultojnë të jenë raste të bazuara në investigimet “ex-officio”*, si pasojë e implementimit me sukses të mekanizmit të monitorimit mbi bazë ditore dhe konstatimit të problematikave të bëra publike në mediat tradicionale dhe ato *on line*, përmes grupeve të punës të ngritura posaçërisht. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se *për 65 ankesa* është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa të tjerat vijojnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave apo rasteve me iniciativë të shqyrtuara, rreth 50 prej tyre rezultojnë të jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të parashtruara nga ata në objektin e ankesës.

Ankesat/rastet me iniciativë evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: (i) trajtimi mjekësor jo konform standardeve për shumë sëmundje të ndryshme, përveç Covid 19, (ii) burokraci lidhur me rradhët e pritjes në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë “Nënë Tereza” (QSUT), (iii) mungesa e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në shumë qendra shëndetësore në vend për shkak të amortizimit të këtyre të fundit, si dhe (iv) mungesa e personelit, respektivisht atij mjek dhe infermier.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka nisur me iniciativë përgjatë vitin 2021 çështjen e identifikimit të kategorive përfituese dhe impaktin financiar (në drejtim të lehtësimit të barrës financiare) që gjeneroi tek qytetarët e infektuar me Covid- 19, miratimi i Vendimi të Këshillit të Ministrave nr.908, datë 18.11.2020 “*Për miratimin e Paketës së Barnave për Trajtimin ambulator në banesë të Personave të Diagnostikuar me COVID-19*”, duke adresuar pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (“MSHMS”), rekomandimet e mëposhtme:

- *Zgjerimin e paketës së barnave për trajtimin ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID-19, duke përfshirë në të analizat laboratorike dhe ekzamimet imazherike për diagnostikim dhe monitorim të ecurisë klinike të pacientit;*
- *Garantimin e dhënies së ofrimit pa asnjë diskriminim të shërbimit shëndetësor duke përfshirë si kategori përfituese edhe individët e diagnostikuar me Covid -19, për periudhën Mars-Nëntor 2020, përpara hyrjes në fuqi të VKM-së nr.908, dt.18.11.2020 , si dhe të pacientëve,*

pas hyrjes në fuqi të kësaj VKM-je, por që janë konfirmuar pozitiv me tampon nga institucionet shëndetësore private. Gjetjen e mekanizmave përkatës për të mundësuar rimbursimin e këtyre shpenzimeve.

- *Marrjen e masave për gjetjen e instrumentave për ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuere për qytetarët përfitues të rimbursimit nga shteti të paketës së ilaçeve të Covid 19.*

Për këto rekomandime nuk është kthyer asnjë përgjigje nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Referuar rasteve specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, të cilat janë finalizuar me hartimin e rekomandimeve përkatëse për vitin 2021, spikasin ato sa më poshtë, drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, (“MSHMS”):

- *Rekomandim për marrjen e masave dhe gjetjen e mundësive për kryerjen e testit laboratorik në një vend evropian, e më pas rimbursimin financiar tërësor apo pjesor të pacientëve që vuajnë nga fibriomialgjia për diagnostikimin, trajtimin dhe kurimin e kësaj lloji sëmundjeje të rrallë në vendet më të zhvilluara dhe të avancuara në kurimin e kësaj sëmundjeje. (Ky rekomandim nuk është pranuar)*
- *Rekomandim për gjetjen e hapësirave ligjore për të siguruar sa më shpejt të jetë e mundur, medikamentet për fëmijët me leuçemi, duke evituar vuajtjen dhe dhimbjen e panevojshme për pacientët, sidomos kur bëhet fjalë për fëmijët, që janë një kategori prioritare që duhet të gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. (Ky rekomandim është pranuar)*
- *Rekomandim për marrjen e masave të menjëherëshme për dhënien e shpërblimit financiar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim, për stafin e urgjencës të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë sipas detyrimit ligjor të përcaktuar në VKM-në nr.207, dt.10.03.2020. (Ky rekomandim është pranuar)*

Gjithashtu institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar edhe ankesën e shtetasit N.Z me profesion infermier i cili, në kundërshtim flagrant me të gjitha parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, u transferua në një qendër shëndetësore larg vendbanimit të tij, megjithëse ishte person me aftësi të kufizuara, dhe për më tepër përgjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Lidhur me këtë rast, institucioni ynë i rekomandoi Operatorit të Kujdesit Shëndetësor Vlorë, sa më poshtë:

- *Shfuqizimin e aktit administrative, konkretisht Urdhrit nr. 128 datë 06.04.2021, të Operatorit Shëndetësor Rajonal Vlorë, për transferimin e z.N.Z me detyrë infermier nga Qendra Shëndetësore Qesarat, Tepelenë në Qendrën Shëndetësore Luftinj, Tepelenë. (Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar)*

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2020 dhe detyrave të lëna për vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet rezolutës së miratuar më 07.07.2021, i ka kërkuar institucionit të Avokatit të Popullit: *Monitorimin e ofrimit të shërbimeve shëndetësore në spitalet rajonale të Shqipërisë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore të ofruara falas për qytetarët dhe adresimin e kundërvajtjeve sistematike.*

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në rezolutën e sipërcituar, përgjatë 6 mujorit të dytë të vitit 2021, filloi punën për hartimin e një raporti, duke vlerësuar se monitorimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore në spitalet rajonale (me qëllim identifikimin e saktë të problematikave të cilat ato shfaqin dhe adresimin adekuat dhe me mjetet e duhura për tejkalimin e tyre), kërkon ekspertizë teknike e specifike.

Institucioni ynë në bashkëpunim me ekspertë/profesionistë të sistemit shëndetësor hartoi raportin me objekt: *“Hulumtim mbi ofrimin e kujdesit shëndetësor në disa nga spitalet rajonale dhe bashkiake në Shqipëri për periudhën Tetor-Nëntor 2021”.*

Raporti evidenton aspektet kyçe të situatës së ofrimit të shërbimeve shëndetësore në spitalet rajonale dhe problematikat që manifestohen për ofrimin e tyre. Analiza vlerësuese e institucionit të Avokatit të Popullit përmbyllet me ofrimin e rekomandimeve për përmirësimin e situatës së ofrimit të shërbimeve në spitalet rajonale dhe bashkiake në vitet në vijim.

Rekomandimet u drejtohen autoriteteve shqiptare në nivelin qendror dhe lokal me qëllim përmirësimin e performancës në spitalet rajonale dhe bashkiake në Shqipëri, të listuara si më poshtë:

- Më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet shërbimeve të urgjencave lidhur me organizimin e punës, rishikimin e kompetencave të stafit të urgjencës, sigurimin e stafit të mjaftueshëm, të specializuar, për të dhënë këtë lloj shërbimi.
- Të vlerësohet edhe një herë organizimi i punës në urgjencën jashtëspitalore, lidhur me delegimin e thirrjeve. Do të ishte mirë të aktivizoheshin dispeçeritë në rrethe, për të shmangur problemet në komunikim (mosnjohja e terrenit, adresave dhe dialektizmat), me qëllimin e vetëm shkurtimin sa më shumë të jetë e mundur të kohës së përgjigjes për dhënien e ndihmës së parë ndaj pacientëve, që është vendimtare në shpëtimin e jetës apo në prognozë.
- Të gjithë protokollet e mjekimit në spitale duhet të përditësohen dhe të miratohen sipas procedurave dhe rregullave në fuqi. Spitalet kishin protokolle të vjetra, që nuk mund të aplikohen.
- Karta e të drejtave të pacientit duhet të jetë e afishuar në çdo ambjent të spitalit që aksesohet nga pacientët. Ajo duhet të jetë e afishuar në formate të mëdha, me qëllim që të jetë e lexueshme. Spitalet duhet të hartojnë strategji që t'u bëjnë të njohur pacientëve të drejtat e tyre. Pothuajse të gjithë të intervistuarit në spitale pohojnë se pacientët nuk i njohin të drejtat e tyre.
- Sistemi i ankesave dhe i kutisë së ankesave në spitale duhet të rregullohet me akt të posaçëm si rregullore ose urdhër dhe të ketë një regjistër të veçantë për administrimin e tyre.

- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale duhet të marrë masa për të plotësuar mungesat në personel mjekësor. Në të gjithë spitalet kishte nevoja imediate për mjekë specialistë, si pediatër, obstetër-gjinekologë, reanimatorë, kirurgë, kardiologë, hematologë, urgjentistë, toksikologë, neurologë, radiologë, etj
- Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale duhet të ofrojë programe trajnimi për stafin mjekësor infermieror. Stafin mjekësor që “vjen” nga portalet është shpesh herë i papërshtatshëm për vendin e punës dhe i patrajnuar.
- Sistemi i informacionit shëndetësor duhet të shtrihet në të gjithë spitalet. Ky sistem duhet të përmbajë jo vetëm elementë që përshkruajnë gjendjen shëndetësore të pacientëve dhe të kujdesit ndaj tyre por edhe shumë elementë menaxherialë.
- Të shihet mundësia e lidhjes në rrjet të të gjitha farmacive spitalore, çka do të lehtësonte komunikimin mes tyre, do të rriste kontrollin, do t'u përgjigjej në kohë reale kërkesave që mund të vinë nga spitale të ndryshme, duke shkurtuar maksimalisht kohën e përgjigjes.
- Rritja e pagave për stafin mjekësor duhet të bazohet në vlerësimin e performancës, bazuar kjo në tregues të matshëm të punës së tyre.
- Buxhetet e spitaleve nuk duhet të jenë buxhete historike, por të kalohet në hartimin e buxhetit dhe alokimin e shpenzimeve bazuar në nevojat reale të spitaleve, në vlerësimin e performancës së ofrimit të shërbimeve shëndetësore të parashikuara për çdo spital, si dhe në realizimin e treguesve të shërbimit spitalor.
- Planifikimi i zërave të buxhetit në shëndetësi bazuar në performancën dhe aktivitetin e çdo spitali do të çojë në plotësimin gjithmonë e më të mirë të kërkesave të tyre, duke ndikuar në autonominë dhe fleksibilitetin e menaxherëve shëndetësorë për të marrë vendime për të përmirësuar ofrimin efikas të shërbimeve shëndetësore.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar përpjekjet e vazhdueshme të institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e pandemisë Covid -19, shprehet se është i domosdoshëm vijimi i angazhimit të qeverisë për një menaxhim më të kujdeshëm e më efektiv, i orientuar drejt një qasjeje e cila synon ofrimin e të gjitha shërbimeve të kujdesit shëndetësor në cilësinë e duhur.

Institucioni i Avokatit të Popullit, vlerëson se mekanizmat e përgjegjësisë janë thelbësore për të siguruar se janë respektuar detyrimet e shtetit që rrjedhin nga zbatimi i të drejtës për kujdes shëndetësor. Monitorimi dhe vënia para përgjegjësisë e shtetit, arrihet nëpërmjet mekanizmave administrative, politike, gjyqësore si dhe duke përfshirë në proces një numër aktorësh siç janë, OJF-të e ndryshme, institucionet kombëtare në mbrojtje të të drejtave të njeriut si dhe vetë qytetarët të cilët po ndërgjegjësohen për të drejtën e tyre për një kujdes të denjë shëndetësor.

Shteti mban përgjegjësi dhe luan një rol aktiv ndikues në faktorët e tjerë ekonomiko-sociale që ndikojnë në shëndetin si dhe në krijimin e infrastrukturës materiale dhe njerëzore për diagnostikimin dhe luftimin e sëmundjeve si dhe përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit.

3.17 Respektimi i të drejtës për arsimim¹²⁴

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë e ka përfshirë të drejtën për arsim si të drejtë kushtetuese në kreun e lirive dhe të drejtave ekonomike e social-kulturore. E drejta kushtetuese për tu arsimuar shihet si e drejtë detyrë, ku në njërin anë të gjithë gëzojnë mundësinë për t'u arsimuar e në anën tjetër, parashikohen disa detyrime për ta jetësuar këtë të drejtë, detyrime të cilat bien mbi shtetin, prindërit por dhe vetë fëmijët. Prindërit kanë detyrim për të regjistruar fëmijët e tyre në shkollë, për të ndjekur të paktën ciklin e detyrueshëm me ligj. Ndërsa mekanizmit shtetëror i lind detyrimi të sigurojë infrastrukturën e nevojshme falas për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtës për arsim.

Arsimi për të gjithë ka qenë gjithashtu një pjesë integrale e axhendës së zhvillimit të qëndrueshëm, por ka fituar më shumë vëmendje në Axhendën për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030, ku qëllimi i katërt i referohet: “*Sigurimit të arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë, dhe promovimit të mundësive të të nxënësve gjatë gjithë jetës për të gjithë*”. Ai thekson eliminimin e pabarazive gjinore në arsim dhe sigurimin e aksesit të barabartë për të gjitha nivelet e arsimit dhe trajnimin profesional për fëmijët vulnerabël. Gjithashtu, axhenda bën thirrje për krijimin dhe përmirësimin e strukturave arsimore që janë të ndjeshme ndaj fëmijës, aftësisë së kufizuar dhe çështjeve gjinore, dhe që ofrojnë mjedise të nxënësve të sigurta, jo të dhunshme, gjithëpërfshirëse dhe efektive për të gjithë .

Gjatë dekadës së fundit janë bërë një sërë përpjekjesh për të promovuar dhe mundësuar një mjedis të nxënësve gjithëpërfshirës në shkollat fillore dhe të mesme në Shqipëri, dhe shumë prej këtyre përpjekjeve synonin arsimin parauniversitar. Qeveria e Shqipërisë ka një Ligj relativisht të ri për Arsimin Parauniversitar (2012) dhe akte normative (Dispozitat Normative, 2013), që përcaktojnë bazën për rishikimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin Parauniversitar.

Nga pikëpamja e aksesit në arsimin e lartë në Shqipëri vërehen disa përparime, gjithësesi, edhe pse diskriminimet e hapura dhe ligjore që ekzistojnë nuk evidentohen më, një sërë diskriminimesh, më të fshehura, por po aq problematike, vijojnë. Studentët potencialë nga komunitetet e marginalizuara, personat me aftësi të kufizuara si dhe ata që vijnë nga grupe social-ekonomike të varfra e të izoluara përballen me pengesa të qenësishme për të pasur akses në arsimin e lartë. Vënia në zbatim e programeve të ‘targetuara’ për të adresuar vështirësitë e tyre, është tashmë domosdoshmëri e detyrim (megjithëse një sipërmarrje jo e lehtë as strukturalisht dhe as financiarisht), dhe një hap i rëndësishëm në rrugën e konsolidimit dhe zgjerimit të aksesit në arsimin e lartë në Shqipëri.

Në kuadër të tagrit të tij ligjor, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2021 e në vijim, problematikat sa i përket të drejtës për arsimim, të bëra prezent, qoftë nëpërmjet ankesave të ndryshme të depozituara pranë institucionit, por edhe ato të evidentuara në rastet e bëra publike në mediane dhe shkruar dhe *online*.

Referuar ankesave të regjistruara nga Institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2021, rezultoi të jenë regjistruar rreth 100 ankesa, nga të cilat 70 rezultojnë të jenë raste të bazuara në investigimet “*ex-officio*”, si pasojë e implementimit me sukses të mekanizmit të monitorimit mbi bazë ditore

¹²⁴ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

dhe konstatimit të problematikave të bëra publike në mediat tradicionale dhe ato *online*, përmes grupeve të punës të ngritura posaçërisht.

Ankesat/rastet me iniciativë evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore të tilla si: (i) mangësitë dhe hendeqet e krijuara në pajisjen me njohuritë e duhura të nxënësve dhe studentëve, si pasojë e zhvillimit të procesit të mësimdhënies on line, përgjatë një periudhe të konsiderueshme kohore të vitit shkollor 2020-2021, (ii) vështitëritë e përshtatjes dhe rikthimit të fëmijëve me kohë të plotë në shkolla në semestrin e parë të vitit 2021.

Problematikë serioze e trashëguar edhe nga viti pararendës dhe e evidentuar në një pjesë të konsiderueshme të ankesave individuale të depozituara pranë institucionit tonë, vijon të jetë punësimi jo mbi bazë meritokracie e arsimtarëve.

Në fokus të veçantë të punës së institucionit përgjatë vitit 2021, janë vënë edhe pretendimet e shumta në numër të studentëve të cilët nuk e pritën me entuziazëm, dhe protestuan mbi vendimin e Komitetit Teknik të Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (“MSHMS”), të vaksinimit të detyrueshëm, si kusht për t’u mundësuar atyre lejimin e frekuentimit të procesit mësimor në auditore.

Vijon të raportohet edhe përgjatë vitit 2021 si problematikë, procesi i akordimit të bursave të studentëve, të parashtruar në ankesat individuale të depozituara pranë institucionit tonë, ankesa të cilat janë adresuar për zgjidhje në administratat e Rektoratit, Universiteteve dhe Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, rezulton se për 90 ankesa është përmbyllur shqyrtimi, ndërsa të tjerat vijojnë ende të jenë në proces hetimi administrativ. Në numrin e ankesave apo rasteve me iniciativë të shqyrtuara, rreth 65 prej tyre rezultojnë të jenë zgjidhur në favor të qytetarëve dhe problematikave të parashtruara nga ata në objektin e ankesës.

Referuar rasteve më specifike të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për të cilat hetimi administrativ është përmbyllur me hartimin e rekomandimit përkatës për vitin 2021, do specifikonim rekomandimin drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, (“MASR”) mbi rastin e ndërmarrë me iniciativë me objekt: *Nxënësit e Mjeshtrisë Sportive të Futbollit pa fushë, paguajnë me lekë fushën për të kryer stërvitje*”. Institucioni ynë rekomandoi sa më poshtë:

- *Marrjen e masave të menjëherëshme për kompensimin financiar të pagesave të nxënësve të shkollës së mesme të mjeshtrisë Sportive “Loro Boriçi”, Tiranë për periudhën shtator-dhjetor 2020. (Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar)*
- *Marrjen e masave të menjëherëshme për arritjen e marrëveshjes me FSHF-në dhe nëse nuk arrihet kjo marrëveshje, mbulimin e shpenzimeve financiare për nxënësit që zhvillojnë stërvitje në fushat e kësaj të fundit. (Ky rekomandim është pranuar dhe zbatuar)*

Nje problematikë tjetër e trajtuar dhe finalizuar me hartimin e rekomandimit përkatës, rezultoi të ishte edhe ankesa e shtetasit B.D nga qyteti i Fierit, i cili u largua nga puna si mësues për arsye

politike, gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, në kundërshtim të hapur me aktet nënligjore në fuqi mbi largimet nga puna në periudhë zgjedhore. Në këtë rast, institucioni ynë i rekomandoi Zyrës Vendore Arsimit Parauniversitar Fier sa më poshtë:

- *Shfuqizimin e aktit administrativ, konkretisht të Vendimit nr.1, datë 11.03.2021 “Për zgjidhjen e menjëherëshme të kontratës së Punës”, për z. B D. (Ky rekomandim është refuzuar)*

Një problematikë e cila vlen të evidentohet, pasi ka marrë trajtën e një problematike përfaqësuese për arsimtarët në proces punësimi, e trajtuar dhe përmbyllur me rekomandim nga institucioni ynë, është edhe ai zonjës D.Xh e cila edhe pse ishte renditur e para në portalin “Mësues për Shqipërinë”, emërimi i saj zvarritej nga administrata e Bashkisë Fier. Për këtë rast institucioni rekomandoi:

- *Marrjen e masave nga ana e Bashkisë Fier për sistemimin sa më parë në një vend pune afatgjatë dhe pranë vendbanimit për shtetasen zj. D. Xh, si një detyrim ligjor i bazuar mbi meritokracinë dhe si një nënë me dy fëmijë në ngarkim, për të ushtruar profesionin e nderuar të mësuesit, në një frymë sa më të shëndetshme. (Ky rekomandim është pranuar por nuk është zbatuar)*

Gjithashtu institucioni ynë ka trajtuar me rekomandim edhe ankesën e shtetasit M.F të cilit i ishte mohuar dhënia e gradës shkencore Prof.As.Dr nga ana e Universitetit të Sporteve Tiranë. Saktësisht iu adresua Universitetit të Sporteve, Tiranë, rekomandimi përkatës, duke kërkuar sa më poshtë:

- *Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e tyre për vijimin e procedurës për dhënien e titullit Prof.Asociuar për z. M. F., sipas kriterëve të përcaktuara në legjislacionit në fuqi në momentin e dorëzimit të dosjes së tij në Këshillin e Profesorëve.*
- *Përcjelljen e Rekomandimit të Këshillit të Profesorëve nr. 15, datë 02.03.2015, shoqëruar me një kopje të plotë të dosjes përkatëse, pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (Ky rekomandim është refuzuar nga Universiteti i Sporteve.)*

Në funksion të mandatit të tij të promovues, institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2021, ka konsoliduar edhe më tej bashkëpunimin me Organizatat e Shoqërisë Civile që operojnë në fushën e së drejtës për arsim, përmes pjesëmarrjes aktive në shumë aktiviteteve *on line*, në të cilat janë bërë prezente studime, raporte dhe monitorime në institucionet arsimore. Vlen për t’u përmendur në veçanti aktivitetet e zhvilluara nga projekti i BE-së "Edukimi për Qytetari Demokratike", në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në kuadër të projektit “Forcimi i Edukimit për Qytetari Demokratike në Shqipëri”, financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke vlerësuar përpjekjet e shtetit shqiptar për parandalimin e pandemisë Covid 19 edhe në sistemin arsimor, nëpërmjet politikave të ndjekura, në një përballje jo të lehtë si për mësuesit të pa trajnuar me mësimdhënien *on line*, ashtu edhe për nxënësit për nxënien dhe përfitim të këtyre njohurive në formë dhe përmbajtje të pa njohura dhe perceptuara më parë, konstaton se mbetet shumë punë ende për të bërë në lidhje me vijueshmërinë e trajnimeve dhe përshtatjen e teksteve shkollore, gjetjen e teknologjive sa më të aksesueshme jo vetëm për nxënësit e zonave urbane por edhe atyre rurale. Gjithashtu mbetet sfidë edhe gjetja e mekanizmave

financiare për mbështetjen dhe motivimin e mësuesve të arsimit parauniversitar, sidomos të asaj armate mësuesish që ushtrojnë këtë profesion të nderuar në zonat e thella rurale të vendit.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson nevojën e vijimit të reformave të thelluara në shtimin arsimor, me synim zgjidhjen e problematikave sistematike dhe sporadike me të cilat ballafaqohet dukshëm sot ky sistem, në funksion të garantimit *de facto* të së drejtës për arsim cilësor të të gjithë qytetarëve që jetojnë në Republikën e Shqipërisë.

3.18 Respektimi i të drejtës për kujdes social¹²⁵

Programi që shënjestron varfërinë është Ndihma Ekonomike (NE) përkufizuar në ligjin nr.57/2019 si “*pagesa që u jepet individëve dhe familjeve vulnerabël të përcaktuara në ligj*”. Të dhënat e fundit të Matjes së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës në Shqipëri (INSTAT, AANJ 2020) tregojnë se individët thellësisht të privuar materialisht *përbëjnë 21.8 % të popullsisë*. Vlerësohet se niveli i varfërisë ose përjashtimit social në Shqipëri, pra i individëve në rrezik varfërie ose thellësisht të privuar materialisht, ose me intensitet shumë të ulët në punësim, është rreth *46.2% e popullsisë* (INSTAT, ABF 2019).

Në kuadrin e politikave sektoriale, Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2020 – 2023) ka si vizion të përgjithshëm ndërtimin e sistemit të mbrojtjes sociale për të luftuar pabarazitë social-ekonomike me politika dhe mekanizma për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë ose të përjashtuar përmes programeve parandaluese dhe riintegritimit social të kombinuara me skemat e punësimit. Kjo strategji ashtu si dhe Strategjia Kombëtare e Barazisë Gjinore (2021-2030) dhe Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara (2021-2025), ndajnë parimin “*askush të mos mbetet pas*”, duke qendëruar barazinë, mbrojtjen e riintegritimit social të viktimave të dhunës apo të personave me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht miratimit të kuadrit ligjor, zbatimi në praktikë i programit të ndihmës ekonomike ka rezultuar sfidues nga këndvështrimi i përfitimit të pagesës së ndihmës ekonomike nga ana e kategorive përfituese.

Referuar rasteve të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, jo vetëm ankesa apo kërkesa të shtetasve, por dhe raste *me iniciativë*, të cilat burimin e kishin nga publikimi në mediat vizive, të shkruara, por edhe *online*, për vitin 2021, rezultojnë të jenë *trajtuar gjithsej 38 raste*, të cilat evidentuan ekzistencën e problematikave kryesore, të tilla si: mospërfitimi i ndihmës, pezullimi dhe ndërprerja e përfitimit të ndihmës ekonomike, si dhe paqartësia e qytetarëve për arsyet e mospërfitimit apo mospërfshirjes së tyre në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike.

Masa e ndihmës ekonomike vijon të raportohet nga qytetarët në ankesat e tyre edhe përgjatë vitit 2021, si **shumë e ulët** në raport me shpenzimet mujore më të domosdoshme për të mbijetuar, e jo më pastaj të synojë të zbusë varfërinë dhe të mundësojë integritimin social të individëve dhe familjeve, çka përbën edhe objektivin kryesor të këtij instrumenti të mbrojtjes sociale. Avokati i

¹²⁵ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Popullit vlerëson ndërhyrjet e kufizuara në kohë në lidhje me dyfishimin e ndihmës ekonomike, gjithsesi vlera mbetet e ulët.

Trajtimi i këtyre ankesave, kërkesave apo rasteve me iniciativë me organet e administratës vendore ka rezultuar jo vetëm me sqarimin e ankuesve lidhur me shkaqet ligjore të ndërprerjes apo të mospërfitimit të ndihmës së kërkuar, sugjerimet përkatëse mbi periudhën e riaplikimit, por edhe në dërgimin e rekomandimeve përkatëse për këto organe të administratës shtetërore¹²⁶.

Shqipëria është ndër vendet që nuk e ka të përcaktuar ligjërisht minimumin jetik, e thënë ndryshe sa i duhen minimalisht një shqiptari për të jetuar. Në programet e mbrojtjes sociale që gjen rregullimin e veçantë në ligjin nr.57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, është dhe ofrimi dhe shpërndarja e ndihmës ekonomike.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e konsideruar si të pajustificueshme në qasjen e tij mungesën e përcaktimit të një minimumi jetik, i cili duhet të qëndrojë në themel të hartimit të politikave sociale që ndjek shteti për grupet në nevojë, ka përgatitur raportin e veçantë “Për Standardin e Minimumit Jetik në Shqipëri”, i cili mund të konsultohet në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit¹²⁷.

Raporti ka synuar dhënien e një vlerësimi të situatës ekonomike, ligjore dhe sociale, sa i përket situatës së mospërcaktimit të minimumit jetik si përkufizim dhe si bazë, jo vetëm për ndihmën ekonomike, por edhe për politikave të tjera në mbështetje të individëve dhe familjeve të varfra në Shqipëri. Objektivat e raportit janë dhënia e një panorame aktuale të situatës ekonomike dhe të varfërisë në Shqipëri, si dhe projektimi i nivelit të minimumit jetik; analiza e legjislacionit, politikave të mbrojtjes sociale, si dhe ndihmës ekonomike dhe vlerësimi nëse këto zhvillime përputhen me parimin e “jetës me dinjitet” në zbutjen e varfërisë dhe riintegrimin e grupeve të cenueshme; si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e ndikimit të ndihmës ekonomike në zbutjen e varfërisë dhe riintegrimin në shoqëri të përfituesve të saj.

Bazuar në analizën e kryer, është arritur në përfundimin se vlera e minimumit jetik për vitin 2019 në Shqipëri është përafërsisht 17, 875 Lekë. Vlera e përlogaritur në këtë studim e minimumit jetik në Shqipëri është 9,9 % më e lartë sesa pensioni minimal për zonat urbane, 37,5 % më e lartë se pagesa e papunësisë dhe rreth 3 herë më e lartë se ndihma ekonomike, ndërsa është 45,5 % më e ulët sesa paga minimale.

Minimumi jetik duhet të sigurojë jetesë dinjitoze me shërbimet bazike dhe duhet t’u mundësojë qytetarëve që të marrin pjesë aktive në shoqëri, pavarësisht nga aftësia e tyre për të punuar¹²⁸. Legjislacioni duhet të parashikojë format dhe mjetet se si duhet të aplikohet ky minimum, deri sa të mundësojë që çdo qytetar të përfitojë lehtësisht një garanci të tillë dhe të mos mjaftohet vetëm

¹²⁶ Për shembull, shkresa me nr.202002323, datë 3.3.2021 drejtuar Bashkisë Shkodër “Rekomandojmë të kryhet verifikimi i gjendjes social-ekonomike të shtetasës M. O nga administratori shoqëror dhe akordimin e ndihmës ekonomike nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”; shkresa me nr.202003298, datë 3.2.2021 drejtuar Bashkinë Dibër “Rekomandojmë marrjen e masave për ndihmën e menjëhershme lidhur me strehimin dhe fuqizimin ekonomik të familjes të A.P”.

¹²⁷ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Minimumi%20jetik%20ok.pdf>.

¹²⁸ Raporti sugjeron ndryshimin e ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” dhe përfshirjen si dispozitë të veçantë të përkufizimit të minimumit jetik.

me përcaktimin e vlerës shifrore të këtij koncepti. Përlllogaritja e minimumit jetik dhe masa e tij duhet të jetë bazë për masën e ndihmës ekonomike. Rritja e pagesës së ndihmës ekonomike është e nevojshme të bëhet dhe të reflektojë nevojat e individëve dhe familjeve jo vetëm për ushqim, por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor. Me synimin e mospërrjashtimit të kategorive që mund të përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, kemi sugjeruar thjeshtëzimin e kategorizimit të individëve dhe familjeve dhe që minimumi jetik të përdoret në themel të hartimit të politikave sociale për shtresat në nevojë dhe si referencë për të përcaktuar edhe ndihmën ekonomike dhe pagesën e papunësisë.

Masa e ndihmës ekonomike që sigurohet me ligj, nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet për ushqimin, por edhe për aktivitete të tjera të zhvillimit njerëzor për individët dhe familjet kur ata kanë nevojë për mbrojtje sociale. Ky raport u lançua për diskutim në një konferencë¹²⁹ me përfaqësuesen e përhershme të PNUD në Shqipëri, ekspertët e angazhuar në përpilimin e këtij Raporti, përfaqësues nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe INSTAT.

Edhe përgjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se varfëria vijon të mbetet një problematikë e mprehtë në nivel kombëtarë dhe se varfëria nuk është vetëm mungesë e të ardhurave por edhe mungesë shërbimesh dhe pjesëmarrjeje në shoqëri, të cilat janë thelbësore për gëzimin e të drejtave të njeriut. Varfëria si shkak, por edhe si pasojë e shkeljeve të të drejtave të njeriut, duhet të adresohet në kontekstin e detyrimeve të shtetit për respektimin e garantimin e të drejtave të njeriut.

3.19 Respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuar¹³⁰

Sikundër vitet pararendëse, edhe përgjatë vitit 2021, mbështetja e respektimit të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, si një ndër grupet e cënueshme, ka qënë në fokusin e punës së institucionit të Avokatit të Popullit. Nga këndvështrimi i cënueshmërisë, personat me aftësi të kufizuara janë ajo pjesë e shoqërisë, e cila e ka të domosdoshme mbështetjen e vazhdueshme nga shteti, për t'iu respektuar e garantuar të drejtat dhe liritë themelore, si dhe aksesin dhe përshtatjen e arsyeshme në çdo fushë të jetës.

Referuar ankesave të regjistruara në për vitin 2021, rezulton të jenë *trajtuar 53 ankesa*, kryesisht raste të bazuara në investigimet “*ex-officio*”. Nga numri total i ankesave të administruara dhe trajtuara, është përmbyllur hetimi administrativ për 45 ankesa, ndërsa 8 ankesa janë ende në proces shqyrtimi. Nga numri total i ankesave të shqyrtuara, *28 ankesa rezultojnë të zgjidhura pozitivisht në favor të qytetarëve*.

Ankesat/rastet me iniciativë evidentuan ekzistencën e problematikave të tilla si: mungesa e mjeteve të jetesës, duke i ekspozuar individët me aftësi të kufizuar drejt varfërisë dhe mbijetesës, problematika e qasjes në infrastrukturën rrugore për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar në shikim, etj.

¹²⁹ Në bashkëpunim me zyrën e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillimin (PNUD) në Shqipëri, me datë 28.7.2021.

¹³⁰ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Problematikë e spikatur dhe trajtuar me precedencë gjatë këtij viti, është ajo e mosmarrjes së përgjigjes nga ana e personave me aftësi të kufizuar për datën e vlerësimit të rastit nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, si strukturë kompetente për vlerësimin e tyre, me qëllim përfitimin e grupit të invaliditetit.

Pas ndërhyrjes sonë institucionale pranë Shërbimit Social Shtetëror (SHSSH), konstatohet një sjellje e përmirësuar administrative e këtij institucioni, duke njoftuar rregullisht ankuesit për datën përkatëse të vlerësimit në KMCAP-in Epror/SHSSH-së. Për kategorinë e personave, të cilët me vendim të vlerësimit në KMCAP-in Epror/SHSSH-së, rezultojnë jo përfitues të grupit të invaliditetit, është përcjellë informacioni i detajuar ligjor për të drejtën e tyre të rivlerësimit.¹³¹

Institucioni i Avokatit të Popullit, edhe këtë vit ka trajtuar një problematikë të raportuar ndër vite nga qytetarët, ende e pazgjidhur, siç është ajo e mosdhënies së detyrimeve të prapambetura, për periudhën 2005-2010, personave me aftësi të kufizuar kryesisht të qyteteve Korçë e Pogradec, për shkak të mosindeksimit të pagesës së aftësisë së kufizuar. Deri në vitin 2004, indeksimi i pagesave të aftësisë së kufizuar, i ardhur si pasojë e rritjes së pagës minimale, është zbatuar plotësisht. Për periudhën 2005-2010, ky indeksim rezulton se është llogaritur me shumë mangësi, duke krijuar rrjedhimisht diferenca të papaguara. Pavarësisht depozitimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë me objekt: *“Saktësim dhe njohje detyrimi të prapambetura, duke përlllogaritur vlerat taksuese për çdo paditës për shkak të aftësisë së kufizuar të kujdestarisë, papunësisë dhe shkollimit, verbërisë si dhe shpërblim dëmi”*, kjo e drejtë e tyre nuk është zbatuar nga ana e pushtetit vendor.

Pas ndërhyrjes sonë institucionale pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, jemi informuar se ky institucion ka akorduar fondin prej 296.705.000 lekë për 20 (njëzet) Bashki gjatë vitit 2021.¹³²

Një problematikë e evidentuar, shqyrtuar dhe raportuar më herët, është edhe e mosnxjerrja e akteve nënligjore në zbatim të nenit 6/pika 3 dhe nenit 7/pika 3 të Ligjit nr.93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*, i ndryshuar, për shërbimet për jetesë të pavarur dhe vendimarrjen e mbështetur.

Në vijim të shqyrtimit të kësaj çështje, informohemi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ka finalizuar projektaktet për të përmirësuar jetesën e personave me aftësi të kufizuar, që përfitojnë nga shërbimet dhe vendimarrja e mbështetur, duke respektuar parimet e ligjit nr.93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*. Nisur nga nevojat e identifikuara nga analiza ligjore si dhe duke marrë në konsideratë situatën e krijuar nga pandemia Covid-19, është konkluduar nga ky institucion se projektaktet e hartuara do të shtrohen për diskutim publik brenda një afati të shkurtër kohor.

Një problematikë përfaqësuese, e trajtuar dhe e përmyllur me hartimin e rekomandimit përkatës, është edhe mosdhënia e kompensimit financiar të faturës së energjisë elektrike për vitin 2016 shtetases F.K, në Njësinë Administrative Pezë,

¹³¹ Rregullore “Për Organizimin, të Drejtat, detyrat dhe Funkcionimin e Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë, për vlerësimin e personave me aftësi të kufizuara dhe Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë”

¹³² Më datë 17.12.2021 Bashkisë Korçë i janë akorduar 7.605.000 lekë dhe Bashkisë Pogradec 22.740.000 lekë për diferencat e papaguara, të krijuara si rezultat i mosindeksimit të pagesës së aftësisë së kufizuar.

Duke çmuar se nuk janë respektuar të drejtat e ligjshme të përfituesve të kompensimit financiar për shpenzimet e energjisë elektrike në Njësinë Administrative Pezë, me mosveprim të vazhdueshëm dhe të pajustificuar nga ana e organe përgjegjëse, i jemi drejtuar Bashkisë Tiranë, me rekomandimin:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për garantimin e të drejtave ligjore të mohuara dhe të identifikuar nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë sipas Akt-Kontrollit nr.1103/1 datë 12.10.2018 për alokimin e fondit të nevojshëm për shlyerjen e pagesave të prapambetura të shpenzimeve të energjisë elektrike për vitin 2016 të përfituesve pranë Njësisë Administrative Pezë, në listën e së cilës bën pjesë edhe shtetësja F.K. (Për këtë rekomandim nuk është kthyer asnjë përgjigje nga Bashkia Tiranë)*

Në praktikën e konsoliduar të punës së institucionit të Avokatit të Popullit është edhe kryerja e monitorimit të procesit zgjedhor, duke patur si qëllim kryesor evidentimin e problematikave potenciale dhe marrjen e masave përkatëse me qëllim garantimin e të drejtës së votës për personat që përfshihen në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara.

Për krijimin e kushteve lehtësuese për aksesin e personave me aftësi të kufizuara në Qendrat e Votimit, në zbatim të planit të punës për monitorimin e aksesueshmërinë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit në disa qytete të Shqipërisë, në kuadër të Zgjedhjeve të Përgjithshme 2021 në Shqipëri, u zhvilluan inspektime në mjediset e përcaktuara si qendra votimi, gjatë periudhës 02.04.2021 – 25.04.2021, për të identifikuar:

- ✓ *Vendosjen e rampave për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë;*
- ✓ *Përshtatshmërinë e infrastrukturës (sinjalistika me shirita të verdhë) për personat me aftësi të kufizuara në shikim;*
- ✓ *Për të garantuar votimin e pavarur dhe të fshehtë për personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe personave të verbër, fleta e votimit të jetë me shkrimin Brail.*

Përpos monitorimeve fizike të infrastrukturës së qendrave të votimit, për garantimin e së drejtës së votës të personave me aftësi të kufizuara, adresuam në Komisionin Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rekomandimin si më poshtë:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, të Udhëzimit nr.1 datë 5.12.2020, “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të miratuar nga Komisioni Rregullator, në KQZ. Shtimin e parashikimeve të detajuara në këtë udhëzim, të cilat kanë të bëjnë me krijimin e lehtësive për votimin e personave PAK në qendrat e votimit, si dhe për çështjet e tjera të parashtruara nga ana jonë në këtë rekomandim.*
- *Parashikimin e një mekanizmi efektiv për kontrollin e përmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e organeve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të cilët qëllimjnë krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit, për ushtrimin lirisht të së drejtës së votës nga ana e personave me aftësi të kufizuara.*

Në përgjigje të rekomandimit të përcjellë nga institucioni ynë, informohemi se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të problemeve të hasura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25 Prill 2021, lidhur me infrastrukturën mbështetëse e cila ngrihet tërësisht sipas një mekanizmi, kriteresh, afatesh dhe ndërveprimi institucional të mirëpërcaktuar, për krijimin e lehtësive për votimin e personave me aftësi të kufizuara, në qendrat e votimit.

Në tagrim e tij ligjor, institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion monitorues për zbatimin e ligjit nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara” në përputhje me Konventën e OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, ka konstatuar se në një ndërthurje të problematikave të parashtruara në ankesat e adresuara dhe rasteve të marra me iniciativë, qasja në infrastrukturën ndërtimore për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar në lëvizje dhe shikim rezultojnë të jetë tejet problematike e prezente në të gjitha qytetet e Shqipërisë.

Axhenda e miratuar në samitin e Kombeve të Bashkuara, “Për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2015 - 2030”, objektivin nr.9¹³³ përpos promovimit të industrializimit gjithëpërfshirës e nxitjes së inovacionit, e lidh edhe me ndërtimin e infrastrukturës elastike (fleksibël).

Personat me aftësi të kufizuar, përveç vështirësisë të identifikuar në aksesin e tyre në trotuare dhe kryqëzime, vijojnë të përballen me barriera të cilat i krijojnë pengesë që në hyrje të institucioneve publike për marrjen e shërbimeve, si pasoje e mungesës së përshtatjes infrastrukturore/ndërtimore për ta.

Për këtë qëllim, në përputhje me planin e punës “Për monitorimin e aksesueshmërisë në infrastrukturë të personave me aftësi të kufizuar në institucionet shtetërore, ku ofrohen shërbime për qytetarët”, u hartua një listë me institucionet shtetërore, objekt monitorimi. Në përmbyllje të procesit të inspektimeve, në muajin Dhjetor 2021, u hartuan rekomandimet përkatëse ndaj institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe vendor, duke rekomanduar shprehimisht:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për realizimin e infrastrukturës ndërtimore, sipas standardeve të elementëve të përshtatshmërisë, duke përfshirë në këtë proces edhe vetë personat me aftësi të kufizuar.*¹³⁴

Me të njëjtin vizion, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar edhe Institucione Rezidenciale të Përkujdesit Shoqëror, ku janë të akomoduar persona me aftësi të kufizuar, duke monitoruar në mënyrë periodike masat e marra për mbrojtjen nga përhapja e Covid-19, duke zhvilluar një korrespondencë të shtuar me Shërbimin Social Shtetëror dhe drejtuesit e institucioneve, sa i përket çështjes së vaksinimit të përfituesve dhe stafit të institucioneve rezidenciale.

¹³³ Objektivi 9. Ndërtimi i infrastrukturës elastike, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm dhe nxitja e inovacionit.

¹³⁴ Rekomandim drejtuar Bashkisë Durrës/Ujësjellës Kanalizime Durrës; Bashkisë Tropojë/Ujësjellës Kanalizime Tropojë; Bashkisë Korçë/Ujësjellës Kanalizime Korçë; Bashkisë Pogradec/ Ujësjellës Kanalizime Pogradec; Bashkisë Lezhë/ Ujësjellës Kanalizime Lezhë; Bashkisë Elbasan/ Ujësjellës Kanalizime Elbasan; Bashkisë Dibër/ Ujësjellës Kanalizime Dibër; Bashkisë Kukës/ Ujësjellës Kanalizime Kukës; Bashkisë Berat; Bashkisë Përmet; Prefekturës Gjirokastrë; Prefekturës Durrës; Postës Shqiptare Sh.a; Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Referuar përgjigjeve të depozituara pranë institucionit, konfirmohet fakti se procesi i vaksinimit është kryer sipas protokolleve të miratuara, dhe nuk ka patur probleme të shfaqura tek përfituesit dhe stafi.

Vijojnë të shfaqen si problematika të qëndrueshme në fushën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, të raportuara ndër vite, mungesa e aksesit në drejtësi, në marrjen e informacionit, në marrjen e shërbimeve, mungesa e aksesit në mjediset publike dhe private, moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar, moszbatimi i rimbursimit të biletës në transportin urban, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson se për të realizuar integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuar, është thelbësore dhe tejet e rëndësishme, barazimi i mundësive të tyre me ato të shoqërisë normale të një vendi.

3.20 Barazia gjinore dhe të drejtat e komunitetit LGBTIQ¹³⁵

Barazia gjinore

Institucioni i Avokati të Popullit vlerëson se gjendja aktuale e të drejtave dhe lirive të grave dhe vajzave në Shqipëri karakterizohet nga problematika të mprehta, sidomos në drejtim të pësimin të dhunës me bazë gjinore dhe asaj në familje, aksesit në drejtësi, punësimin dhe ofrimit të shërbimeve sociale.

Zhvillimi i aktiviteteve promovuese e ndërgjegjësuere që evidentojnë problematikën tashmë të shprehura në fushën e mbrojtjes dhe respektimin e të drejtave të grave, (si pjesë integrale e të drejta të njeriut), të shoqëruara edhe me sugjerime apo rekomandime për mënyrën e adresimit dhe zgjidhjes adekuate të tyre, kanë një vlerë të shtuar dhe ndikim të drejtëpërdrejtë tek komuniteti i grave e vajzave në vendin tonë.

Kjo, pasi në Shqipëri, ende nuk ekziston një kulturë e shoqërisë që të orientojë individët të adresojnë institucionin e Avokatit të Popullit, me ankesa në të cilat të parashtrihen pretendimet e tyre në lidhje me mosrespektimin apo shkeljen e të drejtave për shkak të gjinisë. Sa më sipër, reflektohet dhe në numrin e kufizuar të ankesave me këtë objekt, të depozituara dhe të trajtuara përgjatë vitit 2021, në këtë institucion.

Viti 2021, si një vit ku pandemia vijoi të ishte prezente në mënyrë agresive, pati ndikim në të gjithë jetën ekonomike e sociale të shoqërisë, por me një problematikë më të shtuar për grupet vulnerable të saj, një nga të cilët janë edhe gratë e vajzat.

Nga perspektiva e institucionit të Avokatit të Popullit, në ushtrim të mandatit të tij, si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individit, konstatohet se problematikën më të spikatura përgjatë këtij viti, të identifikuar dhe që vijojnë edhe nga viti pararendës të tilla si; (i) humbja e vendit të punës; (ii) vështirësi në aksesin ndaj shërbimeve sociale e juridike; (iii) rritja e fenomenit të dhunës nga

¹³⁵ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

partnerët apo pjesëtarët e tjerë të familjes, e manifestuar kjo si dhunë në të gjitha format, fizike psikologjike e seksuale.

Referuar ankesave të rregjistruara për vitin 2021, rezulton se problematikat kryesore në nivel individual konsistojnë në (i) mospërfitim i ndihmës ekonomike apo mundësim i aksesit paralel të përfitimit të ndihmës ekonomike nga gratë viktime të dhunës në familje; (ii) mospunësim apo mohim i së drejtës për pension pleqërie; (iii) sigurim i aksesit në drejtësi për gratë dhe vajzat; (iv) ekzekutimin e vendimeve gjyqësore; (vi) sigurimin e strehimit përmes bonusit të qirasë, etj.

Vëmendje të shtuar përgjatë vitit 2021, si vit zgjedhor, institucioni i Avokatit të Popullit i dedikoi garantimit të drejtave të grave e vajzave në proceset zgjedhore, të drejtës së tyre për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur. Përfaqësimi i grave në politikë mbetet ende një detyrim i papërbushur. Të dekurajuar për të marrë pjesë në politikë e kur marrin pjesë, të penguar e të neglizhuara, gratë edhe pse përbëjnë 50% të elektoratit e të popullatës, sërish duhet të bëjnë llogaritë me “kuotat gjinore” të cilat nuk reflektojnë me besnikëri përqindjen e tyre në shoqëri.

Përdorimi i një gjuhe seksiste dhe diskriminuese ndaj kandidateve gra, të partive politike, karakterizoi dukshëm fushatën elektorale të partive politike. I menjëhershëm ishte reagimi institucional i Avokatit të Popullit kundër përdorimit të kësaj gjuhe, përmes deklaratave të publikuara në faqen zyrtare të institucionit apo në rrjetet sociale, duke tërhequr vëmendjen se kjo lloj retorike e përdorur nga liderat politikë, ndikon në shndërrimin e urrejtjes dhe dhunës që buron prej kësaj urrejtje, në model sjelljeje për shoqërinë tonë.¹³⁶

Pjesëmarrja e institucionit nëpërmjet përfaqësuesve të tij në emisione televizive apo forume diskutimi ishte e shtuar, në të cilat u artikulua thirrja ndaj partive politike për distancim të menjëhershëm ndaj kësaj qasjeje, ndarje nga praktikatat sipërfaqësore të marrëdhënieve publike ku skandalizimi përdoret si mjet për devijim debati, me koston e dhunimit të dinjitetit të çdo qytetari e veçanërisht të grave, me impakt të drejtpërdrejtë negativ në shkatërrimin e standardeve të arritura me mund në respektimin e të drejtave të njeriut.

Mbështetja për pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë është dhënë kryesisht përmes reformave të politikave siç janë kuotat gjinore zgjedhore. Megjithatë, miratimi dhe zbatimi i reformave të barazisë gjinore, nuk është i mjaftueshëm. Gjithashtu kuotat mbeten kuota në lista e jo në përfaqësim, e kështu gratë në Kuvendin e Shqipërisë apo në institucionet publike politikëbërëse, mbeten të nënpërfaqësuar.

Duke e konsideruar si domosdoshmëri një analizë vlerësuese, mbi nivelin e përfshirjes dhe pjesëmarrjes së plotë të grave dhe vajzave në politikë, për të përcaktuar se çfarë ndodh në terma konkretë me gratë dhe vajzat kur i bashkohen politikës, institucioni i Avokati të Popullit në bashkëpunim me Komisionerin Për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me mbështetjen e UNDP-së, ndërmorën nismën për hartimin e raportit studimor “*Dhuna ndaj grave në politikë*”¹³⁷, duke

¹³⁶ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/neës/this-article-is-available-only-in-albanian-609/>

¹³⁷Raporti studimor i plotë <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/temp/VIOLENCE%20AGAINST%20WOMAN%20IN%20POLITIC.pdf>

vlerësuar se dhuna ndaj grave në politikë përbën shkelje të të drejtave të njeriut dhe përforcon marginalizimin e grave në politikë.

Raporti studimor bazohet në tri metoda të grumbullimit të të dhënave: ndarjen e historive, diskutimet në grup dhe zhvillimin e një ankete me kandidatët politikë për të adresuar këto pyetje: Çfarë tregojnë historitë e grave për përvojat e tyre të dhunës politike? Cilat janë llojet, motivet dhe ndikimet e dhunës politike? A ka dallime midis grave dhe burrave në lidhje me llojet e dhunës që ato përjetojnë?

Gjetjet e këtij raporti priten të diskutohen përgjatë këtij viti me grupet e interes, në funksion të plotësimit të tij nga pikpamja përmbajtësore edhe me opinionet e grupeve të interesit dhe në përmbyllje të raportit rekomandimet përkatëse do të adresohen pranë autoriteve shtetërore në nivel lokal dhe qendror.

Një problematikë tjetër e evidentuar nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe e referuar pranë tij gjatë vitit 2021, ka qenë edhe pamundësia e aksesit paralel të grave dhe vajzave në skemën e ndihmës ekonomike, sa i përket përfitimit të mbështetjes përkatëse ekonomike në cilësinë e viktimave të dhunës në familje dhe si përfituese të ndihmës ekonomike, si kategori në nevojë. Nga të dhënat e disponueshme, rezulton, se gratë dhe vajzat, viktima të dhunës në familje nuk mund të aksesojnë dhe përfitojnë në mënyrë paralele mbështetjen me ndihmë ekonomike si viktima të dhunës në familje, njëherë që janë të përfshira në programin e mbështetjes së ndihmës ekonomike si kategori në nevojë, nën motivacionin se i njëjti individ nuk mund të përfitojë njëkohësisht nga dy skema të mbështetjes me ndihmë ekonomike. Konstatohet se kjo praktikë aplikohet gjerësisht në të gjithë vendin, me disa përjashtime të papërfillshme.

Në këto kushte, viktimat e papuna të dhunës në familje janë vendosur në pozitë jo të favorshme krahasuar me viktimat e dhunës në familje që janë në marrëdhënie pune, duke u mohuar viktimave të papuna të dhunës në familje, në mënyrë të drejtpërdrejtë, mundësinë për të përfituar ndihmë ekonomike njëkohësisht si viktima të dhunës në familje dhe si kategori në nevojë.

Nisur nga kjo problematikë e identifikuar, institucioni i Avokatit të Popullit, pas takimit institucional me Drejtoren e Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, e adresoi këtë problematikë, së bashku me Komisionerin Kundër Diskriminimit në një raport vlerësues mbi zbatimin në praktikë të legjislacionit të ndihmës sociale, me fokus vlerësimin e aksesit paralel të përfituesve të mbështetjes financiare në skemën e ndihmës sociale.

Raporti, i iniciuar në vitin 2021, do të vlerësojë situatën aktuale të përfituesve të ndihmës ekonomike sipas Ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, më konkretisht të viktimave të dhunës që janë pajisur me Urdhër Mbrojtjeje, personave me aftësi të kufizuar si dhe përfituesve nga fondi 6% i bashkive.

Raporti synon vlerësimin e zbatimit në praktikë të legjislacionit dhe programit të ndihmës ekonomike me qëllim identifikimin e pengesave që cenojnë aksesin e familjeve në nevojë dhe individët me status të veçantë si dhe përdorimin e transfertave të ndihmës ekonomike. Vlerësimi synon të shërbejë për të nxitur përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetin e mbrojtjes sociale, duke

theksuar nevojën për rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse të administratës për zbatimin dhe vlerësimin periodik të politikave sociale në zbatim.

Gjetjet e këtij raporti priten të diskutohen përgjatë këtij viti me grupet e interesit në funksion të plotësimi të tij nga pikpamja përmbajtësore edhe me opinionet e tyre dhe në përmbyllje të raportit, rekomandimet përkatëse do të adresohen pranë autoriteve shtetërore në nivel lokal dhe qendror.

Një problematikë e spikatur dhe e trajtuar gjerësisht nga institucioni i Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2021, është edhe dhuna, ngacmimi dhe ngacmimi seksual në vendin e punës, si një nga format frekvente nëpërmjet së cilës manifestohet dhuna me bazë gjinore.

Ngacmimi seksual dhe dhuna seksuale konsiderohet të jetë një nga format e dhunës me bazë gjinore që fatkeqësisht është ende më pak e raportuara. Ngacmimi seksual në vendin e punës, konkretisht në administratën publike, përbën një shqetësim dhe fenomen akoma më negativ gjatë ushtrimit të tij, pasi në të përfshihen, përveç se shqetësimet individuale në lidhje me dinjitetin e personit, ashtu edhe cenohen marrëdhëniet e punës me objekt funksionimin e shtetit duke gjeneruar një pasojë të dyfishtë për këdo që bie pre e ushtrimit të këtij fenomeni nga ana e punëdhënësit.

Prania dhe toleranca ndaj fenomenit të abuzimit seksual në administratën publike, nëpërmjet abuzimit seksual të drejtuesve të saj, krijon një dëm të madh për vetë shoqërinë të cilën ajo drejton, cenon imazhin e saj në sytë e publikut dhe prek rëndë respektimin e të drejtave të njeriut. Është e dosmosdoshme që strukturat shtetërore dhe organet legjislative, të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për eliminimin e të gjitha formave të ngacmimit seksual në punë, duke nxitur dënimin e këtij fenomeni.

Me këtë qasje institucionale, Avokatit i Popullit, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike, të mbështetur nga UNDP, hartuan e Udhëzuesin "*Për Parandalimin dhe Adresimin e Dhunës, Ngacmimit dhe Ngacmimit Seksual në Mjedisin e Punës në Institucionet e Administratës Shtetërore*".¹³⁸

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është:

- ✓ Të angazhojë institucionet e administratës shtetërore për të krijuar, garantuar dhe promovuar një mjedis të sigurtë pune duke parandaluar, reduktuar dhe eliminuar çdo formë të dhunës, ngacmimit, ngacmimit seksual dhe abuzimit me autoritetin në vendin e punës.
- ✓ Të përcaktojë rregullat dhe procedurën/at për të parandaluar dhe adresuar dhunën, ngacmimin, ngacmimin seksual dhe abuzimin me autoritetin në vendin e punës.
- ✓ Të sigurojë për publikun mekanizmat për të adresuar dhunën, ngacmimin, ngacmimin seksual dhe abuzimin me autoritetin nga nëpunësit civilë gjatë ushtrimit të funksionit të tyre publik.
- ✓ Të ndërgjegjësojë nëpunësit civilë në administratën shtetërore për evidentimin më të lehtë dhe më të qartë të situatave që lidhen me ngacmimin, ngacmimin seksual dhe abuzimin me autoritetin në vendin e punës si dhe me mënyrat e teknikave të ndalimit dhe parandalimit të tyre.

¹³⁸ https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Udhezues_web.pdf

Nëpërmjet këtij dokumenti, çdo punonjës i administratës shtetërore njihet me hapat e nevojshëm për të adresuar, reduktuar dhe eliminuar çdo formë të dhunës apo ngacmimit në ambientet e punës.

Në kuadër të vlerësimit të veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2020 dhe detyrave të lëna për vitin 2021, Kuvendi i Shqipërisë, nëpërmjet rezolutës së miratuar më 07.07.2021, i ka kërkuar institucionit të Avokatit të Popullit hartimin e një raporti mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri.

Në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në rezolutën e sipërcituar, duke vlerësuar se monitorimi i situatës së dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri, është i një rëndësie jetike për nga përmasat që ka marrë tashmë fenomeni, institucioni Avokatit të Popullit me mbështetjen e UN Women, hartoi përgjatë vitit 2021 raportin “*Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri, për periudhën janar 2020-dhjetor 2021*”.

Raporti analizon informacionin që është dërguar nga institucionet kryesore përgjegjëse për të adresuar dhunën me bazë gjinore në nivel qendror dhe lokal, si dhe raporte të organizatave të shoqërisë civile dhe rekomandime të organizatave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në këtë fushë.

Raporti përfshin zhvillimet mjaft pozitive në fushën legjislative, por konstaton nevojën për hartimin e një legjislacioni më gjithëpërfshirës për të adresuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, nevojën për buxhetim të shërbimeve të specializuara, si dhe përmirësimin e legjislacionit penal në drejtim të veprës së marrëdhënieve seksuale me dhunë dhe forma të tjera dhune, të parashikuara në Konventën e Stambollit, në të cilën Shqipëria është palë. *Çështjet që lidhen me këtë raport, janë përmendur edhe në pikën 3, Kreun II të këtij raporti vjetor.*

Në kuadër të tagrit të tij ligjor monitorues, institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar përgjatë vitit 2021, nivelin e respektimit të drejtave të grave dhe vajzave, viktimave të dhunës me bazë gjinore përkatësisht në: (i) Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje dhe (ii) Qendrën për menaxhimin e krizës për rastet e dhunës seksuale “LILIUM”.

Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje është një institucion shtetëror, në varësi të Shërbimit Social Shtetëror. Kjo qendër funksionon në bazë të standardeve, procedurave dhe politikave të MSHMS sipas legjislacionit për sistemin e mbrojtjes shoqërore. Qëllimi i qendrës është mbrojtja, rehabilitimi dhe integrimi i vajzave, grave dhe fëmijëve, viktimave të dhunës në familje për t’i drejtuar për një jetë të pavarur.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson përmirësimin e kuadrit ligjor dhe mundësinë e ofrimit të një game të gjerë shërbimesh për gratë që strehohen në qendër.

Analiza e informacionit të grumbulluar përgjatë inspektimit të realizuar, u përmbyll me përcjelljen pranë institucioneve përkatëse të rekomadimit si me poshtë:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit, si dhe për garantimin e të drejtave të përfituesve në Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje.*¹³⁹

¹³⁹ 1. Plotësimin e organikës së QKTVDHF me punonjës me kohë të plotë: 2 punonjës social/menaxher rasti; 1 psikologe; 1 jurist; 2. Trajnimin e menjëhershëm dhe të vazhdueshëm të stafit të Qendrës, lidhur me standartet e shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, për viktimave të dhunës në familje, në Qendrat rezidenciale, publike dhe jopublike;

Qendra e parë për menaxhimin e krizës për rastet e dhunës seksuale “LILIUM”, u ngrit në 04.12.2018, me fonde të buxhetit të shtetit, në zbatim të rekomandimeve të CEDAW dhe Komitetit të Palëve e raportit të vlerësimit fillestar të GREVIO-s.

Në këtë qendër, ofrohet shërbim emergjent, me një ndalesë, 24/7 dhe afatshkurtër (24 - 72 orë), për viktimat/të mbijetuarit/mbijetuarat e dhunës seksuale dhe familjarët e tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit e vlerëson ngritjen e kësaj qendre, si shumë të nevojshme për të asistuar viktimat e dhunës seksuale. Po ashtu, vlerësohet edhe kuadri nënligjor për funksionimin e qendrës. Analiza e informacionit të grumbulluar përgjatë inspektimit të realizuar, u përmbyll me përcjelljen pranë institucioneve përkatëse të rekomadimit si me poshtë:

- *Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të trajtimit, si dhe për garantimin e të drejtave të përfituesve në Qendrën e menaxhimit, për rastet e dhunës seksuale, LILIUM.*¹⁴⁰

Në përgjigje të rekomandimeve të sipërcituara, informohemi se institucionet përgjegjëse të adresuara, vlerësojnë këto rekomandime të Avokatit të Popullit dhe kanë nisur zbatimin e tyre. Gjithashtu, statistikat mbi të drejtat e njeriut të cilat pasqyrojnë të dhëna sipas gjinisë mbi ankesat për pretendime shkeljeje të të drejtave, të trajtuara nga Avokati i Popullit sipas llojit të së drejtës, tashmë janë pjesë integrale dhe periodike e publikimit “*Burrat dhe Gratë në Shqipëri*” të INSTAT.

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar punën në funksion të promovimit të të drejtave të grave dhe vajzave dhe nxitjen e standardeve më të larta, përmes organizimit apo pjesëmarrjes në aktivitete dhe takime me organizatat e shoqërisë civile, gra e vajza nga grupe vulnerabël apo shpërndarjes së fletëpalosjeve me informacionet e nevojshme mbi legjislacionin dhe institucionet në mbrojtje të të drejtave të grave.

-
3. Sigurimin e fondeve për blerjen e veshmbathjeve për gratë dhe fëmijët;
 4. Sigurimin e fondeve për blerjen e materialeve didaktike, edukative e argëtuese si dhe librave për fëmijët;
 5. Sigurimin e fondeve të nevojshme për instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore të QKTVDHF;
 6. Organizimin e aktiviteteve argëtuese dhe edukative për përfitueset dhe për fëmijët e tyre;
 7. Sigurimin e transportit nga ana e Qendrës për lëvizjet e përfituesve dhe fëmijëve të tyre, sidomos kur ato kishin nevoja për marrjen e shërbimeve shëndetësore, etj;
 8. Vënien në mënyrë të menjëhershme në dispozicion të përfitueseve dhe fëmijëve të tyre të bibliotekës dhe lodrave e materialeve të tjera edukuese që kishte QKTVDHF;
 9. Vaksinimin anti-Covid të stafit të QKTVDHF dhe të përfitueseve të reja në vazhdimësi.
 10. Kryerjen më shpesh të monitorimit të aktivitetit të QKTVDHF nga Shërbimi Social Shtetëror.
- ¹⁴⁰ 1. Zbatimin e standardeve të miratuara për Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës Seksuale (LILIUM), në veçanti standartin bazë për ekzaminimin e rasteve në ambientet e Qendrës - pasi është cënuar parimin bazë i saj për “siguri dhe dinjitet njerëzor”.
2. Sigurimin dhe trajnimin e një stafi të dedikuar nga QSUT, përgjegjës për ofrimin e mbështetjes emergjente dhe vlerësimit psikologjik.
 3. Buxhetimit të shërbimeve të Qendrës nga QSUT dhe sigurimin e fondeve për blerjen e veshmbathjeve dhe të paketave higjieno-sanitare për përfituesit e shërbimeve në këtë Qendër.
 4. Instalimin menjëherë dhe bërjen funksionale të pajisjeve për kryerjen e intervistës (të cilat ishin blerë nga UNDP).
 5. Sigurimin e pajisjeve të cilat lehtësojnë ekzaminimin gjinekologjik dhe mjeko-ligjor brenda në Qendër.
 6. Sigurimin e një koordinimi të shërbimeve të tjera mjekësore që duhet të ofrohen për viktimat në qendër, si psh në rastet e traumave/goditjeve etj, viktimat duhet të referohet jo në QSUT por në Spitalin e Traumës.
 7. Referimin drejtpërdrejtë nga Policia në Qendër të rasteve të dhunës seksuale.
 8. Ngritjen e qendrave të tjera rajonale, të specializuara për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës seksuale, pasi një qendër për të gjithë vendin, është e pamjaftueshme dhe mund të jetë e vështirë për tu aksesuar nga viktimat e dhunës seksuale që jetojnë larg vendodhjes së saj.

Dhuna me bazë gjinore mbetet një plagë e hapur në jetën dhe në shoqërinë tonë. Ajo shfaqet jo vetëm në format më tradicionale por edhe në forma të reja, më të fshehura dhe sofistikuara dhe prek të gjitha shtresat e shoqërisë. Prandaj dhe lufta e përpjekjet për ta parandaluar atë duhen akoma dhe më të forta dhe më gjithëpërfshirëse me të gjithë aktorët e shoqërisë.

Media ka një rol shumë të rëndësishëm dhe është si një pikë hyrëse kyçe për promovimin e të drejtave të grave dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe veçanërisht në këtë periudhë kur daljet nga shtëpia apo takimet ishin më të kufizuara për shkak të situatës së pandemisë dhe kur e vetmja mundësi apo dritare komunikimi sigurisht që mbetej media, media e shkruar, elektronike apo media sociale.

Këtij qëllimi i shërbeu dhe Forumi i diskutimit “*Media, liria e fjalës dhe të drejtat e gruas*”, e organizuar më datë 8 Mars 2021, nga institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Autoritetin e Mediave Audiovizive, e mbështetur nga UN Women.

Raportin midis medias dhe të drejtave të grave, marrëdhënia e ndërlikuar midis së drejtës së medias për të qenë e lirë në raportimin e saj dhe të drejtës së gruas për t’u mbrojtur nga diskriminimi dhe portretizimet diskriminuese gjatë raportimit të episodeve të dhunës gjinore në media, ishte tema e këtij forumi diskutimi i cili gjeneroi edhe rekomandimet përkatëse për autoritetet shtetërore përgjegjëse.

Edhe përgjatë vitit 2021, institucioni i Avokati të Popullit i është bashkuar si çdo vit të gjitha aktivitetet e Fushatës Kombëtare të 16 Ditëve të Aktivizimit kundër dhunës me sloganin: “*Bëje Botën Portokalli: Të ndalim dhunën ndaj grave TANI!*”

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson punën e institucioneve përgjegjëse në drejtim të parandalimit dhe luftës kundër dhunës më bazë gjinore dhe dhunës në familje, por gjithashtu shpreh se do të vazhdojë të jetë i angazhuar në nxitjen e këtyre institucioneve për të bërë akoma edhe më shumë në respekt të standardeve më të larta të garantimit të të drejtave të grave e vajzave.

Të drejtat e komunitetit LGBTIQ

Megjithëse Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë garanton të drejtat dhe liritë themelore të çdo personi, komuniteti LGBTIQ vijon të përjetojë diskriminimin dhe intolerancën, të cilat ndeshen brenda familjes, për t’u përshkallëzuar më tej në shoqëri, ambjentet e punës, shkollës, e jetën publike në përgjithësi.

Nga këndvështrimi i institucionit të Avokatit të Popullit, vlerësojmë se, problematika më e shprehur e këtij komuniteti është vështirësia e të kuptuarit të diversitetit nga shoqëria dhe niveli i njohurive mbi komunitetin LGBTIQ.

Situata e personave LGBTIQ në Shqipëri rezulton të jetë më e favorshme në qytete të mëdha dhe veçanërisht në kryeqytet. Vërehet një tendencë e personave të rinj anëtarë të komunitetit, që të zhvendosen prej qyteteve të vogla drejt qyteteve të mëdha (kryesisht Tiranës), me qëllim gjetjen e mbështetjes në persona, grupime apo komunitete në situatë të ngjashme, për më shumë siguri, mundësi punësimi, mjedis fizik dhe kulturor më përfshirës.

Ofruesit e shërbimeve publike, në fushat e shëndetit, arsimit, zbatimit të ligjit, gjyqësorit, etj rezultojnë se jo gjithnjë e kuptojnë apo vlerësojnë në mënyrë korrekte bazën legjislative dhe zbatimin e të drejtave dhe detyrimeve të përcaktuara në të, sa i përket personave LGBTIQ. Për pasojë, ky komunitet vijon të jetë objekt i trajtimit jo të duhur në terma të marrjes së shërbimeve publike në kohën dhe në cilësinë e duhur.

Veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave që i përkasin komunitetit LGBTIQ për vitin 2021, ka vijuar e ndërthurrur në dy funksione kryesore, atë të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të këtij komuniteti.

Edhe përgjatë këtij viti, institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë maksimalisht i angazhuar në mbështetje të hapur të kërkesave të komunitetit për garantimin e të drejtave të tyre, duke nxitur institucionet shtetërore për të ndërmarrë politika në përputhje me standartet më të larta ndërkombëtare, si dhenë drejtim të promovimit të të drejtave të këtij komuniteti, duke sensibilizuar dhe ndërgjegjësuar shoqërinë se ky komunitet kërkon vetëm të drejta, të garantuara në Kushtetutën e Shqipërisë dhe që gëzohen qetësisht nga të gjithë, dhe jo një kategori të drejtash të hartuara e të implementuara ngushtësisht për këtë komunitet.

Përgjatë këtij viti, pas identifikimit të disa episodeve të ushtrimit të dhunës kundër disa aktivistëve për të drejtat e komunitetit si dhe pas agresionit fizik kundër një personi transgjnjor në Qershor të 2021, institucionit i Avokati i Popullit organizoi në mjediset e institucionit, një forum diskutimi mbi rolin e medias në adresimin e gjuhës së urrejtjes dhe promovimin e të drejtave të komunitetit LGBTIQ.

Në këtë aktivitet u evidentua dhe u nënvizua nevoja që të drejtat e çdo komuniteti përfshi ato të atij LGBTIQ, të trajtohen me paanësi e respekt në media si dhe u përcollën mesazhe solidarizimi me viktimat e dhunës nga radhët e komunitetit LGBTIQ. Gjithashtu, pjesëmarrësit në aktivitet ndanë konkluzionin se mosnjohja dhe mosinformimi mbi të drejtat e komunitetit LGBTIQ, janë shkaktarë të keqkuptimeve e gjuhës diskriminuese, gjuhë e cila frymëzon dhunë verbale e fizike në jetën e përditshme.

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka konsoliduar partneritetin e tij me institucionet si-motra dhe organizatat e shoqërisë civile, të cilat mbrojnë të drejtat e këtij komuniteti, duke luajtur rol proaktiv në të gjitha veprimtaritë e organizuara me qëllim ndërgjegjësimin e shoqërisë në lidhje me këto të drejta.

Në vazhden e sa më sipër ishte dhe organizimi në ditën ndërkombëtare (17 maj) kundër homofobisë, transfobisë dhe bifobisë, i një takimi të përbashkët online i Avokatit të Popullit të Shqipërisë, Avokatit të Popullit të Kosovës dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe shoqërisë civile të të dy vendeve. Qëllimi i këtij takimi ishte të konfirmonte edhe një herë se pavarësisht diferencave e diversitetit, ne jemi të gjithë të barabartë në terma të gëzimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Më tej, institucioni ka vijuar pjesëmarrjen aktive në takimet me organizatat e shoqërisë civile në mbrojtje të të drejtave të njeriut, përmes së cilës është synuar përcjellja e informacionit të

nevojshëm mbi legjislacionin në fuqi, mbi institucionet në mbrojtje të të drejtave të njeriut, orientimet e duhura për procesin si të kërkohet një e drejtë e shkelur apo e mohuar, etj.

Një problematikë e adresuar nga institucioni i Avokatit të Popullit, është edhe gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi, qënë të përditshmen ndodh që të gjejnë vend në gazeta, të gjejnë gjuhën e saj në gojën e politikanëve të caktuar, të gjejnë lehtësinë e saj në qytetarë që bëjnë komente të ndryshme në mediat sociale, çka krijon një situatë për të cilën institucioni Avokati i Popullit, si institucioni kryesor i mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, ka shprehur në vijimësi qëndrimin e tij në mbështetje të komunitetit LGBTIQ.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka mbështetur në vazhdimësi komunitetin përmes deklaratave dhe qëndrimeve publike të bëra prezente si në faqen zyrtare të institucionit, ashtu edhe në mediat vizive apo mediat sociale dhe vlerëson se problemi më i shprehur në lidhje me komunitetin LGBTIQ vijon të mbetet shkalla e ulët e ndërgjegjësimit të shtetit dhe shoqërisë lidhur me të drejtat e këtij komuniteti, e për pasojë hartimi i legjislacionit specifik mbi njohjen e identitetit gjinor të ndryshuar, ndryshimi i Kodit Penal dhe Kodit të Familjes, e ndërthurur dhe me aktivitete promovuese nga institucione në kompetencë të të cilave është kjo detyrë funksionale, është qasja e duhur për avancimin e mbrojtjes dhe të respektimit të të drejtave të këtij komuniteti.

3.21 Respektimi i të drejtave të personave të moshuar¹⁴¹

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion që garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, ka në prioritetet e punës së tij edhe mbrojtjen e të drejtave të të moshuarve, të cilët kategorizohen si një ndër grupet më vulnerabël dhe më të ekspozuar ndaj riskut të mosrespektimit dhe garantimit të të drejtave të tyre, të saksionuara në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar.

Në funksion të rolit të tij promovues, institucioni i Avokatit të Popullit, në vitin 2021, me rastin e *1 Tetorit, Ditës Botërore të të Moshuarve*, organizoi një takim në Shtëpinë e të Moshuarve Shkodër, me fokus rolin e institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të moshuarve.

Në kuadrin e monitorimit për respektimin e të drejtave të të moshuarve në Institucionet Rezidenciale të Përkujdesjes Sociale lidhur me masat e marra nga autoritetet shtetërore për parandalimin e përhapjes së Covid-19, si edhe në vitin pararendës, kemi kontaktuar gjatë gjithë kësaj periudhe pandemie me drejtuesit e Shtëpive të të Moshuarve Tiranë, Shkodër, Kavajë, Gjirokastrë, Fier, të Qendrës Polivalente Poliçan.

Në muajin *Shkurt 2021*, iu drejtua Drejtoreshës së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror, për planifikimin e bërë lidhur me vaksinimin e përfituesve dhe stafit të këtyre institucioneve rezidenciale të Përkujdesit. Referuar përgjigjeve të ardhura, procesi i vaksinimit ishte kryer rregullisht sipas protokolleve dhe nuk ka patur probleme të shfaqura tek të moshuarit dhe stafit.

Përpos kësaj, institucioni i Avokatit të Popullit, ka vijuar të monitorojë përgjatë vitit 2021 edhe nivelin e respektimit të të drejtave të të moshuarve, të cilët janë të akomoduar në Shtëpitë e të Moshuarve Gjirokastrë, Shkodër, Kavajë dhe Tiranë. Pas inspektimeve të kryera për këtë qëllim dhe evidentimit të problematikave, janë hartuar rekomandime konkrete të cilat i janë dërguar

¹⁴¹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

strukturave përkatëse shtetërore, Kryetarëve të Bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror, të cilat orientoheshin drejt përmirësimit të kushteve të jetesës dhe zbatimin sa më cilësor për përmbushjen e standardeve të përkujdesit shoqëror për të moshuarit.

Në funksion të një jetese sa më dinjitoze e në mënyrën më të mirë të mundshme, kemi rekomanduar, si edhe në vitet pararendëse, ngritjen e qendrave socio-sanitare, ku të trajtohen me përkujdesje të veçantë të moshuarit me probleme të rënda shëndetësore.

Nisur nga ankesa të caktuara, kemi evidentuar problematika që cenojnë më shumë se një individ. Është trajtuar ankesa e dy të moshuarve për mosdhënien e së drejtës për të aplikuar për pajisjen me pasaportë biometrike pas afatit 10-vjeçar të përdorimit.

Nga shqyrtimi i çështjes, u konstatua se këta të moshuar, të vetmuar dhe me probleme shëndetësore, janë pajisur me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011 dhe me shumë vështirësi paraqiten në zyrat ALEAT për riaplikim, duke iu kërkuar që përpara aplikimit për datën e paraqitjes në ato zyra, duhet të aplikojnë si për herë të parë në platformën online e-Albania.

Në muajin Shkurt 2021, i sugjeruam Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit përjashtimin nga aplikimi on-line në platformën e-albania për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuar në lëvizje dhe shikim, të cilët janë pajisur njëherë me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011.

Në analizë të akteve të nxjerra për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë biometrike, kemi konstatuar se Udhëzimi nr.289 datë 02.09.2020 “*Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë*”, i ndryshuar së fundmi më datë 16.12.2020, në pikën 2 ka përcaktuar:

“2. Shtetasi, i cili aplikon për herë të parë për t’u pajisur me pasaportë biometrike sipas gërmës a të pikës 1 të këtij udhëzimi, plotëson on-line nëpërmjet portalit e-albania, formularin e vetëdeklarimit me fotografi. Formulari i vetëdeklarimit on-line i përcillet elektronikisht Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Formularin e vetëdeklarimit on-line, e plotësojnë dhe shtetasit që nuk aplikojnë për herë të parë, të cilët janë pajisur me pasaportë biometrike para datës 31.12.2011”.

Në këtë akt nënligjor janë përfshirë të gjitha kategoritë e shtetasve shqiptarë, pa përjashtuar asnjë grup shoqëror, kategorinë e të moshuarve dhe me probleme shëndetësore, të cilët, përpos faktit të vështirësisë për aplikim të formularit të vetëdeklarimit, duhet të shkojnë për të plotësuar edhe një nga procedurat për pajisje me pasaportë biometrike, fotografitë.

Për t’u ardhur në ndihmë të gjithë shtetasve, të cilët e kanë të pamundur të aplikojnë në portalin e-Albania, në muajin Shkurt 2021 i rekomanduam Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile përjashtimine tyre nga aplikimi online në platformën e-Albania.

Nga ana e dy institucioneve u vlerësua se konstatimet dhe sugjerimet e institucionit të Avokatit të Popullit qenë të drejta dhe gjetën zbatim në nxjerrjen e Urdhërit nr.488, datë 28.05.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “*Për zbatimin e Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm*

nr.289 datë 02.09.2020 “Për përcaktimin e procedurës për pajisjen me pasaportë biometrike të shtetasve shqiptarë”.

Në pikën 5 të këtij Urdhëri, është parashikuar që të gjithë shtetasit, të cilët kanë pamundësi plotësimin e formularit të vetëdeklarimit për pajisje me pasaportë nëpërmjet portalit e-Albania, mund të aplikojnë fizikisht në zyrat e Komisarariatit të Policisë, ku aplikuesi është i regjistruar në Regjistrin Themelr të Gjendjes Civile.

Avokati i Popullit ndër vite ka insistuar për miratimin e Statusit të Moshës së Tretë, për të garantuar të drejtat e të moshuarve, për të mbështetur plotësisht dhe efektivisht pjesëmarrjen e të moshuarve në shoqëri, bazuar në nevojat dhe preferencat e tyre.

3.22 E drejta e minoriteteve (pakicave) kombëtare¹⁴²

Gjendja e të drejtave të minoriteteve kombëtare edhe gjatë vitit 2021, ka qenë pjesë e vëmendjes së shtuar institucionale, me një konsiderim të veçantë ndaj të drejtave të ligjshme të minoritetit kombëtar Rom dhe atij Egjiptian, të cilët janë përballuar me një situatë të rënduar, për shkak të vazhdimit të pandemisë së Covid-19.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar të jetë një institucion proaktiv në ndërhyrjet e kryera me anë të rekomandimeve, në nivelin sistemik të zgjidhjes së çështjeve dhe të mënyrës se si administrata publike dhe shoqëria jonë duhet të konsiderojnë dhe ofrojnë zgjidhje, për barazinë, përfshirjen dhe integrimin e pakicave kombëtare jo vetëm në një situatë normale por edhe në kushte të pazakonta dhe sfiduese për vet shtetin dhe shoqërinë. Rol të rëndësishëm në këtë konsiderim ka luajtur identifikimi i çështjeve konkrete nga media dhe shtypi i shkruar dhe shqyrtimi i tyre me iniciativën tonë.

Për t’u gjendur sa më afër individëve dhe komuniteteve pjesë e minoriteteve kombëtare, ka vazhduar shtimi i kontakteve “*on line*” me individët që kanë dashur të paraqesin ankesat e tyre në institucionin tonë, si dhe është intensifikuar bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse, të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në kuadër të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të minoriteteve kombëtare.

Gjatë vitit 2021 janë trajtuar me *iniciativë 8 çështje*, për problematika që i përkasin komuniteteve përkatëse apo edhe individëve pjesëtarë, të minoriteteve (pakicave) kombëtare, në të gjithë vendin, si dhe janë marrë në shqyrtim *4 ankesa individuale*.

Theksojmë se, në shumë ankesa të tjera të trajtuara nga ana e Avokatit të Popullit, janë identifikuar çështje të tjera të ngritura nga individë pjesëtarë të minoriteteve kombëtare, por që nuk identifikohen drejtëpërdrejtë në kuadër të të drejtave komunitare të minoriteteve kombëtare, apo edhe të të drejtave të ligjshme individuale, për shkak të qënies pjesëtar në një minoritet kombëtar. Këto ankesa vazhdojnë të vijnë me objekt ankimi të drejtën për strehim, të drejtën për punësim, të drejtën për të përfituar nga sistemi i përkujdesjes shoqërore si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në tërësi.

¹⁴² Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Vend të rëndësishëm kanë zënë rekomandimet që kanë të bëjnë me një qasje sistemike ndaj problematikave të konstatuara. Më konkretisht janë përgatitur dhe dërguar këto rekomandime:

- ✓ Rekomandim për përsheptimin e procesit të vendimmarrjes ndaj vetëdeklarimeve për legalizim të kryera nga individë, me përkatësi në minoritetin kombëtar Rom dhe atë Egjiptian.¹⁴³
- ✓ Rekomandim për përmirësime të nevojshme në qasjen dhe aksesin ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.¹⁴⁴
- ✓ Rekomandim për përmirësimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.361 datë 29.05.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”.¹⁴⁵

Sjellim në vëmendje faktin se, vazhdon të mbetet aktual në objektin e tij rekomandimi i Avokatit të Popullit për përmbylljen e procesit të nxjerrjes së akteve nënligjore, në bazë dhe për zbatim, të Ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.¹⁴⁶

Sikurse kemi konstatuar në vazhdim, me miratimin dhe hyrjen në fuqi, të ligjit nr.96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, deri në fund të vitit 2021, janë hartuar dhe miratuar 8 akte nënligjore nga 12 të parashikuara si të tilla nga ligji. Më konkretisht, katër vendime në fushën e arsimit, dy vendime mbi pjesëmarrjen në jetën publike, sociale, kulturore, dy vendime mbi krijimin dhe funksionimin e Komitetit të Pakicave Kombëtare. Ndërkohë mbeten ende për t’u miratuar dhe hyrë në fuqi edhe 4 akte të tjera nënligjore.¹⁴⁷

Edhe në vitin 2021, të kushtëzuar nga kushtet e pandemisë së covid-19, ka vazhduar pjesëmarrja e gjerë në shumë aktivitete të organizuara “on line”, nga OJF të ndryshme në mbrojtje të të drejtave të pakicave kombëtare, si dhe nga institucione përgjegjëse shtetërore, ku është analizuar dhe diskutuar gjendja e të drejtave të minoriteteve kombëtare.

Me një vëmendje të veçantë ndaj minoritetit kombëtar Rom dhe minoritetit kombëtar Egjiptian, gjatë këtij viti kemi konstatuar se ankesat e trajtuara si dhe çështjet e filluara me iniciativë nga ana e Avokatit të Popullit kanë të bëjnë kryesisht me të drejtën për përkujdesje shëndetësore dhe trajtim

¹⁴³ Ky rekomandim i është dërguar me shkresën tonë nr. K1/Q3-11 datë 20.01.2021, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

¹⁴⁴ Ky rekomandim i është dërguar me shkresën tonë Nr. K1/I201-5 date 4.05.2021, Operatorit të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik.

¹⁴⁵ Ky rekomandim i është dërguar me shkresën tonë Nr. K1/I132-2 datë 17.12.2021, Kryetarit të Këshillit të Ministrave.

¹⁴⁶ Drejtuar me shkresën Nr. K1/I10-2 datë 25.02.2020, Kryetarit të Këshillit të Ministrave dhe Kryetarit të Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve

¹⁴⁷ Duhet të miratohen dhe hyjnë në fuqi në vazhdim:

1. Projektvendimi “Për përcaktimin e përbërjes, funksioneve dhe procedurës së Komisionit për shqyrtimin e kërkesës për njohjen e pakicës kombëtare (pakicave të reja, krahas pakicave të njohura me ligjin nr.96/2017)”.

2. Projektvendimi “Për mënyrën e përdorimit të gjuhës së pakicave kombëtare në marrëdhëniet ndërmjet personave që i përkasin pakicave kombëtare dhe organeve të vetëqeverisjes vendore”.

3. Projektvendimi “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe procedurave për mbledhjen/verifikimin e të dhënave për përkatësinë e personave në një pakicë kombëtare”. Ky projektvendim ka si qëllim garantimin e parimit të vetë-identifikimit të personave që u përkasin pakicave dhe verifikimi i të dhënave mbi përkatësinë në një pakicë kombëtare, lidhet me kriteret objektive të identitetit të pakicave kombëtare dhe shërben për të bërë të mundur ushtrimin e të drejtave të parashikuara nga ligji.

4. Projektvendimi “Për kriteret e mbështetjes së nismave, projekteve që synojnë mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, tradicional dhe fetar dhe kriteret e përzgjedhjes për financimin dhe administrimin e “Fondit për pakicat kombëtare”.

të barabartë dhe dinjitoz nga sistemi që e ofron atë, të drejtën për arsimim dhe ndalim të praktikave segreguese, të drejtën për të përfitur nga sistemi i përkujdesjes shoqërore, të drejtën për proces të rregullt ligjor në kuadër të proceseve të legalizimit të ndërtimeve informale, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në tërësi për komunitetet përfaqësuese të minoriteteve kombëtare Rome dhe Egjiptiane në Shqipëri.

Fenomeni i “*antixhipsizmit*”, i cili shfaqet si një manifestim i shprehjeve dhe akteve individuale si dhe i politikave institucionale dhe praktikave të marxhinalizimit, përjashtimit, dhunës fizike, zhvleftësimit të kulturës dhe stilit të jetesës së Romëve, në gjuhën e urrejtjes të drejtuar ndaj Romëve si dhe ndaj individëve të tjerë apo grupeve të tjera të perceptuara, stigmatizuara apo persekutuar gjatë periudhës naziste, si edhe sot, të njohura si “*gypsies*”, mbetet në fokusin e veprimtarisë sonë.

Sikurse kemi theksuar në qëndrime tonat të mëparshme, të shprehura në rekomandimet dërguar njësisive të vetëqeverisjes vendore por edhe organeve publike, përgjegjëse të qeverisjes qendrore, do të duhet që nën dritën e kuadrit të ri strategjik ndërkombëtar për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje, të projektojmë vizionin tonë të ri, që krahas luftës ndaj “*antixhipsizmit*”, të projektojmë politika konkrete integrimi dhe përfshirjeje reale të Romëve dhe Egjiptianëve, jo vetëm në nivelin e qeverisjes qendrore por specifikisht edhe në nivelin e vetëqeverisjes vendore, për t’i bërë ata të ndihen pjesë e një shoqërie me diversitet, gjithëpranuese dhe demokratike.

Një zhvillim pozitiv në këtë drejtim, është miratimi i Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, i përgatitur në emër të Qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për çështjet e integritit të Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri. Rezultatet mbetet të shihen dhe vlerësohen në vazhdim, në drejtim të ndikimit që ato do të kenë realisht për përmirësimin e jetesës së komuniteteve Rome dhe Egjiptiane në vendin tonë. Dhe në këtë këndvështrim mendojmë se një bilanc i kohë pas kohshëm, transparent dhe i hapur për diskutim me të gjithë aktorët institucionalë dhe shoqërinë civile do të shërbente si në mënyrë efektive për të parë rezultatet e arritura dhe pengesat apo edhe dështimet, dhe për të nxjerrë konkluzione koherente dhe në të mirë të një procesi gjithëpërfshirës.

Në këtë raport sjellim në vëmendje dy rekomandime që kanë të bëjnë me një qasje sistematike ndaj të drejtave të ligjshme, kryesisht ndaj komuniteteve përfaqësuese të minoriteteve kombëtare Rome dhe Egjiptiane në vendin tonë. Më konkretisht:

- *Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje miratimin dhe hyrjen në fuqi të bazës ligjore për trajtimin e çështjeve të zhvendosjes së individëve apo familjeve nga vendbanimet e tyre, apo e njohur ndryshe si problematika e “dëbimit me forcë”.*

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë Vendimin (VKM) nr.361, datë 29.05.2019, “*Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional*”.

Nga një analizë e kujdesshme e përmbajtjes së kësaj VKM-je, kemi konstatuar se ka vend për përmirësim të pikës 19,¹⁴⁸ të këtij akti normativ, nënligjor, pasi përcaktimi i dhënë në këtë pikë ka mangësi dhe krijon paqartësi lidhur me kohën e njoftimit të Avokatit të Popullit nga ana e njësisë së vetëqeverisjes vendore, për procedurën e zhvendosjes. Ky njoftim përcaktohet në mënyrë të përgjithshme dhe jo i lidhur konkretisht me momentin e inicimit të procedurës administrative të zhvendosjes.

Mbi bazën e një analize të kujdesshme, me anë të shkresës nr. K1/I132-2 prot., datë 17.12.2021, Avokati i Popullit i ka rekomanduar, Kryetarit të Këshillit të Ministrave, shprehimisht: *“Ndryshimin dhe përmirësimin e fjalisë së parë, të pikës 19, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr.361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre, në rastet e parashikuara në ligj, dhe të bashkëpunimit institucional”, për të gjitha arsyet ligjore dhe sipas konstatimeve dhe gjetjeve, të cituara në këtë rekomandim”.* Ky rekomandim është pranuar nga ana e organit përkatës publik.

Konstatojmë ndërkohë me keqardhje se parashikimi i VKM-së nuk është zbatuar nga viti 2019 vit kur ka dalë akt.

- *Marrja e masave të shpejta që synojnë përmirësimet e nevojshme në qasjen ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor, për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.*

Si një çështje e filluar dhe shqyrtuar me iniciativë nga ana e Avokatit të Popullit dhe bazuar në të dhënat zyrtare të dërguara prej Njësisë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Durrës, kemi konstatuar se:

- ✓ Marrëdhënia e krijuar ndërmjet posedimit të kartës së identitetit dhe hyrjes në sigurimin shëndetësor, ka krijuar një hendek dhe problematika referuar gjendjes aktuale të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane. Nga ana tjetër pranohet se shumë anëtarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane nuk kanë karta të sigurimit shëndetësor për faktin se ata nuk janë as të punësuar rregullisht, as të regjistruar si të papunë. Kjo gjendje sjell për pasojë në kushtet aktuale të pandemisë së Covid 19, trajtimin me shërbime të kujdesit shëndetësor vetëm të atyre individëve me përkatësi në minoritetin kombëtar Rom apo Egjiptian, të cilët janë të regjistruar dhe kanë kartë shëndeti. Pjesa tjetër që nuk plotësojnë këto kushte janë të përjashtuar dhe nuk kanë akses për rrjedhojë në këto shërbime.
- ✓ Kryerja e aktiviteteve edukuese e informuese për promocionin shëndetësor, menaxhimi dhe efikasiteti i tyre tek komunitetet Rome dhe Egjiptiane, has në probleme konkrete.
- ✓ Evidencat e sakta statistikore (jo diskriminuese) për pacientët e trajtuar, pjesëtarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, do të ndihmonin në procesin e formulimit sa më efikas të politikave apo strategjive sektoriale, qofshin këto në nivel vendor apo edhe në nivel kombëtar, sa i takon ofrimit të kujdesit shëndetësor. Evidentimi i nevojshëm statistikor do të kishte një impakt të drejtëpërdrejtë edhe në ndërgjegjësimin e pjesëtarëve të këtyre komuniteteve për çështje të shëndetit.

Për sa më sipër, i kemi rekomanduar Operatorit të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutit të Shëndetit Publik, shprehimisht:

¹⁴⁸ Në pikën 19, të VKM nr.361, datë 29.05.2019, përcaktohet shprehimisht se: “Njësia e vetëqeverisjes vendore njofton Avokatin e Popullit për çdo procedurë zhvendosjeje të nisur. Në rastet kur Avokati i Popullit, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, miraton rekomandime, ato publikohen edhe në faqen zyrtare të internetit të njësisë së vetëqeverisjes vendore”.

- ✓ Marrjen e masave të shpejta që synojnë përmirësimet e nevojshme në qasjen ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor, për komunitetet Rome dhe Egjiptiane, lidhur me aksesin dhe trajtimin me këto shërbime të të gjithë individëve pjesëtarë të këtyre komuniteteve, përfaqësuese të minoritetit kombëtar Rom apo Egjiptian, në njësitë territoriale administrative ku ata banojnë.
- ✓ Kryerjen rigoroze nga çdo strukturë përgjegjëse shtetërore e ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, në komunitetet Rome dhe Egjiptiane, të aktiviteteve informuese dhe edukuese, ku promovohet stili i shëndetshëm i jetesës dhe sidomos marrja e masave të nevojshme kundër Covid-19. Përfshirjen në këto aktivitete të ndërmjetësve shëndetësorë, si përfaqësues të drejtëpërdrejtë të këtyre komuniteteve dhe si një urë e dobishme dhe efektive në marrëdhënien ndërmjet institucioneve të kujdesit shëndetësor dhe komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.
- ✓ Realizimin sistemik të të dhënave të nevojshme, statistikore, mbi numrin e personave të testuar për Covid-19, apo të diagnostikuar me “Covid pozitiv”, pjesëtarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane, në të gjithë vendin.

Ajo që kërkohet sot është tejkalimi i gjendjes së “ngërthyer” nga barazia formale e garantuar me ligj, në garancinë thelbësore të materializuar në veprimtarinë konkrete të organeve shtetërore, të institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe të shoqërisë sonë në tërësinë e saj. Ky kapërcim real do të garantojë barazinë para ligjit dhe mosdiskriminim. Dhe duhet të jemi të bindur se nëse kjo gjë arrihet, kemi hedhur baza të shëndosha të një sistemi efektiv të të drejtave të njeriut. Barazia, përfshirja dhe integrimi real i minoriteteve kombëtare në të gjitha sferat e jetës, në nivelin e qeverisjes vendore dhe atë qendrore do të sjellë padyshim produktin e pritshëm të një shoqërie demokratike dhe të harmonisë tradicionale të bashkëjetesës, mbetet një objektivi i qënësishëm dhe plotësisht i realizueshëm.

3.23 Respektimi i të drejtave në fushën e sigurimeve shoqërore¹⁴⁹

Sistemi i Sigurimeve shoqërore në vendin tonë përbën skemën kryesore të mbrojtjes shoqërore në Shqipëri. Skema e pensioneve luan një rol të rëndësishëm në mbrojtjen shoqërore dhe në luftën ndaj varfërisë. Sipas legjislacionit në fuqi, të gjithë shtetasit në Shqipëri për të përfituar nga skema aktuale janë të detyruar të paguajnë kontribute shoqërore dhe shëndetësore duke u garantuar nga shteti me të ardhmen e plotësisht të nevojave jetike bazë për vete dhe për pjesëtarë të familjes.

Edhe përgjatë vitit 2021, kanë vijuar të adresohen nga qytetarë përgjithësisht të njëjta problematika të raportuara ndër vite për të drejtat në fushën e sigurimeve shoqërore. Konkretisht, objekti i ankesës së tyre ka konsistuar në shkelje të të drejtave për shkak të moslllogaritjes së drejtë apo të mosrishikimit të masës së pensioneve të pleqërisë; për mosnjohjen e vjetërsisë së punës; për masën e ulët të pensioneve; mosvënie në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes së pensionit; për datën e lindjes së të drejtës për të përfituar pensionin e pleqërisë; zvarritje në lidhjen e pensionit të pleqërisë; për ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë dhe nxjerrjen debitorë të pensionistëve; për mostrajtim financiar shtesë në masën e pensionit të pleqërisë; për punë të bërë në profesion të vështirë, etj.

Referuar ankesave të regjistruara e administruara për vitin 2021, rezulton të jenë *trajtuar 86 çështje*. Është permbyllur hetimi administrative për *71 raste, nga të cilat 30 çështje janë zgjidhur në favor të ankesave të qytetarëve*.

¹⁴⁹ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Për problematikat në fushën e sigurimeve shoqërore, duhet të theksojmë faktin se nga trajtimi i ankesave, të cilat pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, qytetarët janë sqaruar ligjërisht duke i orientuar drejt qasjes së zgjidhjes së problematikës, përmes ndjekjes së procesit të ankimit administrativ: në Komisionet Rajonale të Apelit pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore si dhe në Komisionin Qendror të Apelit pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Pavarësisht reformimit të sistemit publik të sigurimeve shoqërore, duke iu përshtatur zhvillimeve ekonomiko-sociale, përsëri nga ana e institucionit tonë janë konstatuar shkelje të të drejtave të individëve, sa i përket përfitimeve të ndryshme nga sistemi publik i sigurimeve shoqërore, të listura sipas problematikave më përfaqësuese, si më poshtë:

- *Mosdhënie në kohë të shpërblimit të menjëhershëm për vjetërsi në punë dhe të pagesës kalimtare*

Nga shqyrtimi i çështjes, rezulton se nuk është zbatuar ligji nr. 10142 datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, në të cilin është parashikuar se pagesa kalimtare duhet të fillojë në muajin e tretë nga data e nxjerrjes në rezervë apo lirim. Qytetari shpërblimin e menjëhershëm për vjetërsi në punë në masën e dy pagave referuese mujore e ka përfituar 1 muaj e 15 ditë pas largimit nga detyra, ndërsa pagesën kalimtare e ka përfituar një muaj më pas nga sa i takonte.

Sipas legjislacionit në fuqi, përfundimi i përfitimit të pagesës kalimtare përcakton të drejtën e tij për fillimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Mosdhënia e pagesës kalimtare për periudhën e pretenduar, përpos mospërfitimit financiar, penalizonte qytetarin për datën e fillimit të pensionit të parakohshëm në shërbim.

Pas verifikimeve dhe konstatimit të moszbatimit të drejtë të ligjit të sipërcituar, kemi proceduar me rekomandim për dhënien e pagesës kalimtare për periudhën e pretenduar, rekomandim, i cili u pranua dhe u zbatua nga IEVP-ja dhe ankuesi përfitoi të drejtat e tij të ligjshme.

- *Mosnjohja e të gjitha viteve të punës në llogaritjen e pensionit të pleqërisë*

Në këtë aspekt, për t’u ardhur në ndihmë qytetarëve të cilët i janë drejtuar institucionit tonë për mosnjohje të viteve të punës nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, duke sjellë si pasojë masë me të ulët përfitimi të pensionit të pleqërisë, veprimtaria e Istitucionit të Avokatit të Popullit ka konsistuar në ndërhyrjen institucionale pranë Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore si dhe institucioneve të tjera shtetërore, duke i mundësuar pajisjen me vërtetimin të vjetërsisë në punë. Me dërgimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë, kemi orientuar qytetarët për t’i paraqitur pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ku ata kanë vendbanimin, me qëllim përfitimin e një masë pensioni më të lartë apo dhe plotësimin e dokumentacionit të munguar për aplikim të përfitimit të pensionit të pleqërisë.

- *Llogaritje jo e drejtë e pensionit të pleqërisë*

Një numër i konsiderueshëm ankesash që kanë të bëjnë me llogaritjen jo të drejtë të pensionit të pleqërisë janë referuar pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Për të përmirësuar situatën e përfituesve, gjatë shqyrtimit të çështjeve, u kemi sugjeruar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, rillogaritje të masës së pensionit të pleqërisë, duke rishqyrtuar dokumentacionin e depozituar në dosjen e pensionit. Qytetarëve, pas rillogaritjeve të kryera, u ka ndryshuar masa e pensioneve dhe njëkohësisht kanë përfituar shtesa kreditore.

Institucioni i Avokatit të Popullit, me gjithë arritjet e deritanishme të shtetit shqiptar, përmes reformimit të sistemit publik të sigurimeve shoqërore, vlerëson se duhet të synohet drej objektivitet të të qenit më efektiv në politikat që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore, pasi disa çështje mbeten tepër të ndjeshme në opinionin publik, kryesisht pensionet e ulëta, masa e të cilave është e pamjaftueshme për përballimin e një jetese normale.

Gjithashtu vlerësojmë nismën e marrë të qeverisë për draftimin e ndryshimeve lidhur me mosushtrim të rekursit në Gjykatën e Lartë nga institucionet shtetërore për vendimet e dhëna nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Administrative e Apelit për çështjet në fushën e sigurimeve shoqërore, kryesisht për njohjen e vjetërsisë në punë. Kjo iniciativë do të lehtësojë qytetarët për përfundim më të shpejtë të procesit gjyqësor dhe përfitimin e të drejtave të tyre.

3.24 Çështjet zgjedhore¹⁵⁰

Ndër vite institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar proceset zgjedhore të zhvilluara në vend, si zgjedhjet vendore ashtu edhe ato parlamentare, në përputhje me mandatin e tij. Theksojmë se zgjedhjet e lira dhe të ndershme, janë një nga shtyllat thelbësore të shtetit të së drejtës, ndaj jemi të mendimit se në këto procese, roli i Institucionit të Avokatit të Popullit është shumë i rëndësishëm.

Për realizimin e këtij objekti, Avokati i Popullit ka ndërmarrë me iniciativë trajtimin e çështjeve lidhur me: aksesin dhe lehtësitë e krijuara në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, zbatimin e dispozitave të Kodit Zgjedhor që garantojnë barazinë gjinore, respektimin e dispozitave ligjore që garantojnë afishimin dhe shpërndarjen e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore, ushtrimin e së drejtës së votës të personave të moshuar në Shtëpitë e të Moshuarve, ushtrimin e së drejtës së votës nga personat e ndodhur në vendet e privimit të lirisë ditën e votimit, përdorimi i një gjuhe etike komunikimi gjatë fushatës zgjedhore, etj.

Në lidhje me zgjedhjet e përgjithshme parlamentare, që u mbajtën në datën 25 prill 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka zhvilluar një proces të gjerë monitorimi i cili u përqëndrua në këto faza të procesit zgjedhor:

a. Përgatitja për procesin zgjedhor

b. Dita e zgjedhjeve

Veprimtaritë e kryera gjatë përgatitjeve për procesin zgjedhor lidheshin me dhënie mendimesh dhe sugjerimesh mbi hartimin e legjislacionit zgjedhor si dhe hartimin e rekomandimeve për institucionet përgjegjëse për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

¹⁵⁰ Kjo fushë e së drejtës mbulohet nga Seksioni i Përgjithshëm në institucionin e Avokatit të Popullit.

Kështu, gjatë diskutimeve për amendimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në lidhje me çështjet e zgjedhjeve¹⁵¹ dhe amendimeve të Kodit Zgjedhor¹⁵², institucioni i Avokatit të Popullit u ftua të jepte opinionin e tij gjatë procesit legjislativ, për diskutimin në lidhje me këto ndryshime të propozuara. Qëndrimi i institucionit për ndryshimet e propozuara, kishte të bënte vetëm me çështje që lidheshin me liritë dhe të drejtat themelore të shtetasve që preken apo ndikohen nga proceset zgjedhore. Mendimet dhe sugjerimet e institucionit të Avokatit të Popullit u morën parasysh pjesërisht gjatë diskutimeve të zhvilluara dhe miratimit të projektligjeve përkatëse.

Duke pasur në konsideratë problematikat shqetësuese që ishin konstatuar nga monitorimi i proceseve zgjedhore paraardhëse, apo edhe të çështjeve të konstatuara gjatë këtij procesi zgjedhor, Institucioni i Avokatit të Popullit iu adresoi institucioneve përgjegjëse shtetërore, dy rekomandime, të cilat kishin të bënin me:

1. Rekomandimi i datës 6.4.2021 drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve/Komisionit Rregullator *“Rekomandim për përmirësimin e Udhëzimit nr.1 datë 5.12.2020 “Përcaktimi i rregullave për ngritjen, caktimin dhe njoftimin e vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësisë së vetëqeverisjes vendore për zgjedhjet”, të miratuara nga Komisioni Rregullator, në KQZ”*.

Pavarësisht se ky rekomandim iu dërgua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rreth një muaj e gjysëm para datës së votimit, përgjigja nga ana e këtij të fundit u dërgua rreth dy javë pas datës së votimit¹⁵³. Në këtë përgjigje është konfirmuar se, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të bëjë vlerësimin e përgjithshëm të problemeve të hasura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të zhvilluara në datën 25 Prill 2021, lidhur me infrastrukturën mbështetëse e cila ngrihet tërësisht sipas një mekanizmi, kriteresh, afatesh dhe ndërveprimi institucional të mirëpërcaktuar.

2. Kërkesë për informacion¹⁵⁴, drejtuar gjithë kryetarëve të Bashkive të Shqipërisë, ku kërkohet informacion *“Për krijimin e kushteve në qendrat e votimit, që do të mundësojnë ushtrimin efektiv të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar”*, me objekt: Parashikimin e një mekanizmi efektiv për kontrollin e përmbushjes së kriterëve ligjore nga ana e organeve përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të cilët qëllimojnë krijimin e kushteve të përshtatshme në qendrat e votimit, për ushtrimin lirisht të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar.

Në informacionin e dërguar janë cituar masat e marra nga ana e organeve përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore¹⁵⁵ për mbarëvajtjen e zgjedhjeve, në këtë komponent specifik të tyre si dhe në disa raste, problematikat e ndeshura për përmbushjen e plotë të detyrimeve që rrjedhin nga ligji. Nga monitorimi në terren i zbatimit të masave të kërkuara nga ligji, për krijimin e kushteve në qendrat e votimit, që mundësonin ushtrimin efektiv të së drejtës së votës nga ana e personave më aftësi të kufizuar, rezultoi se kishte shumë problematika në këtë drejtim.

¹⁵¹ Miratuar më datë 30.07.2020.

¹⁵² Miratuar më datë 05.10.2020.

¹⁵³ Shkresa me nr.3412/1 datë 7.5.2021.

¹⁵⁴ Shkresë e dërguar më datë 2.4.2021.

¹⁵⁵ Kërkesë për informacion iu dërgua kryetarëve të 61 (gjashtëdhjetë e një) bashkive, në të gjithë vendin. Ndërkohë, informacionin e kërkuar nga ana jonë, e dërguan në afat (para datës së zhvillimit të zgjedhjeve), 32 bashki.

Nga monitorimi në terren i zbatimit të masave të kërkuara nga ligji për krijimin e kushteve në qendrat e votimit, që mundësonin ushtrimin efektiv të së drejtës së votës nga ana e personave me aftësi të kufizuar, rezultoi se kishte shumë problematika në këtë drejtim. Institucioni i Avokatit të Popullit iu drejtua Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me dy kërkesa të përsëritura për dhënien e një informacioni të detajuar, lidhur me masat e marra, apo që do të ndërmerreshin, për krijimin e lehtësirave për votimin e personave me aftësi të kufizuara.¹⁵⁶ Në përgjigjen e dhënë nga ana e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve¹⁵⁷, veç sqarimeve që lidhen me parashikimet ligjore në caktimin e qendrave të votimit, u konfirmua se të gjitha qendrat e votimit janë vendosur në katet e para të godinave për të lehtësuar pikërisht aksesin e tyre edhe nga personat me aftësi të kufizuar. Po kështu, në përgjigje thuhet se, në ato qendra votimi ku referuar listës së zgjedhësve ka zgjedhës të tillë dhe ku infrastruktura e godinës e ka lejuar, janë vendosur edhe rampa për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Nga monitorimi në terren i zbatimit të masave të premtuara që do të merreshin, rezultoi se kishte shumë problematika. Më konkretisht, nga ana e grupeve tona të monitorimit në ditën e zgjedhjeve, rezultoi që veç të tjerash kishte qendra votimi që ishin në katet e dyta të godinave.¹⁵⁸

Nisur nga eksperiencia të mëparshme, në kuadër të një projekti të Zyrës së Këshillit të Evropës në Tiranë, institucioni i Avokatit të Popullit si pjesë e Aleancës Kundër Urrejtjes,¹⁵⁹ inicioi procesin e hartimit dhe konsultimit të Kodit të Sjelljes së partive politike shqiptare, gjatë fushatave zgjedhore.¹⁶⁰ Në bashkëpunim me Komisionerin Shtetëror për Zgjedhjet, në një aktivitet të zhvilluar nga Aleanca Kundër Urrejtjes, ky Kod Sjelljeje u konsultua me partitë politike të përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë si dhe të tërë subjektet garues që morën pjesë në zgjedhjet e 25 prillit 2021.

Në përfundim të konsultimeve, ky Kod u miratua (nënshkrua) nga partitë kryesore politike në versionin e propozuar nga Aleanca Kundër Urrejtjes, dhe vlen të theksohet se ky Kod do të jetë i vlefshëm edhe për zgjedhjet e ardhshme vendore apo parlamentare.

Në datë 19 prill 2021, Komiteti Teknik i Ekspertëve pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, propozoi si një masë parandaluese për përhapjen e Covid-19, që të gjithë shtetasit shqiptarë që vinin në Shqipëri, nga Maqedonia e Veriut dhe Greqia, të karantinoheshin për një periudhë dy javore, propozim i cili u materializua nëpërmjet Urdhërit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr.219, datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”.

Avokati i Popullit duke vlerësuar se një masë e tillë, përbënte pengesë dhe realisht pamundësonte pjesëmarrjen e shtetasve shqiptarë, të cilët mund të vinin nga Greqia ose Maqedonia e Veriut, për të ushtruar efektivisht të drejtën e tyre themelore për të votuar, nëpërmjet një rekomandimi drejtuar

¹⁵⁶ Shkresa nr.K1/S4-12prot., datë 14.04.2021 dhe shkresa Nr.K1/S4-26 prot, datë 21.04.2021.

¹⁵⁷ Shkresa nr.4153/1, datë 18.05.2021.

¹⁵⁸ Institucioni i Avokatit të Popullit inspektuan 280 qendra votimi, ndërkohë që përfaqësuesit e Zyrave Rajonale inspektuan 582 qendra votimi.

¹⁵⁹ Përveç institucionit tonë në këtë Aleancë marrin pjesë edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoriteti i Mediave Audio-vizive, si dhe Organizata Jofitimprurëse “Këshilli Shqiptar i Medias”.

¹⁶⁰ Kodi përmban rregulla etike për mënyrën e sjelljes së partive politike gjatë fushatave zgjedhore.

Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale¹⁶¹, kërkoi anulimin tërësisht e menjëherë të urdhërit të sipërpërmendur.

Pavarësisht se në nenin 21, pika b, të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “*Paraqitja e rekomandimit pezullon aktet ose veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit*”, ky rekomandim jo vetëm nuk solli anulimin e Urdhërit të sipërcituar të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por siç rezultoi nga mediat, ai filloi të zbatohet nga Policia e Shtetit, ende pa hyrë në fuqi.¹⁶²

Në vijim të rekomandimit tonë edhe Presidenti i Republikës, me shkresën nr. 1413/2 prot., datë 22.4.2021, drejtuar një sërë institucionesh publike, prezencës ndërkombëtare në vend, partive politike me përfaqësim në Kuvendin e Shqipërisë dhe deputetëve të pavarur në Kuvendit,¹⁶³ kërkoi gjithashtu, përmbushjen e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit për anulimin e urdhërit nr. 219, datë 19.4.2021, të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dërgoi shkresën nr.1938/1 datë 12.05.2021, në të cilën bëhej një analizë mbi kompetencat e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të nxjerrë urdhëra, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.15/2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, i ndryshuar.

Në gjykimin dhe vlerësimin e Avokatit të Popullit, kjo përgjigje nuk analizon aspak thelbin e rekomandimit dërguar Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë çështje. Përgjigja formale e kthyer nga ana e këtij institucioni edhe pse brenda afatit procedural të vendosur nga ligji nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nuk i përgjigjej urgjencës së çështjes së ngritur në rekomandim dhe qëndrimin të shpejtë, që duhej të mbahej nga ana e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për këtë rekomandim. Vlen të theksohet fakti se, përgjigja e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, u dërgua pasi, Urdhëri i Ministrit të Shëndetësisë nr.219 datë 19.04.2021 “Për karantinimin e personave që vijnë në Republikën e Shqipërisë nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Greqia”, *kishte humbur fuqinë e tij juridike dhe nuk sillte më pasoja.*

Një problematikë tjetër gjatë fushatës zgjedhore ishte dhe përdorimi i një baze të dhënash, e cila përmbante të dhëna personale të qytetarëve. Duke vlerësuar këtë përdorim të dhënash personale, në kundërshtim me legjislacionin specifik të fushës, institucioni i Avokatit të Popullit doli me një

¹⁶¹ Shkresa nr. 1413/2 prot., datë 22.4.2021.

¹⁶² <https://www.asp.gov.al/kakavije-gjirokaster-drejtori-i-departamentit-te-kufirit-dhe-migracionit-eduart-merkajinspektim-ne-piken-e-kalimit-kufitar-per-masat-ne-prag-te-zgjedhjeve/>

¹⁶³ Shkresa nr. 1413/2 prot., datë 22.4.2021 e Presidentit të Republikës, iu drejtua Këshillit të Ministrave, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Komitetit Teknik të Ekspertëve, organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Kjo shkresë u përcoll në vëmendje të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; misionit të OSBE/ODIHR për vëzhgimin e zgjedhjeve, zyrës së OSBE-së në Shqipëri, Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Ambasadës Britanike, Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, si dhe ju dërgua për dijeni, Partisë Socialdemokrate, Partisë Balli Kombëtar, Partisë Lëvizja Demokratike Shqiptare, Partisë Bindja Demokratike, Partisë Aleanca Bashkimi Popullor, Partisë Lëvizja Socialiste për Integrim, Partisë Nisma Thurje, Partisë Lëvizja e re, Partisë Demokratike, Partisë Aleanca Demokracia e Re, Partisë Lëvizja për ndryshim, Partisë Socialiste dhe kandidatit të pavarur z. Boiken Abazi.

deklaratë publike për mediat,¹⁶⁴ si dhe dha një sërë intervistash në stacione të ndryshme televizive të vendit, ku theksoi qëndrimin se marrja dhe përdorimi i të dhënave personale të qytetarëve, nga cilado parti politike, është e paligjshme, me përjashtim të rastit, nëse vetë qytetarët kanë dhënë një autorizim të posaçëm me shkrim për përdorimin e tyre për qëllimin e lejuar, apo për raste të tjera të veçanta të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Ky qëndrim parimor i Avokatit të Popullit gjen mbështetje në konsiderimin se, mbrojtja e të dhënave personale është një e drejtë themelore e njeriut dhe se, mbledhja e të dhënave personale të shtetasve pa pëlqimin e tyre, lidhet drejtpërdrejtë me jetën e tyre private.

Avokati i Popullit i kërkoi autoriteteve shtetërore dhe ligjzbatuese, të merrnin çdo masë të nevojshme, për të ndaluar çdo përdorim të paligjshëm të të dhënave personale dhe çdo forcë politike, të distancohej në mënyrë të qartë nga të tilla praktika që cenojnë të drejtat e njeriut. Po kështu, u soll në vëmendje të organeve ligjzbatuese dhe u kërkua që çdokush që kishte mbledhur, përpunuar apo ruajtur të dhëna personale, të ishte përgjegjës për të shpërblyer dëmin që u vjen subjekteve të këtyre të dhënave personale, në përputhje me përcaktimet e legjisilacionit në fuqi.¹⁶⁵

Monitorimet në Qendrat e Votimit, në ditën e votimit

Monitorimi i kryer u bazua në një metodologji monitorimi dhe raportimi, e cila bazohej në përcaktimin e disa kriterëve ligjore specifike që duhej të verifikoheshin në vend dhe konkretisht nga grupet monitoruese, duke konstatuar fizikisht dhe drejtpërdrejtë përmbushjen e tyre, si dhe duke adresuar tërësinë e konstatimeve të kryera në plotësimin e një formulari tip, të miratuar për këtë qëllim. Në ditën e votimit u monitoruan nga stafi i institucionit të Avokatit të Popullit në mënyrë të drejtpërdrejtë, 840 qendra të ndryshme votimi në të gjithë Shqipërinë, ku siç përmendëm më sipër, objekti i këtij monitorimi ishte përshtatshmëria e qendrave të votimit dhe aksesit i lehtësuar në to, për Personat me Aftësi të Kufizuara, dhe ushtrimi i lirë i së drejtës së votës. Gjithashtu, pjesë e monitorimit ishin disa institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale.

Përveç verifikimit të infrastrukturës në godinat ku ndodheshin qendrat e votimit, si dhe pajisjen e këtyre qendrave me pajisje të posaçme për të mundësuar dhe lehtësuar votimin e personave të verbër, u monitorua edhe respektimi i protokolleve të vendosura, për shkak të Covid-19. Për kryerjen e një veprimtarie sa më normale në monitorimin e qendrave të votimit, që do të vizitoheshin ditën e votimit, Avokati i Popullit vuri në dijeni zyrtarisht dhe Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve.¹⁶⁶

Rekomandime

Bazuar në angazhimin konkret dhe trajtimin analitik të çështjeve dhe problematikave të caktuara, të konstatuara nga ana e Avokatit të Popullit për Zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të mbajtura në 25 prill 2021, u paraqitën këto rekomandime:

¹⁶⁴ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles-layout-1/media/nees/peoples-advocate-position-eth-regard-to-the-large-number-of-personal-data-of-albanian-citizens-compromised-for-political-purposes-622/>

¹⁶⁵ Neni 17, i ligjit “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

¹⁶⁶ Shkresa nr. 223 prot., datë 22.04.2021.

1. Për zbatimin në mënyrë korrekte të akteve normative në fuqi:

- ✓ Të garantohet plotësisht edhe atje ku kjo gjë nuk është e mundur, sipas një standardi minimum detyrues, nga ana e organeve përgjegjëse të vetëqeverisjes vendore dhe Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve, krijimi i lehtësive për votimin e personave me aftësi të kufizuara, në qendrat e votimit.
- ✓ Garantimi i së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuara, duke filluar nga përshtatshmëria infrastrukturore në hyrje të godinave të qendrave të votimit, duke:
 - a. vendosur në çdo godinë rampa për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë;
 - b. vendosur sinjalistikën me shirita të verdhë për personat me aftësi të kufizuara në shikim.
- ✓ Marrjen e masave lidhur me garantimin e fshehtësisë së votës, veçanërisht për votuesit e moshës së tretë dhe me aftësi të kufizuara, kur votimi kryhet në mënyrë elektronike.
- ✓ Marrjen e masave për ndërgjegjësimin e votuesve (moshës së tretë, personave me aftësi të kufizuara, etj), mbi mënyrën e realizimit të votimit elektronik.
- ✓ Marrjen e masave për identifikimin e personave me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe vendosjen për të votuar vetëm në qendrat e votimit që ndodhen në katet e para të godinave, në mënyrë që tu garantohet e drejta për të votuar.
- ✓ Marrjen e masave të nevojshme nga ana e Bashkive për dërgimin në afatin ligjor të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, të listave të zgjedhësve në IEVP-të, të cilat janë në juridiksionin tokësor të tyre.
- ✓ Marrjen e masave të menjëhershme për pajisjen me dokumentin e identifikimit të të burgosurve, që në momentin e pranimit në ambientet e IEVP-ve. Kjo gjë duhet të konsiderohet si një detyrim ligjor¹⁶⁷ dhe si një nevojë për zhvillimin e procesit të rregullt zgjedhor dhe ushtrimin e së drejtës së votës.
- ✓ Marrjen e masave për gjetjen e zgjidhjeve ligjore, për pajisjen e të burgosurve me mjete identifikimi alternative kur është e qartë pamundësia e tyre financiare për këtë qëllim.
- ✓ Marrjen e masave të nevojshme nga ana e Drejtorive të IEVP-ve, për t'i kërkuar bashkive respektive dërgimin në kohë të listave të zgjedhësve, për personat e privuar nga liria, të dënuar dhe paraburgosur.
- ✓ Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoritë e IEVP-ve për të njoftuar disa muaj para ditës së votimit dhe për të sensibilizuar personat e privuar nga liria, për mundësimin e pajisjes së tyre në kohë, me dokumenta identifikimi (disponimin e tyre kur i kanë apo bërjen e dokumentave të rinj të identifikimit në rastet kur u mungojnë), me qëllim realizimin e të drejtës themelore për të zgjedhur.

2. Rekomandime legislative:

- ✓ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të përmirësojë në një kohë të shpejtë, në vazhdim, bazën ligjore, që lidhet me parashikimet detyruese, ndaj organeve shtetërore përgjegjëse për krijimin e lehtësive për votimin e personave me aftësi të kufizuara në qendrat e votimit.
- ✓ Rekomandohet plotësimi i legjislacionit që garanton votën e emigrantëve.

¹⁶⁷ Bazuar në ligjin nr. 81/2020, në nenin 88, pika 1, gërma “dh” ku parashikohet “1. Pranimi i të paraburgosurve kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm: dh) certifikatën personale dhe dokumentin e identifikimit dhe në mungesë të tyre, dokument identifikimi të përgatitur nga Policia e Shtetit.”

- ✓ Vendimmarrja e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për marrjen e masave parandaluese ndaj infeksionit të përhapjes së Covid 19, si dhe veprimtaria e strukturave të tjera profesionale këshilluese, të krijuara për këtë qëllim, duhet të përfshijë në spektrin konsultues paraprak, mendimet dhe qëndrimet e institucioneve shtetërore, të specializuara, për problematika që janë sensitive dhe që prekin, apo sjellin pasoja të drejtëpërdrejta, për të drejtat themelore të njeriut.

Të gjitha konstatimet dhe gjetjet e kryera gjatë këtij procesi monitorimi janë paraqitur në një raport publik, të përgatitur nga ana e Avokatit të Popullit dhe të publikuar në faqen zyrtare të institucionit.¹⁶⁸

¹⁶⁸<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raport%20monitorimi%20per%20zgjedhjet%20vendore%202021.pdf>.

KREU 4

Angazhime të tjera institucionale

4.1 Raport i Avokatit të Popullit “Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën Janar 2020-Shtator 2021”

Në kuadër të vlerësimit të punës së institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet rezolutës së Kuvendit të miratuar më 07.07.2021, Kuvendi i Shqipërisë i ka kërkuar Avokatit të Popullit të përcjellë një raport të detajuar për çështjet e dhunës në familje.

Për këtë qëllim është hartuar dhe dorëzuar në Kuvend raporti “*Mbi situatën e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në Shqipëri për periudhën Janar 2020-Shtator 2021*”, i cili jep informacion jo vetëm mbi situatën e dhunës në marrëdhëniet familjare por trajton edhe çështje që kanë të bëjnë edhe me format e tjera të dhunës ndaj grave, duke qenë se janë të ndërlidhura.

Raporti është ndërtuar në 4 seksione si më poshtë, ku jepet një pasqyrim i situatës, konstatimet e Avokatit të Popullit dhe rekomandime për secilën nga problematikat.

➤ **Legjislacioni në fushën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore**

Në këtë seksion paraqiten në mënyrë të përmbledhur disa nga zhvillimet më të rëndësishme të viteve të fundit, vlerësohet se legjislacioni kundër dhunës me bazë gjinore, dhunës në familje dhe ai penal, janë përmirësuar ndjeshëm, në veçanti kuadri ligjor dhe nënligjor që adreson dhunën në familje, por konstatohen edhe disa mangësi të cilat duhet të përmirësohen në përputhje edhe me standartet e kërkuara nga Konventa e Stambollit.

➤ **Mbrojtja e grave dhe vajzave nga dhuna**

Ky seksion trajton çështje që kanë të bëjnë me raportimin, masat mbrojtëse, zbatimin dhe monitorimin e tyre; ndihma ligjore për gratë e dhunuara dhe ndëshkimi i dhunuesve, përfshirë dhe programet e rehabilitimit.

➤ **Planifikimi dhe koordinimi i shërbimeve për të mbijetuarat në nivel qendror**

Ky seksion trajton çështjet që kanë të bëjnë me hartimin, zbatimin dhe koordinimin e politikave dhe masave për luftën ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në nivel qendror, duke analizuar rolin e pushtetit qendror përsa i përket menaxhimit të rasteve dhe ofrimin e shërbimeve (në përputhje me detyrimet përkatëse ligjore të legjislacionit kundër dhunës në familje). Në këtë pjesë trajtohet edhe ofrimi i shërbimeve nga strehëzat afatgjata (Strehëza Kombëtare) dhe ato të emergjencës, si dhe qendrave të specializuara (Lilium).

➤ **Menaxhimi i rasteve nga mekanizmat e referimit dhe ofrimi i shërbimeve në nivel lokal**

Ky seksion trajton çështje që kanë të bëjnë me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje në nivel vendor nga Mekanizmat Kombëtarë të Referimit, bashkëpunimin ndërmjet anëtarëve të mekanizmit dhe sigurimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës me bazë gjinore. Avokati i Popullit vlerëson masat e marra dy vitet e fundit për krijimin e MKR-ve në të gjitha bashkitë e vendit si një nevojë e domosdoshme por dhe detyrim që duhej të ishte përmbushur vite më parë. Po ashtu, vlerësohen përpjekjet për zgjerimin dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme si ndihmë juridike, psikologjike, ekonomike, etj.

Gjetjet kryesore të këtij raporti janë:

Avokati i Popullit vëren se dy vitet e fundit janë marrë masa shumë të rëndësishme në adresimin e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, veçanërisht në drejtim të përmirësimit të legjislacionit dhe bazës nënligjore. Po ashtu, përmirësim ka në drejtim të mbrojtjes së viktimave dhe krijimit të strukturave të nevojshme në nivel lokal për adresimin e këtij problemi.

Ndërkohë, pavarësisht zhvillimeve pozitive, më pak progres ka pasur në drejtim të ofrimit të shërbimeve për viktimat e dhunës dhe rehabilitimit të dhunuesve, ku rolin kryesor vazhdon ta luajë shoqëria civile me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe donatorëve.

Rekomandimet kryesore të këtij raporti janë:

1. Legjislacioni në fushën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore

- ✓ Hartimi i një kuadri ligjor që adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, krahas dhunës në familje, si ngacmimi dhe dhuna seksuale, përndjekja, martesat e detyrueshme, etj.
- ✓ Ndryshime ligjore ose nënligjore për të siguruar mënyra alternative për zbatimin e detyrimeve ligjore, që për momentin janë të pamundura për shkak të mungesës së disa shërbimeve si për shembull, detyrimi që ka gjykata të urdhërojë dhunuesit të ndjekin programe rehabilitimi, të cilat në praktikë nuk ekzistojnë në pjesën më të madhe të vendit.
- ✓ Ndryshimi i përkufizimit të veprës penale të marrëdhënieve seksuale me dhunë në Kodin Penal (si për madhorët ashtu edhe të miturit), në përputhje me Konventën e Stambollit.
- ✓ Ndryshime në Kodin Penal në drejtim të përkufizimit të masave ndëshkuese në lidhje me martesat e detyrueshme, si dhe përfshirjen si vepra penale të sterilizimit të detyrueshëm dhe gjymtimit gjenital, të dy këto, krime me natyrë seksuale të parashikuara si të tilla nga Konventa e Stambollit.
- ✓ Marrjen e masave për zbatimin me efektivitet të legjislacionit të përmirësuar.
- ✓ Ndryshimi i ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, për të mundësuar aksesin paralel të viktimave të dhunës dhe përfituesve të ndihmës ekonomike.
- ✓ Ndryshimi i legjislacionit për të evidentuar zbatimin efektiv të programeve rehabilituese për dhunuesit.
- ✓ Ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit ekzistues për t’u dhënë mundësinë viktimave të dhunës në familje për tu paraqitur drejtpërdrejtë pranë institucionit të Mjekësisë Ligjore për tu egzaminuar pa qenë nevoja e pajisjes më parë të tyre me vendim nga organi procedues ose Avokati i Popullit.

2. *Mbrojtja e grave dhe vajzave nga dhuna*

- ✓ Koordinim më të mirë të MKR-ve me strukturat e policisë për të referuar në mënyrë të ndërsjelltë rastet e dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës.
- ✓ Zgjerimin e fushatave ndërgjegjësuese për raportimin e dhunës në të gjithë vendin, si një mënyrë efikase për t'i bërë viktimat të thyejnë ciklin e dhunës dhe të marrin ndihmën e nevojshme; shoqërimin e fushatave ndërgjegjësuese me programe për rritjen e kapaciteteve të strukturave ku raportohet dhuna.
- ✓ Marrjen e masave për shtrirjen e Linjës së Këshillimit ose krijimin e strukturave të ngjashme në të gjithë vendin, në veçanti në zonat e thella rurale, edhe për gratë nga grupet e pafavorizuara si gratë me aftësi të kufizuara, ato nga komuniteti Rom, gratë e moshuara, LBT.
- ✓ Ndërgjegjësimin e gjithë autoriteteve përgjegjëse që kanë detyrimin t'i përgjigjen çdo njoftimi të bërë nga viktimat apo personat e tjerë të përcaktuar në ligj.
- ✓ Vënien përpara përgjegjësisë të personave të cilët marrin dënim për shkak të detyrës apo autoritetit të ngarkuar për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës dhe nuk veprojnë në zbatim të tij.
- ✓ Aktivitete ndërgjegjësuese kundër dhunës me bazë gjinore duhet të organizohen vazhdimisht dhe të mos kufizohen vetëm gjatë fushatave specifike, si psh fushata ndërkombëtare e 16 Ditëve të aktivizimit kundër dhunës me bazë gjinore.
- ✓ Marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e procedurave të miratuara të vlerësimit të riskut në të gjithë vendin dhe përshtetimin e programeve trajnuese për punonjësit e policisë nga vetë institucionet shqiptare, krahas mbështetjes që ofrohet nga organizatat ndërkombëtare.
- ✓ Kontrollin e zbatimit të procedurave të vlerësimit të riskut dhe lëshimit të UMMPM, nga strukturat mbikqyrëse përkatëse dhe evidentimin periodik të problemeve që shfaqen në praktikë.
- ✓ Detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për të ndarë të dhënat dhe zbatueshmërinë e urdhrave për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPM).
- ✓ Zbatimin me prioritet të largimit të dhunuesit nga banesa e përbashkët si masën e parë dhe kryesore që duhet të merret nga Gjykatat kur dhunuesi dhe i dhunuari/e dhunuarat banojnë në një strehë të përbashkët dhe gjithashtu si masa e parë në urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme që lëshohen nga policia, derisa gjykata të lëshojë urdhërin e përkohshëm të mbrojtjes.
- ✓ Shtimin e burimeve njerëzore në zyrat e përmbarimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të stafit për zbatimin me rigorozitet të UMM dhe UM dhe për të siguruar mbrojtje efiksase.
- ✓ Rritjen e bashkëpunimit të vazhdueshëm të zyrave lokale të përmbarimit gjyqësor, organeve të policisë dhe njësive vendore/koordinatorët e dhunës në familje për të siguruar zbatimin efektiv të masave mbrojtëse.
- ✓ Monitorimin më specifik nga organet qeverisëse të sistemit të drejtësisë të shkaqeve për diferencën e madhe ndërmjet raportimeve në polici dhe kërkesë-padive për marrjen e masave të mbrojtjes, me numrin e vendimeve për UM/UMB aktuale që lëshohen nga gjykatat.
- ✓ Përfshirjen dhe bashkëpunimi i organeve të pushtetit vendor (shërbimet sociale, koordinatoret kundër dhunës në familje etj) për monitorimin e zbatimit të urdhrave të mbrojtjes, në përputhje me detyrimin ligjor që kanë, si dhe mbajtjen e përgjegjësisë për mospërmbushjen e këtij detyrimi.

- ✓ Ndjekjen e mëtejshme dhe sqarimin ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, komisariateve lokale dhe bashkive, për mospërputhjen e informacionit të dërguar nga Drejtoria e Policisë dhe bashkive për raportet e monitorimit të UM/UMM.
- ✓ Trajtimin në mënyrë më specifike si femicid i vrasjes së grave në marrëdhëniet familjare ose vrasja e grave në përgjithësi, në të gjithë kompleksitetin e këtij fenomeni, si dhe zbatimin me rigorozitet të procedurave të vlerësimit të riskut, në momentin e parë që raportohet apo konstatohet dhunë në marrëdhëniet familjare, për të ofruar menjëherë masa mbrojtëse të përshtatshme që shmangin vrasjet dhe format e tjera të dhunës në familje, në veçanti largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga streha e përbashkët.
- ✓ Vënien para përgjegjesisë penale dhe administrative të përfaqësuesve të institucioneve shtetërore që nuk përmbushin detyrimet ligjore për parandalimin e dhunës në familje dhe masave mbrojtëse, në veçanti kur nga mosveprimet e tyre janë shkaktuar vrasje në marrëdhëniet familjare ose dëmtime të rënda.
- ✓ Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe organeve mbikqyrëse të sistemit të drejtësisë për të trajnuar dhe monitoruar vendimet e gjykatës për masat mbrojtëse.
- ✓ Përshejtimin e procedurave të zbatimit të legjislacionit për ndihmën juridike të ofruar nga shteti për të mbushur boshllëkun disa vjeçar që krijoi zbatimi i ligjit për ndihmën juridike falas.
- ✓ Rritjen e numrit të viktimave të dhunës në familje që përfitojnë ndihmë juridike nëpërmjet fondeve publike (Drejtorisë së Ndihmës Juridike).
- ✓ Monitorimin e lëshimit të raporteve mjeko-ligjore, i cili është shumë më i vogël se numri aktual i procedimeve gjyqësore për masa mbrojtje dhe veprës penale të dhunës në familje dhe trajnime të vazhdueshme për stafin mjeko-ligjor dhe gjithë aktorët e sistemit të drejtësisë, me iniciativën e vetë institucioneve të drejtësisë për to në shkallë vendi.
- ✓ Angazhimin e organeve qeverisëse dhe monitoruese të sistemit të drejtësisë për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së vendimeve që kanë të bëjnë me masat mbrojtëse dhe procedimet penale për çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare dhe dhunës me bazë gjinore.
- ✓ Publikimin nga Ministria e Drejtësisë brenda një kohe sa më të shpejtë të të dhënave statistikore për çështjet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore për vitin 2020 dhe 2021.

3. Planifikimi dhe koordinimi i shërbimeve për të mbijetuarat në nivel qendror

- ✓ Rritjen e financimit të projekteve për ngritjen e qendrave të emergjencës nga Fondi Social, në veçanti për bashkitë ku kjo nevojë është e domosdoshme për shkak të numrit të lartë të rasteve.
- ✓ Monitorimin e projekteve për ngritjen e qendrave ekzistuese dhe përdorimi efikas i fondeve përkatëse.
- ✓ Qartësimin dhe plotësimin e të dhënave mbi shpenzimet e MSHMS për shërbime të ndryshme ndaj viktimave të dhunës në familje për të cilat janë lëshuar UM ose UMM.
- ✓ Shtimin e fondeve si dhe përcaktimin e procedurave ligjore të qarta, transparente dhe kompetitive për nën-kontraktimin e organizatave jo qeveritare nga organet e pushtetit qendror dhe vendor, për ofrimin e shërbimeve ndaj viktimave të dhunës në familje (dhe potencialisht ndaj viktimave të formave të tjera të dhunës).
- ✓ Përshejtimin e masave mbështetëse nga MSHMS për MKR-të për të siguruar një funksionim sa me efektiv të të gjithë mekanizmave, në veçanti atyre të krijuara rishtazi, për të mundësuar

- që krijimi i tyre të mos jetë thjesht një formalitet, por një mekanizëm real që trajton rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare në të gjitha zonat e vendit, përfshi ato rurale.
- ✓ Angazhimin dhe dedikimin e fondeve publike për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve për të siguruar një qëndrueshmëri të funksioneve të tyre, përtej mbështetjes që aktualisht ofrohet nga shoqëria civile, organizatat ndërkombëtare dhe donatorët.
 - ✓ MSHMS duhet të paraqesë informacion mbi masat e ndërmarra për mbështetje financiare dhe teknike për të gjithë infrastrukturën e nevojshme, në përputhje edhe me parimin e "përshtatjes së arsyeshme", që shërben për një mbështetje e plotësim të të gjitha nevojave për viktimat e dhunës në familje.
 - ✓ Nevojën për trajnime dhe mbikëqyrje të sektorit të shëndetësisë, i cili mbetet një nga sektorët ku janë shfaqur më tepër problematika në drejtim të rolit të tyre për referim të rasteve të dhunës si dhe hartimit të raporteve mjekësore mbi çdo dëmtim, të nevojshme për tu përdorur në proceset gjyqësore nga viktimat.
 - ✓ Intesifikimin e masave mbështetëse dhe monitoruese nga MSHMS për mbledhjen dhe koordinimin e sistemit të të dhënave dhe shtrirjen e sistemit REVALB në të 61 bashkitë e vendit, pasi ky shërbim aktualisht realizohet vetëm në pak më shumë se gjysmën e Bashkive në vend; hedhjen rregullisht të të dhënave nga të gjithë institucionet që kanë detyrimin ligjor, në veçanti të strukturave lokale si dhe publikimin e të dhënave në mënyrë periodike.
 - ✓ Përshejtimin e përpjekjeve për ngritjen e qendrave/programave rehabilituese për dhunuesit në të gjitha qarqet e vendit, sa më shpejt dhe përpara afatit të parashikuar në SKBGJ pasi programet aktuale janë të pamjaftueshme.
 - ✓ Nevojën për një bashkëpunim dhe koordinim ndërmjet institucioneve përkatëse, përfshi policinë, gjykatën, shërbimet e provës dhe drejtorisë së burgjeve, për identifikimin dhe përfshirjen në programet e rehabilitimit të shkaktarëve të dhunës në familje.
 - ✓ Nevojën për shtrirjen e këtyre shërbimeve edhe për shkaktarët e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore, si dhunës seksuale, ngacmimit, përndjekjes, etj.

Rekomandime në lidhje me Qendrën Kombëtare të Trajtimin të Viktimave të dhunës në Familje dhe Qendrës së Trajtimin të Viktimave të Dhunës Seksuale

- ✓ Zbatimin e menjëhershëm të standardeve të miratuara për Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje, për të siguruar të gjitha shërbimet e nevojshme, përfshi nevojat bazë të grave dhe fëmijëve që strehohen si: veshëmbathje dhe ngrohje, masat e përkujdesjes për rehabilitimin e tyre nga trauma, si dhe rritjen e kapacitetit të stafit të qendrës për njohjen e këtyre standarteve.
- ✓ Ngritjen e qendrave afatgjata për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në qarqet kryesore të vendit për të qenë të aksesueshme për të gjitha gratë, përfshi ato nga zonat rurale, si dhe të aksesueshme për gratë me aftësi të kufizuara.
- ✓ Zbatimin e menjëhershëm të standardeve të miratuara për Qendrën Kombëtare për Trajtimin e Viktimave të Dhunës Seksuale (LILIUM), në veçanti standardin bazë për ekzaminimin e rasteve në ambientet e qendrës, pasi është cënuar parimi bazë i saj për “siguri dhe dinjitet njerëzor”, mbështetjen psikologjike për viktimat, plotësimin me paisje që lehtësojnë ekzaminimet, referimin drejtpërdrejtë nga Policia në qendër të rasteve të dhunës seksuale dhe koordinimin me shërbimet e tjera mjekësore që duhet të ofrohen.

- ✓ Nevojën për ngritjen e qendrave të tjera rajonale, të specializuara për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës seksuale, pasi një qendër për të gjithë vendin, është e pamjaftueshme dhe mund të jetë e vështirë për tu aksesuar nga viktimat e dhunës seksuale që jetojnë larg vendndodhjes së saj.
- ✓ Mbështetjen e mëtejshme nga qeveria të organizatave jo qeveritare dhe strehëzave që mund të ofrojnë shërbime më afatgjata dhe të specializuara për viktimat, pasi zakonisht, edhe në vendet e tjera këto qendra janë më të specializuara dhe kanë më tepër kapacitete për t'u ofruar gjithë mbështetjen e nevojshme viktimave të dhunës seksuale.

Rekomandim për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës

- ✓ Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të zbatojë detyrimet e saja të përcaktuara qartë në legjislacionin kundër dhunës në marrëdhëniet familjare.

4. Menaxhimi i rasteve nga Mekanizmat e Referimit dhe ofrimi i shërbimeve në nivel lokal

- ✓ Marrjen e masave nga pushteti lokal për rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të MKR-ve dhe koordinatorëve lokalë për menaxhimin dhe koordinimin e rasteve të dhunës në familje dhe formave të tjera të dhunës.
- ✓ Planifikimin dhe buxhetimin e nevojshëm në nivel lokal për shërbimet e viktimave të dhunës, në mënyrë të ndarë nga shërbimet sociale, për të identifikuar specifikisht fondet e nevojshme si dhe rritur transparencën dhe përgjegjshmërinë e autoriteteve. Prioritetet buxhetore duhet të shoqërohen me identifikimin e masave konkrete për realizimin e tyre, duke pasur parasysh përfituesit direkt dhe evidentimin e tyre me shifra. Ka nevojë për ndryshimin e politikave të buxhetimit, për të bërë të mundur që fondet të jenë të përcaktuara në nivel qendror dhe lokal, pasi bashkitë e vogla nuk kanë fare fonde për të tilla shërbime.
- ✓ Vazhdimin dhe rritjen e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, të cilat janë të specializuara dhe kanë shpesh kapacitetet e nevojshme për të ndihmuar viktimat e dhunës, duke siguruar edhe bashkëfinancim të pushtetit vendor për këto organizata, për të siguruar qëndrueshmëri, përtej donatorëve të huaj dhe mbikqyrur aktivitetin e tyre rregullisht.
- ✓ Krijimin e qendrave/strehëzave të emergjencës, kostoja e të cilave nuk është detyrimisht shumë e madhe dhe bashkëpunimin me OJQ-të që ofrojnë këtë shërbim.
- ✓ Rritjen e mbikqyrjes në lidhje me veprimtarinë e koordinatorëve dhe Ekipeve Teknike Multidisiplinare nga Komitetet Drejtuese të Mekanizmave të Referimit, institucionet drejtuese të bashkive dhe atyre qëndrore që kanë në varësi zyrat vendore të disa prej anëtarëve të ENT, për të siguruar funksionimin e rregullt, në bazë të legjislacionit.
- ✓ Marrjen e masave administrative dhe penale ndaj anëtarëve të MKR-s që nuk përmbushin detyrat e tyre ligjore, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- ✓ Mbajtjen dhe përditësimin e rregullt të të dhënave për numrin e rasteve të trajtuara nga MKR-të, i cili është një element i rëndësishëm në lidhje me transparencën e bashkive dhe analizën e efektivitetit të MKR-ve dhe punës së koordinatorëve të dhunës.
- ✓ Nevojën e koordinimit të ndërsjelltë të pushtetit vendor me organet e policisë dhe ato gjyqësore.
- ✓ Sqarimin ndërmjet organeve të policisë dhe bashkive në lidhje me raportet e monitorimit për UM që bashkitë duhet t'i dërgojnë policisë, pasi vihet re një kontradiktë midis informacionit

të dhënë nga Drejtoria e Policisë, që për asnjë rast nga koordinatorët vendorë, nuk është vënë në dispozicion raport monitorimi dhe informacionit të dërguar nga bashkitë, shumica dërmuese të të cilave informojnë se e kryejnë këtë monitorim dhe përgatisin raporte, të cilat i ndajnë me policinë.

- ✓ Nevojën për krijimin e qendrave sociale që ndihmojnë riintegrimin e viktimave të dhunës në familje në shoqëri, në veçanti të atyre që për shkak të dhunës fizike, psikologjike dhe ekonomike kanë qenë të izoluar, pa mundësi për t'u angazhuar në jetën sociale dhe punësim. Këto qendra mund të krijohen specifikisht për këtë qëllim, ose të integruara me shërbime që ofrohen për grupe të tjera në nevojë.
- ✓ Bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile për shtrirjen dhe funksionimin e tyre në të gjitha rajonet e vendit dhe bashkëfinancimin e tyre.
- ✓ Mbikqyrjen e qendrave dhe paraqitjen e të dhënave specifike për përfituesit, për të identifikuar nevojat dhe efektivitetin e tyre.
- ✓ Shtrirjen e shërbimeve afatgjata dhe afatmesme për viktimat e dhunës me bazë gjinore në të gjitha bashkitë, në veçanti ato që kanë të bëjnë me mundësi punësimi, për të siguruar pavarësinë ekonomike të grave viktimave të dhunës.
- ✓ Marrjen e masave për zbatimin sa më shpejtë të detyrimeve që rrjedhin nga VKM nr. 327/2021, të 2 Qershorit 2021, *“Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij për mbështetjen e rehabilitimitin e viktimave të dhunës”* dhe në veçanti të risive të tij, duke përfshirë:
 - Detyrimin e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendorë (NVV) të trajtojnë jo vetëm rastet e dhunës në familje, por edhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore.
 - Detyrimin që në bashkitë e mëdha me mbi 200 000 (dyqind mijë) banorë të krijohet një njësi kundër dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) koordinatorë vendorë me kohë të plotë që bashkëpunojnë me nga një administrator shoqëror/punonjës social për çdo njësi administrative;
 - Krijimin e Komitetit Drejtues të MKR-s dhe mbledhja e tij së paku një herë në tre muaj në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme.
 - Rritjen e rolit mbikqyrës mbi ENT të Komitetit Drejtues dhe shtrirja e veprimtarisë në lidhje me efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës së shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor, në varësi të funksioneve e të përgjegjësive që ka secili anëtar i komitetit drejtues.
 - Organizimin e mbledhjeve të zakonshme të ENT-së çdo muaj dhe mbledhjeve të jashtëzakonshme sa herë që lind nevoja për raste konkrete të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave.
 - Detyrimin e Policisë dhe autoriteteve të tjera për të njoftuar rregullisht koordinatorin vendorë për çdo rast të raportuar dhune.
 - Realizimin për çdo rast të dhunës në familje të vlerësimit dhe menaxhimi i riskut nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në e bashkisë përkatëse.
 - Bashkëpunimin e rregullt ndërmjet Policisë dhe KVDHF për koordinimin e masave mbrojtëse afatshkurtra dhe afatgjata dhe përfshirja e koordinatorit për monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës.

4.2 Kërkesë e parashtruar nga Avokati i Popullit para Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e një dispozite ligjore, si i papajtueshëm me Kushtetutën dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Avokati i Popullit në funksion të ushtrimit të mandatit të tij kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Republikën e Shqipërisë ka parashtruar kërkesën e tij para Gjykatës Kushtetuese lidhur me:

- ✓ *Shfuqizimin e nenit 131 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si edhe*
- ✓ *Pezullimin e zbatimit të nenit 131 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, me qëllim parandalimin e pasojave që mund t’u shkaktohet shtetasve nga aplikimi i masave të veçanta nga strukturat e Policisë së Shtetit;*

dhe Subjekte të interesuara: Kuvendin e Republikës së Shqipërisë; Presidentin e Republikës së Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Kërkuesi, Avokati i Popullit, ka parashtruar¹⁶⁹ në mënyrë të përmbledhur si vijon:

Avokati i Popullit ka shprehur në vijimësi në media qëndrimin dhe shqetësimin e tij institucional lidhur me projektligjin në fjalë duke evidentuar se disa dispozita të tij kishin probleme serioze, nuk ofronin garancitë minimale të përmbushjes së standardeve kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut dhe se miratimi i tyre do të sillte si pasojë cenimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve.

Kuvendi në datën 29.10.2020 miratoi ligjin nr. 133/2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar.¹⁷⁰ Ligji ju përcoll Presidentit të Republikës për dekretim dhe shpallje, i cili në ushtrim të të drejtës së parashikuar në pikën 1 të nenit 85 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ja ka kthyer Kuvendit për rishqyrtim për arsye se shkel në mënyrë të drejtëpërdrejtë nenet 7, 17, 116 dhe 148 të Kushtetutës dhe nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ndërkohë Kuvendi me Vendimin nr. 73/2020 ka vendosur për rrëzimin e Dekretit nr. 11841, datë 20.11.2020, të Presidentit të Republikës “Për kthimin e ligjit nr. 133/2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar”. Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 217 të vitit 2020 në datën 14.12.2020 dhe ka hyrë në fuqi, 15 ditë pas botimit.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se në rastin konkret kemi një cenim të të drejtës së garantuar nga neni 8 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, e për rrjedhojë edhe cenim të të drejtave dhe garancive kushtetuese për shtetasit shqiptarë. Nga ana jonë janë pasqyruar dhe reflektuar një sërë vendimesh të GJEDNJ tqë mbartin shkelje të dispozitave dhe normave të KEDNJ, pasi në raste analoge shtetet anëtarë të Këshillit të Evropës kanë miratuar ligje apo akte të tjera, mbi bazën

¹⁶⁹ Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 30, datë 05.07.2021. Për më tepër, shih:

https://www.gjk.gov.al/include_php/previewdoc.php?id_kerkesa_vendimi=3276&nr_vendim=1

¹⁷⁰ Miratuar më datë 31.07.2014.

e të cilave janë kryer përgjime, të cilat kanë çenuar dhe shkelur të drejtat e njeriut, parashikuar në normat konkrete të KEDNJ.

Vendimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në interpretim dhe garantim të të drejtave dhe lirive themelore, përbëjnë standardin më të lartë, të cilit duhet t'i referohen Shtetet Palë në mbrojtjen e këtyre të drejtave për qytetarët e tyre, dhe nga ana tjetër *shërbejnë jo vetëm për të vendosur mbi çështjet e parashtruara, por, në përgjithësi, për të sqaruar, mbrojtur dhe zhvilluar rregullat e parashikuara nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, duke kontribuar kështu në respektimin nga Shtetet të angazhimeve të ndërmarra prej tyre si Palë kontraktuese*¹⁷¹.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka parashikuar dhe garantuar një sërë të drejtash dhe lirish themelore të njeriut, ndër të cilat edhe *E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare*¹⁷².

Qëllimi kryesor i nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut është mbrojtja nga ndërhyrjet arbitrare në jetën private dhe familjare, shtëpinë dhe korrespondencën nga një autoritet publik¹⁷³.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, ndryshimet e propozuara dhe miratuara në ligjin e sipërcituar nuk e kalonin testin e kushtetueshmërisë së normave dhe garancive të parashikuara tashmë në Kushtetutën tonë, si dhe më pas në KEDNJ, po të kemi parasysh edhe hierarkinë e akteve. Avokati i Popullit vlerëson masat e ndërmarra për goditjen e kriminalitetit, si edhe ato që parashikohen apo ndërmerren për parandalimin e tij, të cilat gjithsesi duhet të kryhen brenda hapësirave që parashikon Kushtetuta, aktet ndërkombëtare, si edhe ato kombëtare.

Në kërkesën tonë nuk kemi shprehur dhe kërkuar që Policisë së Shtetit të mos i jepet/njihet e drejta/prerogativa e marrjes së masave të veçanta me qëllim gjurmimin e subjekteve të dyshuara që potencialisht mund të rrisin aktivitetin kriminal në vend. Por, kemi vlerësuar që kjo e drejtë të ushtrohet brenda kufijve ligjorë dhe e kontrolluar nga organi i prokurorisë dhe i gjykatës duke respektuar garancitë kushtetuese e ligjore të shtetasve.

Miratimi i këtyre dispozitave të reja, në thelb ka rritur kompetencat e Policisë së Shtetit, duke i dhënë mundësinë për ta ushtruar këtë veprimtari pa kufij në subjekte dhe figura të veprave penale, jashtë kontrollit procedural të prokurorit dhe gjykatës sikurse parashikohet në Kodin e Procedurës Penale dhe pa përcaktuar detyrimin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për të asgjësuar materialet e administruara nga përgjimi me kalimin e një afati të caktuar nëse ato nuk referohen në organin e prokurorisë.

Mungesa e parashikimeve të qarta për këto kufizime dëshmon uljen e garancive procedurale. Rregulli kushtetues parashikon se askush nuk duhet të përgjohet, përjashtimisht rasteve të veçanta të rregulluara dhe parashikuara me ligj. Gjithsesi, procedurat e përgjimit i nënshtrohen gjithmonë kontrollit nga ana e organit të Prokurorisë dhe Gjykatës.

¹⁷¹ Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 154, 18 Janar 1978, Seria A nr. 25, dhe, më vonë, Jeronovičs v. Latvia [GC], nr. 44898/10, § 109, ECHR 2016

¹⁷² Titull i shtuar sipas dispozitave të Protokollit Nr 11 (ETS Nr 155).

¹⁷³ Shih çështjen e GJEDNJ *Libert v. France*, §§ 40-42.

Kjo veprimtari policore në ligjin e mëparshëm ka qenë e rregulluar në këtë mënyrë dhe për kryerjen e këtyre veprimeve Policia e Shtetit kërkonte autorizimin e prokurorit. Ndërhyrja në jetën private nuk mund të jetë abuzive dhe masive, me argumentimin e parandalimit të ndonjë krimi të mundshëm. Gjithashtu, edhe mungesa e një organi apo strukture ankimese e bën të cënueshëm dhe të diskutueshëm procesin që ndërmerret nga strukturat e policisë, duke patur parasysh edhe faktin se subjekti që i nënshtrohet një procesi të tillë nuk ka dhe nuk mund të identifikojë edhe para organeve gjyqësore një strukturë të posaçme shtetërore ndaj të cilës të mund të ngrejë pretendimet për cenim të të drejtave dhe lirive themelore të tij. GJEDNJ ka arsyetuar gjithashtu se ligji kombëtar duhet të jetë i qartë, i parashikueshëm dhe i aksesueshëm në mënyrë të përshtatshme¹⁷⁴. Theksojmë se parashikimi i garancive ligjore, si kontrolli gjyqësor para zbatimit të masave të veçanta, kohëzgjatja e aplikimit të tyre, e drejta e ankimit në gjykatë ndaj vendosjes së këtyre masave, detyrimi i organeve që kanë administruar të dhënat e grumbulluara nga aplikimi i tyre pas kalimit të një afati të caktuar, etj., janë të domosdoshme për të parandaluar arbitraritetin që, sikurse rezulton nga praktika e deritanishme, është i mundshëm nga strukturat shtetërore që kryejnë veprime sekrete si përgjimi, gjurmimi dhe mbikëqyrja e veçantë.

Në gjykimin dhe vlerësimin e Avokatit të Popullit, qartësia dhe saktësia e cunguar apo e munguar e dispozitave ligjore të parashikuara në ndryshimet e ligjit “*Për Policinë e Shtetit*”, shërben si bazë dhe indicie për shqyrtimin e kushtetueshmërisë së tyre për cenimin flagrant të të drejtave të njeriut, të mbrojtura dhe garantuara nga Kushtetuta jonë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka pohuar në mënyrë të përsëritur se çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në të drejtën e një individi për të respektuar jetën private dhe korrespondencën duhet të jetë “*në përputhje me ligjin*”. Kjo shprehje jo vetëm që kërkon pajtueshmëri me ligjin e brendshëm, por gjithashtu lidhet me cilësinë e këtij ligji, duke kërkuar që ajo të jetë në përputhje me shtetin e së drejtës¹⁷⁵. Avokati i Popullit ka shprehur dhe mban qëndrimin e tij institucional se ligji duhet t’i nënshtrohet parimit kushtetues të shtetit të së drejtës. Standardet kushtetuese nuk parashikojnë vetëm faktin që një situatë apo marrëdhënie të jetë e rregulluar me ligj, por edhe faktin që vetë ai ligj të jetë në përputhje me standarde dhe parime të tjera kushtetuese, duke theksuar këtu edhe faktin e respektimit të të drejtave të njeriut, parimit të shtetit të së drejtës dhe atij të ndarjes dhe balancës së pushteteve. Kompetenca e Kuvendit për të miratuar një ligj nuk është e pakufizuar, e në këtë kuadër Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë parashikon kufijtë e kësaj procedure e që janë shteti i së drejtës dhe respektimi i të drejtave të njeriut.

Në rastin konkret, gjykojmë se jemi para një mundësie të pakufizuar të strukturave të Policisë së Shtetit për të kryer përgjime masive, të pajustificuara ligjërisht, si dhe pa një kontroll të strukturave të Prokurorisë dhe Gjykatave. Termi i parashikuar dhe i trajtuar më lart “*në përputhje me ligjin*” duhet të parashikojë jo vetëm mundësinë e realizimit të përgjimit nga struktura kompetente, por edhe faktin që procedurat që do të ndiqen, të ofrojnë dhe parashikojnë garancitë e procesit të rregullt ligjor, parashikuar edhe nga neni 42/2 i Kushtetutës tonë dhe neni 6/1 i KEDNJ-së, me qëllim që individi të ketë dhe të mund të shfrytëzojë të gjitha garancitë dhe mjetet juridike që parashikojnë instrumentat e sipërcituar.

¹⁷⁴ Silver dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar, § 87

¹⁷⁵ Halford v. The United Kingdom, § 49

Avokati i Popullit thekson faktin se përgjimi përbën në vetvete një cenim të të drejtave dhe lirive themelore të individit, i cili duhet të ketë kufizimet dhe specififikimet e tij për mënyrën e ushtrimit të këtij kufizimi. Nga ana tjetër, edhe barra e provës i takon dhe bie përkatësisht mbi legjislatorin për të dëshmuar faktin se ky kufizim po ndjek një qëllim legjitim. Në rastin konkret, nuk ka një dëshmi të qartë për qëllimin legjitim që justifikon këtë kufizim dhe, për më tepër, ky kufizim nuk është proporcional në një kohë që parashikohet të aplikohet në ambiente të hapura publike.

Përsa i përket termave që përdoren në ligj, Avokati i Popullit vlerëson se ato ulin garancitë për mbrojtjen e individit, si dhe mund të çojë në abuzivizëm të strukturave duke mbikëqyrur dhe monitoruar pa kriter dhe kontroll të strukturave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, pra duke kufizuar të drejtën e individëve të mbrojtur dhe garantuar nga disa dispozita të Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ. Siç e theksuam edhe më sipër, kufizimi i të drejtës duhet të jetë i qartë, i parashikuar në ligj dhe proporcional me qëllimin që kërkohet të arrihet. Kufizimet lejohen nëse ato janë “*në përputhje me ligjin*” ose “*të përcaktuara me ligj*” dhe janë “*të nevojshme në një shoqëri demokratike*” për mbrojtjen e një prej objektivave të përcaktuara më sipër.

Gjithashtu është e rëndësishme të evidentojmë faktin se në Kodin e Procedurës Penale parashikohen edhe kufijtë e përgjimit i cili nuk mund të bëhet për gjitha llojet e veprave penale, sikurse i jepet kompetencë Policisë së Shtetit me ligjin nr. 133/2020. Në kundërshtim me përcaktimet e Kodit të Procedurës Penale, ligji nr. 133/2020, me parashikimet e bëra në nenin 131 të ndryshuar, tashmë i lejon Policisë së Shtetit si mbikëqyrjen e veçantë vizuale (ku mund të përfshihet sipas rastit edhe përgjimi/mbikëqyrja fotografike ose me video), edhe gjurmimin dhe mbikëqyrjen e veçantë përmes mjeteve, pajisjeve apo teknikave të veçanta për identifikimin ose lokalizimin e vendndodhjes së personave të dyshuar për kryerjen e një veprave penale. Pra, jo sipas kërkesave të Kodit të Procedurës Penale, pa vendim gjykatë dhe pa veprime paraprake të prokurorit.

Nga ana tjetër, Avokati i Popullit vlerëson se cenimi i parimit të arsyetimit të vendimit të kryerjes së përgjimit, përbën një nga shkeljet që janë parashikuar në garancitë e kuadrit ligjor në fuqi përsa i përket mbrotjes të të drejtave dhe lirive të individit. Arsyetimi i vendimit përbën një nga bazat e fillimit të procedurave respektive dhe shmangia e këtij detyrimi përbën shkak për cënim të parimeve themelore të së drejtës. Arsyetimi i vendimit gjyqësor është detyrim kushtetues, i përcaktuar qartë në nenin 142, pika (1) të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Po ashtu konstatojmë se në këtë dispozitë nuk është parashikuar kohëzgjatja, afati i zbatimit të këtyre masave të veçanta¹⁷⁶, por është parashikuar që të rregullohet me udhëzim të përbashkët të ministrit përgjegjës për rendin dhe sigurinë publike, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe të drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Edhe këtu qartësisht ulen garancitë të cilat përmbahen nga legjislacioni procedural penal në favor të qytetarëve, për shkak të ndërhyrjes dhe kufizimit të kompetencave që ka një strukturë shtetërore ndaj një tjetre, e cila mund të jetë edhe objekt i këtyre gjurmimeve në një rast të mundshëm apo të dyshuar korrupsioni, siç mund të jetë ai i një zyrtari të lartë.

¹⁷⁶ Mbikëqyrja e veçantë zanore të komunikimeve joelektronike të personave të dyshuar, mbikëqyrja e veçantë vizuale, gjurmimi dhe mbikëqyrja e veçantë e personave të dyshuar nëpërmjet përdorimit të mjeteve, pajisjeve apo teknikave të veçanta për identifikimin ose lokalizimin i vendndodhjes së tyre.

Theksojmë se, ndonëse kufizimi (cenimi) i të drejtës së privatësisë së shtetasve është bërë me ligj, nuk rezulton që ai të jetë bërë *për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve*. Interesi publik i parashtruar gjatë procedurave të miratimit të ligjit nuk është i dukshëm dhe për më tepër që nuk ofron garancitë më minimale të parashikuara dhe garantuara nga kuadri jonë kombëtar dhe ai ndërkombëtar, i cili është tashmë pjesë e korpusit tonë juridik.

Neni 8 i Konventës është neni i përpunuar në termat më të gjerë ndërmjet të gjitha neneve të Konventës. Parimi nga ku ky nen nisët është ai që një individ ka të drejtë të jetojë i lirë nga shqetësimet e shtetit, pra që privati është në një pozitë më të lartë sesa shteti në lidhje me gëzimin e kësaj të drejte.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka trajtuar dhe parashikuar parimet dhe kriteret e ndërhyrjes së shtetit përmes procedurave që aplikon për përgjimin e personave të ndryshëm, të cilat janë elaboruar konkretisht në kërkesën e parashtruar nga ana jonë. Gjykata ka pohuar në mënyrë të përsëritur se çdo ndërhyrje nga një autoritet publik në të drejtën e një individi për të respektuar jetën private dhe korrespondencën duhet të jetë “*në përputhje me ligjin*”. Kjo shprehje jo vetëm që kërkon pajtueshmëri me ligjin e brendshëm, por gjithashtu lidhet me cilësinë e këtij ligji, duke kërkuar që ajo të jetë në përputhje me shtetin e së drejtës¹⁷⁷.

Gjykata ka theksuar në vijimësi se edhe në një rast të tillë gjen zbatim po njësoj parimi themelor sipas të cilit e drejta e brendshme duhet të ofrojë mbrojtje kundër arbitraritetit dhe abuzimeve në përdorimin e teknikave të përgjimit dhe regjistrimit¹⁷⁸.

Në përfundim, Gjykata Kushtetuese pasi dëgjoi palët dhe mori në shqyrtim pretendimet e tyre, vendosi pranimin e kërkesave: Shfuqizimin e nenit 6, pika 29/1 dhe të nenit 131 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar; pezullimin e zbatimit të nenit 131 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, deri në hyrjen në fuqi të vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

4.3 Opinioni Amicus Curia¹⁷⁹, për padinë e paraqitur nga ana e paditëseve, A.A, E.M, H.M dhe A.M. në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë

Avokati i Popullit është njohur me kërkesë-padinë e paraqitur nga ana e shtetasve, A.A, E.M, H.M dhe A.M, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, me objekt: “*Ndryshimin e aktit administrativ, shkresë kthim përgjigje nr.2627/1 datë 15.04.2021 dhe detyrimin e të paditurit (Zyra Vendore e Gjendjes Civile) për të regjistruar fëmijët H.M dhe A.M, binjake të seksit femër, të lindura në 18.01.2021 në Tiranë, dhe për të regjistruar si nëna, paditëset A.A dhe E.M me të drejta të barabarta amësie në të njëjtën përbërje familjare*”.

¹⁷⁷ Halford v. The United Kingdom, § 49.

¹⁷⁸ Shih gjithashtu vendimin e 16 korrikut 2002 në lidhje me çështjen Armstrong kundër Mbretërisë së Bashkuar.

¹⁷⁹ Opinioni i plotë gjendet në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Opinion%20Amicus%20Curia.%20mbi%20k%C3%ABrkes%C3%ABn%20e%20sjell%C3%AB%20nga%20Gjykata%20Administrative%20e%20Shkall%C3%ABs%20s%C3%AB%20Par%C3%AB%20Tiran%C3%AB.%20p%C3%ABr%20padin%C3%AB%20e%20paraqitur%20nga%20ana%20e%20padit%C3%ABs%20eve.%20A.%20A.%20E.%20M.%20H.%20M.%20dhe%20A.%20M..pdf>

Pretendimet kryesore të parashtruara në këtë kërkesë-padi:

- Paditëset A.A dhe E.M janë të lidhura mes tyre në një bashkim fakti prej më shumë se 10 vitesh, nga ku prej më shumë se 7 vitesh bashkëjetojnë. Ato kanë konceptuar që në fillim jetën dhe familjen së bashku, pavarësisht mungesës në legjislacion të njohjes të së drejtës për martesën, apo të bashkëjetesës, mes të njëjtës gjini.
- Gjatë bashkëjetesës faktike, zgjerimi i familjes nga ana e tyre është dëshiruar dhe realizuar me ardhjen në jetë të 2 fëmijëve binjake, vajza, në datë 18.01.2021, nga shtatëzania e zhvilluar nga ana e shtetases E.M, përmes metodave të inseminimit artificial.
- Megjithëse, paditëset A.A dhe E.M (H.M dhe A.M), kanë shprehur vullnetin e tyre për të regjistruar fëmijët e lindur me inseminim artificial nga ana e E.M, duke kërkuar njëkohësisht që të njihen dhe regjistrohen me cilësinë “nënë”, në regjistrin përkatës të zyrës së gjendjes civile, ato e kanë të pamundur të kryejnë këtë regjistrim, pasi një kërkesë e tillë është refuzuar me shkresën nr.2627/1 datë 15.04.2021, nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, me arsyetimin ndër të tjera se, *nuk mund të regjistrohen fëmijë të lindur nga prindër të së njëjtës gjini, pasi kjo gjë nuk është e njohur shprehimisht nga ligji.*

Analiza e paraqitur e fakteve dhe provave, nga ana e paditëseve:

- Sipas *Konventës për të Drejtat e Fëmijës* (neni 7 dhe neni 54), fëmija regjistrohet menjëherë sapo lind dhe qysh atëherë ka të drejtën të ketë një emër, të drejtën për të fituar një shtetësi dhe, brenda mundësive të drejtën për të njohur prindërit e tij dhe për të pasur kujdesin e tyre. Kjo e drejtë, sipas paditëseve, iu mohohet paditëseve të mitura H.M dhe A.M, për shkak të mungesës së parashikimeve ligjore për njohjen e familjeve dhe të prindërve të së njëjtës gjini. Kjo pamundësi regjistrimi bie ndesh me Kushtetutën dhe parimin e mbrojtjes së veçantë që duhet të gëzojnë nga shteti fëmijët dhe nënat e reja.
- Sipas *Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut*, çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare (neni 8), por njëkohësisht edhe Kushtetuta (neni 53) sanksionon se kushdo ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. Në këto rrethana, paditëset A.A dhe E.M, gjenden në një situatë ku asnjëri prej ligjeve vendase nuk i ofron siguri juridike për mbrojtjen efektive të të drejtave të tyre dhe respektimin e jetës private dhe familjare, të drejtën për të pasur familje. Ato aktualisht “de facto” kanë krijuar familjen e tyre e kanë sjellë në jetë fëmijë.
- *Ligji nr.10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar*, në nenin 8, parashikon se: *“Lindja, gjinia, emri e mbiemri, raportet e atësisë, amësisë dhe shtetësia njihen e mund të hiqen, të shuhen, të ndryshojnë ose t’u kalojnë të tjerëve vetëm në rastet e në mënyrën e përcaktuar shprehimisht në këtë ligj, apo në çdo ligj tjetër të veçantë”*. Megjithatë, ky ligj nuk parashikon se si do të shënohen/njihen përbërësit e gjendjes civile, të paditëseve H. dhe A., nga dy nëna.
- Pavarësisht përcaktimit të dhënë në nenin 10, të Ligjit nr.10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar, dhe megjithëse paditëset A.A dhe E.M gjenden para një fakti tashmë të krijuar, pasi kanë konceptuar familjen e tyre, ligji nuk e njeh këtë fakt juridik, pra lindjen e paditësve H. dhe A., nga dy nëna.

- Megjithëse Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (neni 12), si dhe *Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë* (neni 7 dhe neni 163), e lidhin konceptin e martesës por edhe të bashkëjetesës në mënyrë të drejtëpërdrejtë me bashkim mes një burri dhe një gruaje, *Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut* e ka orientuar çështjen drejt parimit të subsidiaritetit duke sugjeruar një interpretim evolutiv të Konventës dhe duke ju referuar legjislacioneve të brendshme të vendeve të Këshillit të Europës, që kanë pranuar në legjislacionet e tyre të brendshme bashkime të tilla.
- Edhe pse kërkimi i paditëseve nuk lidhet me të drejtën e tyre për t'u martuar, paditëset A.A dhe E.M kanë krijuar “de facto” familjen e tyre dhe kanë lindur fëmijët e tyre, H. dhe A.
- Mbi këtë bazë kërkohet ndryshimi i aktit administrativ, përkatësisht i shkresës nr.2627/1 datë 15.04.2021, nga ana e Zyrë së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, dhe detyrimi i kësaj zyre për të regjistruar fëmijët H.M dhe A.M, binjake, të lindura në datën 18.01.2021 dhe për të regjistruar si nëna paditëset A.A dhe E.M, me të drejta amësie, në të njëjtën përbërje familjare.
- Po kështu, meqenëse legjislacioni në fuqi, i Republikës së Shqipërisë, që rregullon regjistrimin e amësisë nuk rregullon krijimin e marrëdhënieve të amësisë për shkak të vullnetit të përbashkët të nënës biologjike me bashkëjetuesen e saj, i kërkohet gjykatës të vlerësojë shqyrtimin e çështjes nën dritën e nenit 145, të Kushtetutës, pezullimin e gjykimit dhe dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese.

- **Legjislacioni rregullator në fuqi:**

Legjislacioni rregullator në fuqi, i referohet *Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventës për të drejtat e fëmijës*, si dhe me një konsiderim specifik të së *Drejtës Familjare dhe Kodit të Familjes të Republikës së Shqipërisë*.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 53 dhe 54) njeh dhe afirmon mbrojtjen e veçantë për institutin e martesës dhe njëkohësisht të së drejtës që kushdo ka për t'u martuar. Familja afirmohet si një formacion i rëndësishëm social për shoqërinë, duke gëzuar mbrojtjen e veçantë të shtetit. Kushtetuta shprehet për garantimin e një mbrojtjeje të veçantë për fëmijët dhe nënat e reja, duke njohur dhe barazuar të drejtat e fëmijëve të lindur jashtë martese me të drejtat e fëmijëve të lindur nga martesa. Qartësisht Kushtetuta nuk shprehet drejtëpërdrejtë në lidhje me ndalimin e martesave të të njëjtit seks, pavarësisht se kuptimi i parë, i përgjithshëm dhe i natyrshëm i gjithkujt mbetet se martesa është lidhja midis një burri edhe një gruaje. Ndërkohë Kushtetuta referon lidhjen dhe zgjidhjen e martesës në Kodin e Familjes, ku edhe bëhen parashikimet ndaluese.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në nenin 8 dhe nenin 12, parashikon respektivisht të Drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare si dhe të Drejtën për t'u martuar.

Konventa për të drejtat e fëmijës, jep përcaktimin e kuptimit të nocionit « fëmijë » - neni 1, konsideratën parësore që e gjithë veprimtaria shtetërore, duhet të ketë ndaj interesit më të lartë të fëmijës - neni 3 dhe neni 5, afirmon dhe sanksionon të drejtat e fëmijës për regjistrimin menjëherë sapo lind, të drejtës së emrit, të drejtës për të fituar shtetësi për të njohur prindërit e tij dhe për të

pasur kujdesin e tyre – neni 7, si dhe detyrimin e respektimit të së drejtës së fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, emrin dhe lidhjet familjare që njihen me ligj pa ndonjë ndërhyrje të paligjshme- neni 8. Konceptet bazike të kësaj konvente janë pasqyruara edhe në *Ligjin nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”*.

Në të Drejtën Familjare dhe Kodin e Familjes së Republikës së Shqipërisë, Familja është njësi themelore dhe natyrore e shoqërisë. Pra familja është njësi bazë e shoqërisë dhe njësi themelore natyrore, origjina e së cilës nuk lidhet me ekzistencën e shtetit. Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë, nuk ka një përkufizim fundor për familjen, veç faktit se familja është grupi i personave të lidhur ndërmjet tyre në një lidhje të veçantë. *Familja ligjore krijohet mbi bazën e martesës*.

Sa i takon marrëdhëniet familjare duhet saktësuar fakti se, Kodi i Familjes i kupton si marrëdhënie që krijohen nga martesa, birësimi, kujdestaria dhe krushqia.

Kur flasim për anëtarësi të familjes, sipas të drejtës familjare të Republikës së Shqipërisë, do të kuptohet gjithë rrethi i personave me lidhje të tillë gjinore ose ligjore, e cila konsiderohet si ndalesë për lidhjen e martesës (familja në kuptimin e gjerë – *communi iure*). Ndërsa për familjen në kuptimin e ngushtë - *proprio iure*, familja përbëhet nga bashkëshortët dhe fëmijët e tyre të lindur ose të birësuar. Koncepti i familjes dhe i jetës familjare ka njohur zhvillime të cilat ecin paralel me ndryshimet shoqërore dhe ligjore, sidomos në kushtet kur po zhvillohet instituti i bashkejetesës së çifteve, pa martesë. Familja e bazuar në martesë nuk është e vetmja alternative për të gëzuar jetën familjare. Megjithatë flasim për gëzimin e jetës familjare edhe në rastin e marrëdhëniet midis një nëne dhe fëmijës së saj, pavarësisht nga statusi i saj martesor. Gëzojnë jetë familjare çiftet e pamartuara së bashku me fëmijët e tyre. Jeta familjare ekziston edhe në rastet e mungesës së lidhjeve të gjakut.

E drejta për jetë familjare dhe e drejta për të pasur familje. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, kushdo ka të drejtë të ketë familje, aq më shumë fëmijët, të cilët, për të pasur një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, kanë të drejtë të rriten në një mjedis familjar, në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi (neni 5, i Kodit të Familjes). Në rast të pamundësisë së ofrimit të jetës familjare nga familja natyrore, kuadri ligjor parashikon “familjen kujdestare”, si një familje alternative, e vendosur nga gjykatat në rastet kur prindërit e fëmijëve janë në pamundësi për të ushtruar përgjegjësinë prindërore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk ka një parashikim të veçantë lidhur *me parimin e interesit më të lartë të fëmijës*, megjithëse në nenin 54/1 të saj parashikohet se, fëmijët, ashtu sikurse martesa dhe familja, gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Konsiderata parësore e interesit më të lartë të fëmijës është kryesisht detyrë e prindërve, si edhe e organeve kompetente dhe e gjykatave, të cilat në të gjitha vendimet dhe veprimtaritë e tyre duhet të kenë në qendër të vëmendjes, pikërisht këtë interes.

Sipas nenit 5, të Kodit të Familjes, çdo fëmijë, për një zhvillim të plotë dhe harmonik të personalitetit, ka të drejtë të rritet në një mjedis familjar (elementët subjektivë e objektivë që e kompozojnë familjen), në një atmosferë gëzimi, dashurie dhe mirëkuptimi.

Martesa, premisën e realizimit të saj e ka tek gëzimi i së drejtës për t’u martuar nga ana e individit që qëllimon lidhjen në martesë. Sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (nenit 53), kushdo

ka të drejtë të martohet dhe të ketë familje. Sipas legjislacionit tonë, martesë, si një bashkim vullnetar ndërmjet një burri dhe një gruaje duhet të jetë, një bashkim monogam; një bashkim heteroseksual; një bashkim i lirë dhe vullnetar; një bashkim potencialisht i përjetshëm (pa afat); bashkim ndërmjet personave që kanë arritur një moshë të përcaktuar; një bashkim i realizuar publikisht para nëpunësit përgjegjës shtetëror dhe si një bashkim që mbështetet si bashkësi morale, shpirtërore dhe materiale, që lidhet me pëlqimin e lirë të bashkëshortëve. Edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta për martesë i njihet vetëm një çifti heteroseksual, që dëshiron të martohet dhe të krijojë familje. Diversiteti i sekseve është parashikuar si parim jo vetëm për martesën në legjislacionin tonë në fuqi, por edhe për bashkëjetesën e faktit. Familje kemi edhe atëherë kur çifti bashkëjeton, duke evidentuar kështu një formë të re, të jetës familjare. Ligjvënësi duke mos parashikuar si pengesë të mundshme ligjore, seksin e njëjtë për lidhjen e martesës, ka injoruar plotësisht ekzistencën dhe mundësinë e lidhjes së këtyre lloj martesave.

Amësia dhe atësia e fëmijës (prejardhja). Këto së bashku me emrin, mbiemrin, shtetësinë, kombësinë dhe përbërës të tjerë të gjendjes civile janë të dhëna personale të personit, dhe të drejta jopasurore që mund ti gëzojë vetëm qenia njerëzore që ka lindur gjallë. Atësia dhe amësia janë elementë të rëndësishëm për të përcaktuar edhe origjinën dhe përkatësinë familjare të një personi, përfshi këtu edhe raportet prindërore. Sipas nenit 165, të Kodit të Familjes, “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur nga martesë provohet nga akti i lindjes, i regjistruar në regjistrin e gjendjes civile”. Në nenin 34 të ligjit “Për gjendjen civile”, deklarimi i lindjes së fëmijës është veprimi i detyrues që kushtëzon përpilimin e aktit të lindjes. Po ky ligj përcakton se si rregull, deklarimi i lindjes së fëmijës bëhet nga njëri ose të dy prindërit e tij, por në ligj është parashikuar që ky deklarim mund të bëhet edhe nga persona të tjerë, të lejuar nga ligji.

Sipas të drejtës sonë familjare, konsiderohet fëmijë i lindur jashtë martesë, fëmija i lindur nga një grua e panjohur, nga një grua që nuk ka qënë e martuar ligjërisht asnjëherë, ose kur kanë kaluar më shumë se 300 ditë nga martesë e saj e fundit, ose kur me vendim të formës së prerë i është ç’njohur atësia që i ishte përcaktuar nga zbatimi formal i ligjit. Sipas nenit 170, të Kodit të Familjes: “Amësia dhe atësia e fëmijës së lindur jashtë martesë mund të vendosen me anë të njohjes vullnetare ose nëpërmjet një vendimi gjyqësor...”. Zhvillimet shkencore në fushën e shëndetësisë si inseminimi artificial, nxjerrin nevojën jo vetëm të rregullimit ligjor sa më të detajuar, lidhur me mënyrat e përdorimit të këtyre zbulimeve shkencore në favor të shtetasve, por edhe për mënyrat e përdorimit të tyre si fakte e prova në procesin e përcaktimit ose të vërtetimit të amësisë dhe të atësisë së një fëmije të regjistruar pa amësi e atësi, të atyre të lindur jashtë martesë, si dhe për kundërshtimin e tyre.

Prind bëhesh për shkaqe natyrore ose juridike (birësimi). “Prindi ligjor i fëmijës” përcaktohet si personi ose personat (jo më shumë se dy, të sekseve të kundërta), pra ai/ajo (ata), i cili (e cila) është njohur si i tillë/e tillë në një mënyrë të përcaktuar nga ligji. Në këtë mënyrë për shkak të interesit më të lartë të fëmijës, ndodh që marrëdhëniet me prindin, prindëria (qenia prind) dhe përgjegjësitë prindërore krijohen ose lindin që në çastin e lindjes së fëmijës ose të vendosjes së birësimit dhe me kalimin e kohës këto raporte të krijuara forcohen. Si duhet të kuptohet përkatësia

prindërore në rastin e zbatimit të teknikave të riprodhimit mjekësor të asistuar, që sjellin paqartësi në lidhje me faktin se cilët janë prindërit biologjikë e aq më shumë, prindërit ligjorë të fëmijës? Qëllimi i zbatimit të këtyre teknikave, të riprodhimit mjekësor të asistuar, është që ti përgjigjet kërkesës dhe të drejtës së një individi ose të në çifti, i cili nuk arrin shtatzani, për të pasur fëmijë. Sipas rregullimeve të ligjit “Për shëndetin riprodhues”, një nga teknikat e përdorura për inseminim artificial, është ai që njihet si, “inseminimi jashtëmartesor”. Ky rast njihet si i tillë pasi ndodh kur bëhet fjalë për ti dhënë një fëmijë një çifti të palidhur në martesë, ose një gruaja të vetme. Ndërsa praktika botërore njih edhe raste të këtij inseminimi për çiftet e homoseksualëve, realiteti ynë ligjor nuk e njih dhe nuk bën fjalë për dhënien e një fëmije një çifti homoseksualësh. Kjo pasi martesa dhe bashkëjetesa njohin parimin e heteroseksualitetit. Nëse gruaja e pamartuar e bën këtë trajtim vetëm, dhuruesi i semeneve nuk trajtohet si baba i fëmijës dhe sipas ligjit ky fëmijë quhet “pa baba”. Në fakt nuk ka një rregullim të plotë ligjor në legjislacionin aktual lidhur me këto raste.

Nga një vështrim i kujdesshëm i përcaktimeve ***të ligjit nr.10129 datë 11.05.2009 “Për gjendjen civile”, i ndryshuar***, veç të tjerash mund të thuhet se, ky ligj nuk u ka dhënë zgjidhje rasteve kur nëpunësi i gjendjes civile refuzon të pranojë deklarinimin, të përpilojë aktin e lindjes së fëmijës ose edhe ta regjistrojë atë.

- ***Bazueshmëria dhe përmbajtja e padisë së paraqitur nga paditëset, A.A, E.M, H.M dhe A.M:***
- Shkresa nr.2627/1 datë 15.04.2021, “Kthim përgjigje”, e Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, është një akt administrativ, individual.

Situata e krijuar nga kërkesa e paraqitur nga ana e shtetaseve A.A dhe E.M, në Zyrën e Gjendjes Civile, të Njesisë Administrative nr.2, Tiranë, gjendet në kushtet e nenit 95, të Kodit të Procedurave Administrative ku thuhet se: “Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”.

- Pa paragjykuar aspak të drejtën e paditëseve A.A dhe E.M, për të ndërtuar një jetesë të përbashkët, sikurse kemi analizuar më sipër, Kodi i Familjes si dhe legjislacioni i familjes në tërësi në Republikën e Shqipërisë, nuk njih të drejtën e martesës ndërmjet dy personave të të njëjtës seks, apo edhe bashkëjetesën faktike që mund të ndodhë ndërmjet tyre.

Madje mund të thuhet se, mosparashikimi në ligj, qoftë edhe si pengesë e mundshme për lidhjen e martesës apo njohjen e bashkëjetesës në këto kushte mund të konsiderohet si një mungesë e plotë e mundësisë ligjore që legjitimon sadopak një eveniment të tillë jetësor mes dy personave të së njëjtës gjini.

Kjo lloj bashkëjetese faktike e konsideruar si e tillë prej paditëseve, por jo nga ligji, ka shërbyer sipas konceptit të paditëseve për të krijuar një familje dhe jetë familjare të caktuar, ndërmjet tyre.

Paditëset kanë paralelizuar kuptimin e një marrëdhënieje fakti, në këto kushte, të pa njohur nga legjislacioni i familjes, duke i dhënë kësaj marrëdhënieje të gjitha atributet e një bashkëjetese fakti të njohur nga ligji, për të kërkuar dhe pretenduar të drejtat dhe legjitimuar pasojat që ligji parashikon në këto raste. Sipas këtij koncepti të përdorur nga paditëset, tashmë marrëdhënia e tyre ka krijuar një familje dhe një jetë familjare.

- Duke konsideruar të mirëqënë krijimin e një familjeje, nga një bashkim faktik në këto kushte, shtetaset A.A dhe E.M, kanë dëshiruar ardhjen në jetë të fëmijëve, anëtarë të “familjes së tyre në kuptimin e ngushtë”. E thënë ndryshe, dhe në kuptim të legjislacionit të familjes, paditëset kanë dashur të jenë prindër të këtyre fëmijëve dhe të fitojnë edhe përgjegjësi prindërore ndaj tyre.

Sikurse është sqaruar më sipër, nëse praktika botërore njih edhe raste të inseminimit për çiftet e homoseksualëve, realiteti ynë ligjor nuk e njih dhe nuk bën fjalë për dhënien e një fëmije një çifti homoseksualësh, pasi martesë dhe bashkëjetesa njihin parimin e heteroseksualitetit. Po të shihet me kujdes, në rastin e inseminimit jashtëmartesor, si një teknikë e përdorur në këtë rast nga ana e shtetases E.M, do të mjaftonte vetëm pëlqimi i dhënë nga ana e kësaj shtetaseje për të kryer këtë teknikë. Kjo sepse edhe vet ligji në përcaktimet e tij përdor terminologji të tilla si “individ”, “bashkëshortë”, duke mos lënë vend për trajtimin e një kërkesë të tillë nga një çift i të njëjtit seks.

- Duke kërkuar regjistrimin me cilësinë “nënë” të dy paditëseve, para punonjësit të Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Administrative nr.2, Tiranë, përtej veprimit teknik të regjistrimit të fëmijës, paditëset kanë dashur të legjitimojnë të dhëna që lidhen me origjinën e fëmijëve dhe përkatësinë familjare të tyre, përfshirë këtu edhe raportet prindërore.

Legjislacioni ynë i familjes njih vetëm atësinë dhe amësinë si elementë bazikë të prejardhjes së fëmijës. Sikurse kemi theksuar më lart, konsiderohet fëmijë i lindur jashtë martese ai fëmijë që është lindur nga një grua e cila në momentin e konceptimit dhe të lindjes nuk rezulton e martuar, në aktet e saj të gjendjes civile. H.M dhe A.M, janë fëmijë të lindur jashtë martese. Në këto rrethana, kërkesa e parashtruar nga paditëset do të refuzohej nga ana punonjësit të zyrës përkatëse të gjendjes civile.

- A përbën pengesë legjislacioni ynë në fuqi për regjistrimin e H. dhe A., me prindin/prindët e njohur si të tillë nga ligji? Mendojmë që jo.

Pamundësia për të regjistruar “dy amësinë”, nuk do të thotë se, ligji nuk mundëson kryerjen e veprimit administrativ për regjistrimin në regjistrin e gjendjes civile të fëmijëve të sapolindur, me njohjen dhe regjistrimin e nënës së tyre biologjike (E.M), duke mos deklaruar atësinë së tyre. E megjithatë, a bie kjo ndesh me Kushtetutën dhe parimin e mbrojtjes së veçantë që duhet të gëzojnë nga shteti fëmijët dhe nënat e reja? Mendojmë që ndonëse në pamje të parë duket se jo, kjo çështje

ka nevojë të trajtohet më gjerësisht dhe duhet të krijohet balanca të reja dhe më gjithëpërfshirëse në shoqërinë tonë. Të drejtat e fëmijëve të porsalindur qartësisht mbrohen më mirë nëse ato kanë lidhje familjare për shkak të ligjit me 2 prindër, sesa vetëm një prind, e konkretisht atë të lidhjes së sigurtë të gjakut që është nëna biologjike. Ky parim është balancuar për fëmijët që lindin gjatë martesës (duke iu prezumuar atësia), apo edhe atyre që lindin për një afat të caktuar kohor pas zgjidhjes së martesës duke prezumuar si at, ish bashkëshortin e nënës. Këto parashikime në kod kanë qëllim mirërritjen e fëmijës dhe interesin e tij më të lartë, që të ketë kujdesje prindërore nga dy prindër pasi kjo gjë përbën për ta një garanci të shtuar për jetën e tyre aktuale por edhe në të ardhmen. Ndërsa, dy paditëset kanë qënë apo janë koshiente në lidhje me të drejtat e detyrimet e tyre apo dhe me rrezikun potencial të një mënyre jetese e cila nuk mund të formalizohet sipas legjislacionit aktual në fuqi, e njëjta gjë nuk është e vërtetë për të miturat A. dhe H. për sa ato kanë të drejtë tu garantohet edhe ligjërisht lidhja me partneren e nënës, si kontribuese në mirërritjen e tyre, përse ajo e kërkon një gjë të tillë.

- Pa dashur të paragjykojmë, duket sikur mundësia apo kërkesa për të gëzuar të drejtën për të pasur një jetë familjare nga ana e dy paditëseve që kërkojnë që të regjistrohen njëkohësisht në gjendjen civile si nëna, të dy vajzave të sapolindura, po vendos në balancë interesin më të lartë të fëmijës për tu regjistruar në regjistrin e gjendjes civile, qoftë edhe vetëm me njohjen e prejardhjes nga nëna e tyre biologjike.

Fakti që fëmija i porsalindur përfaqësohet në këto procedura nga prindët e tij, sipas kuptimit të dhënë ligjor për prindin në këtë rast, nuk mundet që t'i japë prindit (nënës biologjike) të drejtën për të mbivendosur dhe dhënë përparësi, realizimit të qëllimit të bashkëjetesës me një person tjetër, qoftë edhe i të njëjtit seks, ndaj interesit më të lartë të fëmijës që lidhet me të drejtën e fëmijës për regjistrim menjëherë pas lindjes, nga ana e prindit/prindërve, apo personave të tjerë të autorizuar nga ligji, brenda afateve ligjore. Në këtë kuptim të drejtat ligjore të prindërve duhet të trajtohen në mënyrë të balancuar me të drejtat ligjore të fëmijëve dhe duhet bërë kujdes në prioritetin e të drejtave të fëmijëve.

A duhet domosdoshmërisht që regjistrimi i fëmijës së porsalindur të lidhet detyrimisht edhe me njohjen e detyruar të “dy amësisë”, sikurse kërkohet nga ana e paditëseve?

Mendojmë që në rastin objekt gjykimi, pavarësisht të drejtës dhe mundësive të barabarta që duhet tu japë shoqëria jonë fëmijëve për të pasur 2 prindër, interesat e tyre do të ishin të mbrojtura më mirë duke bërë regjistrimin e tyre në formën që është e mundur dhe duke e kundërshtuar atë pjesërisht vetëm në lidhje me mosgarantimin e regjistrimit si familje për shkak të ligjit edhe të partneres së nënës biologjike.

Legjislacioni ynë i familjes nuk lejon regjistrimin e dy nënave si prindër të një fëmije në regjistrin e gjendjes civile, ndaj në këtë kontekst duhet mbajtur parasysh edhe fakti se gjykata nuk krijon normë të re, por interpreton dhe zbaton legjislacionin në fuqi, përkatës, për rregullimin e çështjes në gjykim. Në këtë kontekst mendojmë se qasja duke u nisur nga gjinia në lidhjet familjare duhet

të rivlerësohet në shoqërinë tonë për të përfshirë në të edhe realitetet e personave të cilët nuk do të donin të identifikonin në regjister indentitetin tyre gjinor në marrëdhënie me fëmijën. Përfshirja e mundësisë për tu identifikuar pa specifikuar gjininë, por vetëm me fjalën prind është një e drejtë e cila vë theksin në realitetin afektiv që krijojnë anëtarët e një familjeje ligjore apo familje fakti me fëmijët dhe me afeksionin e detyrimet që ata marrin përsipër ndaj femijes. Shoqëria jonë ka evolur dhe siç e thamë më lart në evoluimin e konceptimit të fëmijës, prindit, prindërimit dhe përgjegjësisë për mirërritjen e tyre, duke marrë përsipër shteti mirërritjen kur nuk i kanë prindërit apo kur prindërit nuk i mirërrisin dot. Ndërkohë, në rastin objekt gjykimi, shoqëria shqiptare, për një artificë rrezikon t'ua garantojë këtë të drejtë bebeve A. dhe H.

Në vlerësimin tonë, mendojmë se legjislacioni aktual në fuqi e shkel të drejtën e pretenduar të krijimit të marrëdhënieve të amësisë. Ai shkel gjithashtu edhe të drejtën e fëmijëve H. e A. për të pasur një prind ligjor krahas nënës biologjike. Legjislacioni ynë në evolim të të drejtave të fëmijës apo edhe njeriut ka pranuar në parim të drejtën e një fëmije për tu rritur në një familje dhe ua garanton atyre të drejtën me anë prezumimit për të pasur baba ligjor, apo edhe familje birësuese, apo prind birësues. Fëmijët e lindur me inseminim nga një nënë e vetme me parterë femër, nuk përfitojnë të njëjtat garanci e nën këtë këndvështrim mendojmë se ka nevojë për të pasur një gjykim incidental në lidhje me këtë çështje, si përsa i përket të drejtës për të pasur kujdesin e prindit ligjor, ashtu edhe trajtimit të barabartë të fëmijëve me specifikat e paditëseve H. dhe A. në krahasim me ato fëmijë tjetër të lindur me apo pa baba biologjik.

Edhe duke iu referuar të drejtës për jetë familjare, respektimin e saj si dhe një kontekst diskriminimi në trajtimin e çiftëve të të njëjtit seks, jemi të mendimit se Gjykata e Strasburgut ka një vlerësim dinamik ende në proces lidhur me këto çështje, sa i takon respektimit të nenit 8 dhe nenit 14, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Referuar specifikës së rastit që kemi analizuar, jemi të mendimit se, vendimi që do të nxjerrë kjo gjykatë për Çështjen C-490-20, Case C-2/21, Rzecznik Praw Obywatelskich, do të jetë një “gur kilometrik” referues edhe për gjykatat në vendin tonë.

Në vlerësimin e kësaj çështjeje, gjykata do të duhet që përballë argumenteve të paditësve që kërkojnë në thelb pranimin e realiteteve të reja sociale, të vendosë përballë argumentet e interesit publik në një shoqëri demokratike dhe të konsiderojë gjetjen e një balance të drejtë dhe proporcionale mes tyre. Ne mendojmë se ka nevojë për një interpretim evolutiv të të drejtave të fëmijës për ti garantuar ato në mënyrë efektive.

4.4 Kontributi i dhënë nga institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë procesit të Reformës në Drejtësi

Ashtu si edhe në vitet e mëparshme, edhe këtë viti institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje të posaçme zbatimin e Reformës në Drejtësi në përgjithësi dhe veçanërisht veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (më poshtë KED).

Në zbatim të nenit 149/d, pika 3, të Kushtetutës, sipas të cilit: “...Avokati i Popullit merr pjesë si vëzhgues në procedurën e hedhjes së shortit, si dhe në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, si dhe konform nenit 233, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, sipas të cilit: “1. Mbledhjet e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi janë të mbyllura. Avokati i Popullit merr pjesë në mbledhjet dhe veprimtarinë e Këshillit. ...” roli i institucionit tonë ka qenë i dyfishtë, jo vetëm si institucion Kushtetues i parashikuar për mbrojtjen dhe garantimin e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut, por edhe si një institucion të cilit Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni për Reformën në Drejtësi, i kanë dhënë rol dhe kompetenca të posaçme në këtë proces.

Në vijim të sa më sipër, institucioni ynë fillimisht ka qenë prezent në hedhjen e shortit për zgjedhjen e anëtarëve të KED, bazuar në detyrimet e parashikuara nga neni 221, pikat 7 dhe 11, si dhe neni 284 pika 6, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, sipas të cilave: “Presidenti i Republikës, në prani të Avokatit të Popullit, përzgjedh anëtarët e Këshillit me short, midis datës 1 dhe 5 dhjetor të çdo viti kalendarik. ...”, “Avokati i Popullit bën menjëherë publik në faqen zyrtare të institucionit raportin e monitorimit të procesit të shortit”. Në përfundim të këtij procesi, i cili në vlerësimin tonë u krye në përputhje të plotë me ligjin, u hartua e publikua edhe raporti përkatës i monitorimit, mbi procedurën e hedhjes së shortit për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për vitin 2022, zhvilluar nga Presidenti i Republikës në datën 03.12.2021¹⁸⁰.

Po sipas detyrimeve kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara, institucioni ynë ka marrë pjesë në të 25 (njëzetepesë) mbledhjet e KED-së të zhvilluara gjatë vitit 2021, duke u përpjekur të ushtrojë sa më mirë detyrat e përcaktuara nga legjislatori (mendimet e dhëna nga institucioni ynë, janë publikuar të përmbledhura në proces-verbalet e mbledhjeve të KED-së)¹⁸¹.

Disa nga çështjet kryesore, të evidentuara nga institucioni ynë gjatë veprimtarisë së KED 2021, kanë qenë: a. *Mosparashikimi i buxhetit të nevojshëm për kryerjen si duhet të detyrës*; b. *Nevoja për burime njerëzore shtesë të stafit ndihmës*; c. *Kriteret ligjore për t'u përzgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese*.

a. *Për sa i përket buxhetit*, pavarësisht se ky problem është ngritur nga institucioni ynë edhe më parë, sërish për KED-në 2021 u përsëritën të njëjtat probleme. Në vlerësimin e institucionit tonë, nisur edhe nga situata në të cilën ishte Gjykata Kushtetuese kur u hartuan ndryshimet Kushtetuese (kujtojmë se disa vite më parë kjo Gjykatë kishte mungesa aq të mëdha në numër, sa nuk arrihej as kuorumi i nevojshëm për funksionimin e saj), do duhej të ishte parë më me kujdes çështja e buxhetit të këtij organi. Pra, pavarësisht se KED i parashikuar në Kushtetutë si Institucion i veçantë, për të nuk u parashikua fond direkt dhe i veçantë nga buxheti i shtetit.

Bazuar në parashikimin e nenit 219, pika 3, të ligjit nr. 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, sipas të cilit: “3. Gjykata e Lartë siguron mbështetjen e nevojshme organizative, administrative dhe **financiare** për realizimin e funksionit dhe të detyrave të Këshillit

¹⁸⁰<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20per%20hedhjen%20e%20shortit%20te%20KED%20-Dhjetor%202021.pdf>

¹⁸¹http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Procesverbale_te_mbledhjeve_8069_1.php

të Emërimeve në Drejtësi, të parashikuara në Kushtetutë dhe në këtë ligj”, institucioni Kushtetues i KED nuk ka një zë të veçantë në buxhetin e shtetit, ashtu siç ndodhi me organe të tjera¹⁸².

Shtojmë se edhe vetë parashikimi i buxhetit të Gjykatës së Lartë, nuk paraqitet drejtëpërdrejt në Kuvend, por kalon nëpërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe është ky i fundit që e përcjell në Kuvend, procedurë kjo që gjithashtu vështirëson marrjen e buxhetit të nevojshëm nga KED. Është e rëndësishme të ndreqet një problematikë e tillë, pasi KED nuk është në varësinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe rrjedhimisht s’mund të varet për buxhetin e saj nga ky Këshill.

b. Për sa i përket nevojave për burime njerëzore shtesë të stafit ndihmës, kujtojmë se në zbatim të nenit 149/d, pika 5, të Kushtetutës, sipas të cilit: “5. Gjykata e Lartë krijon kushtet e punës për funksionimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Drejtësisë” dhe nenit 230, pika 2, të ligjit 115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, ku thuhet se: “Kryetari i Këshillit, në bashkëpunim me Kryetarin e Gjykatës së Lartë, cakton, nga radhët e personelit administrativ të Gjykatës së Lartë, një numër të arsyeshëm punonjësish administrativë për të lehtësuar përmbushjen e detyrave të Këshillit”, KED i vihet çdo fillim viti në dispozicion staf ndihmës (kryesisht këshilltarë dhe sekretare). Ajo që institucioni ynë ka konstatuar është se ky staf ndihmës ka një varësi të dyfishtë, jo vetëm në aspektin teorik, por edhe në atë praktik. Pra, përveç detyrave që ata kryejnë gjatë atij viti kalendarik pranë KED, ky staf ndihmës kryen njëkohësisht detyra edhe në Gjykatën e Lartë.

Nisur nga numri i madh i vakancave që ka pasur Gjykata Kushtetuese, puna e stafit ndihmës të KED ka qenë mjaft e madhe, ç’ka ka sjell në mjaft raste shkeljen e afateve (si psh, dërgimi i materialeve jo në afatet e parashikuara nga Rregullorja e KED, zbardhja me vonesë e proces-verbaleve, etj.).

Përveç vështirësive për realizimin në kohë të detyrave nga stafi ndihmës i KED, parë në aspektin e marrëdhënieve të drejtave të punëmarrësit, kjo punë e dyfishtë e tyre (pra njëkohësisht pranë Gjykatës së Lartë dhe pranë KED), në rast të ngarkesës shtesë, duhet të përfitojnë edhe shpërblimin përkatës, gjë që ende nuk është saktësuar në aktet normative që rregullojnë punën e KED. Në tre vitet e fundit të punës së KED (2019 – 2021), stafi ndihmës i KED është shpërblyer me pagë shtese në dy raste¹⁸³, ndërkohë që anëtarët e KED, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues, janë shpërblyer për të tre vitet)¹⁸⁴.

Saktësojmë se Avokati i Popullit nuk ka qenë i përfshirë në asnjë rast në këto tre shtesa fondesh, pavarësisht se ndjekja e veprimtarisë së KED, përbën një ngarkesë të konsiderueshme për institucionin tonë dhe se për këto detyra të reja nuk u parashikua as shtim i stafit dhe as shtim i buxhetit.

¹⁸²Kujtojmë se për organe të tjera që u krijuan me ndryshimet kushtetuese të vitit 2016, si psh rasti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është parashikuar që të jenë direkt pjesë e buxhetit të shtetit. Sipas nenit 188 të Kushtetutës: “2. Buxheti vjetor i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, është pjesë e Buxhetit të Shtetit dhe ndjek të gjitha procedurat e hartimit dhe zbatimit të tij, të parashikuara në legjislacionin përkatës”.

¹⁸³Vendimi nr. 298, datë 10.05.2019 i Këshillit të Ministrave “Për një shtesë fondi, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për sistemin e drejtësisë, miratuar për vitin 2019” dhe VKM nr. 980, datë 21.10.2020, me efekt financiar prej 14,000,000 lekë, për shpërblimin e anëtarëve të KED-së dhe të personelit mbështetës të caktuar pranë tij nga Gjykata e Lartë, nga të cilat në zërin 600 “Paga”: në vlerën 12,200,000 lekë dhe zërin 602 “shpenzime operative”: në vlerën 1,800,000 lekë

¹⁸⁴Dhënia e shpërblimit për anëtarët e KED 2021, u bë e mundur me një VKM të posaçme në mars të vitit 2022.

Gjithsesi për të patur zgjidhje afatgjata, ne kemi rekomanduar në Raportin e Veçantë “Për veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi gjatë vitit 2019” drejtuar Kuvendit, planifikimin e fondeve për të rekrutuar burime njerëzore shtesë për përballimin e ngarkesës dhe parashikimin e fondeve shtesë për stafin ekzistues. Gjithashtu, nëse do të parashikohet mundësia për rekrutim stafi me kontrata të përkohshme, gjë që mund të kërkonte edhe ndryshime në ligj, pasi këshilltarët e Gjykatës së Lartë (nga të cilët merren edhe këshilltarët e KED-së), kanë procedurë përzgjedhjeje të caktuar, pasi ata duhet të ndjekin paraprakisht formimin përkatës në Shkollën e Magjistraturës¹⁸⁵, ne kemi rekomanduar në të njëjtin Raport të sipërpërmendur edhe ndryshimet ligjore përkatëse.

- Përfitojmë nga rasti të kujtojmë edhe një konstatim tjetër të bërë edhe më parë nga Institucioni ynë, por që sërish vazhdon të mbetet i pazgjidhur. Kështu pavarësisht **ngarkesës që përballojnë anëtarët e KED**, legjislacioni ekzistues nuk parashikon lehtësira për gjyqtarët dhe prokurorët që zgjidhen anëtarë të KED. **Avokati i Popullit vlerëson se duhet të rregullohet me akte normative përkatëse, e drejta e anëtarëve të KED-së që të marrin lehtësi në Gjykatat, apo Prokuroritë, ku ata ushtrojnë detyrën e tyre funksionale, gjatë vitit kalendarik, kur ata njëkohësisht kryejnë funksionin e anëtarit të KED-së.**
- Një problem tjetër i konstatuar nga institucioni ynë është edhe përdorimi i një sistemi administrimi të çështjeve nga ana e KED në përmbushje të detyrimit ligjor të përcaktuar në nenin 230, pika 3, të ligjit nr.115/2016, për të rritur efikasitetin e veprimtarisë së tij. Sjellim në vëmendje faktin se kjo çështje e cila ende nuk ka gjetur rregullim në veprimtarinë e KED-së, është një çështje e persëritur për të disatin vit me rradhë. Thënë ndryshe, pavarësisht se shorti manual është hedhur në mënyrë të rregullt dhe ka garantuar në gjykimin e institucionit tonë përzgjedhjen rastësore të relatorëve për vendet vakante, fakti në vetvete nuk garanton qëllimin për të cilin reforma u ndërmor, pra për rritjen e besimit të publikut. Është e qartë se perceptimi i publikut, por edhe i legjislatorit është se pacënueshmeria e procesit të përzgjedhjes së relatorëve garantohen nga shorti elektronik.

Në analizë të *parashikimeve ligjore dhe situatës në praktikë*, të hedhjes së shortit nga KED, për caktimin e Relatorëve, sipas nenit 228, të ligjit 115/2016: “1. Për verifikimin paraprak të plotësisht të kushteve ligjore dhe vlerësimin e kritereve profesionale e morale nga kandidatët, si dhe për renditjen e tyre, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi cakton me short një relator për pozicionet vakante në çdo institucion. 2. Shorti për caktimin e relatorit organizohet përmes sistemit të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë. 3. Përyjashtimisht, në qoftë se sistemi elektronik nuk funksionon, shorti mund të kryhet manualisht. Këshilli miraton rregulla më të detajuara për

¹⁸⁵ Ligji 115/ 2016, neni 274 - **Konkurrimi, formimi fillestar dhe vazhdues i këshilltarëve ligjorë të gjykatave dhe prokurorive:** “Konkurruesit për kandidatë për këshilltarë ligjorë të gjykatave dhe prokurorive, që parashikojnë kushtet e parashikuara në ligj, i nënshtrohen të njëjtit konkurrim si konkurruesit për gjyqtarë dhe prokurorë”.

të bërë të mundur që procedura e shortit për caktimin e relatorit t'u përmbahet parimeve të transparencës, gjurmueshmërisë dhe monitorimit të procesit. ...”.

Ndërkohë, sipas shpjegimeve të dhëna nga kryetarët e KED-së, gjatë mbledhjeve të KED-së për vitet 2019, 2020, 2021, ka rezultuar se është e pamundur të hidhet në mënyrë elektronike shorti për caktimin e relatorit, ashtu siç ligji e parashikon.

Pra, nisur nga një përcaktim përjashtues dhënë nga ligjvënësi, ku lejohet edhe kryerja e hedhjes së shortit manualisht, konstatojmë se shorti është kryer manualisht gjatë viteve 2019, 2020 dhe 2021, dhe se hedhja e shortit për caktimin e relatorit po vazhdon të kryhet në mënyrë manuale.

Pavarësisht rrethanave që mund të kenë krijuar këtë situatë (mosnjohja sa dhe si duhet e një sërë çështjesh, si: baza materiale dhe teknologjia e përdorur nga Gjykata e Lartë, mundësitë financiare të buxhetit të shtetit, etj.), në kushtet kur nuk janë parashikuar as fonde për zbatimin e këtij detyrimi ligjor të miratuar dhe hyrë në fuqi prej shumë vitesh, për mundësimin e hedhjes së shortit nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit të çështjeve të Gjykatës së Lartë, mendojmë se situata të tilla kur në fakt përjashtimet bëhen rregull i përgjithshëm, nuk i shërbejnë rritjes së besimit të publikut tek institucionet e reja të drejtësisë. Për të zgjidhur këtë situatë kontradiktore zgjidhjet që Institucioni ynë rekomandon janë: *a. Parashikimi i fondeve të nevojshme për përmbushjen e detyrimeve ligjore; b. Amendimi i legjisacionit në fuqi.*

c. Një çështje tjetër e konstatuar nga Institucioni ynë gjatë veprimtarive të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, janë edhe *kriteret ligjore për tu përzgjedhur anëtar i Gjykatës Kushtetuese.*

Në lidhje me këtë çështje Institucioni ynë ka konstatuar se shpesh shkak për mungesën e kandidatave serioze, apo edhe të tërheqjes së tyre gjatë procesit, janë bërë afatet mbase tepër strikte për kushtet aktuale të vendit tonë, për kandidatët potencial që do donin të konkuronin në Gjykatën Kushtetuese. Kështu afatet tepër të shkurtra, për juristë që nuk kanë qenë pjesë e sistemit të deklarimit të pasurive, në disa raste kanë bërë që pavarësisht eksperiencës së tyre të gjatë juridike, kandidatët të tërhiqeshin nga procesi i kandidimit.

- Po në kuadër të zbatimit të Reformës në Drejtësi, Institucioni ynë gjatë vitit 2021, ka ndjekur edhe seancat e zhvilluara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.
- Po kështu, janë ndjekur edhe proceset gjyqesore të zhvilluara në Gjykatën Administrative të Apelit gjatë vitit 2020, nga kandidatët që kanë konkuruar për në Gjykatën Kushtetuese, por të ndaluar nga KED.

4.5 Monitorimi i pavarur i të drejtave të emigrantëve të huaj si dhe operacionet e përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së

➤ *Monitorimi i të drejtave të emigrantëve të huaj*

Edhe gjatë vitit 2021, Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës vijoi të zbatojë me efikasitet, Marrëveshjen e Bashkëpunimit të nënshkruar me UNHCR në kuadër të projektit të përbashkët “*Refugjatët dhe Azilkërkuesit në vendet e Evropës Juglindore*”, për kontrollin e kufirit dhe mbrojtjen e refugjatëve në Shqipëri, në zonën jugore të Shqipërisë (Gjirokastrë, Sarandë, Përmet) dhe në zonën juglindore (Korçë, Devoll Bilisht).

Në bashkëpunim me Zyrën e terrenit të UNHCR-së Gjirokastrë dhe Korçë, si dhe pikat fokale nga UNHCR, për zonat e tjera kufitare, në partneritet me organizatën “Caritas” në Gjirokastrë dhe Korçë, në koordinim me Drejtoritë Rajonale të Kufirit në nivel vendor, autoritetet qëndrore të kufirit dhe migracionit në Gjirokastrë dhe Korçë, si dhe në partneritet edhe me organizata të tjera që punojnë në fushën e migracionit, ekspertët e jashtëm të institucionit të Avokatit të Popullit u përfshinë në monitorimin sistematik të kufijve, raportimin periodik të gjetjeve, trajtimin e zgjidhjen e problematikave të hasura në ofrimin e mbrojtjes për të huajt e parregullt që hyjnë nga kufiri grek në Shqipëri.

Raporti i FRONTEX¹⁸⁶ vlerëson se nga janari në Nëntor të vitit 2021 ka pasur rreth 55,310 migrantëve të ndaluar gjatë kalimeve të paligjshme kufitare drejt Bashkimit Evropian përmes së ashtuquajturës “Rrugë e Ballkanit Perëndimor”. Prurjet e migrantëve të parregullt nga vendet e Lindjes së Mesme dhe Afrika Veriore që kaluan kufirin shqiptaro-grek erdhën në rritje gjatë vitit 2021, megjithë situatën e pandemisë së korona virusit. Grupet migratore, pasi mbërrijnë në Greqi në mënyrë të parregullt, në rrugë detare ose tokësore, hyjnë në Shqipëri kryesisht nga brezi i kufirit të gjelbër tokësor në rajonet e Gjirokastrës, Sarandës, Korçës dhe Ersekës. Sipas të dhënave të policisë kufitare në rajonin e Korçës u identifikuan 14.936 migrantëve të parregullt, nga të cilët 7478 ishin për herë të parë dhe 7458 në këtë rajon ishin përsëritës. Ndërkohë, në rajonin e Gjirokastrës u identifikuan 2026 migrantëve të parregullt nga të cilët 1589 u identifikuan për herë të parë në territorin shqiptar dhe 437 përsëritës.

Numri më i madh i migrantëve ishin nga Siria, Afganistani dhe Iraku. Vetëm 14 prej migrantëve të parregullt janë referuar në azil në zonën e Korçës ndërsa në zonën e Gjirokastrës është përfshirë në referimin për azil grupi prej 30 migrantësh, që u përfshi në një incident kontrabandimi në det në Vlorë. Pjesa tjetër e migrantëve në të dy rajonet janë kthyer me “*urdhër për kthimin vullnetar*” drejt territorit grek.

Edhe për vitin 2021, ekspertët kanë punuar për informimin e personave, garantimin e standardit të intervistave të përzgjedhjes; zhvillimin e marrëdhënieve me komunitetet në zonat ndërkufitare për t'i ndërgjegjësuar për mikpritjen e refugjatëve; promovimin dhe monitorimin e aksesit në territor dhe në procedurat e azilit për azilkërkuesit dhe refugjatët e identifikuar në kufijtë shqiptarë. Roli i ekspertëve të Avokatit të Popullit në monitorimin e kufirit shqiptaro-grek, në monitorimin e procedurave të përzgjedhjes dhe në advokimin për çështje të ndryshme të lidhura me mbrojtjen e

¹⁸⁶ <https://frontex.europa.eu/media-centre/news/news-release/eu-external-borders-in-2021-arrivals-above-pre-pandemic-levels-CxVMNN>.

të drejtave të migrantëve të parregullt që hyjnë në territorin shqiptar nga Greqia, është mjaft i rëndësishëm për të siguruar respektimin e standardeve për migrantët e parregullt.

Klima ndaj migrantëve si e komuniteteve të zonave ndërkufitare por edhe vetë efektivave policorë kufitarë është miqësore dhe nuk ka pasur incidente apo dhunë. Ekspertët vlerësojnë se kanë pasur akses të plotë nga Drejtoritë Rajonale e Kufirit të kontaktojnë me grupet e migrantëve, të intervistojnë në raste se e shohin të nevojshme dhe të mbledhin të dhëna për garantimin e standardeve të trajtimit të tyre.

Gjatë vitit 2021 kanë rënë ndjeshëm referimet në azil dhe kjo lidhet me situatën e pandemisë, kapaciteteve të reduktuara të Qendrës së Azilit dhe përpjekjeve të autoriteteve shqiptare për të frenuar tendencën e përdorimit të Shqipërisë si një pikë tranzit nga migrantët e parregullt për të kaluar drejt vendeve perëndimore.

Bashkëpunimi dhe këmbimi i informacionit me policinë kufitare dhe forcat e FRONTEX, por edhe me aktorët e tjerë është mjaft i rëndësishëm për menaxhimin e rasteve, sidomos për personat vulnerabël, në emergjencë shëndetësore apo fëmijët. Përparimi që është bërë në rritjen e kapaciteteve akomoduese dhe kushteve për trajtimin e migrantëve në Grehot, GOS Kakavijë, Qendra Sociale e Bashkisë Gjirokastër, Shtëpia e Caritas në Gjirokastër, Qendra e Përkohshme Kapshticë, duhet të shoqërohet me burime njerëzore për të plotësuar nevojat në shërbimet ndaj migrantëve.

Informimi i migrantëve bëhet rregullisht përmes broshurave që shpërndahen nga UNHCR-ja, Caritas, Avokati i Popullit, FRONTEX, e që janë në disa gjuhë por ka nevojë të plotësohet me elementë në dinamikë. Ekspertët kanë vlerësuar nevojën e përmirësimit të cilësisë së intervistës së përzgjedhjes ku duhet të shmanget tendenca e pyetjeve që detyron kthimin vullnetar të tyre dhe ti jepet hapësirë më e madhe rast pas rasti nevojave (nëse shfaqen) për mbrojtje ndërkombëtare nga migrantët.

Problematikat e evidentuara në terren në Qarqet Gjirokastër dhe Korçë

Duke qenë se legjislacioni i ri “Për të Huajt” si dhe ligji “Për Azilin”, janë tashmë të miratuar, miratimi sa më parë i VKM-ve do t’i hapte rrugë edhe miratimit të akteve të tjera nënligjore si udhëzime dhe urdhra të ministrive përgjegjëse që legjislacioni ka ngarkuar për zbatimin e tyre.

Konkretisht, referuar ligjit “Për të Huajt” përcaktohet shprehimisht se: “*Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore për të përcaktuar kriteret, procedurat dhe dokumentacionin për pajisjen me vizë elektronike, në zbatim të nenit 22, pika 5, dhe për formatin e aplikimit për vizën elektronike, në zbatim të nenit 24, pika 1, të ligjit*”. Po ashtu, në ligjin “Për Azilin” thuhet shprehimisht se: “*Këshilli i Ministrave, brenda 6 (gjashtë) muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 1 të nenit 10, pikës 5 të nenit 34, të pikës 2 të nenit 44, të pikës 2 të nenit 56 dhe të pikës 3 të nenit 78 të këtij ligji*”.

Gjatë vitit 2021, rezulton se forcat policore kufitare shqiptare kanë rritur numrin e kthimeve me urdhrat e kthimit vullnetar drejt territorit grek duke e lidhur me situatën e pandemisë dhe

legjislacionin shqiptar për situatat e tilla. Por janë shmangur nga policia kthimet pas të të huajve të parregullt gjatë orëve të natës. Ndërkohë janë evidentuar në Gjirokastrë 10 raste “push back” të cilat nuk janë raportuar nga policia kufitare.

Cilësia e intervistave të përzgjedhjes - Janë evidentuar disa faktorë që ndikojnë në cilësinë e intervistave të përzgjedhjes së migrantëve të parregullt dhe që lidhen me burimet njerëzore të kufirit, mungesën e oficerëve gra, numrin e kufizuar të përkthyesve në gjuhët nga vijnë të huajt e parregullt, mungesën e shërbimit social nga bashkitë respektive.

Në pikën e GOS Kakavije ka materiale informuese në formë broshurash dhe një panel me numra kontakti, por këto nevojiten të jenë në mjedise të posaçme edhe në Drejtorinë e Kufirit dhe Migracionit, në Grehot Gjirokastrë. Në procedurën e përzgjedhjes krahas punonjësve të policisë të kufirit, migrantët asistohen dhe nga përkthyesit, të cilët sigurohen nga CARITAS. Por, nga intervistat e zhvilluara me punonjësit e policisë kufitare, është problematikë se për disa gjuhë specifike si Dari, Fars, etj., nuk ka përkthyes të licencuar, çka e vështirëson komunikimin mes tyre gjatë procedurës së përzgjedhjes. Sipas tyre, në këto raste komunikimi bëhet në gjuhën angleze, aq sa mund të jetë e mundur ose në një gjuhë të përafërt me gjuhën e tyre. Për këtë duhet krijuar nga institucionet përkatëse lista e përkthyesve dhe psikologëve të licencuar.

Ndërkohë falë një programi të UNHCR gjatë vitit 2021 u vendos përkohësisht një mjek dhe një psikologe në Kakavijë në ndihmë të grupeve të migrantëve të parregullt. Për një periudhë disa mujore dy personat shtesë përmes një projekti pilot afruan asistencë në kufi në dhjetëra raste. Edhe në Kapshticë, Korçë gjatë vitit 2021 në kuadër të programit të UNHCR-së janë vendosur një psikologe, një mjek dhe një mediator kulturor për t'u ardhur në ndihmë emigrantëve të parregullt.

Gjatë periudhës së monitorimit janë evidentuar gjithashtu shumë raste ku nuk është marrë parasysh kërkesa për azil.

Për personat me nevoja specifike apo që kërkojnë trajtim emergjent shëndetësor është ofruar ndihmë e menjëhershme nga urgjencat e spitalit civil që janë përgjigjur në kohë Drejtorive Rajonale të Kufirit në rastet e apelit për ndihmë.

Në kushtet e pandemisë nuk ka në kufi një ekip të epidemiologjisë së Korçës apo Gjirokastrës për të kryer tamponët për COVID 19 për të gjithë të huajt e parregullt që bllokohen në territorin shqiptar dhe ato janë kryer vetëm për raste të dyshuara. Tamponët janë kryer të detyruar edhe në rastet kur migrantët e përkohshëm, sidomos gra dhe fëmijë janë trajtuar për disa ditë në Qendrën Sociale të Bashkisë së Gjirokastrës. Në disa raste është ndërhyrë drejtpërdrejtë tek autoritetet e policisë kufitare për të trajtuar përkohësisht në Qendrën Sociale të Bashkisë Gjirokastrë migrantë me nevoja specifike apo persona vulnerabël.

Rekomandime

- ✓ Përsheptimi i punës për të bërë të mundur miratimin sa më parë të akteve nënligjore, pasi janë tejkaluar edhe afatet që këto ligje përcaktojnë. Miratimi sa më parë i VKM-ve, do ti hapte rrugë edhe miratimit të akteve të tjera nënligjore si udhëzime dhe urdhra të ministrive përgjegjëse që legjislacioni ka ngarkuar për zbatimin e tyre. Plotësimi sa më parë i kuadrit të plotë ligjor dhe nënligjor, do të rriste përgjegjësinë dhe do të bënte më eficiente strukturat shtetërore të krijuara për këtë qëllim, për marrjen në shqyrtim dhe miratimit në kohë sa më të shkurtër të kërkesave të azilkërkuesve apo të të huajve me qëndrim të përhershëm apo të përkohshëm në Shqipëri.
- ✓ Përmirësimi i mbrojtjes së migrantëve që hyjnë në territorin shqiptar përmes njohjes më të mirë të të drejtave prej tyre
- ✓ Rritja e kapaciteteve të qeverisë shqiptare për të garantuar zbatimin e të drejtave të migrantëve, përfshirë dhe bërjen funksionale të sistemit të kërkimit të azilit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Tabelat përmbledhëse për periudhën Janar - Dhjetor 2021

Indikatorët	Rajoni	Progresi	Target
Monitorimi i procedurave të përzgjedhjes dhe intervistime me migrantë	Gjirokastrë dhe Korçë	1200 persona në vit	1420 persona në vit
Vizita monitoruese	Gjirokastrë dhe Korçë	480 vizita	498 vizita
Rekomandime Drejtorisë së Përgjithshme të kufirit dhe Migracionit	Komisionere Ekspertet	4	4
Raporte analitike për prurjet migratore	Gjirokastrë dhe Korçë	4	8

- *Operacionet e përbashkëta me FRONTEX për rikthimin e shtetasve të parregullt nga vendet e BE-së*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në zbatim të marrëveshjes të lidhur midis Avokatit të Popullit dhe FRONTEX, që prej vitit 2014, është pjesë e grupit monitorues të procesit të riadhesimit të shtetasve shqiptar nga vende të BE dhe shteteve të zonës Schengen, duke monitoruar në mënyrë të pavarur operacionet e kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës. Në këtë mënyrë, kjo strukturë luan rolin e vet ligjor dhe kushtetues duke përmbushur njëkohësisht dhe Direktivën 2008/115/EC187 të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta ndërmjet vendeve të BE me vendet e treta. Nga eksperiencia disa vjeçare e monitorimit të këtij operacioni, standardet dhe procedurat e ndjekura nga shtetet anëtare të BE dhe FRONTEX, kanë evoluar pozitivisht në aspektin e respektimit të të drejtave të shtetasve që riadhesohen në Shqipëri nga këto vende, të cilët janë të pajisur me vendim për rikthim të detyruar.

¹⁸⁷ Direktiva 2008/115/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16 dhjetor 2008, parashikon standardet dhe procedurat e përbashkëta në shtetet anëtare për kthimin e shtetasve të vendeve të treta që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në këto vende.

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEX është pjesë e grupit të monitorimit në *operacionet e riatdhesimit* vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe konkretisht Francës. MKPT-së ka vazhduar të monitorojë në mënyrë konstante operacionet e riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen. MKPT ka qenë pjesë e grupit të operacioneve të riatdhesimit për *vitin 2021, gjatë të cilit janë kryer 16 operacione të riatdhesimit*.

Monitoruesi kombëtar i MKPT-së në operacionet e rikthimit të shtetasve të parregullt, asiston këqyrjen dhe dorëzimin e dokumentacionit për secilin shtetas nga policia franceze, përfaqësuesit të policisë së kufirit dhe migracionit të policisë së shtetit. Nga ana jonë, kontrollohet me kujdes nëse shtetasit që do të riatdhesohen janë të pajisur me vendim të formës së prerë për rikthimin e tyre në Shqipëri, si dhe nëse janë njohur apo jo me këtë vendim, përmes firmosjes të vendimit nga secili shtetas.

Përfaqësuesi i MKPT-së zhvillon intervista me këta shtetas para nisjes dhe gjatë udhëtimit në bord, lidhur me kushtet e trajtimit në qendër, nëse janë të njohur me vendimin për rikthimin e tyre, si dhe nëse janë të informuar për procedurat e shoqërimit të detyruar gjatë imbarkimit dhe fluturimit të tyre për në atdhe. Gjatë intervistimit, shtetasit kanë ngritur shqetësimin për cilësinë e ushqimit gjatë ditëve të qëndrimit në qendër, si dhe pamundësinë e tyre për të apeluar vendimin për largimin apo dëbimin e detyruar nga vendet e BE-së.

Përfaqësuesit e MKPT-së, në takimet e zhvilluara me përfaqësuesit e FRONTEX dhe të Drejtorisë së Policisë Kufitare dhe të Migracionit, kanë sugjeruar marrjen e masave për të garantuar kthimin në mënyrë njerëzore duke respektuar plotësisht të drejtat themelore të migrantëve shqiptarë sipas standardeve të BE-së, si dhe legjislacionit shqiptar.

Si rezultat i kontakteve të vazhdueshme dhe sugjerimeve në rolin e monitoruesve kombëtar të MKPT-së, FRONTEX konsideroi të rëndësishme propozimet tona, për vendosjen e përkthyesit në gjuhën shqipe dhe mjekut bashkë me grupin e përbashkët të monitorimit të FRONTEX, për të asistuar shtetasit shqiptarë para nisjes për në atdhe.

Pavarësisht progresit të bërë në këtë drejtim, mbetet ende problematikë fakti që shtetasit shqiptarë që rikthehen nuk kanë shumë informacion në lidhje me marrjen e vendimit dhe mënyrën e ekzekutimit për rikthimin e detyrueshëm të tyre nga vendet e BE-së për në vendin tonë ku shpesh familjet merren nga shtëpitë e tyre në mënyrë të menjëhershme dhe me rroba trupi. Njëkohësisht, nga intervistat e zhvilluar me këta shtetas, ata kanë ngritur me shqetësim faktin se atyre nuk ju lihet kohë në dispozicion për apelimin e vendimeve të rikthimit apo dëbimit në vendet respektive të BE-së.

KREU 5

Bashkëpunimi

5.1 Bashkëpunimi me institucionet e administratës publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të AP-së

Nuk mund të ketë qeverisje të mirë kur administrata publike nuk i respekton të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit gjithnjë e më shumë po bëhet një institucion i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve dhe nxitjen e llogaridhënies nga organet qeveritare.

Me prezencën në media, në evente dhe forume të ndryshme publike në krah të shoqërisë civile, të shtresave apo grupeve shoqërore më pak të mbrojtura kanë bërë që gjithnjë e më shpesh të kërkohet mendimi dhe opinionimi i tij institucional në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të tyre çdo herë që tentohet të çenohen apo vihen në diskutim ato.

Komunikimi dhe bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me institucionet e administratës publike, qendrore dhe vendore, përgjithësisht ka qenë korrekt dhe i dobishëm për qytetarët, por dhe ky bashkëpunim ka pasur herë pas here dhe problematikat e veta. Tregues pozitiv dhe rezultat i bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me institucionet publike kanë qenë trajtimi dhe zgjidhja në dobi të qytetarëve ankues/kërkues të një numri të konsiderueshëm të rasteve të trajtuara gjatë vitit 2021.

Por krahas këtij bashkëpunimi të mirë ka pasur dhe raste të neglizhencës apo mungesës së kthimit të përgjigjeve të kërkesave tona nga institucionet e administratës publike qendrore dhe vendore, moszbatimit të rekomandimeve të adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, herë nga pamundësia e plotësimit të kërkesave për çështje/ankesa të shoqëruara me detyrime financiare dhe herë nga mos angazhimi si duhet i organeve të administratës publike.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020, thekson se “..Norma e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit ka një rënie të lehtë për periudhën raportuese, nga 62% në 55%, dhe Parlamenti duhet të fuqizojë përpjekjet në mbështetje të aktiviteteve të Avokatit të Popullit dhe të institucioneve të tjera të pavarura me një rol mbikëqyrës”. Gjithashtu, ky raport vë në dukje se “Zbatimi efikas i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike nuk është përmirësuar mjaftueshëm për rritjen e llogaridhënies publike institucionale”.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka monitoruar dhe monitoron nivelin e zbatimit të rekomandimeve të adresuara organeve të administratës publike nëpërmjet përgatitjes së informacioneve të përditësuara të cilat bëhen pjesë e raportimeve periodike apo vjetore. Është e rëndësishme të evidentohet fakti se puna e institucionit pengohet jo pak herë nga *qëndrime jo bashkëpunuese të institucioneve të ndryshme shtetërore të cilat dërgojnë informacione të cunguara, të paqarta apo vonojnë kthimin e përgjigjeve duke i zgjatur kështu në kohë afatet e*

hetimeve tona administrative dhe duke eroduar kështu edhe besimin e qytetarëve tek institucioni ynë për veprimtari me efikasitet.

Duke e konsideruar shume të rëndësishëm rolin e institucionit ne kemi thelluar punën për të rritur cilësinë e rekomandimeve dhe arsyeimeve të rekomandimeve tona si edhe të kthimit të përgjigjeve për qytetarët për rastet ku nuk konstatohen shkelje apo çështja zgjidhet pa rekomandim. Fatkeqësisht nuk kemi pasur të njëjten përgjigje nga institucionet në rastin e refuzimit të rekomandimeve të bëra nga Avokati i Popullit.

➤ *Niveli i zbatimit të rekomandimeve*

Gjatë vitit 2021 institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 267 *rekomandime*¹⁸⁸ drejtuar organeve të administratës publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve, niveli i zbatimit të tyre deri në muajin Shkurt të vitit 2022 rezulton si më poshtë:

<i>Rekomandime të pranuar dhe të zbatuara plotësisht</i>	17%
<i>Rekomandime të pranuar dhe të zbatuara pjesërisht</i>	34%
<i>Rekomandime të pazbatuara</i>	19%
<i>Rekomandime të refuzuara</i>	9%
<i>Rekomandime pa përgjigje</i>	22%

Në këtë raportim nuk është përfshirë zëri “në proces”, pasi për të gjitha rekomandimet e adresuara deri në datën 31.12.2021 kanë kaluar afatet procedurale për kthimin e një përgjigje nga institucionet. Megjithatë, pavarësisht kalimit të këtyre afateve, siç do të shohim më poshtë, për një pjesë të madhe të rekomandimeve të adresuara në muajin Dhjetor 2021, ende nuk ka një përgjigje.

Në totalin prej 46 ose 17% të rekomandimeve të pranuar dhe zbatuara plotësisht, janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ka pasur një përgjigje nga institucionet duke adresuar plotësisht të gjitha pikat e rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe njëkohësisht duke i zbatuar këto rekomandime në tërësinë e tyre.

Në totalin prej 89 ose 34 % të rekomandimeve të pranuar dhe zbatuara pjesërisht, janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ka pasur një përgjigje nga institucionet duke adresuar pikat e rekomandimeve të lëna nga institucioni i Avokatit të Popullit, plotësisht ose vetëm një pjesë të tyre dhe, njëkohësisht, duke i zbatuar ato vetëm për një pjesë të rekomandimit.

Në totalin prej 50 ose 19% të rekomandimeve pazbatuara janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ndonëse ka pasur një përgjigje nga institucionet duke pranuar parimisht pikat e rekomandimeve, ato nuk kanë gjetur zbatim të plotë ose të pjesshëm.

Siç vihet re, përqindja e rekomandimeve pa përgjigje shfaq *tendencë në rritje*, krahasimisht me dy vitet e mëparshme (17 % në vitin 2020 dhe 5 % në vitin 2019). Nga ana tjetër, edhe numri total i

¹⁸⁸ Tabelën e plotë me rekomandimet e dërguara për vitin 2021 nga institucioni i AP gjendet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Rekomandimet%20e%20vitit%202021%20te%20sekretuara%20-%20me%20statuset%20.pdf>

rekomandimeve të adresuara gjatë vitit 2021 është rritur me rreth 4% krahasimisht me rekomandimet e adresuara gjatë vitit 2020 dhe me rreth 24% krahasuar me rekomandimet e adresuara gjatë vitit 2019.

Nga totali i 57 rekomandimeve pa përgjigje, 10 prej tyre i përkasin 6 mujorit të parë të vitit 2021, 16 periudhës korrik – nëntor ndërsa 31 muajt Dhjetor të vitit 2021.

Për periudhën Janar – Dhjetor 2021 institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar gjithsej rreth 28 kërkesa për zbatim të rekomandimit drejtuar institucioneve të Administratës Publike. Megjithatë, siç vërehet, adresimi i këtyre kërkesave nuk ka pasur rezultat pasi numri i rekomandimeve pa përgjigje mbetet ende i lartë.

Në totalin prej 23 ose 9% të rekomandimeve të refuzuara janë përfshirë ato rekomandime për të cilat është kthyer përgjigje nga institucionet e administratës publike se refuzohet zbatimi i tyre.

Në totalin prej 57 ose 22% të rekomandimeve pa përgjigje janë përfshirë ato rekomandime për të cilat ndonëse kanë kaluar afatet administrative procedurale, nuk ka pasur një përgjigje nga institucionet.

Rekomandimet e adresuara nga institucioni i Avokatit të Popullit, në pjesën më të madhe të rasteve adresojnë zgjidhjen e më tepër se një problematike të caktuar. Për këtë qëllim, brenda një rekomandimi të vetëm, që i adresohet organeve të administratës publike, mund të ketë disa rekomandime të ndryshme për zgjidhjen e çështjeve të caktuara, ose thënë ndryshe disa nën-rekomandime.

Në 267 rekomandimet e adresuara gjatë vitit 2021, janë adresuar gjithsej 1256 nën-rekomandime. Nga këto, vetëm 29% e tyre janë zbatuar plotësisht, teksa 71% e tyre mbeten ende të pazbatuar. Ndër nën-rekomandimet e pazbatuar, për 16% prej tyre institucioni nuk ka marrë përgjigje, 4.5% janë refuzuar teksa 50.5% e tyre rezultojnë në proces zbatimi. Këto të dhëna janë përfshirë në të dhënat e raportuara për nivelin e zbatimit të 267 rekomandimeve të institucionit, duke i konsideruar rekomandimet me dy apo më shumë nën-rekomandime, për të cilat ka pasur përgjigje apo zbatim vetëm për një pjesë të tyre, si rekomandime të pranuar dhe të zbatuara pjesërisht.

✚ *Raporti i kërkesave për sqarime të nxjerra nga Avokati i Popullit, për të cilat nuk është dhënë përgjigje nga institucionet*

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total rreth 2221 kërkesa për shpjegime drejtuar organeve të administratës publike, prej të cilave rreth 148 ose rreth 6.7 % e tyre nuk kanë marrë përgjigje nga institucionet përkatëse. Indikatorin e raportimit për kërkesat për shpjegime pa përgjigje, sipas pasaportës së indikatorëve në kuadër të Raportimit periodik për Strategjinë Ndërsektoriale të Administratës Publike.

$$R_{\text{RFC}} = \frac{\text{Numri i Kërkesat për Sqarim që nuk kanë marrë përgjigje}}{\text{Numri Total i Kërkesave}} \times 100\%$$

$$R_{rfC} = \frac{148 \text{ kërkesa per sqarime pa pergjigje}}{2221 \text{ kërkesa per shpjegime ne total}} * 100 = 6.7 \%$$

Për llogaritjen e këtij indikator i jemi referuar vetëm rasteve kur nuk ka pasur përgjigje nga institucionet, pavarësisht kërkesave tona të përsëritura për shpjegime.

Siç vihet re, numri i kërkesave për shpjegime nga institucioni i Avokatit të Popullit të cilat nuk marrin përgjigje nga institucionet ka pësuar rënie të lehtë. Për vitin 2019, përqindja e kërkesave për shpjegime pa përgjigje ka qënë rreth 8%, për vitin 2020 ka pësuar një rritje të lehtë, duke shkuar në rreth 9.6% teksa për vitin 2021 është ulur me rreth 3%.

Megjithatë, pavarësisht progresit të vërejtur në drejtim të uljes së përqindjes së kërkesave për shpjegime pa përgjigje mbetet për të evidentuar edhe për vitin 2021 e njeja problematikë e theksuar edhe në raportet e viteve të mëparshme: në shumë raste ka qënë e nevojshme ndërhyrja e institucionit tonë me disa kërkesa të përsëritura, për të marrë një përgjigje, përfshirë këtu edhe rastet e përgjigjeve të dërguara jashtë afateve ligjore dhe të arsyeshme.

Konkretisht, gjatë vitit 2021 nga institucioni i Avokatit të Popullit janë adresuar rreth 857 kërkesa të përsëritura për shpjegime. Thënë ndryshe, në të paktën 857 kërkesa nga 2221 në total (rreth 39% e rasteve), është nevojitur që kërkesa të adresohet të paktën 2 herë nga institucioni i Avokatit të Popullit, për të mundësuar një përgjigje nga institucionet e administratës publike. Për nga vetë natyra e punës së institucionit të Avokatit të Popullit është e rëndësishme që shpjegimet apo informacionet nga institucionet e Administratës Publike të dërgohen brenda afateve të arsyeshme, në koherencë me mundësinë efektive të institucionit tonë për të ndërhyrë në zgjidhjen e çështjeve. Për këtë problem do të kërkonim ndërhyrjen efektive të Kuvendit në mënyrë që të kemi ushtrim efektiv të mandatit të dhënë nga Kushtetuta.

➤ *Bashkëpunimi në dhënien e mendimeve/komenteve për projekt-akte*

Përpos kësaj, institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2021, ka kontribuar me përfshirje si në fazat e konsultimit të jashtëm ashtu edhe në procesin legjislativ, nëpërmjet dhënies së mendimeve dhe sugjerimeve konkrete për disa akte normative dhe nënligjore në fushën e policisë, burgjeve, sistemit gjyqësor, të drejtave të fëmijëve, azilit, kufirit, etj, ku ndër më kryesoret listojmë:

- ✓ Për projektligjin “Për shërbimin e kontrollit të brendshëm dhe ankesat në sistemin e ekzekutimit të vendimeve penale”;
- ✓ Për projektligjin “Për Regjistrin Kombëtar të të dënuarve për krime seksuale”.
- ✓ Për projektligjin “Për paditë kolektive”;
- ✓ Për projektligjin “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
- ✓ Për projektligjin “Për Statusin “Fëmijë në përkujdesje të Republikës”;
- ✓ Për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9062, datë 8.5.2003 “Kodi i Familjes”, të ndryshuar;
- ✓ Projektligji “Për të huajt”;
- ✓ Projektligji “Për Azilin”
- ✓ Për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9695, datë 19.3.2007 “Për procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”, të ndryshuar;

- ✓ Për projektligjin “Për Regjistrin Kombëtar të të Dënuarve për Krime Seksuale”;
- ✓ Për projektligjin “Për statusin “Fëmijë në përkujdesje të RSH””;
- ✓ Për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme mbi organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale”;
- ✓ Projektvendimin “Për Miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”
- ✓ Për projektvendimin “Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërbimin e punës”.
- ✓ Për projektvendimin “Për miratimin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve, 2021-2026”.
- ✓ Projekt Memorandumit e Mirëkuptimit “Mbi Mekanizmat e ankesave për veprimet e kryera nga Agjencia Evropiane e Kufirit dhe Rojës Bregdetare në Shqipëri”;
- ✓ Draft “Manual i Monitorimit të Tubimeve”.

Gjithashtu, përfaqësues nga institucioni i Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë në mënyrë aktive, përmes dhënies së kontributeve konkrete në seancat dëgjimore të zhvilluara në Kuvend, sa i përket ndryshimeve Kushtetuese, ligjit për buxhetin, etj.

➤ *Bashkëpunimi në kuadër të procesit të integrimit evropian*

Bashkimi Europian bazohet dhe zhvillohet mbi një angazhim real për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe shtetit të së drejtës. Garantimi i të drejtave themelore është një nga parimet bazë të sistemit të Bashkimit Evropian. Të drejtat e njeriut, posaçërisht me krijimin e shtetësisë së Bashkimit Europian janë bërë pjesë e brëndshme e tij. Ashtu si dhe në parimet kontinentale të Evropës, në qendër të vëmendjes është individi, kjo e garantuar që në preambulën e Kartës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kapitulli 23 (Gjyqësori dhe të drejtat e njeriut) është një kapitull thelbësor për përpjekjet e para-aderimit dhe ka një rëndësi të veçantë gjatë negociatave për anëtarësim, ku përcaktohen kufizime të sakta dhe pika të rëndësishme së bashku me monitorimin nga Bashkimi Europian. Ky kapitull mbulon tri fusha të rëndësishme, *sistemin gjyqësor, politikat kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore*. Shteti kandidat duhet të sigurojë *respektimin e të drejtave të njeriut si dhe të drejtave themelore të qytetarëve të BE-së*, siç garantohet nga legjislacioni i BE-së. Kjo fushë përmban një numër konventash, protokollesh dhe deklaratash që vendi kandidat duhet t’i ketë pjesë të sistemit të tij ligjor, duke siguruar në cdo rast, zbatimin efektiv të tyre.

Institucioni i Avokatit të Popullit si një nga aktorët kyç në sistemin kombëtar të mbrojtjes të të drejtave të njeriut e ka vlerësuar maksimalisht këtë proces duke bashkëpunuar me të gjitha strukturat shtetërore që janë të ngarkuar me ndjekjen dhe zbatimin e detyrimeve, përmes ofrimit të kontributeve domethënëse që luajnë një rol të rëndësishëm në respektimin e të drejtave të njeriut dhe forcimin e shtetit të së drejtës.

Vlen për tu përmendur angazhimi i vazhdueshëm dhe kontributi i ofruar në kuadër të Kapitulli 23, duke qenë se Avokati i Popullit është një nga anëtarët e grupit të punës për këtë kapitull, por edhe për kapitujt 19 (*Politikat Sociale dhe Punësimi*) dhe 24 (*Drejtësia, Liria dhe Siguria*). Gjatë periudhës raportuese, institucioni i Avokatit të Popullit ka ofruar gjithashtu mbështetjen e tij në hartimin dhe koordinimin e Planit të Masave për zbatimin dhe monitorimin e përmbushjes së

rekomandimeve që Komisioni Evropian ka evidentuar për Shqipërinë për sa lidhet me Kriterin Politik dhe Kapitullin 23 të acquis së Bashkimit Evropian si dhe kontribute në kuadër të hartimit të kontributit të parë të qeverisë shqiptare për raportin e KE për Shqipërinë për vitin 2021 (mars 2021)

Avokati i Popullit ka vazhduar të marrë pjesë në mënyrë aktive edhe në kuadër të mbledhjeve dhe raportimeve të zhvilluara nga Këshilli Kombëtar i Integritimit Evropian (KKIE) si struktura më e lartë këshillimore kombëtare për integrimin evropian që funksionon pranë Kuvendit, me qëllim nxitjen dhe garantimin e bashkëpunimit gjithëpërfshirës ndërmjet forcave politike, institucioneve publike dhe shoqërisë civile, si dhe rritjen e transparencës në vendimmarrjen për çështjet e integritimit.

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë dhe kontribuar edhe në kuadër të takimeve të përbashkëta të zhvilluara me BE-në, ku duhet të përmenden:

- Pjesëmarrja dhe kontributi për takimin e **13 (trembëdhjetë) të Nënkomitetit të Stabilizim-Asociimit (JFS) Bashkimi Evropian – Shqipëri**, i zhvilluar më datë 9-10 dhjetor 2021, kontribut i cili u fokusua tek:
 - ✓ *Antidiskriminimi dhe mbrojtja e grupeve vulnerabël; të drejtat e fëmijëve; personat me aftësi të kufizuara; personat LGBTIQ*
 - ✓ *Përfshirja e komuniteteve romë/egjiptiane: konkluzionet dhe vazhdimi i përfundimit të seminarit të fundit për romët*
 - ✓ *Barazia gjinore: fokusi në zbatimin e strategjisë 2021-2030 për Barazinë Gjinore dhe financimin adekuat; shpërndarjen e burimeve njerëzore në mekanizmin e barazisë gjinore dhe buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në nivel lokal*
 - ✓ *E drejta për jetën , parandalimi i torturës dhe keqtrajtimit dhe sistemi i burgjeve (përqendrimi në zbatimin e rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Degradues)*
 - ✓ *Zbatimi efektiv i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike*

- Pjesëmarrje dhe kontribut në kuadër të takimit të **12-të të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA)**, i zhvilluar në datën 15 shkurt 2022, kontribut i cili u fokusua tek:
 - ✓ *Mbrojtja sociale dhe përfshirja e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane*
 - ✓ *Barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve*
 - ✓ *Mbrojtja sociale dhe përfshirja e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane*

5.2 Bashkëpunimi ndërkombëtar

Institucioni i Avokatit të Popullit i kushton një rëndësi të veçantë krijimit dhe forcimit të marrëdhënieve me institucionet homologe, organizatat dhe rrjete e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Në këtë kuptim institucioni i Avokatit të Popullit e ka përmirësuar ndjeshëm

bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar në nivel dypalësh dhe shumëpalësh në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.¹⁸⁹

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia, ashtu si edhe në vitin e kaluar, institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në shumë veprimtari të zhvilluara në formatin online. Në kalendarin e aktiviteteve ndërkombëtare të vitit 2021, shënohet një rritje e prezencës së përfaqësuesve të Avokatit të Popullit në veprimtari të ndryshme si: trajnime, webinarë, takime pune apo konferenca, të organizuara nga zyrat homologe dhe nga organizatat ndërkombëtare të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Vlen për t'u theksuar zgjedhja me unanimitet e Avokates së Popullit znj. Erinda Ballanca si *Anëtar i Këshillit Administrativ të Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë (AOMF)*, në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, të zhvilluar në datën 25 nëntor 2021. Kjo organizatë përmbledh institucionet e pavarura të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të rreth 50 shteteve frankofone, nga kontinentet e Evropës, Afrikës, Amerikës dhe Oqeanisë.

Gjithashtu, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, më datë 3 dhjetor 2021, është rizgjedhur anëtare e bordit drejtues të dy organizmave të rëndësishëm ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut si: Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI) dhe Aleancës Globale të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (GANHRI) për një mandat 3 vjeçar. Edhe në vitin 2018, Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, është zgjedhur anëtare e Bordit të ENNHRI dhe GANHRI. Ndërkohë, Avokatja e Popullit znj. Erinda Ballanca, vijon të jetë zv.Presidente e dytë e Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM).

Si anëtar i Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur raportimin lidhur me perspektivat institucionale mbi zhvillimet e rëndësishme në vend. Ky raportim do të publikohet gjatë vitit 2022. Ai është përqëndruar në disa fusha kryesore si: pavarësia dhe efektiviteti i institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut; hapësira e shoqërisë civile dhe e mbrojtësve të të drejtave të njeriut; sistemi i kontrollit dhe balancës në shtetin e së drejtës; funksionimi i sistemit të drejtësisë; liria e medias, pluralizmi dhe siguria e gazetarëve; korrupsioni; masat ndaj COVID-19 dhe implikimet afatmesme e afatgjata në kuadrin e shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut, krahas të drejtave sociale dhe ekonomike. Një risi e rëndësishme në ciklin e raportimit për vitin 2021 ishte se, krahas raportimit të zhvillimeve përkatëse, u formuluan dhe rekomandime për të trajtuar sfidat dhe mangësitë e identifikuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar komunikimin, ndërveprimin dhe bashkëpunimin e ngushtë me Këshillin e Evropës dhe struktura të tjera që mbrojnë të drejtat e grupeve në nevojë si personat me aftësi ndryshe, minoritetet, LGBTI, gratë, fëmijët, etj. Institucioni, gjithashtu, është angazhuar me Komitetin Evropian për Parandalimin e Trajtimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruar të Torturës (CPT), Komisionin Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), Agjencinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) dhe organizma të tjerë.

¹⁸⁹ Në mënyrë të detajuar, disa nga drejtimit kryesore të veprimtarisë ndërkombëtare të Institucioni të Avokatit të Popullit gjenden në linkun:

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Bashk%C3%ABpunimi%20nderkombetar%20per%20vitin%202021.pdf>

Avokati i Popullit, gjithashtu, ka bashkëpunuar dhe ndërvepruar me mekanizma të ndryshëm në sistemin e OKB-së, duke përfshirë, Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), Këshillin e të Drejtave të Njeriut (HRC) dhe organet e tjera të traktateve të të drejtave të njeriut, duke synuar fuqizimin e rolit të tij në zbatimin e agjendës globale të të drejtave të njeriut dhe garantimin e barabartë të standarteve ndërkombëtare.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur kontakte të vazhdueshme me Delegacionin e BE-së në Tiranë si edhe me përfaqësues të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare që veprojnë në Shqipëri, si p.sh. Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë, Zyra e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së dhe agjencitë në kuadër të OKB-së si UNDP, UNHCR, UNICEF, UN Women, UNFPA e të tjera.

Në frymën e këtij bashkëpunimi, Avokati i Popullit me mbështetjen e Zyrës së Kombeve të Bashkuara në Tiranë realizoi një trajnim 2 ditor, në *datat 14-15 dhjetor 2021*, me temë: *“Rritja e kapaciteteve të stafit të Avokatit të Popullit, INSTAT dhe Avokatit të Popullit Kosovë, në lidhje me Axhendën 2030 dhe të Drejtat e Njeriut”*.

Në kuadër të këtij Bashkëpunimi, Zyra e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri dhe Avokati i Popullit, në *dhjetor të vitit 2021*, organizuan Konferencën Vjetore të Avokatit të Popullit me temë: *“Të Drejtat e Brezave të Ardhshëm dhe Ndryshimet Klimatike”*. Ndërkohë që përgjatë vitit 2021 ka vazhduar bashkëpunimi me zyrën e UNICEF-it në Shqipëri në kuadër të projektit *“Fuqizimi Institucional i Institucionit të Avokatit të Popullit – mbështetje për Seksionin e Mbrojtjes dhe Promovimit e të Drejtave të Fëmijëve”*.

5.3 Bashkëpunimi në kuadër të projekteve

Avokati i Popullit, përgjatë vitit 2021 ka vijuar zbatimin e *Marrëveshjes së Bashkëpunimit me UNHCR* për monitorimin e pikave të kalimit të migrantëve, forcimin si dhe respektimin e të drejtave të tyre. Dy ekspertët e jashtëm të Institucionit të Avokatit të Popullit, në pikat e kalimit kufitar, *Gjirokastër dhe Kapshticë*, kanë vazhduar të kryejnë monitorimin sistematik të kufijve, monitorimin e procedurave të përzgjedhjes së migrantëve të parregullt, raportimin periodik të gjetjeve si dhe trajtimin e zgjidhjen e problematikave të hasura. Në fund të dhjetorit 2021, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit edhe për vitin 2022, e cila do të mbulojë më shumë aktivitete duke qënë se fondet e vendosura në dispozicion nga donatori janë më të mëdha krahasuar me një vit më parë.

Avokati i Popullit përgjatë vitit 2021 vijoi zbatimin e projektit të financuar nga Programi i Drejtësisë së Bashkimit Evropian me titull *“B-Competent Forcimi i Kompetencave të stafit penitenciar në Evropë.”*¹⁹⁰ Projekti “B-Competent”, i cili përfundoi me sukses më 15.12.2021, synoi analizimin e mungesave të trajnimeve në shërbimet e burgjeve duke ofruar një paketë aftësish shumë disiplinore për stafin civil të burgjeve në 6 shtete (Itali, Francë, Spanjë, Shqipëri, Mal i Zi dhe Greqi). Ky objektivi u arrit nëpërmjet krijimit dhe zhvillimit të një programi inovativ

¹⁹⁰ Më shumë informacion në lidhje me projektin gjendet në linkun: <https://www.bcompetent.eu/>

ndërkufitar të trajnimit të trajnerëve, ndërthurur me shpërndarjen e praktikave më të mira, rritjen e ndërgjegjësimit dhe përmes mjeteve praktike shumëgjuhësore.

Në kuadër të projektit, Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në zhvillimin aktivitetëve të tilla si: *analizë e thelluar e mungesave të trajnimeve dhe identifikimi i praktikave më të mira; krijimi dhe zhvillimi i një kursi e-learning; botimi i broshurave shumëgjuhëshe me lojra edukative për stafin civil të burgjeve dhe video e animuar me skenarë rastesh e çështjesh praktike; 6 workshop-e ndërkufitare të trajnimit të trajnerëve në Itali, Shqipëri, Spanjë, Mal të Zi, Greqi dhe Francë, etj.*

Vlen të përmendet këtu aktiviteti i zhvilluar (Ditë e hapur) nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), më datë 28.06.2021, me temë "*Respektimi i të drejtave të shtetasve të huaj të cilët vuajnë dënimin në Republikën e Shqipërisë*". Aktiviteti kishte si qëllim zbatimin efektiv dhe koherent të ligjeve dhe standardeve të BE-së për trajtimin e të burgosurve të huaj, nëpërmjet një bashkëbisedimi të përbashkët, si dhe ndarjen e eksperiencave mbi veprimet ndërgjegjësuese dhe mjetet praktike.

Në datën 19 korrik 2021, Avokati i Popullit në rolin e tij si Mekanizmi për Parandalimin e Torturës organizoi në Tiranë Konferencën kombëtare me temë "*Respektimi i të drejtave të të burgosurve të huaj – Përmirësimi i kompetencave të stafit penitenciar. Eksperiencat në Shqipëri, Europë dhe globalisht*". Kjo konferencë u organizua për zbatimin efektiv dhe koherent të ligjeve dhe standardeve të BE-së për trajtimin e të burgosurve të huaj, nëpërmjet një bashkëbisedimi për ndarjen e eksperiencave dhe adresimit të problematikave kryesore.

Gjithashtu, po në kuadër të këtij projekti, në datat 01-04 nëntor 2021, një përfaqësi e institucionit të Avokatit të Popullit (përfshirë dhe një ekspert i jashtëm), kryesuar nga Komisionerja e Seksionit të Mekanizmit Kombëtar Kundër Torturës (MKPT), znj. Ermonela Xhafa, kryen një vizitë zyrtare në Athinë, Greqi. Qëllimi i kësaj vizite ishte interesimi i institucionit tonë në lidhje me gjendjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë në këto institucione, si dhe njohjen me nevojat dhe ankesat e tyre për krijimin edhe të mundësive për përmirësimin e situatës së tyre aktuale.

Nga takimet me të burgosurit shqiptarë u evidentuan problematikat lidhur me mos realizimin e kërkesave për transferim, për të vijuar dënimin në Shqipëri; si dhe pamundësia financiare për të paguar avokat mbrojtës (pavarësisht se u ofroreshin avokatë kryesisht nga ministria greke), si dhe pamundësia ekonomike për të komunikuar me familjet si dhe dhe për të kryer shërbime të tjera personale etj. Në përfundim të kësaj vizite është përgatitur një raport nga eksperti i jashtëm.¹⁹¹

Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdoi zbatimin e *Marrëveshjen e Bashkëpunimit me UNICEF*, e cila përfundoi më 30 Nëntor 2021. Në ndryshim nga viti 2020, gjatë vitit 2021, një vëmendje e shtuar i është kushtuar, ndikimit që masat për parandalimin e përhapjes së pandemisë Covid-19,

¹⁹¹ Ky raport gjendet në linkun: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/REPORT-english.pdf>

patën në të drejtat e fëmijëve. Në këtë aspekt, institucioni i Avokatit të Popullit në zbatim të legjislacionit të administrimit të drejtësisë penale për të mitur, *realizoi 6 (gjashtë) inspektime në komisariate dhe në institucionin e privimit të lirisë (IMK)*, me qëllim zbatimin e rekomandimeve të adresuara në vijëmbësi si dhe zbatimin e masave anticovid. Po në zbatim të kësaj marrëveshjeje, një ndër objektivat e planit të veprimit ishte edhe mbrojtja sociale. Kështu, për monitorimin e veprimtarisë administrative të institucioneve përgjegjëse shtetërore, pjesë e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, janë organizuar *14 monitorime*, në disa nga bashkitë e vendit, me përfaqësues të autoriteteve publike në nivelin vendor, përgjegjëse për mbrojtjen sociale të fëmijëve, për ofrimin e shërbimeve sociale të dedikuara fëmijëve.

Në kuadër të Marrëveshjes të Mirëkuptimit për vitet 2021-2022, ndërmjet *Avokatit të Popullit dhe Save the Children*, institucioni i AP/SMPDF është një nga përfituesit e këtij projekti, në drejtim të përmirësimit të njohurive dhe kapaciteteve të institucionit të Avokatit të Popullit/Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve, për ndryshimet klimatike, duke promovuar pjesëmarrjen dhe konsultimin e fëmijëve në planifikimin institucional.

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit është përzgjedhur nga *Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA)*, për të kontribuar mbi situatën në Shqipëri në raportin vjetor të FRA për respektimin e të drejtave të njeriut. Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA) është institucion i Bashkimit Evropian, që ofron asistencë dhe ekspertizë për çështje të lidhura me të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kjo Agjenci publikon çdo vit një raport vjetor mbi çështjet e të drejtave të njeriut në vendet anëtare të Bashkimit Evropian, duke përfshirë dhe vendet që kanë statusin e vëzhguesit pranë kësaj Agjencie, siç është dhe rasti i Shqipërisë që bëhet pjesë e këtij raportimi për herë të parë.

Për mbledhjen e të dhënave në kuadër të hartimit të këtij raporti, krahas punës kërkimore në mënyrë të pavarur, institucioni i Avokatit të Popullit ka bashkëpunuar me rreth 102 institucione të administratës publike nga të cilët janë mbledhur të dhëna dhe informacion në lidhje me zhvillimet gjatë vitit 2021, që përafrojnë ligjin vendas me atë të BE-së ose zhvillimet ligjore të krahasueshme me legjislacionin aktual të BE-së në disa fusha të veçanta si:

- barazia dhe mosdiskriminimi;
- racizmi, ksenofobia dhe intoleranca e lidhur me të;
- barazia dhe përfshirja e romëve;
- azili, vizat, migrimi, kufijtë dhe integrimi;
- shoqëria e informacionit, privatësia dhe mbrojtja e të dhënave;
- të drejtat e fëmijës;
- aksesin në drejtësi, përfshirë të drejtat e viktimave të krimit;
- zhvillimet në zbatimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Për secilën prej këtyre fushave është raportuar mbi zhvillimet në fushën e legjislacionit dhe politikave si dhe raportimet apo gjetjet nga studime të ndryshme në fushat përkatëse. Krahas raportimit, për secilën prej fushave të mësipërme (përveç fushës mbi azilin, vizat, migrimin, kufijtë dhe integrimin), është identifikuar një praktikë premtuese lidhur me politikat, veprimet ose masat e zbatuara nga institucionet publike. Praktikrat e përzgjedhura janë të qëndrueshme dhe me ndikim

konkret e të matshëm. Për fusha të veçanta si barazia dhe mosdiskriminimi, shoqëria e informacionit dhe mbrojtja e të dhënave personale, është raportuar gjithashtu praktika më e fundit gjyqësore.

Zbatimi i këtij projekti ka filluar në muajin Shtator të vitit 2021 dhe pritet të përfundojë gjatë vitit 2022, me publikimin e raportit përfundimtar nga Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore.

Institucioni i Avokatit të Popullit është bërë tashmë pjesë e programit “*Drejtësia*” të Komisionit Evropian, një projekt 2 vjeçar i emërtuar “*SERENY*”, i cili ka filluar zyrtarisht zbatimin e tij në nëntor 2021. Projekti “*SERENY*” me titull “*Përforcimi i qasjeve për parandalimin e radikalizimit të të rinjve në burgje dhe në Shërbimin e Provës*”, synon të forcojë qasjet për parandalimin e radikalizimit të të rinjve (18-29 vjeç) në burgje dhe shërbimin e provës në nivel evropian, sipas standardeve ndërkombëtare dhe rezolutës së Parlamentit Evropian të 5 tetorit 2017 “*Mbi sistemet dhe kushtet e burgjeve*” (2015/2062(INI)). Ky projekt do të fokusohet te stafet e institucioneve të privimit të lirisë dhe shërbimit të provës si dhe te aktorë të tjerë të përfshirë (politikëbërësit dhe Ombudsmanët) të cilët do të sigurojnë që problemi i radikalizimit tek të rinjtë në paraburgim t’iu adresohet në mënyrë efektive profesionistëve dhe vendimmarrësve.

Gjatë vitit 2021, institucioni i Avokatit të Popullit në kuader të *fondeve të Programit IPA 2020*, u përzgjodh si institucion përfitues i një Projekti Twinning në shumën prej 300.000 mijë euro. Projekti “*Mbështetje për Zyrën e Avokatit të Popullit dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri*”, ka si objekt kryesor të saj të kontribuojë në demokratizimin e shoqërisë, promovimin e parimeve të shtetit të së drejtës, të drejtave të njeriut dhe qeverisjes së mirë përmes rritjes së efikasitetit të kontrollit të ligjshmërisë në punën e organeve të administratës publike, përmes rritjes së kapaciteteve të institucionit të Avokatit të Popullit në fushën e të drejtave të njeriut, mbrojtjes dhe promovimit të lirive themelore, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Në përputhje me procedurat e ndjekuara në kuadër të projekteve twinning, aktualisht nga institucioni përfitues (Avokati i Popullit) është përzgjedhur Ombudsmani i Austrisë si partner për zbatimin e këtij projekti, marrëveshja me të cilin pritet të nënshkruhet gjatë mesit të vitit 2022.

5.4 Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit në ushtrim të mandatit të tij promovues

(Media online, media tradicionale, intervista televizive, rritje dhe kujdes për audiencën në rrjetet zyrtare sociale, faqja zyrtare e institucionit, nënfaqet e seksioneve, aplikacioni smartphone)

Në kuadrin e mandatit të tij promovues të të drejtave të njeriut, institucioni i Avokatit të Popullit vijon një politikë të hapur dhe gjithëpërfshirëse informimi dhe pasqyrimi të aktiviteteve të tij.

Promovimi i institucionit dhe punës së tij kryhet në mënyrë shumëplanëshe e të sinkronizuar, përmes disa kanaleve të cilat janë publikimi i eventeve dhe aktiviteteve në seksionin e lajmeve të faqes zyrtare online të institucionit, aplikacionit për smart-phone “Avokati i Popullit”, rrjeteve sociale të institucionit apo edhe mediave të interesuara ose të adresuara prej vetë institucionit.

Faqja zyrtare e Avokatit të Popullit www.avokatipopullit.gov.al mbahet e përditësuar me informacione që vlerësohen se kanë rëndësi për dokumentimin dhe pasqyrimin e aktiviteteve të institucionit.

Në seksionin e “Qendra e medias” publikohen në vazhdimësi lajme, të reja, statistika e përditësime mbi punën e institucionit.

Përgjatë vitit 2021 janë publikuar mbi **145** lajme e informacione në këtë faqe. Gjithashtu në seksionin e multimedias të kësaj faqeje publikohen video nga intervistat e titullarëve të institucionit në mediat kombëtare e vendore, apo edhe kronika me interes të veçantë për institucionin.

Gjatë periudhës në fjalë, janë përpiluar dhe publikuar **69** qëndrime publike të institucionit të Avokatit të Popullit mbi një gamë të gjerë çështjesh që përfshijnë reagime kundër dhunës ndaj grave, emigrantëve, personave të komunitetit LGBTI, reagime inkurajuese për garantimin e të drejtave të gazetarëve, të tubimeve, të strehimit, shërbimit shëndetësor, minimumit jetik, etj.

Periudha e mbuluar nga ky raport përfshin edhe pjesëmarrjen e Avokates së Popullit në **57** konferenca të tematizuara mbi të drejtat e njeriut, të kryera in-persona apo online, secila prej të cilave është adresuar me një fjalim, mesazh apo qëndrim nga titullarja e institucionit.

Përgjatë vitit 2021 Avokatja e Popullit Erinda Ballanca është ftuar dhe ka marrë pjesë në mbi **36** intervista në studio televizive të kanaleve kryesore kombëtare në vend si Top Channel (27 janar, 19 prill), Euroneës Albania (20 prill, 17 nëntor), Zëri i Amerikës (16 prill), RTSH (6 korrik), A2 CNN (20 prill, 22 prill, 20 nëntor), etj.

The screenshot displays the website's interface with a navigation bar at the top containing: LEGJISLACIONI, AKTIVITETET, BOTIMET, TRANSPARENÇA, MEDIA, STATISTIKA, PLANET TONA, and KONTAKT. A dropdown menu for ANKOHU is visible on the right. Below the navigation bar is a grid of video thumbnails. Each thumbnail includes a small image, a caption, and a date. The thumbnails are arranged in two rows of four. The first row includes videos from January 30, 2021, and November 30, 2021. The second row includes videos from January 27, 2021, and December 28, 2021. The captions describe various interviews and appearances on television channels like ABC News, Dëshmitë, TV Euroneës Albania, and SCAN TV.

Faqja e Avokatit të Popullit në Facebook ka rritur gjithashtu shtrirjen dhe ndikimin e saj përgjatë vitit 2021. Duhet theksuar se faqja e ka dhjetëfishuar audiencën e vet prej **800-1000** ndjekës në vitin 2017 në afro **9000** në fund të vitit 2021, me një rritje prej mesatarisht **1800** ndjekësish në vit.

Rritja e ndjekjes dhe zgjerimi i audiencës së faqes së Avokatit të Popullit në Facebook është kryer në mënyrë organike, pa asnjë sponsorizim dhe me zero shpenzime burimesh financiare e njerëzore.

Gjithashtu, çdo seksion i Avokatit të Popullit është pajisur dhe operon një nën-faqe shtesë në Facebook, ku secila prej tyre ka zhvilluar audiencën e vet specifike përmes pasqyritit të aktiviteteve të veta.

Mesatarisht, faqja e Avokatit të Popullit në Facebook ka pasur përgjatë vitit 2021 një numër prej **20-30** postimesh, me një reach total mujor prej afro **15.000** dhe me afro **2.770** angazhime të audiencës dhe mbi **1100** reagime ndaj postimeve të publikuara.

Page Overview	
Discovery	
Post reach	14,995
Post engagement	2,775
New Page Followers	62
Interactions	
Reactions	1,100
Comments	23
Shares	80
Photo Views	565
Link Clicks	8

Mbërritja e mesazhit të Avokatit të Popullit tek publiku përmes mjeteve të shumëfishta, ku një vend të rëndësishëm e zënë rrjetet sociale, është i një rëndësie të veçantë, prandaj ekipi ynë i ka kushtuar një vëmendje të posaçme punës promovuese në këtë drejtim.

Në total, duke përfshirë edhe numrin e ndjekësve dhe angazhimeve prej **5** nënfaqeve të tjera të seksioneve të Avokatit të Popullit në Facebook, numri i përgjithshëm i ndjekësve të angazhuar i afrohet **20.000**.

KREU 6

Shërbimet mbështetëse

6.1 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Është gjerësisht e pranuar që menaxhimi i burimeve njerëzore luan një rol thelbësor në zhvillimin e një vendi dhe në veçanti, në zbatimin e aktiviteteve të rëndësishme strategjike të administratës publike. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është pjesë e rëndësishme e funksionit të procesit të menaxhimit. Selektimi, trajnimi dhe vlerësimi i njësive dhe strukturave të institucionit është një mjet i rëndësishëm dhe strategjik që ndihmon në krijimin e një përparësie të qëndrueshme konkurruese të institucionit dhe i shton vlerën asaj. Kjo nënkupton në rradhë të parë përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit të shërbimit civil, nëpërmjet forcimit të parimit të meritës në rekrutim, rritjen e mobilitetit dhe zhvillimit të karrierës brenda shërbimit civil, si dhe përmirësimin të sistemit të trajnimit.

Në këtë kontekst, punonjësit apo nëpunësit civilë konsiderohen si pjesë e një trupe të mirëpërgatitur, profesionale të cilët janë rekrutuar për t'i shërbyer interesit publik dhe për të qenë të përgjegjshëm për veprimet e ndërmarra në interes të qytetarëve.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, i ka kushtuar dhe i kushton një rëndësi thelbësore menaxhimit të burimeve njerëzore, forcimit dhe trajnimit të vazhdueshëm të tyre në funksion të ushtrimit të mandatit të tij kushtetues në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Kjo, edhe për faktin se institucioni i Avokatit të Popullit në veprimtarinë e tij duhet të mbështetet nga një infrastrukturë njerëzore dhe financiare që mundëson realizimin e objektivave dhe qëllimeve të tij në përputhje të plotë me Parimet e Parisit dhe Parimet e Venecias, të cilat theksojnë nevojën e një qasje gjithëpërfshirëse për të forcuar kapacitetet e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut në trajtimin e rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Janë këto parime, të cilat i lejojnë një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të përshtatë strukturën me prioritetet e tij, qoftë edhe nëpërmjet krijimit të strukturave ad hoc, duke pasur një autonomi organizative për sa i përket strukturës dhe mënyrës së funksionimit të saj.

Me qëllim përmirësimin e përcaktimit të fushave të përgjegjësisë dhe të drejtave specifike që mbulohen nga seksionet përkatëse të institucionit, Avokatja e Popullit miratoi Urdhërin nr.154, datë 18.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë dhe të drejtave specifike që do të mbulohen nga ndihmëskomisioneret e seksioneve në Institucionin e Avokatit të Popullit”, në të cilën janë përfshirë edhe disa fusha të reja (të papërcaktuara më parë) të cilat duhet të jenë në vëmendjen e institucionit si pjesë e një mandate të gjërë në të cilën ai operon. Këtu përfshihen

çështje dhe të drejta që lidhen me: *inteligjencën artificiale, të drejtat e gjeneratave të ardhshme, mbrojtjen e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të drejtën për martesë, familje etj.*

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatit e Popullit”, i ndryshuar, në muajin dhjetor 2021, institucioni i Avokatit të Popullit shpalli konkurimin për 2 (dy) vende vakante për Komisioner dhe konkretisht: *Komisioner në Seksionin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve; Komisioner në Seksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimin ose Dënimit të Egër, Ç’njerëzor ose Poshtëruës.* Në përfundim të procesit të vlerësimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve ligjore nga kandidatët, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të tyre (përfshirë edhe intervistimin) nga Komisioni Ad hoc, Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca më datë 04.02.2022¹⁹², i përcolli Kuvendit të Shqipërisë, listën e kandidaturave për pozicionet e mësipërme.

Duhet të theksojmë, gjithashtu, se gjatë vitit 2021, në përputhje me dispozitat e rekrutimit të legjislacionit në fushën e shërbimit civil, nga Institucioni janë shpallur disa pozicione të lira, duke pasur parasysh dorëheqjet, largimet në detyra të tjera brenda administratës publike apo pezullimin e statusit për arsye të ndryshme. Nuk duhet të harrojmë edhe faktin se legjislacioni aktual në fushën e shërbimit civil është konceptuar në funksion të mbështetjes së karrierës së nëpunësve dhe lëvizjeve brenda sistemit të shërbimit civil, gjë që imponon respektimin e atyre afateve të gjata procedurale që legjislacioni parashikon për këto raste.

Në kuadër të paraqitjes së kërkesave buxhetore për vitin 2022 dërguar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, institucioni i Avokatit të Popullit kërkoi miratimin e shtesës për 3 (tre) punonjës të nivelit ndihmëskomisioner duke paraqitur argumentet përkatëse. Këto kërkesave lidheshin për shkak të burimeve të kufizuara të kapaciteteve njerëzore të Institucionit të Avokatit të Popullit, i cili që prej vitit 2016, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme nuk i ishte miratuar asnjë shtesë në burime njerëzore.

Në pamundësi të miratimit të 3 (tre) punonjësve të rinj, gjatë diskutimeve të zhvilluara në Komisionin e Ligjeve, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut për çështjet e buxhetit (nëntor 2021), nga përfaqësuesit e institucionit në këtë seancë dëgjimore u kërkua, si plotësisht e mundshme dhe e nevojshme, vlerësimi i mundësisë të miratimit të paktën të një ndihmëskomisioneri, kërkesë e cila gjeti mirëkuptimin nga përfaqësuesit jo vetëm të këtij komisioni por dhe nga përfaqësuesit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë prezent në këtë seancë dëgjimore.

Me miratimin e ligjit nr.115/2021, “*Për buxhetin e vitit 2022*”, u konstatua se numri i përgjithshëm i miratuar i punonjësve të institucionit për vitin 2022 është 57 (*pesëdhjetë e shtatë*) nga 56 (*pesëdhjetë e gjashtë*) që ishte, gjë që është reflektuar edhe në strukturën e institucionit.

Siç është informuar edhe më parë, në bashkëpunim me pushtetin vendor janë hapur dhe funksionojnë zyrat rajonale në qytetet e Shkodrës, Vlorës, Beratit, Sarandës, Kukësit, Pogradecit dhe Bashkisë Dropull, të cilat në vetvete lehtësojnë komunikimin e qytetarëve të këtyre zonave me institucionin e Avokatit të Popullit. Një indikator matës që tregon efektivitetin e zyrave rajonale


¹⁹² Shkresa nr.57, datë 04.02.2022.

të Avokatit të Popullit, dhe për rrjedhojë rritjen e besimit të qytetarëve tek këto zyra, është numri i ankesave që depozitohen prej qytetarëve pranë këtyre zyrave rajonale si dhe ndjekja dhe adresimi i duhur i tyre nga Institucioni.

Gjatë vitit raportues e në vijim, bazuar në marrëveshjen e nënshkruar me UNHCR për monitorimin e emigrantëve në pikat e kalimit kufitar, në mbështetje të punës së Seksionit të MKPT-së ka vazhduar puna me kohë të plotë e 2 ekspertëve të jashtëm. Ndërkohë, me mbështetjen e UNICEF, institucioni i Avokatit të Popullit mundësoi vazhdimin e punës të 2 ekspertëve të tjerë të jashtëm për të mbështetur Seksionit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve.

Për vitin 2021, Struktura e institucionit, miratuar me Urdhërin e brendshëm nr.42, datë 18.02.2020 “Për disa ndryshime në Urdhërin nr.252, datë 22.11.2018, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të nstitutionit të Avokatit të Popullit”, i ndryshuar, paraqitet si më poshtë:

Organigrama



Struktura

Emërtimi i funksionit	Numri i punonjësve (56)	Kategoria/Klasa
Avokati i Popullit (1)		
Avokati i Popullit	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
Kabineti (7)		
Drejtor Kabineti	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
Këshilltar	5	I-b
Sekretar	1	VKM nr. 187, datë 08.03.2017, i ndryshuar
Sekretar i Përgjithshëm (1)		
Sekretar i Përgjithshëm	1	I-a
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre (7)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	3 3	II-a b
Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor (5)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	2 2	II-a II-b
Seksioni i Përgjithshëm (5)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	3 1	II-a II-b
Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve (4)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner	2 1	II-a II-b
Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (5)		
Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
Ndihmëskomisioner		

	2	II-a
	2	II-b
Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve (18)		
Drejtor	1	II-b
Sektori i Burimeve Njerëzore dhe (3)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Specialist për Burimet Njerëzore	1	III-b
Specialist Protokolli	1	III-b
Sektor i Shërbimeve (8)		
Përgjegjës Sektori	1	III-a
Arkivist/Bibliotekar	1	Klasa VIII
Shofer i titullarit	1	Klasa VI
Shofer	2	Klasa IV
Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme	1	Klasa VI
Punëtor pastrimi	2	Klasa I
Sektori i Financës dhe Prokurimeve (3)		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist i Financës	1	III-b
Specialist i Prokurimeve	1	III-b
Sektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve (3)		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit	2	III-b
Sektori për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian (3)		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	2	III-b

6.2 Vështrim mbi të ardhurat dhe shpenzimet

Realizimi i buxhetit të Institucionit për vitin 2021

Në mbështetje të ligjit nr. 137/2020, datë 16.11.2020, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2021", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 2, datë 06.02.2012, "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 4, datë 25.01.2021 "Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2021", i ndryshuar, performanca e produkteve të buxhetit për institucionin e

Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2021, paraqitet si më poshtë:

Programi - “Shërbimi Avokatisë”

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2021-2023 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2021-2023)

Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2020

Me Ligjin Nr. 137/2020, datë 16.11.2020, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2021", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të institucionit të Avokatit të Popullit, sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Raporti i Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Tabela nr. 1

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa dhe Pakësime	Plani i ndryshuar	Fakti
600	Paga	86,000,000		86,000,000	82,349,911
601	Sig. Shoqërore e Shëndetësore	12,500,000		12,500,000	12,201,295
602	Mallra dhe shërbime të tjera	15,400,000		15,400,000	14,613,532
605	Transferta. Korente të Huaja	1,600,000	10,000	1,610,000	1,607,936
606	Transf për buxhetet familjare	500,000	140,000	640,000	292,461
231	Investimet	3,000,000		3,000,000	2,974,920
	TOTALI	119,000,000	150,000	119,150,000	114,040,055


Raporti Vjetor i Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2021

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	86,000,000	82,349,911	3,650,089	95.76
2	Sigurime Shoqërore e Shëndetësore	12,500,000	12,201,295	298,705	97.61
3	Mallra dhe shërbime të tjera	15,400,000	14,613,532	786,468	94.89

4	Transferta Korente të Huaja	1,610,000	1,607,936	2,064	99.87
5	Transferta për buxhetet familjare	640,000	292,461	347,539	45.69
6	Investimet	3,000,000	2,974,920	25,080	99.16
	Totali	119,150,000	114,040,055	5,109,945	95.71

Siç përmendet dhe më poshtë, diferenca e mosrealizimeve (4.29%) të buxhetit për vitin 2021 lidhet në pjesën më të madhe me fondin *paga dhe sigurime shoqërore* të cilat vijnë për shkak të mosplotësimit të strukturave organike duke pasur në konsideratë procedurat që kërkohen të ndiqen dhe afatet kohore që duhen të respektohen për rekrutimin e stafit në pozicionet e punës që bien brenda ligjit për shërbimin civil. Gjithashtu, edhe në zërin 602 (*mallra dhe shërbime*) kemi një diferencë në mosrealizim për shkak të vetë situatës së pandemisë gjë që realisht pamundësoi realizimin e shumë aktiviteteve të parashikuara apo realizimin e tyre pa kosto financiare (aktivitete online), përfshirë këtu dhe aktivitete ndërkombëtare.



1-Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikë, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fondi i akorduar për vitin 2021, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli ishte 86,000,000 lekë, ndërsa realizimi është 82,349,911 lekë ose 95.76%, i buxhetit, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore ishin në plan 12,500,000 lekë, ndërsa realizimi është 12,201,295 lekë ose në masën 97.61% i buxhetit.

Të dy zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2021 janë realizuar në masën 95.99% i buxhetit. Gjatë vitit 2021, numri mesatar i punonjësve ka qenë 54,25 punonjës nga 56 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2020 dhe gjatë vitit 2021 nga lëvizja e punonjësve të institucionit në detyra të tjera. Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2021, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë këtyre periudhave.

Ka patur mungesa në katër/mujorin e parë:

- 1 Ndhmëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tjetërve që veprojnë për llogari të tyre për tre muaj për katër muaj;
- 1 Përgjegjës në Sektorin e Shërbimeve për dy muaj;
- 1 Specialist në Sektorin e Financës dhe Prokurimeve për një muaj;
- 1 Specialist në Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian për tre muaj.

Gjatë katër/mujorit të tretë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1 Këshilltar për tre muaj;
- 1 Ndhmëskomisioner në Seksionin për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të tjetërve që veprojnë për llogari të tyre për tre muaj;
- 1 Përgjegjës në Specialist në Sektorin për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrimin Evropian për një muaj.

Nr.	Vitet	Miratuara					
		600-601	602-606	231	Nr. i Punonjësve		Totali
		Paga dhe sigurime	Shpenzime Operative	Investime	Nd/Komisioner	Gjithsëj	
1	2014	75,500	16,000	4,000	21	50	95,500
2	2015	75,500	16,000	4,000	21	51	95,500
3	2016	84,500	17,000	4,000	21	55	105,500
4	2017	84,500	18,000	4,000	21	56	106,500

5	2018	94,500	17,500	4,000	21	56	116,000
6	2019	104,500	18,600	2,000	21	56	125,100
7	2020	98,500	17,000	1,000	21	56	116,500
8	2021	98,500	17,500	3,000	21	56	119,000
9	2022	102,500	22,700	4,000	22	57	129,200

2.- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera

Fondi i akorduar për shpenzime mallra e shërbime (**zëri 602**) për periudhën janar – dhjetor 2021 ishte 15,400,000, ndërsa realizimi është 14,613,532 lekë ose 94.89% i buxhetit.

Për këtë periudhë shpenzimet operative, janë përdorur kryesisht për pagesat e blerjeve për kancelari, materiale pastrimi, elektrike, materiale promovuese, furnizim me materiale të tjera zyre, shpenzime për energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafonë, shërbimi postar, siguracion automjetesh, shpenzime për dezinfektim e ambienteve të institucionit, shpenzime për mirëmbajtjen e automjeteve të institucionit, dieta brenda dhe jashtë vendit. shpenzime për mirëmbajtje ndërtime, shpenzime për mirëmbajtje aparatura e pajisje teknike, shpenzime pritje-përcjellje të huajve, si dhe shpenzime për taksa të paguara.

Fondi për transfertat korentë të huaja (**zëri 605**) për vitin 2021, ishte 1,600,000 lekë, i ndryshuar me shkresë nr. 3137/1 Prot., datë 17.02.2021, “Transferim fonde për vitin 2021” në 1,610,000 lekë ndërsa realizimi është 1,607,936 lekë ose 99.87% i buxhetit të ndryshuar.

Për vitin 2021 këto fonde janë përdorur për shlyerjen e detyrimeve në kohë të kuotave të anëtarësimit ku institucioni i Avokatit të Popullit është anëtarë në organizata ndërkombëtare si:

- *Association des Ombudsmans et Mediateurs de la Francophonie(AOMF)*,
- *European Ombudsman Institute (EOI)*,
- *Association of Mediterranean Ombudsman (AOM)*,
- *International Ombudsman Institute (IOI)*,
- *Global Alliance of National Human Rights Institutions (GANHRI)*,
- *European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI)*,
- *European Network of Ombudspersons for Children (ENOC)*.

Nr.	Emërtimi i Organizatës	Monedha	Kuotacionet në vite						
			Vlera në vite						
			2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
1.	Shoqata e Ombudsmanit të Vendeve Mesdhetare (AOM)	Euro	750	750	750	750	1,000	1,000	1,000

2.	Shoqata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF)	Euro	650	650	750	900	900	900	900
3.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI)	Euro	3,000	3,000	3,000	4,000	4,000	4,000	4,000
4.	Rrjeti Evropian të Ombudsmanit për Fëmijë (ENOC)	Euro	0	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100	1,100
5.	Instituti Evropian i Ombudsmanit (EOI)	Euro	350	350	350	350	350	350	350
6.	Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI)	CHF	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000	5,000
7.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI)	Euro	750	750	750	750	750	750	750

Fondi për transfertat buxhetore familjare dhe individë (**zëri 606**) për periudhën Janar - Dhjetor 2021, ishte 500,000 lekë, i ndryshuar me shkresat nr. 3137/1, datë 17.02.2021, “Transferim fonde për vitin 2021”, si dhe “Dërgohet detajimi fondit të veçantë për vitin 2021” nr. 1381/31, datë 17.02.2021 në 640,000 lekë, ndërsa realizimi është *292,461 lekë ose 45.69% i buxhetit të ndryshuar.*

3.- Shpenzime në investime

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit është *3,000 mijë lekë, ndërsa realizimi 2,975 mijë lekë.*

Në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
Pajisje - Kompjuterike	M660001	2,372	2,372	100
Blerje kondicioner	M660001	108	108	100
Blerje orendi zyre	M660001	520	495	95.17

“Blerje Pajisje kompjuterike”

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej *2,372,160 lekë, ose në masën 100%.*

" Blerje kondicioner"

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej *108,000 lekë, ose në masën 100%.*

" Blerje orendi zyre"

Për këtë zë të investimeve siç paraqitet në tabelën mësipërme është realizuar në vlerën prej 494,760 lekë, ose në masën 95.17%.

KREU 7

Shifra dhe fakte në lidhje me ankesat dhe trajtimin e tyre

Një vend të veçantë në raportin vjetor të veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit, zë pasqyrimi i statistikave pëmbledhëse e cila jep një panoramë më koncize të punës një vjecare të institucionit. Shtetasve shqiptarë, shetasve të huaj, personave pa shtetësi, organizatave të shoqërisë civile, u është dhënë mundësia që të adresojnë rastet/ankesat e shkeljes së të drejtave dhe lirive themelore në çdo formë të mundshme që lehtëson aksesin e tyre në institucion, konkretisht: me paraqitjen fizike pranë zyrës qendrore në Tiranë, pranë 7 zyrave rajonale të vendosura në qytetet e Beratit, Dropullit, Kukësit, Pogradecit, Sarandës, Shkodrës dhe Vlorës si dhe nëpërmjet mënyrave të tjera të komunikimit si e-mail, aplikacion për telefon celular, faqja zyrtare e institucionit, shërbimi postar, rrjetet sociale, telefon etj.

Kështu në vitin 2021, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar gjithsej **5837** raste/kërkesa. Konkretisht:

- 1170 raste të cilat janë konstatuar si ankesa “brenda juridiksionit dhe kompetencës” së institucionit të AP;
- 460 raste të trajtuara me iniciativën e institucionit të AP nga indicie të tilla si mediat, rrjetet sociale, emisionet investigative etj. ;
- 4188 kërkesa të cilat janë trajtuar si këshillime dhe orientime mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin subjektet ankues/kërkues për trajtimin e rasteve;
- 19 raste të trajtuara si jashtë kompetencës së institucionit të AP.




Figura 3. Paraqitja grafike e rasteve të depozituara dhe të trajtuara pranë institucionit të Avokatit të Popullit dhe 7 Zyrave Rajonale.

Krahasuar me vitet e mëparshme, në vitin 2021 vihet re që është arritur numri më i lartë i rasteve të paraqitura ndonjëherë nga institucioni i Avokatit të Popullit.




Figura 4. Paraqitja grafike e rasteve të paraqitura nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite.




Figura 5. Paraqitja grafike e shpërndarjes së ankesave/këshillimeve dhe rasteve me iniciativë në 7 zyrat rajonale për vitin 2021.




Figura 6. Paraqitja grafike e të dhënave të zyrave rajonale në 3 vitet e fundit.




Figura 7. Paraqitja grafike e rasteve të depozituara në zyrat rajonale për vitet 2020-2021.




Figura 8. Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit sipas qarqeve të Republikës së Shqipërisë




Figura 9. Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit sipas qyteteve të Republikës së Shqipërisë.




Figura 10. Paraqitja grafike shpërndarjes së rasteve të shqyrtuara nga institucioni në vitet 2020 dhe 2021 sipas qyteteve.




Figura 11. Paraqitja grafike e shpërndarjes së rasteve sipas institucioneve përgjegjëse për shkëlqje ndaj qytetarëve.




Figura 12. Paraqitja grafike e rasteve të regjistruara dhe të trajtuara nga institucioni sipas fushës së të drejtës dhe sipas gjinisë.

Në vitin 2021, institucioni i Avokatit të Popullit gjatë ushtrimit të mandatit të tij ka përfunduar hetimin administrativ për 1933 raste ndër të cilat 40% raste i përkasin rasteve të depozituara në institucion përgjatë vitit 2021 dhe 60% të rasteve të mbartura në vite.

Për këto raste rezulton se për:

- 8% të rasteve ka përfunduar hetimi administrativ ku janë adresuar shklejet nëpërmjet rekomandimeve;

- 43% të rasteve ka përfunduar në favor të ankuesit, duke adresuar shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ pa nevojën e ndërhyrjes me rekomandim;
- 26% të rasteve gjatë hetimit administrativ kanë rezultuar si ankesa të pabazuara;
- 8% të rasteve ka përfunduar hetimi si rezultat i heqjes dorë nga ankuesit;
- 6% të rasteve të cilat gjatë hetimit kanë rezultuar si raste jashtë juridiksioni;
- 9% të rasteve të cilat gjatë hetimit kanë rezultuar si raste jashtë kompetence.



Figura 13. Paraqitja grafike e rasteve për të cilat ka përfunduar hetimi administrativ.



Figura 14. Paraqitja grafike e numrit të rasteve të zgjidhura pa rekomandim në vitet 2020 dhe 2021.




Figura 15. Paraqitja grafike e mënyrave të përfundimit të hetimit administrativ të rasteve.

Në vitin 2021, nga monitorimi i përditshëm i shërbimeve mediatike në Republikën e Shqipërisë për identifikimin e rasteve të shkeljes të së drejtës, insitucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar me iniciativën e tij 460 raste me iniciativë.



Figura 16. Paraqitja grafike e rasteve me iniciativë të trajtuara nga seksionet e AP.



Figura 17. Paraqitja grafike e rasteve me iniciativë e shprehur në % sipas seksioneve.



Figura 18. Paraqitja grafike e kurbës së ndryshimit të rasteve me iniciativë të trajtuara ndër vite.

Në vitin 2021, insititucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 267 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike, përfshirë ato qendrore dhe vendore.




Figura 19. Paraqitja fizike e kurbës së ndryshimit të numrit të rekomandimeve të adresuar në vitet 2018-2021.




Figura 20. Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuara nga 5 seksionet e Avokatit të Popullit.




Figura 21. Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuara nga seksionet në përqindje.




Figura 22. Paraqitja grafike e rekomandimeve të adresuara nga seksionet në vitet 2019-2020-2021.

Kështu, institucioni nga 267 rekomandime të realizuara në vitin 2021, ka adresuar gjithsej 1256 nën-rekomandime, rritje kjo me 51.5% krahasimisht me zërat e rekomanduara në vitin 2020.




Figura 23. Paraqitja grafike e numrit të zërave të rekomanduara sipas seksioneve krahasuar dhe me vitin 2020.

Nga 1256 zëra të rekomanduara, vetëm 29% e tyre janë zbatuar plotësisht nga institucionet e adresuara dhe 71% janë të pazbatuara. Nga zërat e pa zbatuara, për 16% e tyre institucioni nuk ka marr asnjë përgjigje, 4.5% rezultojnë të refuzuara dhe 50.5% e tyre rezultojnë në proces zbatimi.



Figura 24. Paraqitja grafike e zbatueshmërisë së zërave të rekomanduara nga institucioni i Avokatit të Popullit për vitin 2021.




Figura 25. Paraqitja grafike e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i veçantë për vitin 2021.



Figura 26. Paraqitja grafike në përqindje e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i veçantë për vitin 2021.




Figura 27. Paraqitja grafike e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i MKPT-së për vitin 2021.



Figura 28. Paraqitja grafike në përqindje e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i MKPT-së për vitin 2021.




Figura 29. Paraqitja grafike e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i përgjithshëm, për vitin 2021.



Figura 30. Paraqitja grafike në përqindje e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i përgjithshëm, për vitin 2021.




Figura 31. Paraqitja grafike e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i administratës, për vitin 2021.



Figura 32. Paraqitja grafike në përqindje e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i administratës, për vitin 2021.




Figura 33. Paraqitja grafike e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i fëmijëve, për vitin 2021.



Figura 34. Paraqitja grafike në përqindje e statusit të zërave të rekomanduara nga seksioni i fëmijëve, për vitin 2021.



Figura 35. Paraqitja grafike e zbatueshmërisë së pikave të rekomanduara nga 5 seksionet e insitucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2021.

267 rekomandimet e realizuara u janë drejtuar dhe ridrejtuar 559 institucioneve si dhe janë vënë në dijeni 121 institucione të tjera.



Figura 36. Paraqitja grafike e numrit të institucioneve të cilave u janë adresuar rekomandimeve dhe të vëna në dijeni.




Figura 37. Paraqitja grafike e numrit të institucioneve të adresuara dhe të vëna në dijeni sipas Seksioneve.




Figura 38. Paraqitja grafike e rekomandimeve sipas gjinisë së ankuesit krahasuar me të dhënat e vitit 2020.

Shpërndarja e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit sipas Objektivave të Zhvillimit të Qendrushëm (SDG) për vitin 2021, paraqitet si më poshtë vijon:




Figura 39. Paraqitja grafike e rekomandimeve sipas Objektivave të Zhvillimit të Qendrushëm



Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj

Shumë faktorë ndikojnë në kushtet e jetesës dhe mirëqenien personale. Disa nga më themelore janë të jemi në gjendje të mbijetojmë dhe të kemi një çati mbi kokë për të na mbajtur ngrohtë.



Shëndet i mirë dhe mirëqenia

4 QUALITY
EDUCATION



Edukim Cilësor

Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të barabartë dhe promovimi i mundësive të të nxëniet gjatë gjithë jetës për të gjithë

5 GENDER
EQUALITY



Të arrihet barazia gjinore dhe të fuqizohen të gjitha gratë dhe vajzat

6 CLEAN WATER
AND SANITATION



Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimi i qëndrueshëm i ujit dhe shërbimeve sanitare për të gjithë

8 DECENT WORK AND
ECONOMIC GROWTH



Nxitja e rritjes ekonomike të vazhdueshme, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, punësim të plotë dhe produktiv dhe punë të denjë për të gjithë

9 INDUSTRY, INNOVATION
AND INFRASTRUCTURE



Ndërtimi një infrastrukture të fortë, nxitja e industrializimit gjithëpërfshirës e të qëndrueshëm dhe nxitja e novacionit

10 REDUCED
INEQUALITIES



Reduktimi i pabarazisë ndërmjet shteteve

11 SUSTAINABLE CITIES
AND COMMUNITIES



Bëni qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike (fleksibël) dhe të qëndrueshme

12 RESPONSIBLE
CONSUMPTION
AND PRODUCTION



Sigurooni modele të qëndrueshëm të konsumit dhe prodhimit

16 PEACE, JUSTICE
AND STRONG
INSTITUTIONS



Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet



Figura 40. Paraqitja grafike e monitorimeve/inspektimeve/verifikimeve të realizuara nga seksioni i veçantë gjatë vitit 2021.



Figura 41. Paraqitja grafike e monitorimeve/inspektimeve/verifikimeve të realizuara nga seksioni i MKPT-së gjatë vitit 2021.




Figura 42. Paraqitja grafike e monitorimeve/inspektimeve/verifikimeve të realizuara nga seksioni i fëmijëve gjatë vititi 2021.




Figura 43. Paraqitja grafike e monitorimeve/inspektimeve të realizuara nga seksioni i përgjithshëm gjatë vititi 2021.




Figura 44. Paraqitja grafike e monitorimeve/inspektimeve të realizuara nga seksioni i administratës gjatë vititi 2021.




Figura 45. Paraqitja grafike e kontributeve dhe botimeve të institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vititi 2021.

Gjatë vitit 2021 pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë regjistruar gjithsej 52 kërkesa për informacion, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Të gjitha kërkesat janë pranuar dhe u është kthyer përgjigje sipas objektit, duke u siguruar për kufizimin e të dhënave personale sipas legjislacionit në fuqi. Koha mesatare e kthimit të përgjigjeve të kërkesave për informacion është 6 ditë kalendarike.

Nga totali i kërkesave për informacion të regjistruara gjatë vitit 2021, rezulton se 32 prej tyre janë adresuar nga qytetarët, 4 prej tyre nga zyra të avokatisë, 10 nga organizata të shoqërisë civile dhe 6 nga media. Prej totalit të 52 kërkesave, 32 prej tyre kanë pasur për objekt kërkesë për kopje dokumentacioni, 16 prej tyre kërkesë për informacion dhe 4 kërkesa për informacion dhe dokumentacion.

Ecuria e numrit të kërkesave për informacion të regjistruara dhe të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit ndër vite, prej vitit 2016 paraqitet si më poshtë vijon:



Figura 46. Paraqitja grafike e ecurisë së kërkesave për informacion ndër vite.

Tabela pasqyruese e shërbimit mjekësor në burgje sipas të dhënave të mbledhura gjatë inspektimeve të realizuara nga MKPT për vitin 2021

Nr.	Institucioni	Mjek			Infermier			Kapaciteti zyrtar i nr. te te burgosurve ne IEVP
		Organika Mjek	Fakti	Mungesa Mjek [1]	Organika Stafi Infermier	Fakti	Mungesa Infermier	
1	Jordan Misja 313	2	2 mjek me kohe te plote -	Nuk ka	9	8	1	320
2	Mine Peza 302	2	2 mjek me kohe te plote -	Nuk ka	6	6	0	170
3	IEVP Durrës	5	4 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	11	11	0	300
4	IEVP Krujë	6	4 mjek me kohe te plote 2 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te plote (ose 2 mjek me kohe te	12	12	0	196
5	IEVP Fier	4	2 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme dhe 1 mjek	12	10	2	870
6	IEVP Kosovë, Lushnjë	2	1 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	5	5	0	189
7	IEVP Vlorë	2	Nuk ka mjek me kohe te plote 2 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te plote (ose 2 mjek me kohe te	6	6	0	115
8	IEVP Reç, Shkodër	4	1 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme dhe 2 mjek	11	9	2	775
9	IEVP Tepelenë	2	1 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	5	5	0	70
10	IEVP Drenovë	3	3 mjek me kohe te plote	Nuk ka	7	4	3	312
11	IEVP Elbasan	2	1 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	5	5	0	140
12	IEVP 325 Burgu i Grave	2	2 mjek me kohe te plote	Nuk ka	5	5	0	80
13	IEVP Burrel	2	1 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	5	5	0	198
14	IEVP Sarandë	1	Nuk ka mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	4	3	1	31
15	IEVP Peqin	4	3 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	10	9	1	685
16	IEVP Fushë Krujë	3	1 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme dhe 1 mjek	6	6	0	312
17	IEVP Rrogozhinë	3	3 mjek me kohe te plote	Nuk ka	6	6	0	343
18	IEVP Lezhë	3	1 mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme dhe 1 mjek	9	9	0	100
19	IEVP Berat	3	Nuk ka mjek me kohe te plote 2 mjek me kohe te pjesshme	2 mjek me kohe te plote	5	5	0	37
20	IEVP Kukës	1	Nuk ka mjek me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	0	-	-	36
21	IEVP Kavajë	2	1 me kohe te plote 1 mjek me kohe te pjesshme	1 mjek me kohe te pjesshme	5	5	0	40
	Totali	58	33 mjek me kohe te plote 19 mjek me kohe te pjesshme	16 mjek me kohe te plote	144	134	10	5592

[1]Për qëllim të dhënies së shërbimit 1 mjek me kohë të plotë mund të zëvendësohet me 2 mjek me kohë të pjesshme.

Për 21 IEVP të inspektuara nga MKPT për vitin 2021, rezulton se organikat e këtyre institucioneve kanë në total 58 mjek të miratuar, nga të cilët :

- 33 prej tyre janë të punësuar me kohë të plotë;
- 19 prej tyre janë të punësuar me kohë të pjesshme.

Mungesa e mjekëve në total në të gjithë Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale, është gjithsej **16 mjekë me kohë të plotë**. Kjo është përlogaritur duke marrë në konsideratë edhe faktin se në një pjesë të madhe të IEVP një pjesë e shërbimit mjekësor mbulohet nga mjeket me kohë të pjesshme.

Tabela me të dhënat për mbipopullimin dhe shtretërit e lirë në IEVP

NR.	Institucioni	Kapaciteti zyrtar në website-in e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	Kapaciteti fakt	Popullimi në I.E.V.P në muaj të ndryshëm	Mesatarja e popullimit për muajt përkatës	Mbipopullimi/ Shtretër bosh (e llogaritur duke marrë si referencë muajin dhjetor dhe kapacitetin zyrtar)
1	IEVP Fier	870	860	Korrik 697	750 të burgosur	187 shtretër bosh
				Gusht 756		
				Shtator 775		
				Tëtor 824		
				Nëntor 824		
				Qershor 694		
				Dhjetor 683		
2	IEVP-së Kosovë, Lushnjë	189	182	Qershor 93	122 të burgosur	66 shtretër bosh
				Korrik 92		
				Gusht 92		
				Shtator 129		
				Tëtor 156		
				Nëntor 166		
				Dhjetor 123		
3	IEVP Kukës	36	34	Qershor 46	34 të burgosur	8 shtretër bosh
				Korrik 40		
				Gusht 37		
				Shtator 31		
				Tëtor 27		
				Nëntor 27		
				Dhjetor 28		

4	IEVP Vlorë	115	168	Maj 166	181 të burgosur	55 persona mbi popullim
				Qeshor 169		
				Korrik 184		
				Gusht 202		
				Shtator 206		
				Tëtor 177		
				Nëntor 175		
				Dhjetor 170		
5	IEVP Reç, Shkodër	775	813	Prill 471	471 të burgosur	296 shtretër bosh
				Maj 456		
				Qershor 457		
				Korrik 455		
				Gusht 471		
				Shtator 508		
				Dhjetor 479		
6	IEVP Tëpelenë	70	75	Shkurt 91	94 të burgosur	19 persona mbi popullim
				Mars 93		
				Prill 93		
				Maj 94		
				Qershor 100		
				Korrik 98		
				Dhjetor 89		
7	IEVP Drenovë	312	382	Janar 464	466 të burgosur	152 persona mbi popullim
				Shkurt 469		
				Mars 469		
				Prill 471		
				Maj 460		
				Qershor 464		

				Korrik 464		
				Dhjetor 464		
8	IEVP Elbasan	120	140	Mars 158	186 të burgosur	43 persona mbi popullim
				Prill 160		
				Maj 157		
				Qershor 160		
				Korrik 163		
				Gusht 170		
				Dhjetor 163		
9	IEVP Durrës	300	299	Janar 261	271 të burgosur	39 shtretër bosh
				Shkurt 258		
				Mars 255		
				Prill 259		
				Maj 256		
				Qershor 265		
				Korrik 277		
				Gusht 311		
				Shtator 318		
				Dhjetor 261		
10	IEVP Burrel	198	196	Shkurt 158	157 të burgosur	38 shtretër bosh
				Mars 150		
				Prill 150		
				Maj 165		
				Qershor 164		
				Korrik 155		
				Dhjetor 159		
11	IEVP Sarandë	31	36	Janar 35	37 të burgosur	4 persona mbi popullim
				Shkurt 35		

				Mars 37		
				Prill 37		
				Maj 40		
				Qershor 38		
				Dhjetor 35		
12	IEVP Peqin	685	550	Janar 414	411 të burgosur	271 shtretër bosh
				Shkurt 414		
				Mars 401		
				Prill 413		
				Maj 414		
				Qershor 409		
				Dhjetor 414		
13	IEVP Minë Peza	170	170	Janar 162	198 të burgosur	8 shtretër bosh
				Shkurt 167		
				Mars 161		
				Prill 161		
				Maj 158		
				Dhjetor 162		
14	IEVP Fush Krujë	312	312	Janar 367	375 të burgosur	61 persona mbi popullim
				Shkurt 375		
				Mars 382		
				Prill 381		
				Nëntor 373		
				Dhjetor 373		
15	IEVP Rrogozhinë	343	338	Janar 241	248 të burgosur	3 shtretër bosh
				Gusht 259		
				Nëntor 244		
				Tëtor 255		

				Shtator 249		
				Dhjetor 240		
16	IEVP Lezhë	700	105	Prill 80	107 të burgosur	563 shtretër bosh
				Maj 96		
				Qershor 99		
				Korrik 94		
				Gusht 116		
				Shtator 124		
				Dhjetor 137		
17	Jordan Misja 313 Tiranë	320	468	Janar 391	403 të burgosur	69 persona mbi popullim
				Shkurt 406		
				Mars 406		
				Prill 407		
				Nëntor 418		
				Dhjetor 389		
18	Ali Demi (Gra)	80	114	Qershor 60	71 të burgosur	22 shtretër bosh
				Muaji Korrik 71		
				Gusht 77		
				Shtator 75		
				Tëtor 77		
				Nëntor 76		
				Dhjetor 58		
19	IEVP Berat	37	112	Janar 127	136 të burgosur	90 persona mbi popullim
				Shkurt 138		
				Mars 139		
				Prill 141		
				Maj 142		

				Qershor 141		
				Dhjetor 127		
20	IEVP Krujë (Zaharia)	196	308	Nëntor 308	E mbyllur	
				Dhjetor 0		
21	IEVP Kavajë	40	40	Korrik 24	20 të burgosur	13 shtretër bosh
				Gusht 20		
				Shtator 20		
				Tëtor 19		
				Djetor 17		
22	Spitali i burgut	99	100	-	E ndryshueshme	
23	IEVP Tropoje	25	26	Korrik 20	22 të burgosur	1 person mbi popullim
				Gusht 20		
				Shtator 22		
				Tëtor 20		
				Nëntor 22		
				Dhjetor 26		
24	IEVP Vaqar	146		-	E mbyllur	

Totali		5728 shtretër sipas faqes zyrtare	5238 shtretër faktik		4762 - numri mesatar i të burgosurve	494 persona mbi popullim per IEVP të caktuara (bazuar në të dhenat e muajit dhjetor dhe kapacitetit të publikuar në faqen zyrtare të Ministrise se Drejtësisë) si dhe 1514 shtretër të lire.
--------	--	---	-----------------------------------	--	---	---

- Për IEVP të cilat janë të mbyllura, nuk janë llogaritur numri i kapaciteteve. Gjithashtu për spitalin e burgjeve, numri nuk mund të përlllogaritet pasi është një e dhënë e ndryshueshme në mënyrë periodike.

Mbipopullimi në IEVP me %

Institucionet e Ekzekutimit të Veprave Penale	Kapaciteti zyrtar	Numri i personave të burgosur në muajin dhjetor	% e mbipopullimit për muajin dhjetor
IEVP Vlorë	115	170	48%
IEVP Tepelenë	70	89	27%
IEVP Drenovë	312	464	49%
IEVP Elbasan	120	163	36%
IEVP Sarandë	31	35	13%
IEVP Fush Krujë	312	373	20%
Jordan Misja 313 Tiranë	320	389	22%
IEVP Berat	37	127	243%
IEVP Tropoje	25	26	4%